



PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

Akte Ligjore dhe Nënligjore të Administratës Doganore

1999 - 2012

VELLIMI I

Ideuar, përpunuar, redaktuar dhe përgatitur për botim nga:

Ervina Domi

Borana Ajazi

Drejtoria Juridike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave

Në hartimin e kësaj Përmbledhje Legjislacioni kanë kontribuar gjithashtu i gjithë stafi i Sektorit të legjislacionit dhe përafrimit me BE-në në Drejtorinë Juridike në DPD si dhe të gjitha strukturat e tjera me të cilat jemi konsultuar gjatë procesit të hartimit të kësaj Përmbledhje Legjislacioni.

Të nderuar lexues

Ndër vite Administrata Doganore Shqiptare e ka ndjerë nevojën e një përmbledhjeje zyrtare të akteve ligjore dhe nënligjore të të gjitha niveleve. Adaptimi e ratifikimi i akteve të ndryshme ndërkombetare, miratimi i ligjit 8449, datë 27.01.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe i VKM nr. 205, datë 13.04.1999, “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i hapi rrugë padyshim zhvillimeve dhe vizioneve të reja në Administratën Doganore Shqiptare. Për këtë qëllim ndër vite kjo administratë e ka pasuruar fondin e saj të akteve nënligjore me akte të ndryshme të të gjitha niveleve.

Zhvillimet integruese apo dokumentet strategjike të Qeverisë Shqiptare, gjithashtu janë pasuar me një sërë iniciativash ligjore e nënligjore të cilat në thelb kanë patur dhe kanë për qëllim, harmonizimin dhe përditësimin e procedurave doganore me atë të vendeve të BE-së, adaptimin e praktikave me të mira, krijimin e lehtësirave për biznesin dhe uljen e barrierave ndaj tij, mundësimin e përmbushjes së misioneve të rëndësishme të Administratës Doganore ku padyshim theksin ashtu si edhe vetë vendet e BE-së e kemi vendosur në sigurinë kombëtare, në mbrojtjen e kufijve, sigurinë shëndetin dhe konsumatorin, pronësisë intelektuale, lirisë së lëvizjes etj.

Tërësia e këtyre akteve të shumtë në vite në mungesë të një përmbledhjeje të tyre e bënte të vështirë përdorimin dhe zbatimin e tyre në praktikë. Për këtë qëllim Administrata Doganore, përmes Drejtorisë Juridike ndërmori këtë iniciativë vërtetë ambicioze për të mundur këtë përmbledhje të Legjislacionit të Administratës Doganore.

Kërkuam të jemi ambicioz në pretendimin tonë në lidhje me këtë Përmbledhje për shkak se ambiciet të drejtojnë drejt suksesit dhe mundësojnë realizimin e standarteve të larta. Kërkesat e larta dhe të papërmbushura janë në vetvete më të vlefshme sesa kërkesat e ulëta tërësisht të përmbushura (J. V. Gëtë).

Përmbledhja e Legjislacionit që po prezantojmë pranë Jush, përmbledh aktet më të rëndësishme mbi të cilat bazohet veprimtaria doganore pa pretenduar apo absolutizuar prezencën dhe përmbajtjen e të gjitha akteteve të të gjitha niveleve të miratuara ndër vite.

Kjo përmbledhje është hartuar mbi bazën e nivelit hierarkik të akteve sipas Kushtetutës së Shqipërisë, duke filluar me Konventat Ndërkombetare në fushën doganore ku vendi ynë ka aderuar, me Marrevëshjet Ndërkombëtare, Marrevëshjet Bilaterale, aktet ligjore me shumicë të cilësuar, ligjet e thjeshta dhe aktet nënligjore të nivelit të dytë dhe të tretë.

Ky padyshim është vetëm hapi i parë duke i lënë rrugë në këtë mënyrë përditësimeve dhe përmirësimeve të vazhdueshme të saj.

Flamur GJYMISHKA

Drejtor i Pergjithshem

Mbi mënyrën e përdorimit të Përmbledhjes së Legjislacionit.

Përmbledhja e legjislacionit është krijuar në një mënyrë të tillë që të krijojë lehtësira maksimale në përdorimin e saj. Ajo përbëhet nga 5 volume të renditur e numra nga 1-5. Secili volum në fillimin e tij ka një pasqyrë të lëndës, përmes së cilës lexuesi mund të orientohet lehtësisht për të kërkuar aktin që ai dëshiron.

Gjithashtu duke qënë së Përmbledhja është e ndarë në seksione sipas llojit të akteve apo sipas institutive të së drejtës doganore në fillim të çdo sesioni specifik për lehtësi do të gjeni edhe një pasqyrë të lëndës vetëm për aktet brenda atij seksioni.

Kjo Përmbledhje Legjislacioni gjithashtu do të jetë e adaptuar edhe në një program specifik të përgatitur për këtë qëllim nga Departamenti i IT në DPD, bazuar në kërkesat specifike të Drejtorisë Juridike për mënyrën e funksionimit të saj.

KONVENTAT

Faqe

1.	Ligj Nr. 8648, datë 28.07.2000	Për ratifikimin e Protokollit të anëtaresimit të Republikës së Shqipërisë në “Marrevëshjen e Marakeshit, që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë”.	1
2.	Ligj Nr. 8759, datë 26.03.2001	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare, “Për asistencë të ndërsjelltë administrative për parandalimin, hetimin dhe goditjen e shkeljeve doganore”, Nairobi.	3
3.	Ligj Nr.8754, datë 26.03.2001	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për harmonizimin e rregullave për kontrollin kufitar të mallrave".	23
4.	Ligj Nr. 9316, datë 18.11.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare "Për asistencë të ndërsjelltë administrative në çështjet doganore", Johannesburg.	41
5.	Ligj Nr. 9404, datë 19.05.2005	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, për parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet komunitare".	63
6.	Ligj Nr. 9503, datë 26.03.2006	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për kontratën e transportit rrugor ndërkombëtar të mallrave (CMR) dhe Protokollin e nënshkrimit”.	69
7.	Ligj Nr. 9926, datë 09.06.2008	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për taksimin e automjeteve rrugore për përdorim privat në Trafikun ndërkombëtar dhe në Protokollin e nënshkrimit”.	86
8.	Ligj Nr. 10 077, datë 16.02.2009	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën “Për Lejimin e Përkohshëm, bërë në Stamboll me 26 Qershor 1990”.	92
9.	Ligj Nr.37/2012,datë 05.04.2012	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare “Për thjeshtimin dhe harmonizimin e procedurave doganore”, Kyoto, 18 Maj 1973”, e ndryshuar.	136
10.	Ligj Nr.35/2012, datë 29.03.2012	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare “Për sistemin e harmonizuar të kodifikimit dhe përshkrimit të mallrave”.	158
11.		Konventa TIR, 1975 (Version Anglisht)	547



LIGJ

Nr.8648, date 28.07.2000

PER RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT TE ANETARESIMIT TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE "MARREVESHJEN E MARAKESHIT, QE THEMELOI ORGANIZATEN BOTERORE TE TREGTISE"

Ne mbeshtetje te neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Protokolli i anetaresimit te Republikes se Shqiperise ne "Marreveshjen e Marrakeshit, qe themeloi Organizaten Boterore te Tregtise"", sipas materialeve perberese si me poshte:

1. Raporti i Grupit te Punes per anetaresimin ne OBT.
2. Skeduli koncesioneve dhe angazhimeve ne mallra.
3. Skeduli i angazhimeve specifike ne sherbime.

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Skender Gjinushi

Shpallur me dekretin nr.2719, date 3.8.2000 te Presidentit te Republikes se Shqiperise Rexhep Mediani

**PROTOKOLL I ANETARESIMIT TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE
MARREVESHJEN E MARAKESHIT QE THEMELOI ORGANIZATEN
BOTERORE TE TREGTISE**

Organizata Boterore e Tregtise (e quajtur ketej e tutje "OBT") ne vijim te miratimit te Keshillit te Pergjithshem te OBT-se i marre ne baze te Nenit XII te Marreveshjes se Marrakeshit, qe themeloi Organizaten Boterore te Tregtise (e quajtur ketej e tutje "Marreveshja e OBT-se) dhe Republika e Shqiperise (e quajtur ketej e tutje "Shqiperia"),

Duke u bazuar ne Raportin e Grupit te Punes per Anetaresimin e Shqiperise ne OBT ne dokumentin WT/ACC/ALB/SPEC/6/Rev.4 (i quajtur ketej e tutje "Raporti i Grupit te Punes"),

Duke pasur parasysh rezultatet e negociatave per anetaresimin e Shqiperise ne OBT,

Bien dakord si me poshte:

PJESA I Te pergjithshme

1. Me hyrjen ne fuqi te ketij Protokolli, Shqiperia pranohet ne Marreveshjen e OBT-se sipas Nenit XII te kesaj Marreveshjeje dhe, ne kete menyre, behet anetare e OBT-se.
2. Marreveshja e OBT-se ne te cilen pranohet Shqiperia do te jete Marreveshja e OBT-se e korrigjuar, e permiresuar ose e modifikuar nga instrumente ligjore te tilla qe mund te kene hyre ne fuqi perpara dates se hyrjes ne fuqi te ketij Protokolli. Ky Protokoll, i cili do te perfshije angazhimet e permendura ne paragrafin 167 te Raportit te Grupit te Punes, do te jene pjese perberese e Marreveshjes se OBT-se.
3. Pervec rasteve te parashikuara ndryshe ne paragrafet e permendur, ne paragrafin 167 te Raportit te Grupit te Punes, obligimet ne Marreveshjet Tregtare Multilaterale qe i jane aneksuar Marreveshjes se OBT-se dhe qe duhen implementuar per nje periudhe kohe qe fillon me hyrjen ne fuqi te kesaj Marreveshjeje, do te zbatohen nga Shqiperia ne ate menyre qe ajo do ta kishte pranuar kete Marreveshje ne daten e hyrjes se saj ne fuqi.
4. Shqiperia mund te ruaje ndonje mase qe nuk pajtohet me paragrafin 1 te nenit II te Marreveshjes se Pergjithshme te Tregtise ne Sherbime (GATS), me kusht qe kjo mase te jete regjistruar ne listen e Perjashtimeve nga Neni II, qe i eshte aneksuar ketij Protokolli dhe qe ploteson kushtet e Aneksit te GATS-it per Perjashtimet nga Neni II.

PJESA II Skedulet

5. Skedulet qe i jane aneksuar ketij Protokolli do te quhen Skeduli i Koncesioneve dhe i Angazhimeve qe i eshte aneksuar Marreveshjes se Pergjithshme Per Tarifat dhe Tregtine 1994 (e quajtur ketej e tutje "GATT 1994") dhe Skeduli i Angazhimeve Specifike qe i eshte aneksuar Marreveshjes se Pergjithshme Per Tregtine ne Sherbime (e quajtur ketej e tutje "GATS") qe kane te bejne me Shqiperine. Afati i koncesioneve dhe i angazhimeve te renditura ne Skedulet do te zbatohet siç eshte percaktuar ne pjeset perkatese te Skeduleve respektive.
6. Per qellime reference lidhur me daten e kesaj Marreveshjeje, permendur ne paragrafin 6(a) te Nenit II te GATT-it 1994, data e zbatimit ne lidhje me Skedulet e Koncesioneve dhe te Angazhimeve qe i jane aneksuar ketij Protokolli, do te jete data e hyrjes ne fuqi e ketij Protokolli.

PJESA III Dispozita Perfundimtare

7. Ky Protokoll do te jete i hapur per pranim nga Shqiperia deri me 31 dhjetor 2000, nepermjet nenshkrimit ose ndonje menyre tjeter.
8. Ky Protokoll do te hyje ne fuqi ne ditën e tridhjetë qe pason ditën e pranimit te tij.
9. Ky Protokoll do te depozitohet tek Drejtori i Pergjithshem i OBT-se. Drejtori i Pergjithshem i OBT-se do t'i jape menjehere çdo anetari te OBT-se dhe Shqiperise nje kopje te vertetuar te ketij Protokolli dhe nje njoftim lidhur me pranimin ne vijim te paragrafit 7.
10. Ky Protokoll do te regjistrohet ne perputhje me dispozitat e Nenit 102 te Kartes se Kombeve te Bashkuara.

Bere ne Gjeneve ditën e shtatëmbëdhjetë të muajit korrik të vitit dy mijë, në një kopje të vetme në gjuhën angleze, franceze dhe spanjolle, duke qenë secili tekst autentik, përveç faktit që ndonjë Skedul i aneksuar mund të specifikojë që është autentik në një ose më shumë prej këtyre gjuhëve.



LIGJ
Nr. 8759, date 26.03.2001

**PER ADERIMIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE "KONVENTEN
NDERKOMBETARE PER ASISTENCE TE NDERSJELLE ADMINISTRATIVE PER
PARANDALIMIN, HETIMIN DHE GODITJEN E SHKELJEVE DOGANORE",
Nairobi.**

Ne mbeshtetje te neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI :

Neni 1

Republika e Shqiperise aderon ne "Konventen Nderkombetare per asistence te ndersjelle administrative per parandalimin, hetimin dhe goditjen e shkeljeve doganore".

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2960, date 6.4.2001 te Presidentit te Republikes se Shqiperise Rexhep Meidani

**KONVENTA NDERKOMBETARE MBI ASISTENCEN RECIPROKE
ADMINISTRATIVE PER PARANDALIMIN, HETIMIN DHE GODITJEN E
SHKELJEVE DOGANORE ,**

(NAIROBI, 9 QERSHOR 1977)

Hyrje

PALET KONTRAKTUESE ne Konventen ne fjale, themeluar nen mbikeqyrjen e Keshillit te Kooperimit Doganor,

Duke marre parasysh qe shkeljet ndaj Ligjit Doganor jane te demshme per interesat ekonomike, sociale dhe fiskale te Shteteve dhe interesave legitime te tregtise, Duke marre parasysh se aksionet ndaj shkeljeve doganore mund te kryhen me efektivisht nepermjet kooperimit ndermjet Administratave Doganore, dhe se ky kooperim eshte nje nga qellimet e Konventes duke themeluar nje Keshill Kooperimi Doganor,

Kane rene dakord si me poshte:

KREU I

Perkufizime

Neni 1

Per qellimet e kesaj Konvente:

- (a) termi "Ligj Doganor" do te there gjithë dispozitat statusore ose rregullatore qe jane ne fuqi ose administrohen nga Administrata Doganore lidhur me importimin, eksportimin ose transitin e mallrave;
- (b) termi "Shkelje Doganore " do te thote çdo thyerje ose perpjekje per thyerje te ligjeve doganore;
- (c) termi "Mashttrim Doganor" do te thote; nje shkelje doganore nga e cila nje person mashtron doganat dhe ne kete menyre i shmanget pjeserisht ose teresisht pagesave te detyrimeve dhe taksave te importit ose eksportit ose zbatimit te kufizimeve dhe ndalimeve te parashtruara ne Kodin Doganor ose perfiton ndonje avantazh ne kundershtrim me ligjin Doganor;
- (d) termi "kontrabande" do te thote mashtrimi doganor qe konsiston ne levizjen e mallrave permes nje kufiri Doganor ne nje menyre klandestine;
- (e) termi "detyrime dhe taksa doganore" do te thote detyrime Doganore dhe detyrime te tjera, taksa, kuota ose pagesa te tjera te cilat mblidhen gjate ose ne lidhje me importin ose eksportin e mallrave, por pa perfshire kuotat ose pagesat e tjera te cilat jane te kufizuara me shume, afersisht me koston e sherbimeve te tjera;
- (f) termi "person" do te thote si personat fizike ashtu dhe ata juridike, ne rastet kur konteksti nuk kerkon diçka tjeter;
- (g) termi "Keshill" do te thote organizata e ngritur nga konventa e cila themelon nje "Keshill te Kooperimit Doganor", kryer ne Bruksel me 15 dhjetor 1950;
- (h) termi "Komiteti Teknik Permanent" do te thote Komiteti Teknik Permanent i Keshillit;
- (i) termi "ratifikim" do te thote ratifikim, pranim ose aprovim.

KREU II

Neni 2

Fusha e veprimit te Konventes

1. Palet Kontraktuese te lidhura nga nje ose me teper Anekse te kesaj Konvente bien dakord se Administratat e tyre Doganore do te perballojne asistence reciproke ndaj njera-tjetres me synim parandalimin, hetimin dhe goditjen e shkeljeve doganore, ne perputhje me dispozitat e kesaj Konvente.
2. Administrata Doganore e nje Pale Kontraktuese mund te kerkoje asistence te ndersjelle siç parashikohet ne paragrafin 1 te ketij Neni gjate çdo lloj investigimi ose ne lidhje me ndjekjet penale ose administrative qe ndermerren nga nje Pale Kontraktuese. Nese Administrata Doganore nuk e kryen vete kete ndjekje, ajo mund te kerkoje asistence te ndersjelle vetem brenda limiteve te kompetences se vet ne kete proces. Ne menyre te ngjashme, nese ndjekja kryhet ne vendin e administrates qe i kerkohet asistence, kjo e fundit jep asistencen e kerkuar brenda limiteve te kompetencave te veta ne kete proces.
3. Asistenca e ndersjelle siç pershkruhet ne paragrafin 1 te ketij Neni nuk do te zgjerohet ne kerkesa per arrestimin e personit ose grumbullimin e detyrimeve, taksave, pagesave, gjobave ose parave te tjera ne interes te Pales Kontraktuese.

Neni 3

Nese njera Pale Kontraktuese konsideron se asistenca e kerkuar bie ne kundershtim me sovranitetin, sigurine ose interesa te tjera themelore kombetare ose demton interesat legjitime komerciale te ndonje kompanie, publike ose private, ajo mund te mohoje dhenien e kesaj asistence ose ta jape sipas disa kushteve ose kerkesave te percaktuara.

Neni 4

Nese Administrata Doganore e nje Pale Kontraktuese kerkon asistencë e cila ne vetvete nuk do te ishte ne gjendje ta jepte kete asistencë nese do t'i kerkohej nga nje Pale Kontraktuese, duhet ta theksoje kete ne kerkesen e vet. Pergjigjja per kete kerkese do te varet nga konsiderata e Pales se Kerkuar Kontraktuese.

KREU III

Neni 5

Procedura e asistences se pergjithshme

1. Çdo inteligjence, dokument ose informacione te tjera te komunikuar ose te perfituara ne kete Konvente:
 - (a) do te perdoret vetem per qellimet e specifikuar ne kete Konvente, duke perfshire perdorimin ne procedimet penale ose administrative, dhe varur nga kushtet e vena nga Administrata Doganore e cila i ka derguar; dhe
 - (b) do te kete ne vendin marres te njejten mbrojtje lidhur me konfidencialitetin dhe sekretin zyrtar; siç aplikohet ne ate vend per te njejtat lloje dokumentesh, inteligjence dhe informacione te tjera te perfituara ne territorin e vet.
2. Kjo lloj inteligjence, dokumenti ose informacioni mund te perdoret per qellime te tjera vetem me aprovimin e shkruar te Administrates Doganore qe i ka dhene dhe e kushtezuar nga kufizimet e percaktuara nga ajo administrate, si dhe nga dispozitat e paragrafit 1 (b) te ketij

Neni 6

1. Komunikimi mes Paleve Kontraktuese dhene nga kjo Konvente do te kryhet direkt ndermjet Administratave Doganore. Administratat Doganore te Paleve Kontraktuese do te emerojne sherbimet ose nepunesit per keto nderlidhje dhe do te informojne Sekretarin e Pergjithshem te Keshillit per emrat dhe Adresat e ketyre Sherbimeve ose Personave. Sekretari i Pergjithshem do t'ua komunikojte kete informacion Paleve te tjera Kontraktuese.
2. Administrata Doganore e Pales se Kerkuar Kontraktuese, kushtezuar nga rregullat dhe ligjet ne fuqi ne territorin e vet, do te marre te gjitha masat e nevojshme per t'iu pergjigjur kerkesave per asistencë.
3. Administrata Doganore e Pales se Kerkuar Doganore do t'i pergjigjet kerkeses per asistencë, sa me shpejt te jete e mundur.

Neni 7

1. Kerkesa per asistencë, sipas kesaj Konvente, duhet te kryhet normalisht me shkrim; kjo duhet te permbaje informacionin e kerkuar dhe te shoqerohet nga dokumente te tilla qe konsiderohen te dobishme.
2. Kerkesa me shkrim duhet te behet ne nje gjuhe te pranueshme nga Palet Kontraktuese te interesuara. Çdo lloj dokumenti shoqerues i kerkeses te perkthehet ne nje gjuhe reciprokisht te pranuar, nese eshte e nevojshme.
3. Palet Kontraktuese do te pranojne, ne çdo rast, kerkesat per asistencë dhe dokumentet shoqeruese ne anglisht dhe frengjisht, shoqeruar nga nje perkthim ne anglisht ose frengjisht.
4. Kur, per arsye urgjence te veçante, kerkesat per asistencë nuk jane bere me shkrim, Pala e Kerkuar Kontraktuese mund te kerkoje konfirmim me shkrim.

Neni 8

Çdo shpenzim që rrjedh nga kjo Konvente lidhur me eksperte ose deshmitare do të perballohet nga Pala që ben kërkesen. Palet Kontraktuese do të heqin dore nga çdo kërkesë për rimbursim ose çdo kosto tjetër që rrjedh nga zbatimi i kesaj Kontrate.

KREU IV

Neni 9

Dispozita të ndryshme

Keshilli dhe Administratat Doganore të Paleve Kontraktuese do të koordinojnë shërbimet lidhur me parandalimin, hetimin dhe ndalimin e shkeljeve doganore për të mirembajtur lidhje personale dhe direkte me synim nxitjen e synimeve të përgjithshme të kesaj Konvente.

Neni 10

Për qëllimet e kesaj Konvente çdo Aneks ose Anekse të pranuar nga Palet Kontraktuese do të konsiderohen pjesë integrale të kesaj Konvente, dhe në lidhje me ato Pale Kontraktuese, çdo referencë ndaj kesaj Konvente duhet të përmbajë dhe referencën ndaj Aneksit ose Anekseve.

Neni 11

Dispozitat e kesaj Konvente nuk do të shmangin aplikimin e çdo lloji marrëveshjeje tjetër të zgjeruar të ndërsjelle, që mund të kenë ose mund të lidhin në të ardhmen Palet Kontraktuese.

KREU V

Neni 12

Roli i Keshillit dhe Komiteti Teknik Permanent

1. Keshilli do të jetë përgjegjës për administrimin dhe zhvillimin e kesaj Konvente, në përputhje me dispozitat e kesaj Konvente.
2. Për këtë qëllim Komiteti Teknik Permanent, nën autoritetin e Keshillit dhe në përputhje të çdo udhezimi dhënë nga Keshilli, do të ketë këto funksione:
 - (a) T'i kalojë Keshillit propozime për ato amendamente të kesaj Konvente që mund të konsiderohen të nevojshme.
 - (b) Të furnizojë me opinione lidhur me interpretimin e dispozitave të Konventes.
 - (c) Të mirembajë marrëdhënie me organizatat e tjera ndërkombëtare të interesuara, dhe veçanërisht me organet kompetente të Kombeve të Bashkuara, me UNESCO-n dhe me Organizatën Nderkombëtare të Policisë Kriminale/Interpol, për sa i takon aksioneve kundër trafikut ilegal për lëndet narkotike dhe substancat psikotrope, dhe aksionet kundër trafikut ilegal për veprat e artit, antikitetet dhe pasuritë e tjera kulturore.
 - (d) Të kryejë çdo aksion me synim zgjerimin e synimeve të përgjithshme të Konventes dhe veçanërisht për të studiuar metoda të reja dhe procedura për të lehtësuar parandalimin, hetimin dhe ndalimin e shkeljeve doganore, për të organizuar takime etj.
 - (e) Të kryejë aksione të tilla të drejtuara nga Keshilli në lidhje me dispozitat e Konventes.

Neni 13

Për qëllime votimi në Keshill dhe në Komitetin Teknik Permanent, çdo Aneks do të merret si Konvente e veçantë.

KREU VI

Neni 14 Dispozita Finale

Çdo mosmarreveshje mes dy ose me teper Paleve Kontraktuese, lidhur me interpretimin ose zbatimin e kesaj Konvente, do te zgjidhet me negocime midis tyre.

Neni 15

1. Çdo shtet anetar i Keshillit dhe çdo shtet anetar i Kombeve te Bashkuara ose i agjencive te saj te specializuara mund te behet Pale Kontraktuese e kesaj Konvente (sipas amendamentit te Protokollit i cili hyri ne fuqi me 27 Korrik 1989):

(a) duke e nenshkruar ate pa rezerva ratifikimi;

(b) duke depozituar nje instrument te ratifikimit, pasi e ka nenshkruar ate ne baze te ratifikimit; ose

(c) duke hyre ne te.

2. Kjo Konvente do te jete e hapur deri me 30 Qershor 1978 per nenshkrim ne Drejtorine e Keshillit ne Bruksel nga shtetet e referuara ne paragrafin 1 te ketij Neni. Me pas do te jete e hapur per pranimin e tyre.

3. Çdo shtet i referuar ne Paragrafin 1 te kesaj Konvente duhet, ne kohen e ratifikimit, nenshkrimit ose hyrjes ne kete Konvente te specifikoje Aneksin ose Anekset qe ai pranon, duke qene e nevojshme te pranoje te pakten nje Aneks. Ne vazhdim, duhet te njoftoje Sekretarine e Pergjithshme te Keshillit se pranon nje ose me teper Anekse.

4. Instrumentet e ratifikimit ose pranimit duhet te depozitohen ne Sekretarine e Pergjithshme te Keshillit.

5. Doganat ose bashkimet ekonomike mundet, se bashku me Vendet e Tyre Anetare ose ne do kohe qe Vendet Anetare te tyre te jene bere Pale Kontraktuese ne kete Konvente, gjithashtu, te behen Pale Kontraktuese ne kete Konvente, ne perputhje me dispozitat e paragrafeve 1,2 dhe 3 te ketij Neni. Megjithate, keto Unione nuk do te kene te drejten per te votuar.

Neni 16

1. Kjo Konvente do te hyje ne fuqi tre muaj pasi pese nga shtetet e permendura ne paragrafin 1 te Nenit 15 ta kene nenshkruar Konventen pa rezerva ratifikimi ose te kene depozituar instrumentet e ratifikimit ose te hyrjes.

2. Per do Pale Kontraktuese e cila ka nenshkruar Konventen pa rezervime ose ratifikime, e ka ratifikuar ose ka hyre ne te pasi pese shtete kane ratifikuar ose hyre ne te pa rezerva ose ratifikim, ose kane depozituar instrumentet e ratifikimit ose te pranimit, kjo Konvente do te hyje ne fuqi tre muaj pasi Pala Kontraktuese ne fjale ta kete nenshkruarat pa rezerva ose ratifikime ose te kete depozituar instrumentet e veta te pranimit ose te ratifikimit.

3. Çdo aneks i kesaj Konvente do te hyje ne fuqi tre muaj pasi dy shtete te kene pranuar Aneksin. Per çdo Pale Kontraktuese e cila ne vazhdim pranon nje Aneks, pasi dy shtete ta kene pranuar ate, ky Aneks do te hyje ne fuqi tre muaj pasi Pala Kontraktuese ne fjale te kete njoftuar pranimin e ketij Aneksi. Asnje Aneks nuk do te hyje ne fuqi per nje Pale Kontraktuese perpara se Konventa te kete hyre ne fuqi ne ate Vend Kontraktues.

Neni 17

1. Çdo Shtet mundet, qe ne momentin e nenshkrimit te kesaj Konvente pa rezerva ose ratifikime ose pasi ka depozituar instrumentet e ratifikimit ose pranimit, ose ne çdo kohe pas kesaj te deklaroje nepermjet nje njoftimi tek Sekretari i Pergjithshem i Keshillit se kjo

Konvente do të zgjerohet në gjithë territorin ose një pjesë të territorit për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit ai Shtet është përgjegjës. Ky njoftim do të ketë efekt tre muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Sekretari i Përgjithshëm i Keshillit. Megjithatë, Konventa nuk do të aplikohet në territoret e përmendura në njoftim, përpara se Konventa të ketë hyrë në fuqi në shtetin në fjalë.

2. Çdo Shtet i cili ka bërë njoftim sipas paragrafit 1 të këtij Neni, duke e zgjeruar këtë Konventë në territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës, mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Keshillit, sipas procedurave të Nenit, 19 të kësaj Konvente, se territori në fjalë nuk do të vazhdojë të zbatohet me këtë Konventë.

Neni 18

Çdo Pale Kontraktuese do të konsiderohet se ka hyrë ose ka pranuar gjithë dispozitat e Konventës ose Anekset lidhur me të, përjashtuar rast kur në momentin e hyrjes në Konventë ose pranimit të veçantë të një Aneksi, ose në çdo kohë pas kësaj, ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Keshillit për çfarëdo rezerve lidhur me dispozitat të cilat nuk mund t'i aplikojë. Duhet të ndermarre ekzaminimin periodik të dispozitave për të cilat ka pasur rezervë dhe të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm, lidhur me anulimin e këtyre rezervave.

Neni 19

1. Kjo Konventë është e një kohezgjatjeje të pacaktuar, por çdo Pale Kontraktuese mund të largohet prej saj (denoncim) në çdo kohë pas datës së hyrjes në fuqi, sipas Nenit 16 me sipër.
2. Denoncimi duhet të njoftohet nëpërmjet një instrumenti të shkruar, depozituar tek Sekretari i Përgjithshëm i Keshillit.
3. Denoncimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas marrjes së dokumentit të denoncimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Keshillit.
4. Dispozitat e paragrafeve 2 dhe 3 të këtij Neni, gjithashtu do të aplikohen në respekt të Anekseve të kësaj Konvente, duke pasur mundësi që çdo Pale e cila ka hyrë në të, të ketë të drejtën në çdo datë pas hyrjes në fuqi, sipas Nenit 16 të kësaj Konvente, të distancohet nga pranimi i një ose më tepër Anekseve. Çdo Pale Kontraktuese, e cila ka deklaruar terheqjen nga pranimi i gjithë Anekseve, do të konsiderohet se ka denoncuar Konventën.
5. Çdo Pale Kontraktuese e cila denoncon Konventën ose terheq pranimin e një ose më tepër prej Anekseve, do të konsiderohet e lidhur me dispozitat e Nenit 5 të kësaj Konvente, për atë kohë sa ajo do të ketë në dispozicion çfarëdo informacioni, dokumenti ose informacioni tjetër të marrë nën këtë Konventë.

Neni 20

1. Keshilli mund të rekomandojë amendamente në këtë Konventë.
2. Teksti i çdo amendamenti të rekomanduar në mënyrë të tillë do t'i komunikohet, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Keshillit, gjithë Paleve Kontraktuese në këtë Konventë, Shteteve të tjera Nenshkruese dhe atyre Shteteve anetare të Keshillit që nuk janë Pale Kontraktuese në këtë Konventë.
3. Çdo amendament i propozuar dhe i komunikuar sipas paragrafit të mësipërm do të hyjë në fuqi në respekt të të gjitha Paleve Kontraktuese, tre muaj pas skadencës së periudhës prej dy vjetësh që ndjekin datën e komunikimit të amendamenteve të propozuara, kur gjatë periudhës në fjalë nuk i janë komunikuar kundërshtime për propozimet e paraqitura Sekretarit të Përgjithshëm të Keshillit nga ndonjë shtet, i cili është Pale Kontraktuese.
4. Nëse Sekretarit të Përgjithshëm të Keshillit i është komunikuar ndonjë kundërshtim për amendamentet e propozuara nga ndonjë Shtet që është Pale Kontraktuese përpara skadencës së periudhës prej dy vjetësh, specifikuar në paragrafin 3 të këtij Neni, amendamentet do të konsiderohen si të papranuara dhe nuk do të kenë efekt.

Neni 21

1. Çfaredo Pale Kontraktuese e cila ratifikon ose hyn ne kete Konvente do te konsiderohet se ka pranuar çdo amendament ne fjale i cili ka hyre ne fuqi ne daten e depozitimit te instrumenteve te vet te ratifikimit ose pranimimit.
2. Çdo Pale Kontraktuese, e cila pranon nje Aneks, do te konsiderohet se ka pranuar çdo amendament lidhur me kete Aneks i cili ka hyre ne fuqi ne daten ne te cilen ka njoftuar kete pranim tek Sekretari i Pergjithshem i Keshillit.

Neni 22

Sekretari i Pergjithshem i Keshillit do te njoftoje Palet Kontraktuese ne kete Konvente, Shtetet nenshkruese, Shtetet anetare te Keshillit te cilat nuk jane Pale Kontraktuese ne Konvente dhe Sekretarin e Pergjithshem te Kombeve te Bashkuara mbi:

- a) nenshkrimin, ratifikimin, pranimin dhe njoftimin sipas Nenit 15 te kesaj Konvente;
- b) daten e hyrjes ne fuqi te Konventes dhe te gjithe Anekseve, ne perputhje me Nenin 16;
- c) njoftimin e marre ne perputhje me Nenin 17;
- d) denoncimin, sipas Nenit 19;
- e) Çdo amendament qe konsiderohet te jete pranuar, ne perputhje me Nenin 20 dhe daten e hyrjes ne fuqi.

Neni 23

Pas hyrjes ne fuqi, kjo Konvente do te regjistrohet ne Sekretariatin e Kombeve te Bashkuara, ne perputhje me Nenin 102 te Kartes se Kombeve te Bashkuara.

Deshmitare per sa me siper, te nenshkruarit, te autorizuar, per kete, kane nenshkruar kete Konvente.

Kryer ne Najrobi, me 9 Qershor 1977, ne gjuhen angleze dhe frenge" duke qene te dyja tekstet barazisht autentike, ne nje origjinal te vetem i cili do te depozitohet tek Sekretari i Pergjithshem i cili do t'u transmetoje kopje te certifikuara gjithe Shteteve te permendura ne paragrafin 1 te Nenit 15 te kesaj Konvente.

ANEKSI I

Asistence nga nje Administrate Doganore, sipas iniciatives se vet

1. Administrata Doganore e nje Pale Kontraktuese, me iniciativen e vet, do t'i komunikojë Administrates Doganore te nje Pale Kontraktuese, e cila ka interes, çfaredolloj informacioni te nje natyre thelbesore, e cila eshte gjetur gjate aktivitetit te vet normal dhe qe jep shkaqe te mira per te besuar se ne territorin e nje pale Kontraktuese do te kryhet nje shkelje serioze doganore. Informacioni i cili do te komunikohet te permbaje, veçanerisht, levizjen e personave, mallrave dhe mjeteve te transportit.
2. Administrata Doganore e nje Pale Kontraktuese do t'i komunikojë kur e sheh te pershtatshme, sipas iniciatives se vet Administrates Doganore te Pales tjetere Kontraktuese dokumente, raporte, regjistrime evidencash ose kopje te certifikuara lidhur me te ne mbeshtetje te informacionit te transmetuar sipas paragrafit 1.

3. Administrata Doganore e nje Pale Kontraktuese, me iniciativen e vet do t'i komunikoj Administrates Doganore te nje Pale tjeter Kontraktuese e cila ka interes direkt, çdolloj informacioni i cili duket se eshte i nje interesi material per te, lidhur me shkeljet doganore, dhe, veçanerisht, lidhur me mjetet ose metodat e reja qe perdoren per te kryer keto lloj shkeljesh.

ANEKS II

Asistence, sipas kerkeses, lidhur me percaktimin e detyrimeve dhe taksave te importit ose eksportit

1. Sipas kerkeses se nje Administrate Doganore te nje Pale Kontraktuese e cila ka arsye te forta per te besuar se ne vendin e vet eshte kryer shkelje serioze doganore, Administrata Doganore e Pales Kontraktuese te ciles i eshte kerkuar asistence do te komunikoj gjithë informacionin i cili mund te ndihmoje per te siguruar percaktimin e sakte te detyrimeve dhe taksave te importit ose eksportit.

2. Nje Pale Kontraktuese do te konsiderohet se ka permbushur detyrimet lidhur me kete, nese p.sh. ka komunikuar, siç duhet ne pergjigje te nje kerkese informacionin e meposhtem ose dokumentet e nevojshme per te:

a) lidhur me vleren e mallrave per qellime doganore: faturat tregtare te paraqitura ne doganat e vendit te eksportit ose importit ose kopje te ketyre faturave, te certifikuara ose jo nga Dogana, siç mund ta kerkojne rrethanat, dokumentet qe tregojne çmimet momentale te importit ose eksportit, kopje te deklarates se vleres te kryer ne importimin ose eksportimin e mallrave, kataloget e tregut, listat e çmimeve, etj., te publikuara ne vendin e eksportit ose te importit;

b) lidhur me klasifikimin tarifor te mallrave, analizat e kryera nga sherbimet laboratorike per te vendosur klasifikimin tarifor te mallrave, perskrimin tarifor te deklaruar gjate importit ose eksportit;

c) lidhur me origjinen e mallrave, deklaraten e origjines kryer gjate eksportit, kur kerkohet nje deklarate e tille, statusin Doganor te mallrave ne vendin e eksportimit (transit doganor, magazine doganore, pranim i perkohshem, zone e lire, qarkullim i lire, eksport per rikthim, etj).

ANEKSI III

Asistence, sipas kerkeses, lidhur me kontrollat

Me kerkese te Administrates Doganore te nje Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e Pales tjeter Kontraktuese do ti komunikoj asaj Administrate Doganore informacion lidhur me çeshtjet e meposhtme:

a) Autenticitetin e dokumenteve zyrtare te prodhuar ne mbeshtetje te nje deklarate Doganore qe i eshte dhene Autoriteteve Doganore te Pales Kerkuese.

b) Nese mallrat e importuara ne territorin e Pales Kontraktuese Kerkuese jane eksportuar ne menyre te ligjshme nga territori i nje Pale tjeter Kontraktuese.

c) Nese mallrat e eksportuara nga territori i Pales Kerkuese Kontraktuese kane qene importuar ne menyre te ligjshme ne territorin e Pales Kontraktuese qe i kerkohet informacion.

ANEKS IV

Asistence, sipas kerkeses, lidhur me survejimet

Sipas kerkeses se Administrates Doganore te nje Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e nje Pale tjeter Kontraktuese, per aq sa i lejon kompetenca dhe mundesia, do te kryejeurvejim special per nje periudhe te caktuar kohe mbi:

a) levizjet, veçanerisht per hyrjet brenda dhe daljet jashte territorit te vet, per persona te veçante, per te cilen ka arsye te besohet se jane lidhur profesionalisht ape vazhdimisht me shkelje doganore ne territorin e Pales Kontraktuese Kerkuese;

b) levizjen e mallrave te veçanta te cilat jane raportuar nga Administrata Doganore e Pales Kontraktuese Kerkuese se shkaktojne rritje te Trafikut ilegal te importit ne drejtim ose nga territori i asaj Pale Kontraktuese;

c) vende te veçanta ku jane grumbulluar mallra, te cilat japin shkaqe per te arsyetuar se ato mallra do te perdoren per nje import te paligjshem ne territorin e Pales Kontraktuese Kerkuese

d) mjete levizese te veçanta, anije, avione ose mjete te tjera transporti per te cilat besohet me arsye se mund te perdoren per te kryer nje shkelje doganore ne territorin e Pales Kontraktuese Kerkuese; dhe do t'i dergoje nje raport per keto Administrates Doganore te Pales Kontraktuese Kerkuese.

ANEKS V

Kerkime dhe njoftime, sipas kerkeses, per interes te Pales tjeter Kontraktuese

1. Sipas kerkeses se Administrates Doganore te nje Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e Pales tjeter Kontraktuese, kushtezuar nga Ligjet dhe rregullat ne fuqi ne territorin e vet, do te beje kerkime per te marre te dhenat lidhur me nje shkelje Doganore nen hetim ne territorin e Pales Kerkuese Kontraktuese, dhe do te marre deklarata nga çdo person i konsideruar i lidhur me kete shkelje ose nga deshmitare ose eksperte, dhe do t'ua dergoje rezultatet e kerkimeve, si dhe dokumente ose evidenca te tjera, Administrates Doganore te Pales Kerkuese Kontraktuese.

2. Sipas kerkeses me shkrim te Administrates Doganore te nje Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e nje Pale tjeter Kontraktuese, kushtezuar nga Ligjet dhe rregullat ne fuqi ne territorin e vet, do te njoftoje personal qe lidhen me tete, dhe qe jane rezidente ne territorin e vet ose do t'i kete njoftuar nepermjet autoriteteve kompetente per çfaredolloj aksioni ose vendimi te marre nga Pala Kontraktuese Kerkuese, lidhur me çfaredolloj çeshtje qe ndodhet brenda fushes se veprimiteve te kesaj Konvente.

ANEKS VI

Paraqitja perpara gjyqit ose Tribunaleve jashte shtetit e zyrtareve te Doganes

Kur nuk mjafton qe evidenca te dergohet vetem ne formen e nje deklarate me shkrim, sipas kerkeses se Administrates Doganore te nje Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e Pales tjeter Kontraktuese, per aq sa i lejon mundesia, do te autorizojte nepunesit e vet te paraqiten perpara gjyqit ose Tribunaleve ne territorin e Pales Kontraktuese Kerkuese si deshmitare ose eksperte ne nje çeshtje te shkeljeve doganore. Kerkesa per paraqitje do te specifikojte, se veçanerisht ne çfare çeshtje dhe ne çfare pozicioni do te degjohet ky nepunes. Administrata Doganore e Pales Kontraktuese qe pranon kerkesen, do te deklaroje, ne autorizimin e paraqitjes, çfaredo limiti ne te cilat nepunesit e vet do te detyrohen te japin evidencat.

ANEKS VII

Prezenca e Zyrtaresve te Doganes se nje Pale Kontraktuese ne territorin e nje Pale tjeter Kontraktuese

1. Sipas kerkeses me shkrim te Administrates Doganore te nje Pale Kontraktuese qe po investigon per nje shkelje te caktuar doganore, Administrata Doganore e nje Pale tjeter Doganore, kur e sheh te nevojshme, do te autorizojte zyrtare te caktuar specifikisht, te deleguar nga Pala Kontraktuese Kerkuese, te konsultohen ne zyrtat e veta me librat e nevojshem, regjistrat dhe dokumentet e tjera ose te dhenat e ruajtura ne keto zyra, te marrin kopje te tyre, ose pjese te informacioneve ose partikulareve qe lidhen me ate shkelje.
2. Ne aplikim te dispozitave te paragrafit 1 me siper zyrtareve te Pales Kontraktuese Kerkuese do t'i jepet gjithë asistenca e mundshme dhe bashkepunimi per te lehtesuar investigimet e tyre.
3. Sipas kerkeses me shkrim te Administrates Doganore te ne Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e nje Pale tjeter Kontraktuese, kur konsiderohet e pershtatshme, do te autorizojte zyrtaret e administrates kerkuese te jene prezent ne territorin e Pales Kontraktuese qe i kerkohet asistence, lidhur me kerkimet ose raportin zyrtar per nje shkelje Doganore qe i intereson Pales Kontraktuese.

ANEKS VIII

Pjesemarrje ne investigimet jashte

Kur shihet e pershtatshme nga te dyja Palet Kontraktuese, zyrtaret e Administrates Doganore te nje Pale Kontraktuese, sipas kerkeses se nje Pale tjeter Kontraktuese, do te marrin pjese ne investigimet jashte qe kryen ne territorin e asaj Pale tjeter Kontraktuese.

ANEKS IX

Grumbullimi i informacionit

1. Administratat Doganore te Paleve Kontraktuese do t'i komunikojne Sekretarit te Pergjithshem te Keshillit informacionin e specifikuar me poshte, per aq kohe sa kjo perben interes nderkombetar.
2. Sekretari i Pergjithshem i Keshillit do te institucionalizojte dhe mbaje vazhdimisht nje indeks qendror per informacionin e komunikuar atij nga Palet Kontraktuese dhe do te perdore informacion prej saj per te pergatitur permbledhje dhe studime mbi tendencat e reja dhe te rinovuara mbi Mashtrimet Doganore. Ai, periodikisht, do ta rifreskoje indeksin per te eliminuar informacione te cilat, per mendimin e tij, jane te panevojshme ose kane kaluar kohen.
3. Administratat Doganore te Paleve Kontraktuese, sipas kerkeses se Sekretarit te Pergjithshem te Keshillit dhe, kushtezuar nga dispozitat e tjera te kesaj Konvente dhe ketij Aneksi, do t'i japin Sekretarit te Pergjithshem informacione te tilla qe mund te jene te nevojshme per te pergatitur keto permbledhje dhe studime te permendura ne paragrafin 2 te ketij Aneksi.
4. Sekretari i Pergjithshem i Keshillit do te shperndaje tek nepunesit ose sherbimet e emeruara nga Palet Kontraktuese informacion specifik qe permbahet ne indeksin qendror, ne ate sasi qe ai e konsideron kete shperndarje te dobishme, si dhe permbledhje dhe studime te permendura ne paragrafin 2 te ketij Aneksi.
5. Sekretari i Pergjithshem i Keshillit, sipas kerkeses, do te furnizojte Palet Kontraktuese me çfaredolloj informacioni tjeter qe ai ka ne dispozicion, sipas ketij Aneksi.
6. Sekretari i Pergjithshem i Keshillit do te respektojte çdo kufizim qe Pala Kontraktuese ka kerkuar prej tij kur i ka dhene informacionin.

7. Nje Pale Kontraktuese qe ka derguar informacion ka te drejte te kerkoje qe ne vazhdim ky te fshihet nga indeksi qendror dhe nga çfaredolloj regjistri te themeluar nga Palet Kontraktuese me te cilat ka komunikuar dhe se nuk do te perdoret me ky informacion.

Pjesa I: Personat

Seksioni I. Kontrabanda

8. Njoftimet sipas ketij Seksioni do te permbajne informacion lidhur me:

- a) personat e denuar perfundimisht per kontrabande; dhe,
- b) kur eshte e pershtatshme, personat e dyshuar per kontrabande ose te kapur ne akt kontrabande ne territorin e Pales Kontraktuese, duke bere njoftimin, megjithese procesi penal mund te mos jete kompletuar, e cila nenkupton se kur Palet Kontraktuese nuk njoftojne emrat dhe pershkrimin e personave te implikuar, sepse kjo ndalohet nga ligjet e tyre kombetare, ata gjithsesi duhet te bejne nje njoftim i cili te permbaje sa me shume nga te dhenat qe jane ne liste ne kete Seksion.

Ne parim, informacioni i njoftuar duhet te kufizohet ne shkeljet qe kane rezultuar ose kane çuar ne burgosje ose gjoba qe tejkalojne ekuivalentin e 2000 US \$.

9. Informacioni i derguar te permbaje sa me shume te jete e mundur faktet e meposhtme:

(A) Person fizik

- a) Mbiemri;
- b) Emri;
- c) Emri i dhene (nese perdoret);
- d) Pseudonimi;
- e) Profesion;
- f) Adresa;
- g) Datelindja dhe Vendlindja
- h) Shtetesia/Kombesia;
- ij) Vendi i rezidences dhe vendet e vizituara ne 12 muajt e fundit;
- k) Tipi dhe numri i letrave te identifikimit, duke perfshire vendin dhe daten e leshimit

I. Pershkrimi fizik

1. Seksi;
2. Gjatesia;
3. Pesha;
4. Konstrukti;
5. Floket;
6. Syte;
7. Kompleksiteti;
8. Shenja dalluese ose femerore;
- m) Te dhena te permbledhura per shkeljen (duke perfshire te dhena per tipin, sasine dhe origjinen e mallrave qe jane perfshire ne shkelje, prodhuesi, transportuesi dhe ngarkuesi) dhe kushtet te cilat kane çuar ne zbulimin;
- n) Natyra dhe sasia e denimeve ose gjobave te vena;
- o) Vezhgime te tjera, duke perfshire gjuhete qe jane folur dhe (nese eshte e mundur) ndonje shkelje te kaluar te regjistruar;
- p) Palen Kontraktuese qe jep informacionin (duke perfshire numrin e references).

(B) Personal juridike (firmat)

- a) Emri;
- b) Adresa;

- c) Emrat e drejtuesve kryesore ose nepunesve te firmes kunder te cileve eshte kryer ndjekje ligjore, dhe nese eshte e mundur te identifikohen te dhena, siç tregohet ne Pjesen (a), Pikat (A)-(1).
 - d) Kompania nderkombetare e lidhur;
 - e) Natyra e biznesit qe kryen;
 - f) Natyra e shkeljes;
 - g) Te dhena per shkeljen (duke perfshire prodhuesin, transportuesin dhe derguesin) dhe kushtet qe çuan ne zbulimin e shkeljes;
 - h) Madhesia e denimit;
 - ij) Vezhgime te tjera, duke perfshire (nese ka mundesi) ndonje shkelje tjeter e regjistruar;
 - k) Pala Kontraktuese qe dergon informacionin (duke perfshire numrin e references);
10. Si rregull i pergjithshem, Sekretari i Pergjithshem i Keshillit do te shperndaje informacionin lidhur me personal fizike te pakten ne vendet e shtetesise kombesise dhe rezidences, si dhe ne vendet qe personi fizik ne fjale ka vizituar gjate 12 muajve te fundit.

Seksioni II. Mashtrime Doganore te tjera veç kontrabandes

11. Njoftimet nen kete Seksion do te permbajne informacion lidhur me:

- a) personal perfundimisht te denuar per shkelje doganore te tjera veç kontrabandes;
- b) kur eshte e mundur, personal e dyshuar per mashtrime te tilla, edhe ata per te cilet procesi penal nuk ka perfunduar ende, qe duhet kuptuar se kur Palet Kontraktuese mohojne dhenien e emrave dhe pershkrimeve te personave te implikuar sepse ky njoftim ndalohet nga ligji i tyre kombetar, ata gjithsesi bejne nje njoftim i cili permban sa me shume nga te dhenat qe jane ne liste ne kete Seksion.

Ne parim, informacioni i njoftuar do te kufizohet ne shkelje te cilat kane rezultuar ose kane çuar ne burgosje ose gjoba qe kalojne ekuivalentin e 2.000 US \$

12. Informacioni qe do te dergohet, te permbaje sa me shume qe te jete e mundur, te dhenat e meposhtme:

- a) Emri (ose emri i firmes) dhe adresa;
- b) Emrat dhe te dhena identifikuese per drejtuesit e firmes ndaj te cileve eshte bere nje ndjekje penale;
- c) Lloji i mallrave;
- d) Vendi i origjines;
- e) Kompania nderkombetare e lidhur;
- f) Emri dhe adresa e shitesit;
- g) Emri dhe adresa e transportuesit;
- h) Emrat dhe adresat e partnereve te tjere te implikuar (agjente bleres apo shites, ndermjetes te tjere, etj);
- i) Portet apo vendet e tjera ku mallrat u eksportuan;
- k) Te dhena te shkurtra te shkeljes dhe kushtet qe çuan ne zbulimin e saj;
- l) Sasia e denimit dhe deficiti i krijuar ne te ardhurat qe do mblidheshin, nese ka;
- m) Vezhgime te tjera qe perfshijne (nese ka) ndonje shkelje tjeter te regjistruar;
- n) Palen Kontraktuese qe jep informacionin (duke perfshire numrin e references).

Pjesa II: Metoda te kontrabandes dhe mashtrime te tjera, duke perfshire mashtrim me falsifikim, duplikim faturash dhe fatura te genjeshterta

13. Njoftimet nen kete Pjese do te japin informacion lidhur me metodat e kontrabandes dhe mashtrimet e tjera, duke perfshire metodat e fshehjes, mashtrimit me falsifikim, duplikim faturash, fatura te genjeshterta, ne te gjitha rastet e interesave te rendesishme nderkombetare. Palet Kontraktuese do te raportojne çdo perdorim te metodave te reja te kontrabandes dhe mashtrimeve te tjera si metoda te reja dhe te pazakonta ose te mundshme ne menyre qe te zbulohen tendencat e reja ne kete fushe.

14. Informacioni qe do te dergohet te permbaje sa me shume qe te jete e mundur, te dhenat e meposhtme:

a) Pershkrimin e metodave te kontrabandes dhe mashtrimeve te tjera, duke perfshire mashtrim me fshehje, falsifikim ose fatura te genjeshterta. Nese eshte e mundur, pershkrimin (modeli, pamja, numrat e regjistrimit) te mjeteve te transportit te perdorura. Kur eshte e mundur, te dhena nga targat ose certifikatat e kontejnereve ose maunave, format e te cilave jane aprovuar nga nje konvente nderkombetare, dhe informacione mbi demtimin e pumbosjeve, pjeseve te vulosura, pjeseve metalike dhe pjeseve te tjera te kontejnereve apo mjeteve.

b) Pershkrim, nese eshte e mundur, te vendit te fshehjes, duke perfshire nese eshte e mundur nje fotografi ose skice.

c) Pershkrimi i mallrave te fshehura.

d) Natyra ose pershkrimi i falsifikimit, faturave te genjeshterta, te duplikuara, menyra e perdorimit te ketyre falsifikimeve, mashtrimeve, duplikimeve te genjeshterta, vulave doganore, targave fallco etj.

e) Vezhgime te tjera duke perfshire rrethanat qe çuan ne zbulim

f) Pala Kontraktuese qe dergoi informacionin (duke perfshire numrin e references).

Pjesa III: Mjetet lundruese te perfshira ne kontrabande

15. Njoftimet nen kete pjese do te permbajne informacion lidhur me mjetet lundruese, te te gjitha tipeve, qe jane implikuar ne kontrabande, por duhet te kufizohen, ne parim, ne rastet te cilat konsiderohen se jane te nje interesi nderkombetar.

16. Per sa te jete e mundur dhe aq sa e lejon ligji kombetar, informacioni i derguar duhet te permbaje te dhenat e meposhtme:

a) Emri dhe identifikime te shkurtra te mjetit (S.S, M.V, tonazhi, silueta, etj);

b) Emri dhe adresa e pronarit;

c) Flamuri;

d) Porti i regjistrimit, dhe nese eshte i ndryshem, porti vendas;

e) Emri dhe shtetesia/kombesia (dhe nese eshte e mundur, oficeret kryesore);

f) Natyra e shkeljes, duke perfshire pershkrimin e mallrave te kapura;

g) Pershkrim, nese eshte e mundur, te vendit te fshehjes, (duke perfshire nese eshte mundur fotografi ose skice) dhe rrethanat e tjera qe çuan ne zbulim;

h) Vendi i origjines se mallrave te kapura;

ij) Porti i pare hyres;

k) Porti final i destinacionit;

l) Portet ku ndaloi midis (ij) dhe (k);

m) Vezhgime te tjera (numri i rasteve ne te cilat i njejti mjet lundrues, kompani, detare, karter ose operatore te tjere detare kane qene te implikuara ne kontrabande etj.)

n) Pala Kontraktuese qe dergon informacionin (duke perfshire numrin e references)

ANEKS X

Asistence ne aksionet kunder kontrabandes se lendeve narkotike dhe substancave psikotrope

1. Dispozitat e ketij Aneksi nuk do te perjashtojne aplikimin e masave ne fuqi ne nivel kombetar per koordinimin e aktiviteve te autoriteve te ndryshem kompetente per te ndermarre aksione te tilla kunder abuzimit me lende narkotike dhe substancave te tjera psikotrope. Gjithashtu keto nuk do te pengojne, por permbushin, zbatimin e Dispozitave te Konventes se Vetme mbi Lendet Narkotike 1961, dhe Konventes se 1971 mbi Substancat Psikotrope, nga Palet ne keto Konventa te cilat kane pranuar gjithashtu kete Aneks.

2. Dispozitat e ketij Aneksi qe kane te bejne me kontrabanden e lendeve narkotike dhe substancave psikotrope, do te aplikohen sa here te jete e pershtatshme dhe ne mundesine qe

japin kompetencat e Administrates Doganore, gjithashtu per operacionet financiare te ndermarra ne lidhje me kete kontrabande.

Shkembimi i informacionit nga Administratat Doganore sipas iniciatives se vet.

3. Administratat Doganore te Paleve Kontraktuese, me iniciativen e vet dhe pa vonese, do t'i komunikojne Administratave te tjera Doganore te cilat mund te jene vete te interesuara, çdo informacion qe ka, lidhur me:

- a) veprime qe dihen ose dyshohen qe kane kryer, ose duket se kane bere kontrabande te lendeve narkotike ose substancave psikotrope;
- b) personal qe dihet se jane perfshire, ose informacione lidhur me persona qe i eshte komunikuar sipas ligjit, persona qe jane perfshire ne pjesemarrje ne veprimet e referuara me siper ne paragrafin a) me siper, dhe mjete transporti anije, avione ose mjete te tjere transportues te perdorur ose te dyshuar qe jane perdorur per veprime te tilla;
- c) mjete dhe metoda te tjera te perdorura per kontrabanden e lendeve narkotike ose te substancave psikotrope;
- d) produkte qe jane zhvilluar ose perdorur per here te pare si lende narkotike ose substanca psikotrope dhe te cilat jane subjekt kontrabande.

Asistence, sipas kerkeses lidhur meurvejimet.

4. Sipas kerkeses se Administrates Doganore te nje Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e nje Pale tjetere Kontraktuese, ne kuadrin e kompetencave dhe mundesive te saj, do te mirembajeurvejim special per nje periudhe te caktuar kohe mbi:

- a) levizjet, veçanerisht hyrjet dhe daljet nga territori i vet i personave te veçante qe besohet me arsye se jane perfshire profesionalisht ose ne menyre te vazhdueshme ne kontrabanden e lendeve narkotike dhe substancave psikotrope ne territorin e Pales Kontraktuese Kerkuese;
- b) levizjen e lendeve narkotike ose substancave psikotrope, te cilat jane raportuar nga Administrata Doganore e Pales Kontraktuese Kerkuese se kane shkaktuar rritje te trafikut ilegal te importit drejt ose nga territori i asaj Pale Kontraktuese;
- c) vende te veçanta ku jane ndertuar grumbullime te lendeve narkotike ose substancave psikotrope, te cilat japin shkaqe per te besuar se ato do te perdoren per import ilegal ne territorin e Pales Kontraktuese Kerkuese;
- d) mjete te veçanta, anije, avione dhe mjete te tjera per te cilat besohet me arsye se jane perdorur per kontrabande te lendeve narkotike ose substancave psikotrope ne territorin e Pales Kontraktuese Kerkuese; dhe do t'i komunikojne nje raport, lidhur me kete, Administrates Doganore te Pales Kontraktuese Kerkuese. Kerkime, sipas kerkeses, per interes te nje Pale tjetere Kontraktuese.

5. Sipas kerkeses se Administrates Doganore te Pales Kontraktuese Kerkuese, Administrata Doganore e Pales tjetere Kontraktuese, kushtezuar nga ligjet dhe rregullat ne fuqi ne territorin e vet, do te beje kerkime per te marre fakte lidhur me kontrabanden e lendeve narkotike ose substancave psikotrope nen investigim ne territorin e Pales Kontraktuese Kerkuese dhe te marre deklarata nga çfaredolloj personi te lidhur me kete kontrabande, ose nga deshmitare dhe eksperte; dhe t'i komunikojne rezultatet e kerkimit, si dhe ndonje dokument ose evidence, Administrates Doganore te Pales Kontraktuese Kerkuese.

Aksione nga oficeret e Doganes se nje Pale Kontraktuese ne territorin e Pales tjetere Kontraktuese.

6. Kur nuk mjafton qe evidencat te jepen vetem ne menyren e nje deklarate me shkrim, sipas kerkeses se Administrates Doganore te nje Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e Pales tjetere Kontraktuese, ne kuadrin e mundesive te veta, do te autorizojne zyrtaret e saj te paraqiten perpara gjyqit ose tribunaleve ne territorin e Pales Kerkuese Kontraktuese si deshmitare ose eksperte ne çeshtjet e kontrabandes se lendeve narkotike dhe substancave psikotrope. Kerkesa per paraqitje do te specifikojne, veçanerisht per çfare çeshtje dhe ne çfare pozicioni do te degjohen keta zyrtare. Administrata Doganore e Pales Kontraktuese qe pranon kerkesen dhe autorizimin e paraqitjes, do te deklaroje limitet te cilat zyrtaret e saj do te permbushin per te dhene faktet.

7. Sipas kërkeses se shkruar te Administrates Doganore te nje Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e nje Pale tjetër Kontraktuese, kur shihet e pershtatshme dhe ne kufijte e kompetencave dhe mundesive te veta, do te autorizojë zyrtaret e Pales Kontraktuese per t'u prezantuar ne territorin e Pales Kontraktuese qe i kerkohet, lidhur me kerkimet ose per raportimet zyrtare lidhur me kontrabanden e lendeve narkotike ose te substancave psikotrope qe jane shqetesim per Palen Kontraktuese Kerkuese.

8. Kur shihet e mundur nga te dyja Palet Kontraktuese, dhe kushtezuar nga ligjet dhe rregullat ne fuqi ne territorin e vet, zyrtaret e Administrates Doganore te nje Pale Kontraktuese, sipas kërkeses se nje Pale tjetër Kontraktuese, do te marrin pjese ne investigime te kryera ne territorin e Pales tjetër Kontraktuese.

Grumbullimi i informacionit

9. Administrata Doganore e Paleve Kontraktuese do t'i komunikojë Sekretarit te Pergjithshem te Keshillit, kur ky informacion eshte i nje interesi te perbashket, informacionet e specifikuar ketu.

10. Sekretari i Pergjithshem i Keshillit do te institucionalizojë dhe do te mbaje te rifreskuar nje indeks qendror te informacionit, komunikuar atij nga Palet Kontraktuese dhe do te perdore informacion prej tij per te pergatitur permbledhje dhe studime mbi tendencat e reja dhe te vazhdueshme per kontrabanden e lendeve narkotike dhe substancave psikotrope. Ai do ta rishikojë periodikisht kete indeks per te eliminuar informacionet te cilat, sipas opinionit te tij, kane kaluar dobishmerine ose kane dale jashte kohe.

11. Administrata Doganore e Paleve Kontraktuese, sipas kërkeses se Sekretarit te Pergjithshem te Keshillit dhe varur nga dispozitat e tjera te kesaj Konvente, do te furnizojë Sekretarin e Pergjithshem te Keshillit me informacione te tilla, qe mund te jene te nevojshme per te pergatitur permbledhjet dhe studimet e referuara ne paragrafin 10 te ketij Aneksi.

12. Sekretari i Pergjithshem i Keshillit do t'i shperndajë sherbimeve ose zyrtareve te caktuar nga Administratat Doganore te Paleve Kontraktuese informacion specifik qe permbahet ne indeksin qendror, aq sa e konsideron ai te dobishem, si dhe permbledhje dhe studime te permendura ne paragrafin 10 te ketij Aneksi.

13. Sekretari i Pergjithshem i Keshillit, nese nuk kundërshtohet nga Pala Kontraktuese qe jep informacionin, gjithashtu, do t'u shperndajë sherbimeve ose zyrtareve te emeruar nga anetaret e tjere te Keshillit, trupave kompetente te Kombeve te Bashkuara, Organizates Nderkombetare te Policise Kriminale/Interpol dhe organizatave te tjera me te cilat jane bere marreveshje lidhur me keto çeshtje, çfaredolloj informacioni lidhur me kontrabanden e lendeve narkotike dhe substancave psikotrope te permbajtura ne indeksin qendror, ne limitet qe ai i konsideron keto shperndarje te dobishme, si dhe permbledhje ose studime qe ai mund te kete pergatitur nen kete teme sipas paragrafit 10 te ketij Aneksi.

14. Sekretari i Pergjithshem i Keshillit, sipas kërkeses, do te furnizojë Palet Kontraktuese qe kane pranuar kete Aneks me çfaredolloj informacioni tjetër qe ai ka ne dispozicion lidhur me grumbullimin e informacionit te parashikuar ne kete Aneks.

Indeksi Qendror, Pjesa I: Personat

15. Njoftimet nen kete Pjese te Treguesit Qendror do te japin informacion lidhur me:

a) personat perfundimisht te denuar per kontrabande; dhe

b) kur eshte e mundur, persona te dyshuar per kontrabande ose te perfshire ne akte kontrabande ne territorin e Pales Kontraktuese qe ben njoftimin, megjithese procedimet penale mund te mos kene perfunduar,

qe kuptohet si: kur Palet Kontraktuese shmangen nga dhenia e njoftimit per emrat dhe pershkrimet e personave te implikuar ne raste te tilla sepse njoftime te tilla jane te ndaluara nga legjislacioni i tyre kombetar, ata gjithsesi duhet te bejne njoftime qe te permbajne sa me shume qe te jete e mundur nga te dhenat e permendura ne listen e kesaj Pjese te Indeksit Qendror.

16. Informacioni qe do te dergohet, te permbaje sa me shume qe te jete e mundur, te dhenat e meposhtme:
- a) Mbiemrin;
 - b) Emrin;
 - c) Emrin e dhene (nese ka);
 - d) Pseudonimet;
 - e) Profesionin;
 - f) Adresa (e tanishme);
 - g) Datelindja dhe vendlindja;
 - h) Shtetesia/Kombesia;
 - i) Vendi i rezidences dhe vendet e vizituara gjate 12 muajve te fundit;
 - j) Tipi dhe numri i letrave te identifikimit, duke perfshire daten dhe vendin e leshimit;
 - k) Pershkrimi fizik;
 1. Seksi;
 - 2) Gjatesia;
 - 3) Pesha;
 - 4) Konstrukti;
 - 5) Floket;
 - 6) Syte;
 - 7) Kompleksi;
 - 8) Shenja dalluese ose femerore.
 - m) Pershkrime te shkurtra te shkeljes (duke perfshire tipin, sasine dhe origjinen e mallrave te perfshira ne shkelje, prodhuesi, transportuesi dhe ndermjetes) si dhe konditat qe çuan ne zbulimin e shkeljes;
 - n) Natyra dhe sasia e shkeljeve ose denimeve te dhena;
 - o) Vezhgime te tjera, duke perfshire gjuhen e folur dhe nese eshte e mundur shkeljet e kaluara te regjistruara;
 - p) Palen Kontraktuese qe jep informacionin (duke perfshire numrin e references).
17. Si rregull i pergjithshem, Sekretari i Pergjithshem i Keshillit do te shperndaje informacion lidhur me Pjesen I te Indeksit Qendror te pakten ne vendet e Kombesise/Shtetesise, rezidences dhe vendeve qe ka vizituar ky person ne 12 muajt e fundit.

Indeksi Qendror, Pjesa II: Metodat

18. Njoftimet nen kete Pjese te Indeksit Qendror do te japin informacion lidhur me metodat e kontrabandes se lendeve narkotike dhe substancave psikotrope, duke perfshire metodat e fshehjes, ne te gjitha rastet e interesave te rendesishme nderkombetare. Palet Kontraktuese do te raportojne çdo perdorim te metodave te njohura te kontrabandes, si dhe metoda te pazakonta ose te mundshme ne menyre qe te zbulohen tendencat e kohes ne kete fushe.

19. Informacioni qe do te dergohet te permbaje sa me shume te jete e mundur, te dhenat e meposhtme:

- a) Pershkrim te metodave te kontrabandes. Nese ka mundesi, pershkrimi (ndertimi, marka, modeli, numri i regjistrimit, etj), i çfaredolloj mjeti transporti te perderur. Kur eshte e mundur, te dhena nga targa e aprovuar e certifikates se Kontejnerit apo mjetit, dizenjot e te cilave jane aprovuar nen nje Konvente Nderkombetare, çfaredolloj informacioni mbi demtimet e vulave, pjeseve metalike, pajisjeve vulosese ose pjeseve te tjera te kontejnereve ose mjeteve.
- b) Pershkrim, nese ka mundesi, te vendit te fshehjes, duke perfshire nese eshte e mundur nje fotografi ose skice.
- c) Pershkrim i mallrave ne fjale.
- d) Vezhgime te tjera duke perfshire rrethanat qe çuan ne zbulim.
- e) Palen Kontraktuese qe jep informacionin (duke perfshire numrin e references).

Indeksi Qendror, Pjesa III: Mjetet lundruese te perfshira ne kontrabande

20. Njoftimet nen kete Pjese te Treguesit Qendror do te permbajne informacion lidhur me mjetet lundruese te te gjitha tipeve, te cilat jane perfshire ne kontrabanden e lendeve narkotike ose substancave psikotrope, por duhet te kufizohet, ne parim, ne rastet te cilat konsiderohen se jane te nje interesi nderkombetar.

21. Per aq sa lejon ligji kombetar dhe sa te jete e mundur, informacioni i derguar do te permbaje te dhenat e meposhtme:

- a) Emri dhe identifikime te permbledhura te mjetit lundrues (S.S., M.V., tonazhi, silueta etj.);
- b) Emri dhe adresa e pronarit, karter;
- c) Flamuri;
- d) Porti i regjistrimit, dhe nese eshte i ndryshem, porti vendas;
- e) Emri dhe shtetesia; kombesia e kapitenit (dhe nese eshte e mundur, oficeret kryesore);
- f) Natyra e shkeljes, duke perfshire pershkrimin e mallrave te kapura;
- g) Pershkrimi nese eshte e mundur i vendit te fshehjes (duke perfshire nese eshte e mundur nje fotografi ose skice) dhe pershkrim te rrethanave qe çuan ne zbulim;
- h) Vendi i origjines se mallrave te kapura;
- i) Porti i pare i ankorimit;
- k) Portin final i destinacionit;
- l) Portet ku ka ndaluar ndermjet i) dhe k);
- m) Vezhgime te tjera (numri i rasteve ne te cilat e njejta anije, linje detare, karter ose operator tjetër detar eshte perfshire ne kontrabande, etj .);
- n) Pala Kontraktuese qe jep informacionin (duke perfshire numrin e references).

ANEKS XI

Asistence ne aksione kunder kontrabandes se veprave te artit, antikave dhe pasurive te tjera kulturore

1. Dispozitat e ketij Aneksi aplikohen per veprat e artit, antikat dhe "pasurite e tjera kulturore", te cilat ne baze besimi fetar, etj, Jane te nje rendesie per arkeologjine, per historine, historine, literaturen, artin dhe shkencen, sipas parimeve te paragrafit (a)-(k) te nenit 1 te Konventes UNESCO lidhur me kufizimin dhe parandalimin e transportit ilegal, eksportin dhe transportimin e vlerave kulturore (Paris, 14 nentor 1970), per aq kohe sa vepra e artit, antikat dhe pasurite e tjera kulturore te jene subjekt kontrabande. Ato nuk perjashtojne aplikimin e masave kombetare mbi kooperimin me sherbimet kombetare per mbrojtjen e pasurive kulturore, dhe ne fushen e doganave, permbushin zbatimin e dispozitave te Konventes se UNESCO-s, nga Palet Kontraktuese per kete Konvente te cilat gjithashtu kane pranuar kete Aneks.

2. Dispozitat e ketij Aneksi lidhur me kontrabanden e veprave te artit, antikave dhe pasurive te tjera kulturore, ne kuadrin e kompetencave te Administrates Doganore dhe sa here te jete e mundur, do te zbatohen gjithashtu per operimet financiare te ndermarra lidhur me kete kontrabande.

Shkembimi i informacionit nga Administratat Doganore me iniciativen e vet.

3. Administratat Doganore te Paleve Kontraktuese, me iniciativen e vet dhe pa vonese, do t'i komunikojne Administratave te tjera Doganore qe mund te jene direkt te interesuara, çdo informacion qe kane ne dispozicion lidhur me:

- a) operacionet qe dihen ose dyshohen, qe perbejne, ose duket se kane sjelle, kontrabande te veprave te artit, antikave ose pasurive te tjera kulturore;
- b) personat qe dihet se jane perfshire, ose per aq sa, informacionet qe kane te bejne me keta persona mund te komunikohen ne perputhje me ligjin kombetar, personat e dyshuar qe jane perfshire ne veprimet e referuara ne paragrafin a) me lart, si dhe mjete lundrimi, anije, avione dhe mjete te tjera transporti te perdorura ose qe jane dyshuar se jane perdorur per keto operacione;

c) mjete ose metoda te reja te perdorura per kontrabanden e veprave te artit, antikave ose pasurive te tjera kulturore.

Asistence, sipas kerkeses, lidhur meurvejimem;

4. Sipas kerkeses se Administrates Doganore te Pales Kontraktuese, Administrata Doganore e nje Pale tjeter Kontraktuese, ne kufirin e mundesive dhe kompetencave te veta, do te kryejeurvejim special per nje periudhe te caktuar kohe mbi:

a) levizjet, veçanerisht gjate hyrjes ose daljes nga territori i vet i personave te veçante qe besohet se jane perfshire, profesionalisht ose vazhdimisht, ne kontrabanden e veprave te artit, antikave ose pasurive te tjera kulturore ne territorin e Pales Kontraktuese Kerkuese;

b) levizjet e veprave te artit, antikave ose pasurive te tjera kulturore te cilat jane raportuar nga Administrata Doganore e nje Pale Kontraktuese Kerkuese se kane shkaktuar rritje serioze te trafikut ilegal nga territori i asaj Pale Kontraktuese;

c) mjetet lundruese te veçanta, anije, aeroplane ose mjete te tjera transporti per te cilat besohet me arsye se jane perdorur per kontrabanden e veprave te artit, antikave ose pasurive te tjera kulturore nga territori i Pales Kontraktuese Kerkuese; dhe do te komunikojne nje raport lidhur me te Administrates Doganore te Pales Kontraktuese Kerkuese.

Kerkime, sipas kerkeses, per interes te nje Pale tjeter Kontraktuese.

5. Sipas kerkeses se Administrates Doganore te nje Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e nje Pale tjeter Kontraktuese, kushtezuar nga mundesite dhe varur nga ligjet kombetare ne fuqi ne territorin e vet, do te beje kerkime per te marre fakte lidhur me kontrabanden e veprave te artit, antikave dhe pasurive te tjera kulturore nen hetim ne territorin e Pales Kontraktuese Kerkuese, dhe do te marre deklarata nga çdo person i lidhur me kete kontrabande ose nga deshmitare dhe eksperte, dhe do t'i komunikojte rezultatet e kerkimit, si dhe ndonje dokument tjeter dhe evidence, Administrates Doganore te Pales Kontraktuese Kerkuese.

Aksione nga zyrtaret e Doganes se nje Pale Kontraktuese ne territorin e nje Pale tjeter Kontraktuese.

6. Kur mjafton qe faktet te jepen vetem ne formen e nje deklarate te shkruar, sipas kerkeses se Administrates Doganore te nje Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e nje Pale tjeter Kontraktuese, per aq sa ka mundesi, do te autorizojte zyrtaret e saj te paraqiten perpara gjykates ose tribunaleve ne territorin e Pales Kontraktuese Kerkuese si eksperte ose deshmitare ne çeshtjet e kontrabandes se veprave te artit, antikave ose pasurive te tjera kulturore. Kerkesa per paraqitje, do te specifikoje, per çfare çeshtje dhe ne çfare pozicioni do te degjohen keta zyrtare. Administrata Doganore e Pales Kontraktuese qe pranon kerkesen, ne autorizimin e paraqitjes, do te deklaroje limitet te cilat zyrtaret e vet duhet te permbushin ne dhenien e fakteve.

7. Sipas kerkeses me shkrim te Administrates Doganore te nje Pale Kontraktuese, Administrata Doganore e nje Pale tjeter Kontraktuese, kur e sheh te mundur dhe ne kufijte e kompetencave dhe aftesive te veta, do te autorizojte zyrtaret e administrates kerkuese te jene prezent ne territorin e Pales Kontraktuese te ciles i kerkohet informacion lidhur me kerkimet mbi, ose do te autorizojte zyrtaret qe do te raportojne mbi kontrabanden e veprave te artit, antikave ose pasurive te tjera kulturore qe shqetesojne Palen Kontraktuese Kerkuese.

8. Kur shihet e pershtatshme nga te dyja Palet Kontraktuese dhe, kushtezuar nga ligjet dhe rregullat ne fuqi ne territorin e tyre, zyrtaret e Administrates Doganore te nje Pale Kontraktuese, sipas kerkeses se nje Pale tjeter Kontraktuese, do te marre pjese ne investigimet e kryera ne territorin e asaj Pale Kontraktuese.

Grumbullimi i informacionit

9. Administrata Doganore e Paleve Kontraktuese do t'i komunikojë Sekretarit të Pergjithshëm, të Keshillit, në kushtet kur ky informacion është i një interesi ndërkombëtar, informacionin e specifikuar më poshtë.

10. Sekretari i Pergjithshëm i Keshillit do të institucionalizojë dhe mbajë të freskët Indeksën Qendror të Informacioneve të komunikuar aty nga Palet Kontraktuese dhe do të perdorë informacionin prej tij për të përgatitur studime dhe përmbledhje të tendencave dhe menyrave të reja në kontrabandën e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore. Ai, periodikisht, do të rishikojë indeksin për të eliminuar informacionet, që sipas mendimit të tij, kanë dalë jashtë kohe ose janë bërë të padobishme.

11. Administratat Doganore të Paleve Kontraktuese, sipas kërkesës së Sekretarit të Pergjithshëm të Keshillit, dhe kushtëzuar nga dispozitat e tjera të Konventës dhe këtij Aneksi, do të furnizojnë Sekretarin e Pergjithshëm me informacion të tillë shtesë që mund të jetë i nevojshëm për të përgatitur këto studime dhe përmbledhje, të referuara në paragrafin 10 të këtij Aneksi.

12. Sekretari i Pergjithshëm i Keshillit do t'i shpërndajë zyrtarëve dhe shërbimeve të emëruara nga Administratat Doganore të Paleve Kontraktuese informacionin specifik të përmbajtur në Indeksën Qendror, në kufijtë që ai i gjykon këto informacione të dobishme, si dhe përmbledhjet dhe studimet e referuara në paragrafin 10 të këtij Aneksi.

13. Sekretari i Pergjithshëm i Keshillit, (nëse nuk kundërshtohet kjo gjë nga Palet Kontraktuese që kanë dhënë informacionin) do t'i shpërndajë këtë informacion UNESKO-s, Interpolit, lidhur me kontrabandën e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore të përmbajtura në indeksin qendror, kur ka ndodhur një transport i legal dhe kur ai e konsideron këtë informacion të dobishëm, së bashku me ndonjë studim ose përmbledhje të cilat ai ka përgatitur për këtë çështje sipas paragrafit 10 të këtij Aneksi.

14. Sekretari i Pergjithshëm i Keshillit, (nëse nuk kundërshtohet kjo gjë nga Palet Kontraktuese që kanë dhënë informacionin) do t'ua shpërndajë këtë informacion UNESKO-s, Interpolit, lidhur me kontrabandën e veprave të artit, antikave ose pasurive të tjera kulturore të përmbajtura në Indeksën Qendror, kur ka ndodhur një transport i legal dhe kur ai e konsideron këtë informacion të dobishëm, së bashku me ndonjë studim ose përmbledhje të cilat ai ka përgatitur për këtë çështje sipas paragrafit 10 të këtij aneksi.

Indeksi Qendror, Pjesa I: Personat

15. Njoftimet nën këtë pjesë të Indeksit Qendror do të japin informacion lidhur me:

a) personat perfundimisht të denuar për kontrabandë; dhe
b) kur është e mundur, personat e dyshuar për kontrabandë ose kapur në akte kontrabande në territorin e Paleve Kontraktuese që nën njoftimin, megjithatë proceset penale mund të mos kenë perfunduar, që duhet kuptuar se kur Palet Kontraktuese shmanen nga njoftimi i emrave dhe përshkrimeve të personave të përfshirë sepse këto njoftime ndalohen nga legjislacioni i tyre kombëtar, ata gjithsesi duhet të bëjnë njoftime që të përmbajnë sa më shumë nga të dhënat e vëna në listë më poshtë në këtë pjesë të indeksit qendror.

16. Informacioni që do të dergohet, të përmbajë sa më shumë të jetë e mundur, të dhënat e mëposhtme:

- a) Mbiemri;
- b) Emri;
- c) Emri i dhënë;
- d) Pseudonimi;
- e) Profesioni
- f) Adresa (e tanishme);
- g) Datelindja dhe vendlindja;
- h) Shtetësia/Kombësia;
- i) Vendi i rezidencës dhe vendet e vizituara gjatë 12 muajve të fundit;
- k) Tipi dhe numri i letrave të identifikimit, duke përfshirë vendin dhe datën e leshimit
- l) Përshkrimi fizik

- 1) Seksi;
 - 2) Gjatesia;
 - 3) Pesha;
 - 4) Konstrukti;
 - 5) Floket;
 - 6) Syte;
 - 7) Kompleksi;
 - 8) Shenja te veçanta ose femerore.
- m) Pershkrim shkurt te shkeljes, (duke perfshire pershkrim te tipit dhe origjines se mallrave te perfshira ne shkelje, dhe nese eshte kryer nje transport ilegal ose pronesi ilegale) dhe kushtet qe çuan ne zbulimin e shkeljes.
- n) Natyra dhe sasia e denimit/gjebes se vene;
- o) Vezhgime te tjera, duke perfshire gjuhen e folur, dhe (nese ka mundesi) shkelje te kaluara te regjistruara
- p) Palen Kontraktuese qe ka dhene informacionin (duke perfshire numrin e references)
17. Si rregull i Pergjithshem, Sekretari i Pergjithshem i Keshillit do te qarkulloje informacionin lidhur me Pjesen I te Indeksit Qendror, te pakten ne vendet e shtetesise/kombesise dhe rezidences, si dhe ne vendet qe personi ne fjale ka vizituar 12 muajt e fundit.

Indeksi qendror, Pjesa II: Metodat

18. Njoftimet nen kete Pjese te Indeksit Qendror, do te japin informacion lidhur me metodat e kontrabandes se veprave te artit, antikave ose pasurive te tjera kulturore, duke perfshire metodat e fshehjes, ne gjithe rastet e interesave te rendesishem nderkombetare. Palet Kontraktuese do te raportojne çdo lloj perdorimi te metodave te njohura te kontrabandes, si dhe te metodave te pazakonta, ose te mundshme ne menyre qe tendencat e reja ne kete fushe te mund te zbulohen.
19. Informacioni qe do te shperndahet, sa me shume te jete e mundur te permbaje te dhenat e meposhtme:
- a) Pershkrim te metodave te kontrabandes. Nese eshte e mundur, pershkrimin (marka, modeli, numri i regjistrimit, ne rastet e mjeteve tokesore, tipi i mjetit lundruar, etj.) te çdo mjeti transporti te perdorur. Kur eshte e mundur, te dhena nga targat e aprovuara ose certifikatat e kontejnereve ose mjeteve levizes, disenjot e te cilave jane aprovuar nen nje Konvente Nderkombetare, si dhe per ndonje demtim te vulave, pjeseve metalike, pumbosjeve, ose pjeseve te tjera te maunave ose kontejnereve.
 - b) Pershkrim, nese ka mundesi te vendit te fshehjes, duke perfshire nese ka mundesi, nje fotografi ose skice;
 - c) pershkrimi i mallrave ne fjale
 - d) vezhgime te tjera, duke perfshire rrethanat qe çuan ne zbulim;
 - e) Palen Kontraktuese qe dergon informacionin (duke perfshire numrin e references).



LIGJ

Nr. 8754, date 26.3.2001

**PER ADERIMIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE "KONVENTEN PER
HARMONIZIMIN E RREGULLAVE PER KONTROLLIN KUFITAR TE
MALLRAVE"**

Ne mbeshtetje te neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te
Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI :

Neni 1

Republika e Shqiperise aderon ne "Konventen per harmonizimin e rregullave per kontrollin
kufitar te mallrave".

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2955, date 6.4.2001 te Presidentit te Republikes se Shqiperise
Rexhep Meidani

**KONVENTA NDERKOMBETARE PER HARMONIZIMIN E RREGULLAVE PER
KONTROLLIN KUFITAR TE MALLRAVE
HYRJA**

Palet kontraktuese,

Duke pasur si deshire te permiresojne levizjen nderkombetare te mallrave,
Duke pasur ne mend nevojten per te lehtesuar kalimin e mallrave ne kufi,
Duke vene re se masat e kontrollit qe zbatohen ne kufi kryhen nga sherbime te ndryshme te
kontrollit,

Duke njohur faktin qe kushtet ne te cilat kryhen keto kontrole mund te harmonizohen pa
demptuar qellimin ne vetvete te kontrollit dhe te efektivitetit te tij,
Te bindur se harmonizimi i rregullave te kontrollit kufitar perben nje mjet te fuqishem per
arritjen e ketyre objektiveve, kane rene dakord si vijon:

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Perkufizime

Per qellimin e kesaj Konvente:

- (a) "Dogana" do te thote Sherbimi Qeveritar qe eshte pergjegjes per administrimin dhe zbatimin e ligjit te doganave, lidhur me mbledhjen e taksave nga doganat, siç dhe ka pergjegjesi per zbatimin e ligjeve dhe rregullave lidhur me te, ku nder te tjera perfshihet transportimi, tranzitimi dhe eksportimi i mallrave;
- (b) "Kontroll Doganor" do te thote masat e zbatuara per te siguruar perputhjen me ligjet dhe rregullat te cilat autoritetet doganore duhet te zbatojne gjate aktivitetit te tyre;
- (c) "Inspektim Mjeko - Sanitar" do te thote kontrollet e ushtruara per mbrojtjen e jetes, te shendetit, te personit, duke perjashtuar kontrollin veterinar;
- (d) "Kontroll Veterinar" do te thote kontrolli shendetesor i ushtruar te kafshet dhe prodhimet e tyre, duke synuar ne mbrojtjen e jetes dhe te shendetit te personave dhe kafsheve. Ky kontroll do te ushtrohet edhe mbi mjetet dhe te mirat te cilat do te sherbejne per transportimin e semundjeve te kafsheve;
- (e) "Kontroll Fitosanitar" do te thote kontrolli qe ka si qellim parandalimin e shperndarjes dhe hyrjen ne kufijte shtetore te semundjeve te bimeve ose te prodhimeve nga bimet;
- (f) "Kontrolli per Standardet Teknike" do te thote kontrolli i ushtruar per te siguruar qe mallrat te gezojne standardet minimum kombetar dhe nderkombetar, ashtu siç percaktohet ne ligjet dhe rregulloret e veçanta;
- (g) "Kontrolli i Cilesise" do te thote, perveç formave te kontroleve te permendura me siper, kontroll i ushtruar me qellim qe mallrat te jene brenda parametrave kombetare dhe nderkombetare, ashtu siç percaktohet ne ligjet e rregulloret e veçanta;
- (h) "Kontrolli i Sherbimeve" do te thote çdo sherbim i kryer per te kontrolluar gjithë kontrollet e kryera me pare, lidhur me importimin, eksportimin ose tranzitimin e mallrave.

Neni 2

Qellimi

Me qellim lehtesimin e levizjes se lire te mallrave, kjo Konvente ka si qellim te permiresoje kuadrin ligjor per kryerjen e formaliteteve sidomos te numrit dhe kohezgjatjes se kontrollit, ne veçanti te koordinimit te rregullave dhe procedurave kombetare dhe nderkombetare per kryerjen e kontrollit.

Neni 3

Shtrirja

1. Kjo Konvente aplikohet mbi te gjithë mallrat e importuara, te eksportuara ose ne transit, te cilat jane transportuar me nje nga mjetet e transportit, qofte ky detar, rrugor dhe ajror.
2. Kjo Konvente do te aplikohet per te gjithë sherbimet e kontrollit te kryera nga palet kontraktuese.

KREU II

HARMONIZIMI I PROCEDURAVE

Neni 4

Koordinimi i Kontrolleve

Palet nenshkruese, brenda mundesive te tyre, do te ndermarrin masa per harmonizimin e rregullave ne kontrollin e sherbimeve doganore dhe te sherbimeve te tjera te Kontrollit.

Neni 5

Mjetet e kerkuara per kryerjen e ketyre sherbimeve

Ne menyre qe kontrolli te kryhet ne menyre te suksesshme, palet kontraktuese, brenda mundesive te tyre, dhe duke respektuar kuadrin e tyre te brendshem ligjor, te sigurojne:

- a) personelin e kualifikuar ne perputhje me shkallen e kerkesave te trafikut;
- (b) pajisjet dhe lehtesite per kryerjen e kontrollit, duke pasur parasysh llojin e transportit, mallrat te cilat do te kontrollohen, si dhe kerkesat e qarkullimit;
- (c) udhezime zyrtare ne drejtim te personelit te kontrollit ne menyre qe aktiviteti i tyre te jete ne perputhje me marreveshjet nderkombetare, si dhe me rregullat e tjera te legjislacionit te brendshem.

Neni 6

Bashkepunimi Nderkombetar

Palet kontraktuese marrin persiper detyrimin te bashkepunojne me njeri-tjetrin, duke kerkuar te njejtin bashkepunim edhe nga autoritetet kompetente nderkom betare, me qellim arritjen e qellimeve te Konventes, duke u perpjekur keshtu, ne hartimin e marreveshjeve dypaleshe ose shumepaleshe, ne qofte se kjo konsiderohet e nevojshme nisur nga rrethanat.

Neni 7

Bashkepunimi ndermjet vendeve te anetaresuara ne kete Konvente

Ne çdo rast, qe nje kufi i nje shteti te caktuar kalohet, Palet kontraktuese te perfshira do te duhet te marrin masat e duhura, qe kur eshte e mundur, te lehtesojne kalimin e mallrave. Ne kete aspekt ato do te:

(a) perpiqen te marrin masa per nje kontroll te shpejte te mallrave dhe dokumenteve shoqeruese, duke krijuar lehtesi ne qarkullimin e tyre;

(b) perpiqen qe veprimet e tyre te jene ne pajtim:

me oret zyrtare te punes se postave kufitare; me sherbimet e kontrollit qe gjenden atje, te cilat jane te ngarkuara per kryerjen e kontrollit; me kategorite e mallrave, menyren e transportimit te tyre dhe ne pajtim me procedurat e pranuar ose qe jane ne perdorim per tranzitimin nderkombetar te mallrave.

Neni 8

Shkembimi i Informacionit

Palet kontraktuese mund, me kerkesen e seciles, mund te shkembejne informacionin e nevojshem per zbatimin e detyrimeve te kesaj Konvente, ashtu siç eshte percaktuar edhe te shtesat (anekset) e kesaj Konvente.

Neni 9

Dokumentacioni

1. Palet kontraktuese do te perpiqen te nxisin ndermjet tyre dhe autoritetet nderkombetare kompetente per perdorimin e dokumentacionit, ashtu siç eshte parashikuar edhe ne dokumentin e OKB-se.
2. Palet kontraktuese do te pranojne dokumentet e miratuara sipas nje procedure te caktuar, duke pasur parasysh qe keto procedura te jene ne konformitet te plote me ligjet e brendshme, duke respektuar nder te tjera formen, autenticitetin dhe verifikimin, lexueshmerine dhe kuptueshmerine e tyre.
3. Palet kontraktuese do te marrin masa qe dokumentacioni shoqerues dhe i domosdoshem te pergatitet dhe vertetohet ne perputhje te plote me legjislacionin e brendshem te çdo vendi.

KREU III

RREGULLAT LIDHUR ME TRANZITIMIN E MALLRAVE

Neni 10

Mallrat ne Transit

1. Palet kontraktuese, brenda mundesive te tyre, do te sigurojne nje trajtim te shpejte dhe te thjeshte te mallrave ne transit, sidomos per mallrat te cilat transportohen nen kujdesin dhe mbikeqyrjen e dispozitave te Tranzitimit Nderkombetar te Mallrave, duke parashikuar kufizimin e kontrolleve ne rastet kur kjo diskutohet nga rrethanat e veçanta. Per kete, do te merret ne konsiderate edhe gjendja e vendeve te cilat nuk kane dalje ne det. Ato do te duhet te sigurojne edhe zgjatjen e kohes se punes dhe dhenien e kompetencave me te medha per kontrollin kufitar te mallrave te cilat kryhen ne baze te dispozitave te Tranzitimit Nderkombetar te Mallrave.
2. Palet kontraktuese do te perpiqen te lehtesojne ne nje mase sa me te madhe tranzitimin e mallrave me kamione ose me mjete te tjera, duke u siguruar atyre shkallen e duhur te sigurise.

KREU IV

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 11

Rendi Publik

1. Asnje dispozite e kesaj Konvente nuk do te pengoje zbatimin e kufizimeve ose ndalimeve, lidhur me importimin, eksportimin ose tranzitimin e mallrave te cilat jane vendosur nga rendi publik, rregulla te cilat kane si qellim mbrojtjen e jetes, shendetit, sigurise dhe moralit, mbrojtjen e mjedisit, pasurise kulturore dhe industriale, pasurive dhe te drejtave intelektuale.

2. Megjithate, kur eshte e mundur dhe pa ndonje paragjykim per efektivitetin e ketyre kontrolleve, palet kontraktuese do te perpiqen te zbatojne kontrollet, duke mbajtur parasysht edhe masat e permendura ne paragrafin e mesiperme, dhe nder te tjera edhe masat te cilat jane perfshire ne nenet 6 dhe 9 te kesaj Konvente.

Neni 12

Masat Emergjente

1. Masat emergjente, te cilat nje pale do te mund te aplikojte si pasoje e rasteve te veçanta, duhet te jene ne proporcion me arsyet dhe faktoret te cilet kane çuar ne ndodhjen e rasteve urgjente. Keto masa duhet te ekzistojne sapo te hiqen ose menjahen faktoret qe çuan ne marrjen e ketyre masave urgjente.

2. Kur eshte e mundur, dhe pa asnje paragjykim per efektivitetin e masave te ndermarra, palet kontraktuese duhet te botojne dispozitat te cilat jane zbatuar per marrjen e masave urgjente.

Neni 13

Shtesat (Anekset)

1. Anekset jane pjese perberese e kesaj Konvente.

2. Anekse te reja, lidhur me sektore te tjere te kontrollit, mund te perfshihen ne kete Konvente duke respektuar procedural e percaktuara ne nenet 22 dhe 24 te kesaj Konvente.

Neni 14

Marredheniet me Traktate te tjera

1. Pa asnje paragjykim te nenit 6, Konventa ne fjale nuk do te kete superioritet mbi te drejtat dhe detyrimet qe shtetet, anetare te kesaj Konvente kane ne baze te Traktateve te tjera ku ato jane pale, para se te jene bere pale ne kete Konvente.

Neni 15

1. Kjo Konvente nuk do te perjashtojte zbatimin e lehtesirave me te medha te cilat 2 ose me shume shtete pale te kesaj Konvente, duan t'i japin njeri-tjetrit. Po ashtu, kjo Konvente nuk do te perjashtojte as edhe te drejten e shteteve anetare te behen anetare te organizatave te ndryshme te integritit ekonomik, siç eshte parashikuar ne nenin 16, i cili ben fjale per zbatimin e legjislacionit kombetar ne rastet e kontrolleve ne pikat kufitare, me kushtin e vetem qe ky kontroll te mos pengojte levizjen e mallrave.

Neni 16

Nenshkrimi, ratifikimi, pranimi. Aprovimi dhe aderimi

1. Konventa, e cila eshte depozituar tek Sekretari i Pergjithshem i OKB-se, do te jete e hapur per te gjitha shtetet dhe te gjitha organizatat e integritit ekonomik rajonal ne te cilat kane aderuar shtete te veçanta, te cilat kane te drejten dhe kompetencen te negociojne, te arrijne marreveshje dhe te zbatojne marreveshjen e cila lidhet me çeshtje te cilat mbulohe nga Konventa e mesiperme.

2. Organizatat e integritit ekonomik rajonal, siç eshte folur edhe ne paragrafin e mesiperme

per çeshtjet e përfshira brenda kompetencës së tyre, ushtrojnë në emër të tyre, të gjitha të drejtat dhe detyrimet, të cilat sipas kësaj Konvente do t'i përkisnin shteteve të veçante, të cilët janë pa pjesëmarrje të kësaj Konvente. Në rastet e tilla, anëtarët e kësaj Organizate nuk kanë të drejtë të ushtrojnë individualisht të drejtat, përfshirë këtu edhe të drejtën e votës.

3. Shtetet, si dhe organizatat e integritit ekonomik rajonal, e përmendur më sipër, mund të behen pa kontraktuese në këto Konvente:

(a) duke depozituar instrumentin e ratifikimit, pranimit ose aprovimit, pasi ajo është nënshkruar;

(b) ose duke depozituar instrumentin e aderimit.

4. Kjo Konvente do të qendrojë e hapur që nga 1 Prill 1983 deri 31 Mars 1984, vetëm për nënshkrimin në Zyrat e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë nga të gjitha Shtetet dhe nga organizatat e integritit ekonomik rajonal të përmendura në paragrafin 1.

5. Nga 1 prilli 1983 ajo do të jetë e hapur për aderimin e tyre.

6. Instrumenti i ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit do të depozitohet në Sekretariatit të Përgjithshëm në Kombet e Bashkuara.

Neni 17

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konvente do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës në të cilën pesë Shtetet kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit.

2. Pasi të pesë Shtetet të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose aderimit, kjo Konvente do të hyjë në fuqi për Palet të tjera Kontraktuese tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit, ose aderimit.

3. Çdo instrument i ratifikimit, pranimit, aprovimit, ose aderimit i depozituar pas hyrjes në fuqi të amendamenteve të kësaj Konvente, do të gjykohet të aplikojë në këto Konvente të ndryshuar.

4. Çdo instrument i depozituar, pasi amendamentet të jenë pranuar në përputhje me procedurat e nenit 22, por para se instrumenti të ketë hyrë në fuqi, do të gjykohet si i aplikuar në këto Konvente të ndryshuar në datën që amendamenti hyn në fuqi.

Neni 18

Denoncim

1. Çdo pa kontraktuese mund të denoncojë këto Konvente, duke i dërguar njoftim Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të ketë efekt 6 muaj nga data e marrjes së këtij materiali denoncimi nga Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 19

Mbarimi

1. Ne qofte se pas hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente, numri i shteteve te cilat jane pale, eshte reduktuar ne me pak se 5 shtete, per nje periudhe 12 mujore, Konventa do te pushoje se pasuri efekt pas perfundimit te periudhes 12 mujore.

Neni 20

Zgjidhja e Mosmarreshjeve

1. Çdo mosmarreshje ndermjet dy ose me shume paleve kontraktuese, qe ka te beje me interpretimin ose zbatimin e kesaj Konvente, do te zgjidhet, me sa eshte e mundur, nepermjet negociimit ndermjet tyre ose me ane te mjeteve te tjera te zgjidhjes se mosmarreshjeve.
2. Çdo mosmarreshje ndermjet dy ose me shume paleve, qe ka te beje me interpretimin ose zbatimin e kesaj Konvente, e cila nuk mund te zgjidhet me mjetet qe tregohen ne paragrafin e pare te ketij neni, me kerkesen e njerit prej tyre, do t'i parashtrahet nje gjykate arbitrazhi, e perhere si me poshte: secila pale ne mosmarreshje do te emeruje nje arbiter dhe te dy arbitrat e caktuar nga palet, caktojne nje arbiter tjeter i cili do te jete kryetari i arbitrazhit. Ne qofte se nje muaj pas marrjes se kerkeses, njera nga palet ka deshtuar ne emerimin e arbitrit te saj, ose ne qofte se arbitrat kane deshtuar ne zgjedhjen e kryetarit, secila nga palet mund t'i kerkoje Sekretarit te Pergjithshem te Kombeve te Bashkuara, te emeruje nje arbiter ose kryetar te gjykates se arbitrazhit.
3. Vendimi i gjykates se arbitrazhit, i marre sipas paragrafit 2, do te jete perfundimtar dhe i detyrueshem per secilen pale ne mosmarreshje.
4. Gjykata e arbitrazhit do te percaktoje rregullat e saj te procedimit.
5. Gjykata e arbitrazhit do te mare vendimet e saj me ane te votimit te shumices, ne baze te marreshjeve qe ekzistojne ndermjet paleve ne mosmarreshje dhe sipas ligjeve te pergjithshme nderkombetare.
6. Çdo kundershtrim, i cili mund te ngrihet nderm jet paleve per mosmarreshjen ne lidhje me interpretimin dhe ekzekutimin e vendimit te gjyqit, mund te dergohet, nga secila pale, per gjykim ne gjykatën e arbitrazhit e cila ka marre vendimin e gjykimit.
7. Secila pale ne mosmarreshje do te mare persiper shpenzimet lidhur me arbitrin e emeruar dhe te perfaqesuesve te tij ne nje proces arbitrazhi, shpenzimet e Kryetarit dhe shpenzimet e tjera te cilat do te ndahen ne pjese te barabarta ndermjet paleve ne mosmarreshje.

Neni 21

Rezervimet

1. Çdo pale kontraktuese mundet, ne kohen e nenshkrimtit, te ratifikimit, pranimit ose aprovimit te kesaj Konvente ose te aderimit ne te, te deklarroje se nuk e konsideron veten te lidhur me nenin 20/2 deri ne paragrafin 7 te kesaj Konvente. Palet e tjera kontraktuese, nuk do te jene te lidhur me kete paragraf, ne marredhenie me çdo shtet, pale te kesaj Konvente, e cila e ka bere nje rezervim te tille.
2. Çdo pale kontraktuese, qe ka bere nje rezervim sipas paragrafit te mesiperm, mund ne çdo kohe te terheqe kete rezervim, duke njoftuar Sekretarin e Pergjithshem te OKB-se.
3. Pervec rezervimit, qe eshte parashikuar ne paragrafin 1 te ketij neni, nuk do te lejohet asnje lloj rezervimi tjeter qe mund te behet nga çdo pale e kesaj Konvente.

Neni 22

Procedura per ndryshime ne kete Konvente

1. Kjo Konvente, duke perfshire dhe anekset e saj, mund te ndryshoje me propozimin e paleve kontraktuese, sipas procedurave te vecanta te ketij neni.
2. Çdo ndryshim, i propozuar ne kete Konvente, do te merret ne shqyrtim nga nje Komitet Administrativ i perbere nga te gjitha palet kontraktuese, duke respektuar rregullat e procedures te perfshira ne aneksin 7. Çdo ndryshim qe eshte shqyrtuar ose miratuar gjate takimit te Komitetit Administrativ dhe eshte adaptuar nga ai, duhet te komunikohet nga Sekretari i Pergjithshem i OKB-se paleve kontraktuese per aderim.
3. Çdo ndryshim, i propozuar dhe i komunikuar ne pajtim me paragrafin e mesiperm, do te hyje ne fuqi per te gjitha shtetet pale te kesaj Konvente, 3 muaj pas perfundimit te periudhes 12 mujore, duke filluar afati qe nga data e komunikimit te ndryshimit te propozuar, periudhe gjate se ciles, asnje kundershtrim per ndryshimin e bere nuk eshte paraqitur tek Sekretari i Pergjithshem i OKB-se nga shteti i cili eshte pale e kesaj Konvente, ose nga nje organizate rajonale e integritit ekonomik, e cila eshte pale e kesaj Konvente dhe vepron ne perputhje me kushtet e percaktuara ne nenin 16 te paragrafit 2 te kesaj Konvente.
4. Ne qofte se nje kundershtrim per ndryshimin e propozuar eshte komunikuar lidhur me paragrafin 3 te ketij neni, ndryshimi do te merret si i papranuar dhe nuk do te kete asnje lloj efekti.

Neni 23

Kerkesat, komunikimet dhe kundershtrimet

1. Sekretari i Pergjithshem i OKB-se do te njoftoje te gjitha palet kontraktuese dhe te gjitha shtetet per çdo kerkese, komunikim ose kundershtrim sipas nenit 22, si dhe per daten ne te cilen çdo amendament hyn ne fuqi.

Neni 24

Konferenca Rishikuese

Pas nje kohe 5-vjeçare pas hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente, çdo pale e kesaj Konvente, nepermjet njoftimit te Sekretarit te Pergjithshem te OKB-se, te kerkoje te mbledhe konferencen me qellimin e rishikimit te Konventes, duke treguar edhe propozimet te cilat do te jene objekt diskutimi nga Konferenca. Ne keto raste:

1. Sekretari i Pergjithshem i OKB-se do te njoftoje te gjitha palet nenshkruese per kerkesen e bere nga nje shtet dhe t'i ftoje ato te parashtrojne, brenda nje kohe prej 3 muajsh, komentet e tyre, lidhur me propozimet ose me propozimet e tjera te cilat konferenca mund t'i marre ne konsiderate per t'i diskutuar.
2. Sekretari i Pergjithshem i OKB-se do t'i jape te gjitha paleve tekstin e propozimeve dhe do te mbledhe konferencen nese, 6 muaj pas komunikimit ne fjale, jo me pak se 1/3 e paleve te kene njoftuar Sekretarin e Pergjithshem te OKB-se per miratimin e tyre per mbledhjen e kesaj Konference.
3. Megjithate, ne qofte se Sekretari i Pergjithshem i OKB-se e konsideron se nje propozim per rishikimin e Konventes ka te beje me teper me amendimin e tij, siç parashikohet edhe ne nenin 22/1, ai mund, duke mare edhe pelqimin e pales qe ka bere propozimin, te zbatoje procedurat e ndryshimit te parashikuar ne nenin 22, ne vend te perdorimit te procedures se

rishikimit.

Neni 25

Njoftimet

Perveç rasteve të lajmerimeve dhe komunikimeve të parashikuara në nenet 23 dhe 24, Sekretari I Pergjithshem i OKB-se do të njoftojë të gjitha shtetet përsa vijon:

- (a) nënshkrimet, ratifikimet, pranimet dhe aderimet në baze të nenit 16;
- (b) (b) datat e hyrjen në fuqi të Konventes, në zbatim të nenit 17 të kësaj Konvente;
- (c) (c) denoncimet, në baze të nenit 18;
- (d) mbarimin e kësaj Konvente, në baze të nenit 19.

Neni 26

Kopjet origjinale

Pas 31 Marsit 1984, Sekretari i Pergjithshem i OKB-se do të komunikojë dy kopje të vertetuara të kësaj Konvente seciles pale të kësaj Konvente, si dhe të gjitha shteteve të tjera që nuk janë pale të kësaj Konvente.

Be re në Gjenevë në datën 21 Tetor 1982, në një kopje origjinale. Kopjet në anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht janë njelloj autentike.

Sa më sipër, palet e autorizuara e kanë nënshkruar këto Konvente.

ANEKSI 1

HARMONIZIMI I KONTROLLIT DOGANOR DHE KONTROLLEVE TË TJERA

Neni 1

Parimet

1. Duke pasur parasysh që shërbimi doganor ekziston në çdo vend, si dhe nisur nga natyra e tij e përgjithshme, të tjera kontrolle përveç atij doganor, për sa është e mundur, do të organizohen në një mënyrë të koordinuar me kontrollet doganore.
2. Në zbatim të këtij parimi, është e mundur që të sigurohet përdorimi i procedurave të cilat do të mund të lehtësojnë levizjen e lire të mallrave, në qoftë se këto kontrolle ose pjesët e tyre do të ushtrohen jo në pikat e kalimit të kufirit.

Neni 2

1. Shërbimet doganore do të mbahen vazhdimisht të informuara për kërkesat ligjore ose rregulloret të cilat zbatohen në rastet e kontrolleve të tjera përveç kontrolleve doganore.
2. Kur gjykohet se të tjera kontrolle janë të nevojshme, doganat do të marrin masa që shërbimet e kryera për kontrollet e tjera, ndryshe nga kontrolli doganor, të bashkëpunojnë me këto të fundit.

Neni 3

Organizimi i Kontrolleve

1. Kur kontrolle te ndryshme duhet te organizohen ne te njejtin vend, organet kompetente te sherbimit do te marrin masat e duhura per te kryer keto kontrolle ne te njejten kohe, ne qofte se eshte e mundur dhe me sa me pak vonese.
2. Ne veçanti, organet kompetente do te marrin te gjitha masat e nevojshme per sigurimin e personelit dhe te lehtesive te tjera ne vendin ku do te kryhen kontrollet.
3. Doganat mund, nepermjet delegimit te shprehur te pushtetit nga organet kompetente te sherbimit, te kryeje ne emer te tyre te gjitha ose pjese te kontrolleve per te cilat organet kompetente jane pergjegjese. Ne kete rast, keto sherbime, do te marrin masa per ofrimin e mjeteve te duhura doganave per te kryer kontrollin e deleguar.

Neni 4

Rezultatet e Kontrollit

1. Te gjitha çeshtjet per te cilat ben fjale kjo Konvente, sherbimet e kontrollit dhe sherbimet doganore do te shkembjne te gjitha informacionet lidhur me keto kontrolle sa me shpejt qe te jete e mundur, per te siguruar efikasitetin e kontrollit.
2. Ne baze te rezultateve te kontrolleve te kryera, autoritetet kompetente do te vendosin se çfare trajtimi do t'i nenshtrohen mallrat e kontrolluara, dhe, ne qofte se eshte e nevojshme, do te informojne sherbimet pergjegjese per kryerjen e ketyre kontrolleve. Ne baze te ketij vendimi, sherbimi doganor do te zbatoje procedurat e veçanta doganore.

ANEKSI 2

KONTROLLI MJEKO- VETERINAR

Neni 1

Parimet

Kurdo qe te kryhet ky kontroll, ai do te respektoje parimet e parashtruara ne kete Konvente dhe sidomos ato te perfshira ne Aneksin e pare.

Neni 2

Informacioni

Cdo pale kontraktuese do te siguroje qe informacioni, lidhur me mallrat e meposhtme, te jete ne dispozicion te çdo subjekti te interesuar duke perfshire:

mallrat te cilat i nenshtrohen kontrollit mjeko-sanitar;
vendet ne te cilat mallrat do te mund te paraqiten per ushtrimin e kontrollit;

kerkesat e percaktuara nga ligje dhe rregullore per kontrollet mjeko-sanitare, si dhe procedurat per aplikimin e tyre.

Neni 3

Organizimi i Kontrolleve

1. Sherbimet e kontrollit do te marrin masa per sigurimin e lehtesive, ne pikat ku do te kryhet kontrolli mjeko-sanitar.

2. Kontrolli mjeko-ligjor mund të kryhet edhe në brendësi të territorit të një vendi, në qoftë se, nga certifikata e mallrave të transportuara dhe mjetet e transportit të cilat janë përdorur për transportimin e tyre, vërtetohet se mallrat nuk do të pesojnë ndonjë dëm ose do të shkaktojnë infektim gjatë transportimit të tyre.

3. Brenda kuadrit të kësaj Konvente, palet kontraktuese do të përpiqen sa është e mundur, të ulin numrin e kontrolleve të mallrave të cilat janë në tranzitim

4. Kur mallrat duhet të ruhen derisa të perfundojnë procedurat e kontrollit mjeko-sanitar, shërbimet e organeve kompetente të çdo vendi, do të marrin masa për depozitimin e mallrave. Ky depozitim do të duhet të sigurojë kushtet e nevojshme për ruajtjen e mallrave, duke respektuar një minimum të kushteve të depozitimit të tyre.

Neni 4 Mallrat në Transit

Brenda kuadrit të kësaj Konvente, për sa është e mundur, palet kontraktuese do të merren me kontrollin mjeko-sanitar të mallrave në transit, duke respektuar kushtet që tranzitimi i tyre të mos sjellë rrezik për sëmundje infektive.

Neni 5 Bashkëpunimi

1. Shërbimet e inspektimit mjeko-sanitar do të bashkëpunojnë me shërbimet e njëjta të paleve kontraktuese, duke pasur si qëllim lehtësimin e kalimit të mallrave të prishura, të cilat do t'i nënshtrohen kontrollit mjeko-sanitar, duke shkëmbyer informacionin e nevojshëm.

2. Kur ngarkesa e mallrave të prishura është zbuluar gjatë kontrollit mjeko-sanitar, shërbimet kompetente do të përpiqen të njoftojnë shërbimet e njëjta të vendeve të tjera, për destinacionin e tyre brenda një kohe sa më të shkurtër që të jetë e mundur, duke përcaktuar arsyet të cilat çuan në kryerjen e kontrollit dhe masat pasuese të marra lidhur me mallrat e kontrolluara.

ANEKSI 3

KONTROLI VETERINAR

Neni 1 Parimet

Kurdo që të kryhet kontrolli veterinar, do të respektoje parimet e parashtruara në këtë Konventë dhe, sidomos, ato të përfshira në Aneksin e parë.

Neni 2 Përkufizimet

Kontrolli veterinar, i përcaktuar në nenin 1 (d) të kësaj Konvente, mbulon gjithashtu edhe kontrollin mbi mjetet dhe kushtet e transportit të kafsheve dhe të prodhimeve të kafsheve. Ky kontroll mund të përfshijë edhe kontrollet lidhur me cilesinë, standardet dhe rregullat e ndryshme, si p. sh. kontrolli që synon ruajtjen e llojeve të rrezikuara, të cilat, për arsye të rritjes së efektivitetit, shoqërohen me kontrolle veterinarë.

Neni 3 Informacioni

Çdo pale kontraktuese do të marrë masa që informacioni të sigurohet çdo personi të interesuar lidhur me çështjet e mëposhtme

Mallrat të cilat i nënshtrohen kontrollit veterinar;
Vendet ku këto mallra i nënshtrohen kontrollit
Njoftimet e detyrueshme lidhur me semundjet e mundshme;
Kërkesat ligjore lidhur me kontrollin veterinar, si dhe procedurat respektive lidhur me zbatimin e tij.

Neni 4 Organizimi i Kontrolleve

1. Palet kontraktuese do të perpiqen: të ngrenë, kur është e nevojshme dhe e mundshme, strukturat ndihmëse për kontrollin veterinar, të cilat duhet të jenë në përputhje të plote me kërkesat e qarkullimit të këtyre mallrave; të krijojnë lehtësi për levizjen e mallrave, sidomos duke koordinuar orët e punës së shërbimit të kontrollit veterinar me shërbimin e kontrollit doganor, si dhe duke siguruar marrëveshje për kontrollin pas orarit zyrtar të punës, kur ardhja e mallrave është lajmëruar me përparësi.

2. Kontrolli veterinar i prodhimeve të kafshëve duhet të kryhet në pikat e caktuara nga vendi pritës, duke marrë masa që një vend i tillë të tregohet; si dhe mjetet e përdorura për transportimin e tyre të mos sjellin keqesim ose përhapjen e semundjeve ngjitëse gjatë transportimit të tyre.

3. Në kuadër të kësaj Konvente, palet kontraktuese do të perpiqen të ulin, sa të jenë e mundur, kontrollet fizike të mallrave të prishura në tranzitim.

4. Kur mallrat do të duhet të mbahen derisa të perfundojë kontrolli veterinar, shërbimet e organeve kompetente të çdo pale duhet të marrin masa për depozitimin e tyre në vende të caktuara duke pasur parasysh që një depozitim i tillë të bëhet me sa më pak shpenzime dhe depozitimi në fjalë të sigurojë ruajtjen dhe mosdëmtimin e mallrave të depozituara.

Neni 5 Mallrat në Transit

Në kuadër të kësaj Konvente, çdo pale kontraktuese, sa të jenë e mundur, të reduktojë kontrollin veterinar të prodhimeve të kafshëve në tranzitim, kur, nisur nga rrethanat, nuk ka ndonjë rrezik për infektim me semundje ngjitëse.

Neni 6 Bashkëpunimi

1. Shërbimet e kontrollit veterinar do të bashkëpunojnë me shërbimet përkatëse të vendeve të tjera, në mënyrë që të lehtësohet kalimi i mallrave të cilat i nënshtrohen një kontrolli të tillë, duke shkëmbyer informacionin e duhur.

2. Kur një ngarkesë e mallrave të prishura ose ngarkesë në kafshë të gjalla është zbuluar gjatë kontrollit veterinar të tyre, atëherë autoritetet kompetente do të perpiqen të njoftojnë shërbimet përkatëse të vendit nga është eksportuar malli, brenda një kohe sa më të shkurtrë, duke treguar arsyet të cilat çuan në kryerjen e këtij kontrolli dhe masat e marra në këto rast.

ANEKSI 4

KONTROLI FITOSANITAR

Neni 1 Parimet

Kurdo që të kryhet kontrolli veterinar, do të respektoje parimet e parashtruara në këto Konvente dhe sidomos ato të përfshira në Aneksin e parë.

Neni 2 Perkufizimet

Kontrolli fitosanitar i përcaktuar në nenin 1 (e) të kësaj Konvente mbulon edhe kontrollin e mjeteve dhe të kushteve të transportimit të bimeve dhe të prodhimeve të tyre. Ky kontroll mund të përfshijë edhe masat të cilat synojnë në ruajtjen e llojeve të bimeve të cilat janë të rrezikuara.

Neni 3 Informacioni

Çdo pale kontraktuese do të marrë masa që informacioni të sigurohet çdo personi të interesuar, lidhur me çështjet e mëposhtme:

Mallrat të cilat i nënshtrohen kontrollit fitosanitar;
Vendet ku bimët ose prodhimet e tyre do t'i nënshtrohen kontrollit;
Listën e sëmundjeve të bimeve ose prodhimeve të tyre, për të cilat ka një sërë ndalimesh ose kufizimesh;
Listën e kërkesave ligjore, lidhur me kontrollin fitosanitar, si dhe procedurat respektive lidhur me zbatimin e tij;

Neni 4 Organizimi i Kontrolleve

1. Palet kontraktuese do të perpiqen:

të ngrenë, kur shihet e nevojshme dhe e mundshme, mjetet e nevojshme, si kontrollin e duhur fitosanitar, depozitimin dhe dezinfektimin e bimeve dhe prodhimeve të tyre, duke respektuar edhe kërkesat e qarkullimit të tyre;

të lehtësojnë levizjen e lirë të mallrave, sidomos koordinimin e orëve të punës së shërbimeve të kontrollit fitosanitar në ato të kontrollit doganor, si dhe duke siguruar marrëveshje për kontrollin pas orarit zyrtar të punës kur ardhja e mallrave është lajmëruar me parë.
2. Kontrolli fitosanitar i bimeve dhe prodhimeve të tyre duhet të kryhet në pikat e caktuara nga vendi prites, duke marrë masa që një vend i tillë të tregohet, si dhe mjetet e transportit të përdorura për transportimin e tyre të mos sjellin keqesim ose përhapjen e sëmundjeve ngjitesë gjatë transportimit të tyre.

3. Në kuadër të kësaj Konvente, palet kontraktuese do të perpiqen të ulin, sa të jetë e mundur, kontrollet fizike të bimeve ose prodhimeve të tyre të prishura të cilat janë në tranzitim.

4. Kur mallrat do të duhet të mbahen derisa të përfundojë kontrolli fitosanitar, shërbimet e organeve kompetente të çdo pale duhet të marrin masa për depozitimin e tyre në vende të caktuara, duke pasur parasysh që një depozitim i tillë të bëhet sa më pak shpenzime dhe depozitimi në fjalë të sigurojë ruajtjen dhe mosdëmtimin e mallrave të depozituara.

Neni 5 Mallrat në Transit

Ne kuader te kesaj Konvente, çdo pale kontraktuese, sa te jete e mundur, do te reduktoj kontrollin fitosanitar te bimeve dhe te prodhimeve te tyre, kur, nisur nga rrethanat, keto mos shihen te rendesishem per mbrojtjen e bimeve.

Neni 6 Bashkepunimi

1. Sherbimet e kontrollit fitosanitar do te bashkepunojne me sherbimet perkatese te vendeve te tjera, ne menyre qe te lehtesohet kalimi i bimeve ose prodhimeve te tyre, te cilat i nenshtrohen nje kontrolli te tille, duke shkëmbyer informacionin e duhur.

2. Kur nje ngarkese e bimeve ose prodhimeve te tyre te prishura, eshte zbuluar gjate kontrollit fitosanitar te tyre, atehere autoritetet kompetente do te perpiqen te njoftojne sherbimet perkatese te vendit nga eshte eksportuar bima brenda nje kohe sa me te shkurter, duke treguar arsyet te cilat çuan ne kryerjen e ketij kontrolli dhe masat e marra ne kete rast.

ANEKSI 5

KONTROLLI I PERPUTHSHMERISE ME STANDARDET TEKNIKE

Neni 1 Parimet

Kurdo qe zbatohet ky lloj kontrolli, ai duhet te jete ne perputhje me standardet teknike, lidhur me mallrat e perfshira ne kete Konvente, do te duhet te perputhet me parimet e parashtruara ne Konvente dhe sidomos ne Aneksin 1.

Neni 2 Informacioni

Secila pale do te siguroje qe informacioni te jete ne dispozicion te çdo personi te interesuar lidhur me:

Standardet e aplikuara ne te;

Vendin ne te cilin do te behet kontrolli i mallrave;

Kerkesat ligjore, lidhur me perputhshmerine e kontrolleve me standardet teknike, si dhe procedurat e zbatuara per kryerjen e ketyre kontrolleve.

Neni 3 Harmonizimi i Standardeve

Ne mungese te standardeve nderkombetare, palet kontraktuese te cilat gjate ketyre kontrolleve zbatojne standarde kombetare, do te marrin masat qe keto standarde kombetare te jene ne perputhje me kerkesat qe rrjedhin nga marreveshjet nderkombetare.

Neni 4 Organizimi i Kontrolleve

1. Palet kontraktuese do te perpiqen:

te ngrene, kur shihet e nevojshme dhe e mundshme, qendrat per perputhjen e kontrollit te kryer me standardet teknike, duke respektuar edhe kerkesat e qarkullimit te tyre; te lehtesoje levizjen e lire te mallrave, sidomos koordinimin e oreve te punes se sherbimeve te kontrollit per perputhshmerine e kontrolleve, me standardet teknike me ate doganor, si dhe duke siguruar marreveshje per kontrollin pas orarit zyrtar te punes, ku ardhja e mallrave eshte lajmeruar me pare.

2. Kontrolli i perputhshmerise me standardet teknike duhet te kryhet ne pikat e caktuara nga vendi prites, duke marre masa qe nje vend i tille te tregohet, si dhe mjetet e transportit te perdorura per transportimin e tyre te mos sjellin keqesim gjate transportimit te tyre.

3. Ne kuader te kesaj Konvente, palet kontraktuese do te perpiqen te ulin, sa te jete e mundur, kontrollet fizike te mallrave te prishura qe jane ne tranzitim, te cilat i nenshtrohen kontrollit per perputhshmerine me standardet teknike.

4. Palet kontraktuese do te organizojne kontrolle te perputhshmerise me standardet teknike, duke harmonizuar, kur eshte e mundur, procedurat e zbatuara per kontrollin e mallrave, te kryer nga sherbimet pergjegjese, duke harmonizuar procedural edhe me sherbimet e tjera pergjegjese per kryerjen e kontrolleve te tjera.

5. Ne rastet e mallrave te prishura te cilat do te duhet te mbahen derisa te perfundoje kontrolli i perputhshmerise me standardet teknike, sherbimet e organeve kompetente te çdo pale duhet te marrin masa per depozitimin e tyre ne vende te caktuara, duke pasur parasysh qe nje depozitim i tille te behet me sa me pak shpenzime dhe depozitimi ne fjale te siguroje ruajtjen dhe mosdemptimin e mallrave te depozituara.

Neni 5
Mallrat ne Transit

Kontrollet per perputhshmerine e mallrave me standardet teknike nuk do te zbatohen mbi mallrat te cilat do te kalojne transit.

Neni 6
Bashkepunimi

1. Sherbimet pergjegjese per kontrollin e perputhshmerise se mallrave me standardet teknike do te bashkepunojne me sherbimet perkatese te vendeve te tjera, ne menyre qe t e lehtesohet kalimi i mallrave te prishura, te cilat i nenshtrohen nje kontrolli te tille, duke shkëmbyer informacionin e duhur.

2. Kur nje ngarkese e mallrave te prishura, eshte zbuluar gjate kontrollit te ushtruar per perputhshmerine e tyre me standardet teknike, atehere autoritetet kompetente do te perpiqen te njoftojne sherbimet perkatese te vendit nga eshte eksportuar malli brenda nje kohe sa me te shkurter, duke treguar arsyet te cilat çuan ne kryerjen e ketij kontrolli dhe masat e marra ne kete rast.

ANEKSI 6

KONTROLLI I CILESISE

Neni I

Parimet

Kurdo qe zbatohet kontrolli i cilesise se mallrave qe perfshihen ne kete Konvente, do te duhet te perputhet me parimet e parashtruara ne Konvente dhe sidomos ne Aneksin I.

Neni 2 Informacioni

Secila pale do te siguroje qe informacioni te jete ne dispozicion te çdo personi te interesuar lidhur me:

Vendin ne te cilin do te behet kontrolli i mallrave;

Kerkesat ligjore lidhur me perputhshmerine e kontrolleve te cilesise, si dhe procedural e zbatuara per kryerjen e ketyre kontrolleve.

Neni 3 Organizimi i Kontrolleve

1. Palet kontraktuese do te perpiqen:

te ngrene, kur shihet e nevojshme dhe mundshme; qendrat e kontrollit te cilesise, ne perputhje me kerkesat e qarkullimit te mallrave;

te lehtesojne levizjen e lire te mallrave, sidomos koordinimin e oreve te punes se sherbimeve te kontrollit te cilesise me ate doganor, si dhe duke siguruar marreveshje per kontrollin pas orarit zyrtar te punes per mallrat e prishura, kur ardhja e tyre eshte lajmeruar me pare.

2. Kontrolli i cilesise duhet te kryhet ne pikat e caktuara nga vendi prites, duke marre masa qe procedural e perdorura gjate kontrollit te lehtesojne levizjen nderkombetare te mallrave.

3. Ne kuader te kesaj Konvente, palet kontraktuese do te perpiqen te ulin, sa te jete e mundur, kontrollet fizike te mallrave te prishura qe jane ne tranzitim, te cilat i nenshtrohen kontrollit cilesor.

4. Palet kontraktuese do te organizojne kontrolle cilesore, duke harmonizuar, kur eshte e mundur, proceduralat e zbatuara per kontrollin e mallrave te kryer nga sherbimet pergjegjese, duke harmonizuar procedural edhe me sherbimet e tjera pergjegjese per kryerjen e kontrolleve te tjera.

Neni 4 Mallrat ne Transit

Kontrollet per cilesine nuk do te zbatohen mbi mallrat te cilat do te kalojne transit.

Neni 5 Bashkepunimi

1. Sherbimet pergjegjese per kontrollin e cilesise do te bashkepunojne me sherbimet perkatese te vendeve te tjera, ne menyre qe te lehtesohet kalimi i mallrave te prishura, te cilat i nenshtrohen kontrollit te cilesise, duke shkëmbyer informacionin e duhur.

2. Kur nje ngarkese e mallrave te prishura, eshte zbuluar gjate kontrollit cilesor te ushtruar, atehere autoritetet kompetente do te perpiqen te njoftojne sherbimet perkatese te vendit nga eshte eksportuar malli brenda nje kohe sa me te shkurter, duke treguar arsyet te cilat çuan ne kryerjen e ketij kontrolli dhe masat e marra ne kete rast.

ANEKSI 7

ADMINISTRATIV I CILI ESHTË PERMENDUR NE NENIN 22 TE KESAJ KONVENTE

Neni 1 Anetaret

Anetare te Komitetit Administrativ do te jene palet kontraktuese ne kete Konvente.

Neni2 Vezhguesit

1. Komiteti administrativ mund te vendose te ftoje administratoret kompetente nga te gjithë shtetet te cilat nuk jane pale te kesaj Konvente, ose perfaqesues te organizatave nderkombetare te cilat nuk jane pale kontraktuese per te ndjekur , pyetur per çeshtje qe interesojne atyre ne sesionet e Komitetit me statusin e vezhguesit.

2. Pa paragjykuar nenin 1 te kesaj Konvente, organizatat nderkombetare te cilave u referohemi ne paragrafin 1, te cilat jane kompetente per çeshtjet e adresuara atyre ne kuader te anekseve te kesaj Konvente, kane te drejten te marrin pjese si vezhgues ne punen e Komitetit administrativ.

Neni 3 Sekretariati

Sekretari i Komitetit do te caktohet nga Sekretari ekzekutiv i Komisionit Ekonomik per Evropën.

Neni 4 Mbledhjet e Komitetit

Sekretari ekzekutiv i Komisionit Ekonomik per Evropën do te mbledhe Komitetin:

- (i) Dy vjet pasi Konventa te kete hyre ne fuqi;
- (ii) Pastaj ne daten e caktuar nga Komiteti por jo me vone se ne periudhe 5-vjeçare;
- (iii) Me kerkesen e administratoreve kompetente se paku 5 shteteve te cilat jane pale te kesaj Konvente.

Neni 5 Zyrtaret

Komiteti do te zgjedhe nje Kryetar dhe nje nen-Kryetar me rastin e mbledhjes se çdo sezoni te tij.

Neni 6 Kuorumi

Nje kuorum i perbere nga jo me pak se 1/3 e shteteve te cilat jane pale te kesaj Konvente, kerkohet per efektin e marrjes se vendimit.

Neni 7 Vendimet

- (i) Propozimet do te hidhen ne vote;
- (ii) Çdo shtet pale e kesaj Konvente, do te kete te drejten e nje vote;

(iii) Në rastin e zbatimit të nenit 16/2 të Konventës, palët e organizatave të integritit ekonomik rajonal do të kenë vetëm një të drejtë vote e cila do të jetë shuma e votave të shteteve të cilat janë palë të kësaj organizate. Në këto raste shtetet palë të kësaj Konvente nuk kanë të drejtën e votes.

(iv) Në rastet e parashikuara në nënparagrafin e mëposhtëm, çdo propozim do të miratohet nga një mazhorancë e thjeshtë që përfshin anëtarët e pranishëm të cilët do të votojnë në pajtim me kushtet e përcaktuara në paragrafin (ii) dhe (iii).

(v) Ndryshimet e kësaj Konvente do të miratohen nga 2/3 e anëtarëve të pranishëm dhe që votojnë në përputhje me kushtet e përcaktuara në nënparagrafin (ii) dhe (iii).

Neni 8 Raporti

Para mbylljes së çdo sezoni, Komiteti do të miratojë raportin e tij.

Neni 9 Nene Shtese

Në mungesë të neneve të cilat nuk janë përfshirë në këtë Aneks, Rregullat e Procedurës të Komisionit Ekonomik për Evropën do të jenë drejtperdrejt të zbatueshme, përveç rasteve kur Komiteti vendos të veprojë ndryshe.



LIGJ

Nr. 9316, date 18.11.2004

**PER ADERIMIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE KONVENTEN
NDERKOMBETARE "PER ASISTENCE TE NDERSJELLE ADMINISTRATIVE NE
ÇESHTJET DOGANORE", Johaneshurgu.**

Ne mbeshtetje te neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqiperise aderon ne Konventen Nderkombetare "Per asistence te ndersjelle administrative ne ceshtjet doganore", bere ne Bruksel me 27 qershor 2003.

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4418, date 14.12.2004 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Alfred Moisiu

ORGANIZATA BOTERORE E DOGANAVE

PREAMBUL

Palet Kontraktuese ne kete Konvente, themeluar nen mbikeqyrjen e Keshillit te Kooperimit Doganor, tani e njohur si Organizata Boterore e Doganave,

duke ditur se bashkepunimi me i ngushte ndermjet administratave doganore eshte nje synim primar i Konventes qe ka themeluar nje keshill te kooperimit doganor, te bindur se bashkepunimi me efektiv ndermjet administratave doganore mund te arrihet nepermjet vullnetit te mire te Paleve Kontraktuese,

duke marre ne konsiderate rendesine e percaktimit te sakte te detyrimeve doganore dhe taksave te tjera dhe te sigurimit te ushtrimit te sakte nga administratat doganore te ndalimeve, kufizimeve dhe masave te kontrollit ne lidhje me mallra te caktuara,

duke marre ne konsiderate se shkeljet ndaj ligjeve doganore jane te demshme per sigurine e Paleve Kontraktuese dhe per interesat e tyre ekonomike, tregtare, fiskale, shoqerore, kulturore dhe te shendetit publik,

duke marre ne llogari kercenimin e krimit nderkombetar te organizuar dhe te grupeve terroriste me resurset e tyre thelbesore dhe nevojën per t'i luftuar efektivisht ato,

duke njohur shqetesimin e rritur global per sigurine dhe lehtesimin e rrjetit nderkombetar te furnizimit tregtar dhe Rezoluten e Keshillit te Kooperimit Doganor te qershorit 2002 lidhur me kete,

duke njohur rendesine e arritjes se nje ekuilibri ndermjet zbatimit te ligjit dhe lehtesimit per te siguruar levizjen e lire te tregtise se ligjshme dhe per te arritur nevojat e qeverive per mbrojtjen e shoqerise dhe te te ardhurave, te bindur se tregtia nderkombetare do te lehtesohet nepermjet adoptimit te teknikave moderne te kontrollit, si menaxhimi i riskut nga administratat doganore,

duke ditur se shkembimi nderkombetar i informacionit eshte nje komponent thelbesor i menaxhimit efektiv te riskut dhe se nje shkembim i tille informacioni duhet te bazohet ne dispozita te qarta ligjore,

duke marre ne konsiderate Konventen nderkombetare mbi ndihmen e ndersjelle administrative per parandalimin, hetimin dhe goditjen e shkeljeve doganore, adoptuar ne Najrobi me 9 qershor 1997 nen mbikeqyrjen e Keshillit te Kooperimit Doganor, i cili shtron nje strukture per lehtesimin e ndihmes se ndersjelle administrative ne çeshtjet doganore,

duke marre ne konsiderate Konventen e Kombeve te Bashkuara kunder krimit transnacional te organizuar, adoptuar ne Nju-Jork me 15 nentor 2000 dhe per te cilen u mbajt Konferenca Nenshkruese Politike e Nivelit te Larte ne Palermo me 12-15 dhjetor 2000, e cila shtron strukturen per ndihme te ndersjelle nderkombetare ne çeshtjet kriminale me synim parandalimin dhe luftën ndaj krimit te organizuar transnacional;

duke marre ne konsiderate konventat nderkombetare qe perfshijne ndalimet, kufizimet dhe masat e kontrollit lidhur me mallra te caktuara,

duke marre parasysh Deklaraten Universale te Kombeve te Bashkuara per te Drejtat e Njeriut te 1948;

Rane dakord per sa me poshte vijon:

KAPITULLI I PERKUFIZIME

Neni 1

Per qellimet e kesaj Konvente:

- a) "Komitet Administrativ" do te thote Komiteti Pergjegjes per Menaxhimin e kesaj Konvente siç percaktohet ne nenin 45;
- b) "Keshill" do te thote organizata e ngritur nga Konventa themeluese e Keshillit te Kooperimit Doganor, kryer ne Bruksel me 15 dhjetor 1950 dhe hyre ne fuqi me 4 nentor 1952;
- c) "Zyrtar i Keshillit" do te thote çdo zyrtar apo punonjes i Keshillit dhe çdo person tjetër i caktuar nga Sekretari i Pergjithshem per te kryer funksionet ne zbatim te kesaj Konvente;
- d) "Bashkepunim nderkufitar" do te thote bashkepunimi ndermjet administratave doganore te Paleve Kontraktuese ndermjet kufijve te tyre respektive;
- e) "Administratë doganore" do te thote autoriteti doganor dhe çdo autoritet tjetër i Paleve Kontraktuese i autorizuar sipas legjislacionit kombetar nga kjo Pale Kontraktuese per te zbatuar dispozitat e kesaj Konvente;
- f) "Pretendime doganore" do te thote çdo sasi e detyrimeve doganore te cilat nuk mund te

- grumbullohen ne njeren prej Paleve Kontraktuese;
- g) "Detyrime doganore" do te thote te gjitha detyrimet, taksat, kuotat dhe te tjera te cilat ushtrohen ne territoret e Paleve Kontraktuese ne zbatim te ligjit doganor, por qe nuk perفشijne taksa dhe detyrime te tjera per sherbimet e kryera;
- h) "Ligj doganor" do te thote çdo dispozite ligjore apo administrative e zbatuar apo e ushtruar nga administrata doganore e nje Pale Kontraktuese lidhur me importimin, eksportimin, transitin, transngarkimin, magazinimin dhe levizjen e mallrave, duke perفشire dispozitat ligjore dhe administrative lidhur me masat e ndalimit, kufizimit dhe kontrollit, dhe per te luftuar larjen e parave;
- i) "Shkelje doganore" do te thote çdo shkelje ose perفشekje per shkelje te ligjit doganor te nje Pale Kontraktuese;
- j) "Union Ekonomik ose Doganor" do te thote nje bashkim, i konstatuar dhe perbere nga anetare, i cili ka kompetence te adoptoj e rregullat e veta te cilat jane te detyrueshme per anetaret e vet ne respekt te çeshtjeve te trajtuara nga kjo Konvente, dhe ka kompetenca te vendose, ne perفشutje me procedurat e veta te brendshme per te firmosur, ratifikuar apo hyre ne kete Konvente;
- k) "Komiteti i Antikontrabandes" do te thote Komiteti i Antikontrabandes se Keshillit;
- l) "Informacion" do te thote çdo e dhene, e perفشuar dhe analizuar ose jo, si dhe dokumente, raporte, dhe komunikime te tjera ne çdo format, perفشire ato elektronike, ose kopje te certifikuara dhe te autentifikuara te ketyre;
- m) "Rrjeti nderkombetar i furnizimit te tregtise" do te thote te gjitha proceset e perفشira ne levizjen nderkufitare te mallrave nga vendi i origjines deri ne vendin e destinacionit final;
- n) "Nepunes" do te thote çdo zyrtar i doganes ose agjente te tjere qeveritare te caktuar nga nje administrate doganore;
- o) "Person" do te thote si person fizik, ashtu edhe person juridik, me perفشashtim te rasteve kur konteksti nenkupton diçka tjeter;
- p) "Te dhena personale" do te thote çdo e dhene lidhur me nje person fizik te identifikuar apo te identifikueshem;
- q) "Ratifikim" do te perفشijje pranimin ose aprovimin;
- r) "Administrate kerkuese" do te thote administrata doganore qe kerkon ndihme;
- s) "Administrate e kerkuar" do te thote administrata doganore nga e cila kerkohet ndihme; t) "Pale Kontraktuese kerkuese" do te thote Pala Kontraktuese, administrata doganore e se ciles kerkon ndihme;
- u) "Pale Kontraktuese e kerkuar" do te thote Pala Kontraktuese, administrata doganore e se ciles kerkohet te mundesoje ndihme;
- v) "Sekretar i Pergjithshem" do te thote Sekretari i Pergjithshem i Keshillit.

KAPITULLI II FUSHEMBULIMI I MARREVESHJES

Neni 2

1. Palet Kontraktuese, nepermjet administratave te tyre doganore, do t'i mundesoje njera-tjetres ndihme administrative sipas termave te vendosura ne kete Konvente, per zbatimin e sakte te legjislacionit doganor, per parandalimin, hetimin dhe luften ndaj shkeljeve doganore, si dhe per te garantuar sigurimin e rrjetit nderkombetar te furnizimit tregtar.
2. Çdo aktivitet i kryer sipas kesaj Konvente nga Palet Kontraktuese do te jete ne perفشutje me dispozitat ligjore dhe administrative dhe brenda limiteve te kompetencave dhe resorceve te mundshme te administrates se vet doganore.
3. Çdo Pale Kontraktuese do te njoftoje Sekretarin e Pergjithshem per autoritetet e permendura ne nenin 1(e), te autorizuar sipas legjislacionit kombetar dhe te caktuara nga kjo Pale Kontraktuese per te zbatuar çdo dispozite te kesaj Konvente. Sekretari i Pergjithshem do t'ua komunikojte kete informacion, si dhe zhvillimet e reja lidhur me kete Paleve te tjera Kontraktuese.

4. Kjo Konvente mbulon vetem ndihmen e ndersjelle administrative ndermjet Paleve Kontraktuese dhe nuk synon te kete pasoja mbi marreveshjet e ndihmes se ndersjelle ligjore ndermjet tyre. Nese ndihma e ndersjelle do te mundesohet nga autoritete te tjera te Pales Kontraktuese te kerkuar, administrata e kerkuar do te ndikojte keto autoritete dhe kur njihen marreveshjet apo rregullimet e zbatueshme.

5. Dispozitat e kesaj Konvente nuk do t'i japin te drejte nje Pale per ndonje person qe te pengoje ekzekutimin e kerkeses per ndihme.

KAPITULLI III PROCEDURAT E NDIHMES SE PERGJITHSHME

Neni 3 Komunikimi i kerkesave

1. Kerkesat per ndihme sipas kesaj Konvente do te komunikohen direkt ndermjet administratave doganore te interesuara. Secila administrate doganore do te caktojte nje pike zyrtare kontakti per kete qellim dhe keto te dhena do t'i jepen Sekretarit te Pergjithshem. Sekretari i Pergjithshem do t'ua komunikojte kete informacion, si dhe çdo rifreskim te ketij informacioni administratave te tjera doganore.

2. Kerkesat per ndihme sipas kesaj Konvente do te behen me shkrim ose ne rruge elektronike dhe do te shoqerohen nga nje informacion qe konsiderohet i nevojshem per qellimin e permbushjes se kerkeses. Administrata e kerkuar mund te kerkoje konfirmim me shkrim te kerkeses elektronike. Kur e kerkojne situatat, kerkesa mund te behet me goje. Nje kerkesa e tille duhet te konfirmohet sa me shpejt te jete e mundur me shkrim ose nese pranohet nga administrata e kerkuar, me rruge elektronike.

3. Kerkesat duhet te behen ne nje gjuhe te pranueshme nga administrata doganore e interesuar. Çfaredolloj dokumenti shoqerues i kerkeses do te perkthehet per aq sa eshte e nevojshme ne nje gjuhe reciprokisht te pranuar. Administrata e kerkuar gjithsesi do ta pranoje kerkesen per ndihme dhe dokumentet shoqeruese, ne njerën prej gjuheve zyrtare te Keshillit te cilen ajo percakton.

4. Kerkesat e bera ne perputhje me paragrafin 2 te ketij neni do te permbajne detajet e meposhtme:

- a) emrin e administrates kerkuese;
- b) çeshtjen, llojin e ndihmes se kerkuar dhe arsyet per kerkesen;
- c) nje pershkrim te permbledhur te çeshtjes, si dhe dispozitat ligjore dhe administrative qe zbatohen;
- d) emrat dhe adresat e personave me te cilet ka te beje çeshtja nese dihen;
- e) nje reference ne perputhje me paragrafin 2 te nenit 42, nese aplikohet;
- f) verifikimet e bera ne perputhje me paragrafin 2 te nenit 7.

5. Kur administrata kerkuese kerkon qe te ndiqet nje procedure apo metodologji e caktuar, administrata e kerkuar do t'i pergjigjet kerkeses kushtezuar nga dispozitat e veta kombetare ligjore dhe administrative.

Neni 4 Ndhma spontane

Per rastet qe perfshijne deme thelbesore per ekonomine, shendetin publik, sigurine publike, duke perfshire sigurine e rrjetit nderkombetar te furnizimit te tregtise, ose interesa te tjera vitale te nje Pale Kontraktuese, administrata doganore e nje Pale Kontraktuese, sa here te jete e mundur do te furnizojte me ndihme sipas iniciatives se vet dhe pa vonese.

KAPITULLI IV INFORMACIONI

Neni 5

Informacion per zbatimin dhe ushtrimin e ligjit doganor

Administratat doganore do t'i mundesojne njera-tjetres sipas kerkeses ose me iniciativen e vet, informacion i cili ndihmon per te siguruar zbatimin e sakte te ligjit doganor dhe parandalimin, hetimin dhe luften ndaj shkeljeve doganore dhe per te garantuar sigurine e rrjetit nderkombetar te furnizimit te tregtise. Ky informacion duhet te permbaje:

- a) teknika te reja antikontabande te cilat kane treguar efektivitetin e tyre;
- b) tendenca te reja, mjete dhe metoda per kryerjen e shkeljeve doganore;
- c) mallra te njohura si subjekt i shkeljeve doganore, si dhe metoda transporti dhe magazinimi te perdorura lidhur me keto mallra;
- d) persona te njohur se kane kryer nje shkelje doganore ose te dyshuar se jane gati te kryejne nje shkelje doganore;
- e) te dhena te tjera qe mund te asistojne administratat doganore mbi percaktimin e riskut per qellime kontrolli dhe lehtesimi.

Neni 6

Informacioni lidhur me shkeljet doganore

Administrata doganore e nje Pale Kontraktuese do t'i mundesoje administrates doganore te nje Pale tjeter Kontraktuese te interesuar, sipas iniciatives ose sipas kerkeses, informacion mbi veprime te planifikuara, ne vazhdim apo te kryera, te cilat japin baza te arsyeshme per te besuar se eshte kryer ose do te kryhet nje shkelje doganore ne territorin e Pales Kontraktuese te interesuar.

Neni 7

Informacion mbi percaktimin e detyrimeve dhe taksave te importit ose eksportit

1. Sipas kerkeses, administrata e kerkuar, pa paragjykuar nenin 42, ne mbeshtetje te zbatimit te sakte te ligjit doganor ose per parandalimin e kontrabandes, do te mundesoje informacion per te ndihmuar administraten e kerkuar, e cila ka arsye per te dyshuar mbi vertetesine apo origjinalitetin e nje deklarate.
2. Kerkesa do te specifikoje procedurat e verifikimit per te cilat eshte perpjekur apo ka ndermarre administrata kerkuese, si dhe informacionin specifik te kerkuar.

Neni 8

Lloje te vecanta informacioni

Sipas kerkeses, administrata e kerkuar do t'i mundesoje administrates kerkuese, e cila ka arsye te dyshoje mbi vertetesine e informacionit te dhene asaj mbi nje ceshtje doganore, informacion:

- a) nese mallrat e importuara ne territorin e Pales Kontraktuese kerkuese jane eksportuar ne menyre te ligjshme ne territorin e Pales Kontraktuese te kerkuar;
- b) nese mallrat e eksportuara nga territori i Pales Kontraktuese kerkuese jane importuar ligjerisht ne territorin e Pales Kontraktuese te kerkuar, si dhe procedurat doganore, nese ka, nen te cilat jane vendosur mallrat.

Neni 9
Shkembimi automatik i informacionit

Palet Kontraktuese, sipas rregullimeve te ndersjella ne perputhje me paragrafin 2 te nenit 48, mund te shkembejne informacion te mbuluar nga kjo Konvente, mbi baza automatike.

Neni 10
Shkembimi paraprak i informacionit

1. Palet Kontraktuese, nepermjet rregullimeve te ndersjella ne perputhje me paragrafin 2 te nenit 48, mund te shkembejne informacion specifik para mberritjes se ngarkesave ne territoret e tyre respektive per te garantuar ne veçanti, sigurine e rrjetit nderkombetar te furnizimit te tregtise.

2. Nje informacion i tille, sa me shume qe te jete e mundur, duhet te permbaje te dhenat e meposhtme:

- i) Derguesin ose kodin e derguesit, eksportues in ose kodin e eksportuesit;
- ii) Pershkrimin e mallrave ose numrin e kodit tarifar;
- iii) Numrin UNDG (kodin e mallrave te rrezikshme);
- iv) Identifikimin e tipit te paketimit;
- v) Numrin e pakove;
- vi) Vleresimin e njesise matese;
- vii) Peshen totale gross;
- viii) Sasine totale te fatures;
- ix) Kodin e valutes;
- x) Vendin e ngarkeses ose kodin e vendit te ngarkeses;
- xi) Identifikimin e transportuesit ose emrin e transportuesit;
- xii) Numrin identifikues te pajisjeve;
- xiii) Masen e pajisjeve dhe identifikimin e tipit;
- xiv) Numrin e plumbçes;
- xv) Identifikimin e mjeteve te transportit qe kalojne kufirin e nje Pale Kontraktuese ose kodin;
- xvi) Kombesine e mjeteve te transportit qe kalojne kufirin e territorit te Pales Kontraktuese ose kodin;
- xvii) Numrin e references se ngarkeses;
- xviii) Kodin ose metoden e pageses se detyrimeve te transportit;
- xix) Degen doganore te daljes ose kodin;
- xx) Vendet gjate rruges ose kodin;
- xxi) Portin e pare te mberritjes ose kodin;
- xxii) Daten dhe oren e mberritjes ne portin e pare te mberritjes ne territorin e Pales Kontraktuese ose kodin;
- xxiii) Marresin ose kodin e marresit ose importuesin ose kodin e importuesit;
- xxiv) Palen e njoftuar ose kodin e pales se njoftuar;
- xxv) Destinacionin e dergeses;
- xxvi) Agjentin ose kodin e agjentit;
- xxvii) Numrin e references unike te ngarkeses.

3. Komiteti Administrativ do te kete autoritetin te modifikoje listen e referuar ne paragrafin 2 te ketij neni.

KAPITULLI V LLOJE SPECIALE NDIHME

Neni 11 Mbikeqytja

1. Sipas kerkese, administrata e kerkuar, per aq sa eshte e mundur, do te mbaje nen survejim, dhe do t'i mundesoje administrates kerkuese informacion mbi:
 - a) mallrat ne transport apo magazinim te njohura se jane perdorur ose dyshuar se mund te jene perdorur per te kryer nje shkelje doganore ne territorin e Pales Kontraktuese kerkuese;
 - b) mjete transporti te njohura se jane perdorur ose te dyshuara se jane perdorur per te kryer nje shkelje doganore ne territorin e Pales Kontraktuese kerkuese;
 - c) vende te njohura se jane perdorur ose te dyshuara se mund te perdoren ne lidhje me kryerjen e nje shkeljeje doganore ne territorin e Pales Kontraktuese kerkuese;
 - d) persona te njohur se kane kryer ose te dyshuar se jane gati per te kryer nje shkelje doganore ne territorin e Pales Kontraktuese kerkuese, veçanerisht ato qe levizin per ne, apo nga territori i Pales Kontraktuese te kerkuar.
2. Administrata doganore e nje Pale Kontraktuese mund te kryeje nje survejim te tille me iniciativen e vet nese ka arsye te besojse se veprime te planifikuara, ne kryerje e siper ose te perfunduara mund te perbejne nje shkelje doganore ne territorin e nje Pale tjetere Kontraktuese.

Neni 12 Shperndarja e kontrolluar

1. Palet Kontraktuese, sipas rregullimeve reciproke ne perputhje me paragrafin 2 te nenit 48, mund te lejojne levizjen e mallrave te paligjshme ose te dyshuara qe te kalojne nga, neper ose per ne territorin e tyre, me njohurine ose nen kontrollin e administrates doganore, me synimin investigimin dhe goditjen e shkeljeve doganore.
2. Nese nje levizje e tille nuk mund te kryhet nen kontrollin e autoritetit doganor, ky autoritet do te perpiqet te filloje bashkepunimin me autoritetet shteterore te cilat kane kompetenca te tilla ose do t'ua transferoje çeshtjen atyre.

Neni 13 Njoftimet

1. Sipas kerkeses, administrata e kerkuar, nese eshte e lejueshme nen legjislacionin e vet kombetar, do te ndermarre te gjitha masat e nevojshme per te njoftuar nje person rezident ose te regjistruar ne territorin e vet mbi te gjitha vendimet e marra nga administrata kerkuese ne zbatim te ligjit doganor lidhur me ate person, te cilat bien brenda fushes se mbulimit te kesaj Konvente.
2. Keto njoftime do te behen ne perputhje me procedurat e zbatueshme ne territorin e Pales Kontraktuese te kerkuar per vendime kombetare te ngjashme.

Neni 14 Rimbursimi i pretendimeve doganore

1. Sipas kerkeses, administratat doganore mund t'i japin njera-tjetres ndihme per rimbursimin e pretendimeve doganore.
2. Rregullimet e nevojshme per ndihme lidhur me rimbursimin e pretendimeve doganore do te behen ndermjet Paleve Kontraktuese te interesuara, ne perputhje me paragrafin 2 te nenit 48.

Neni 15
Ekspertet dhe deshmitaret

Sipas kerkeses, administrata e kerkuar mund te autorizojë punonjesit e vet per t'u paraqitur perpara nje gjykate apo tribunali ne territorin e Pales Kontraktuese kerkuese si eksperte apo deshmitare ne nje çeshtje te lidhur me zbatimin e ligjit doganor.

Neni 16
Prania e punonjesve ne territorin e nje Pale tjeter Kontraktuese

Sipas kerkeses, punonjes te caktuar specifikisht nga nje administrate kerkuese, me autorizimin e administrates se kerkuar dhe kushtezuar nga konditat qe kjo e fundit mund te caktojë, me qellim investigimin e nje shkeljeje doganore:

- a) mund te ekzaminojne, ne zyrtar e administrates se kerkuar, dokumente dhe informacione te tjera lidhur me shkelje doganore dhe te furnizohen me kopje te ketyre;
- b) mund te jene prezente gjate nje hetimi te kryer nga administrata e kerkuar ne territorin e Pales Kontraktuese te kerkuar, e cila ka lidhje me administraten kerkuese; keta punonjes do te kene vetem rol keshillues.

Neni 17
Prania e punonjesve te administrates kerkuese sipas fteses se administrates se kerkuar

1. Kur administrata e kerkuar e konsideron te pershtatshme per nje punonjes te administrates kerkuese qe te jete prezent kur, ne perputhje me nje kerkese jane duke u ndermarre masa ndihme, ajo mund te ftojë pjesemarijen e administrates kerkuese ne baze te termave dhe kushteve qe kjo mund te caktojë.
2. Administrata doganore ne fjale mund te zgjeroje rolin e punonjesit vizitues pertej atij te keshillimit, sipas rregullimeve te ndersjella ne perputhje me paragrafin 2 te nenit 48.

Neni 18
Rregullime per punonjesit vizitues

1. Pa paragjykuar nenet 19, 20, 21, 22 dhe 23, kur punonjesit e nje Pale Kontraktuese jane prezente ne territorin e nje Pale tjeter Kontraktuese sipas kushteve te kesaj Konvente, ata ne çdo kohe duhet te jene te afte te provojne, ne nje gjuhe te pranueshme per administraten e kerkuar, identitetin e tyre zyrtar dhe statusin ne administraten e tyre dhe te statusit te tyre zyrtar qe u eshte dhene ne administraten e kerkuar.
2. Punonjesit, gjate qendrimit te tyre ne territorin e nje Pale tjeter Kontraktuese sipas termave te kesaj Konvente, jane pergjegjes per çdo shkelje qe mund te kryejne dhe do te gezojne, per aq sa mundesohet nga ligji kombetar i asaj pale, te njejten mbrojtje siç u jepet nepunesve te vet doganore.

KAPITULLI VI
BASHKEPUNIMI NDERKUFITAR

Neni 19
Dispozita te pergjithshme

Punonjes te nje Pale Kontraktuese, sipas rregullimeve te ndersjella ne perputhje me paragrafin 2 te nenit 48, mund te angazhohen ne nje nga veprimet e caktuara ne kete kapitull ne territorin e nje Pale tjeter Kontraktuese dhe ne perputhje me kushte shtese siç mund te caktohen nga Pala Kontraktuese ne territorin e se ciles zhvillohen keto veprime. Secila nga

keto veprime do te ndaloje ne momentin qe e kerkon Pala Kontraktuese ne territorin e se ciles zhvillohen keto veprime.

Neni 20 Ndjekja e nxehte

1. Punonjes te nje Pale Kontraktuese te cilet ndjekin ne territorin e Pales se vet nje individ te kapur ne aktin e kryerjes se nje shkeljeje doganore, e cila jep shkak per ekstradim, ose i cili merr pjese ne nje shkelje te tille, mund te vazhdojne ndjekjen ne territorin e nje Pale tjeter Kontraktuese, sipas kushteve te nje kerkese paraprake, autorizimi ose kushtezimeve te caktuara nga Pala e Kerkuar.
2. Nese, per shkaqe tejet urgjente, nuk ka qene e mundur te informohen autoritetet kompetente te nje Pale Kontraktuese perpara hyrjes ne territorin e saj ose kur keto autoritete nuk kane pasur mundesi te angazhohen ne ndjekje aktive, ndjekja mund te vazhdohet pa autorizim paraprak.
3. Kur ndjekja vazhdon pa autorizim paraprak, autoritetet doganore te Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles po kryhet ndjekja, duhet te informohen menjehere mbi kalimin e kufirit dhe duhet te dorezohet sa me shpejt te jete e mundur nje kerkese zyrtare autorizimi, duke theksuar arsyet per kalimin e kufirit pa autorizimin paraprak.
4. Sipas kerkeses se punonjesve ndjekes, autoritetet kompetente te Pales Kontraktuese ku po zhvillohet ndjekja do te ndjekin individin e kerkuar ne menyre qe te percaktohet identiteti apo te gjendet ai/ajo.
5. Kur ndjekja zhvillohet ne det, kjo ndjekje, kur zhvillohet ne det te hapur, do te kryhet ne perputhje me ligjet nderkombetare te detit siç paraqiten ne Konventen e Kombeve te Bashkuara mbi ligjin per detin.

Neni 21 Mbikeqyrja nderkufitare

1. Punonjesit e nje Pale Kontraktuese, te cilet mbajne nenurvejim ne territorin e pales se tyre nje person per te cilin ka te dhena serioze per te besuar se ai apo ajo eshte i perfshire ne nje shkelje doganore, mund te vazhdojne mbikeqyrjen ne territorin e nje Pale tjeter Kontraktuese sipas nje kerkese paraprake, autorizimi apo kushteve qe Pala Kontraktuese e kerkuar mund te vendose.
2. Nese per arsye tejet urgjente, autorizimi paraprak nuk mund te kerkohet, mbikeqyrja ne perputhje me paragrafin 1 te ketij neni mund te vazhdohet me kusht qe autoritetet kompetente te Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles do te vazhdoje mbikeqyrja te informohen menjehere mbi kalimin e kufirit, dhe nje kerkese zyrtare per autorizim, e cila thekson arsyet e kalimit te kufirit pa autorizim paraprak, duhet te paraqitet sa me shpejt te jete e mundur.

Neni 22 Hetimet e mbuluara

1. Nje Pale Kontraktuese e kerkuar mund te autorizojte punonjes te nje Pale Kontraktuese kerkuese te hetojne ne territorin e vet, nen mbulimin e identiteteve false, per te siguruar apo sqaruar fakte mbi nje shkelje doganore kur eshte jashtezakonisht e pamundur per te vepruar ndryshe. Punonjesit ne fjale do te autorizohen te grumbullojne informacion dhe te kene kontakt me subjektet e hetimit ose me persona te tjere te lidhur me ta gjate veprimtarive hetuese.

2. Keto hetime do te kryhen ne perputhje me ligjin dhe procedurat e Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles zhvillohen hetimet.

Neni 23

Kontrolli dhe ekipet hetuese te perbashketa

1. Palet Kontraktuese mund te kryejne kontrolle ose ekipe hetuese te perbashketa per te gjetur dhe parandaluar lloje te veçanta shkeljesh doganore, te cilat kerkojne veprime te njekohshme dhe te koordinuara.

2. Keto ekipe do te operojne ne perputhje me ligjin dhe procedurat e Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles kryhen keto veprime.

KAPITULLI VII

PERDORIMI, KONFIDENCIALITETI DHE MBROJTJA E INFORMACIONIT

Neni 24

perdorimi i informacionit

1. Pa paragjykuar nenin 36, çdo informacion i komunikuar sipas kesaj Konvente do te perdoret vetem nga administrata doganore per te cilen eshte derguar dhe vetem per qellime te ndihmes se ndersjelle sipas kushteve te vendosura ne kete Konvente.

2. Sipas kerkeses, Pala Kontraktuese qe ka derguar informacionin, pa paragjykuar paragrafin 1 te ketij neni, mund te autorizojte perdorimin e tij per qellime te tjera ose nga autoritete te tjera, kushtezuar nga termat dhe kushtet qe mund te caktoje. Ky perdorim do te jete ne perputhje me dispozitat ligjore dhe administrative te Pales Kontraktuese qe kerkon te perdore kete informacion. perdorimi i informacionit per qellime te tjera perfshin perdorimin ne hetime kriminale, procedime apo penalizime.

Neni 25

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e informacionit

1. Çdo informacion i komunikuar sipas kesaj Konvente do te trajtohet si konfidencial dhe, te pakten, do te gezoje te njejten mbrojtje dhe konfidencialitet siç gezon i njejti informacion nen dispozitat ligjore dhe administrative te Pales Kontraktuese qe e ka marre.

2. Shkembimi i te dhenave ndermjet dy ose me shume Paleve Kontraktuese sipas kesaj Konvente nuk do te filloje derisa Palet Kontraktuese ne fjale, sipas rregullimeve ne perputhje me paragrafin 2 te nenit 48, te kene vendosur se keto te dhena do te gezojne ne territorin e Pales Kontraktuese marrese, nje nivel mbrojtjeje te tille qe ploteson kerkesat e ligjit kombetar te Pales Kontraktuese derguese.

3. Ne mungese te rregullimeve te ndersjella siç referohen ne paragrafin 2 te ketij neni, te dhenat personale mund te dergohen kur Pala Kontraktuese derguese eshte e kenaqur se keto te dhena personale do te mbrohen ne territorin e Pales Kontraktuese marrese ne perputhje me dispozitat e kesaj Konvente.

4. Palet Kontraktuese, ne momentin e firmosjes, ratifikimit apo hyrjes ne kete Konvente, do te njoftojne Sekretarin e Pergjithshem me shkrim mbi dispozitat e tyre ligjore apo administrative ne respekt te konfidencialitetit te informacionit dhe mbrojtjes se te dhenave personale. Ato do te bejne nje deklarate me shkrim te Sekretari i Pergjithshem ne kohen e firmosjes, ratifikimit apo hyrjes, mbi detyrimet e tyre, te pakten mbi detyrimin e konfidencialitetit te informacionit dhe dispozitave te mbrojtjes se te dhenave te kesaj Konvente.

Neni 26
Mbrojtja e te dhenave personale

1. Te dhenat personale do t'i transmetohen vetem nje administrate doganore. Dergimi i te dhenave personale te nje autoritet tjetër do te lejohet vetem pas nje aprovimi paraprak nga administrata doganore e cila ka derguar te dhenat ne fjale.
2. Sipas kerkeses, administrata doganore e cila ka marre te dhena personale, do te informoje administraten doganore qe ka derguar te dhenat mbi perdorimin qe i eshte bere te dhenave dhe mbi rezultatet e arritura.
3. Te dhenat personale te derguara sipas kesaj Konvente do te mbahen vetem per kohen e nevojshme per te arritur qellimet per te cilat eshte derguar.
4. Administrata doganore e cila dergon te dhena personale, per aq sa ka mundesi, do te siguroje se keto te dhena jane grumbulluar saktesisht dhe ligjerisht dhe se jane te plota dhe te rishikuara dhe nuk e tejkalojne qellimin per te cilin jane derguar.
5. Nese te dhenat personale te derguara duket se jane jokorrekte ose nuk duhet te ishin shkëmbyer, kjo gje duhet njoftuar menjehere. Administrata doganore e cila ka marre keto te dhena duhet t'i ndryshoje ose t'i fshije.
6. Administratat doganore do te regjistrojne dergimin ose marrjen e te dhenave personale te shkëmbyera sipas kesaj Konvente.
7. Administratat doganore do te ndermarrin masat e nevojshme te sigurise per te mbrojtur te dhenat personale te shkëmbyera sipas kesaj Konvente nga akseset e paautorizuara, ndryshimi apo shperndarjet.
8. Nje Pale Kontraktuese do te jete pergjegjese, ne perputhje me dispozitat e veta ligjore dhe administrative, per demtimin shkaktuar nje personi nga perdorimi i te dhenave personale te shkëmbyera sipas kesaj Konvente. Gjithashtu, ky do te jete dhe rasti kur demtimi eshte shkaktuar nga nje Pale Kontraktuese qe ka derguar te dhena jo te sakta ose qe ka derguar te dhena te cilat jane ne kundërshtim me kete Konvente.
9. Nese nje Pale Kontraktuese e gjetur pergjegjese per demtime sipas paragrafit 8 te ketij neni nuk eshte Pala Kontraktuese e cila ka derguar te dhena personale, Palet Kontraktuese te interesuara do te rakordojne mbi termat dhe kushtet e rimbursimit te Pala Kontraktuese pergjegjese mbi shumat qe kjo pale ka paguar si kompensim.

KAPITULLI VIII

PERQENDRIMI I INFORMACIONIT

Neni 27
Qellimi i perqendrimit

1. Informacioni i referuar ne nenet 28, 29 dhe 30 do te vendoset ne nje sistem te automatizuar qendror informacioni te sigurte per qellimet e percaktimit te riskut e per te siguruar zbatimin e sakte te ligjit doganor per parandalimin, hetimin dhe luften ndaj shkeljeve doganore dhe per te garantuar sigurine e rrjetit nderkombetar te furnizimit te tregtise.
2. Te dhenat personale do te vendosen gjithashtu ne nje sistem qendror informacioni te automatizuar per qellimet e dhenies se informacionit mbi persona te njohur se kane kryer nje shkelje doganore ose te dyshuar se jane gati te kryejne nje shkelje doganore.

Neni 28 Informacioni jopersonal

1. Per qellimet e neneve 27 dhe 31 dhe nese eshte e lejueshme sipas ligjeve te tyre kombetare, administratat doganore do te dergojne te sistemi qendror i automatizuar i informacionit informacionet e meposhtme jopersonale:

i) informacion mbi çeshtjen ne reference, kur eshte e nevojshme;

ii) mallrat;

iii) sasite dhe njesite e matjes;

iv) mjetet e transportit;

v) menyrat e fshehjes;

vi) tregues nese mallrat jane gjetur gjate importit, eksportit, ne transit apo ne brendesi te territorit;

vii) rrugen;

viii) mjetet e gjetjes.

2. Komiteti Administrativ do te kete autoritetin per te modifikuar listen e paragrafit 1 te ketij neni.

Neni 29 Informacion mbi persona fizike dhe juridike

1. Per qellimet e neneve 27 dhe 31 dhe nese eshte e lejueshme nga ligjet e tyre kombetare, administratat doganore mund t'i komunikojne sistemit qendror te automatizuar te informacionit, informacionin e meposhtem:

A. Mbi personat fizike:

i) mbiemrin, emrin e dhene, emrin dhe pseudonimet, dhe emrat e kaluar sipas rastit;

ii) daten dhe vendin i lindjes;

iii) kombesine;

iv) llojin dhe numrin e dokumenteve te identifikimit;

v) seksin;

vi) vendin e banimit;

vii) natyren e shkeljes;

viii) punesimin;

ix) tiparet e dallueshme;

x) historine e meparshme ose informacione mbi dyshime;

xi) numrat e regjistrimit te mjeteve te transportit;

xii) tregues te nivelit te rrezikut qe mund te mbarbe personi;

xiii) arsye specifike per perfshirjen e te dhenave;

xiv) organizaten kriminale se ciles i takon;

xv) bashkepunetore te njohur.

B. Mbi personat juridike:

i) emrin, emrin tregtar;

ii) vendin e regjistrimit;

iii) numrin e regjistrimit;

iv) daten e regjistrimit;

v) zyren e regjistrimit;

vi) adresen tregtare;

vii) llojin e biznesit;

viii) llojin e shkeljes;

ix) historite e kaluara ose informacione mbi personat e dyshuar juridike;

x) arsye specifike per perfshirjen e te dhenave;

xi) emrat e drejtuesve ose punonjesve dhe nese eshte e mundur çdo informacion tjetër identifikues siç pershkruhet ne paragrafin (A) i deri xv.

2. Komiteti Administrativ do te kete autoritetin te modifikojë listat ne paragrafet 1(A) dhe (B) te ketij neni.

Neni 30

Informacione te tjera

Administratat doganore mund t' i komunikojne sistemit qendror te automatizuar te informacionit, nese eshte e lejueshme sipas ligjeve te tyre kombetare, çdo lloj informacioni qe mund te kete lidhje me zbatimin e duhur te ligjit doganor per parandalimin, hetimin dhe luften ndaj shkeljeve doganore, dhe per te garantuar sigurine e rrjetit nderkombetar te furnizimit te tregtise.

Neni 31

Sistemi qendror i automatizuar i informacionit

1. Informacioni i permendur ne nenet 28, 29 dhe 30 do te vendoset ne nje sistem te sigurte qendror te automatizuar informacioni per qellime doganore. Ky sistem do te menaxhohet nga drejtoria e keshillit dhe do te lejoje hyrje sipas dispozitave te caktuara ne nenin 38.

2. Komunikimi i informacionit nga nje Pale Kontraktuese drejt sistemit qendror te automatizuar te informacionit do te kushtezohet nga dispozitat administrative dhe ligjore te asaj Pale, me perjashtim te rasteve kur Konventa percakton dispozita me strikte.

3. Çdo Pale Kontraktuese do te caktojë nje autoritet kompetent ne administraten e vet doganore per te qene kompetent ne nivel kombetar per zbatimin korrekt te sistemit qendror te automatizuar te informacionit dhe per masat e nevojshme per te siguruar zbatueshmerine e kapituj ve VIII dhe X.

4. Sekretari i Pergjithshem do te caktojë punonjesit e Keshillit per te qene pergjegjes ne nivelin e Keshillit per zbatimin korrekt dhe mirembajtjen e sistemit qendror te automatizuar te informacionit dhe per masat e nevojshme per te siguruar zbatueshmerine e neneve VIII dhe" X.

5. Çdo Pale Kontraktuese do te njoftojë Sekretarin e Pergjithshem mbi autoritetet kompetente qe ka caktuar sipas paragrafit 3 te ketij neni, i cili do te mundesoje kete informacion te Palet e tjera Kontraktuese, se bashku me ndonje informacion lidhur me punonjesit e Keshillit, te caktuar sipas paragrafit 4 te ketij neni. Informacioni i referuar ne kete paragraf do te perfshihet ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit, por nuk do te kushtezohet nga dispozitat e kapitullit VII.

Neni 32

Menaxhimi i sistemit qendror te automatizuar te informacionit

1. Nje skuader do te ngrihet per te menaxhuar sistemin qendror te automatizuar te informacionit lidhur me çeshtjet teknike, operacionale dhe procedurale. Ajo do te perbehet nga perfaqesues te administratave doganore te Paleve Kontraktuese dhe punonjes te Keshillit. Perberja e skuadres menaxhuese do te vendoset nga Komiteti Administrativ.

2. Ekiye menaxhuese do te percaktojne procedurat per te gjitha çeshtjet teknike dhe operacionale lidhur me:

a) komunikimin e informacionit, ne perputhje me nenet 28, 29 dhe 30;

b) aksesin ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit dhe ne informacionet qe ai permban, ne perputhje me nenin 38 dhe

c) ndryshimin e informacionit, ne perputhje me dispozitat e neneve 39 dhe 40.

3. Pas marrjes se aprovimit nga Komiteti Administrativ per procedurat e referuara ne paragrafin 2 te ketij neni, ekiye manaxhuese do te sigurojne zbatimin.

4. Ekipte manaxhuese do te raportojne te pakten nje here ne vit tek Komiteti Administrativ mbi menaxhimin e sistemit qendror te automatizuar te informacionit sipas paragrafit 1, 2 dhe 3 te ketij neni, duke bere rekomandimet e nevojshme.

KAPITULLI IX

SIGURIMI I SISTEMIT QENDROR TE AUTOMATIZUAR TE INFORMACIONIT

Neni 33

Pergjegjesia per masat e sigurise

1. Palet Kontraktuese dhe Sekretari i Pergjithshem do te jene pergjegjes per zbatimin e te gjitha masave te nevojshme per sigurine e sistemit qendror te automatizuar te informacionit. Objektivat e ketyre masave do te perfshijne, por nuk do te kufizohen ne:

a) parandalimin e aksesit te paautorizuar te pajisjet e perdorura per perpunimin e te dhenave ne sistem;

b) parandalimin e aksesit te paautorizuar ne sistem;

c) parandalimin e hyrjes, leximit, kopjimit, amendimit apo fshirjes se paautorizuar te çdo informacioni ne sistem;

d) sigurimin se eshte i mundur kontrolli dhe percaktimi se cili autoritet kompetent i caktuar dhe zyrtare te Keshillit, referuar ne paragrafin 1 te nenit 38, kane akses ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit dhe cilet punonjes dhe zyrtare te caktuar te Keshillit, referuar ne paragrafin 2 te nenit 38, kane akses per informacionin ne sistem;

e) sigurimin se eshte i mundur kontrolli dhe percaktimi se cili informacion ka hyre ne sistem, nga kush dhe te monitorojne kerkimet;

f) parandalimin e leximit, kopjimit, ndryshimeve apo fshirjes se paautorizuar te informacionit gjate komunikimit te te dhenave dhe transportimit te te dhenave.

2. Perfaqesuesi apo perfaqesuesit e pavarur te caktuar sipas paragrafit 1(f) te nenit 45 do te kryejne verifikime te aksesit dhe te kerkimeve mbi te dhenat personale per te siguruar se akses i dhe kerkimet e bera jane te pranueshme dhe jane kryer nga perdorues te autorizuar. Nje regjister i te gjitha verifikimeve do te mbahet ne sistem per te raportuar te Komiteti Administrativ dhe qe do te fshihet pas 12 muajsh.

Neni 34

Zbatimi i masave te sigurise

1. Çdo Pale Kontraktuese do te caktojte nje autoritet kompetent ne administraten e vet doganore per te zbatuar, ne nivel kombetar, masat e sigurise te referuara ne paragrafin 1 te nenit 33.

2. Sekretari i Pergjithshem do te caktojte punonjesit e Keshillit per te zbatuar, ne nivel keshilli, masat e sigurise te referuara ne paragrafin 1 te nenit 33.

3. Çdo Pale Kontraktuese do te njoftojte Sekretarin e Pergjithshem mbi autoritetet kompetente qe ka caktuar sipas paragrafit 1 te ketij neni, te cilet do te mundesojne kete informacion te Palet e tjera Kontraktuese, se bashku me çdo informacion tjeter lidhur me punonjesit e Keshillit te caktuar sipas paragrafit 2 te ketij neni. Informacioni i permendur ne kete paragraf do te perfshihet ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit, por nuk do te kushtezohet nga dispozitat e kapitullit VII.

KAPITULLI X

MBROJTJA E INFORMACIONIT NE SISTEMIN QENDROR TE AUTOMATIZUAR TE INFORMACIONIT

Neni 35
Perfshirja e informacionit

Perfshirja e informacionit ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit do te udhëhiqet nga dispozitat ligjore dhe administrative te Pales Kontraktuese derguese, me perjashtim te rasteve kur kjo Konvente parashtron dispozita me strikte.

Neni 36
Perdorimi i informacionit

1. Perdorimi i informacionit te marre nga sistemi qendror i automatizuar i informacionit do te udhëhiqet nga dispozitat ligjore dhe administrative te Pales Kontraktuese qe perdor kete informacion, me perjashtim te rasteve kur Konventa parashtron dispozita me strikte.
2. Palet Kontraktuese mund te perdorin vetem informacionin e perfituar nga sistemi qendror i automatizuar i informacionit me synim arritjen e qellimeve te permendura ne nenin 27. Gjithsesi, sipas kerkeses, Pala Kontraktuese qe ka derguar informacionin mund te autorizojë perdorimin e tij per qellime te tjera, kushtezuar nga termat dhe kondi tat qe ajo mund te specifikojë. Ky perdorim tjetër duhet te jete ne perputhje me dispozitat ligjore dhe administrative te Pales Kontraktuese qe kerkon te perdore kete informacion. perdorimi i informacionit per qellime te tjera perfshin perdorimin e tij ne hetime kriminale, procese ose gjykate.
3. Nen pergjegjesine e Sekretarit te Pergjithshem, punonjesit e Keshillit mund te perdorin informacionin e perftuar nga sistemi qendror i automatizuar i informacionit vetem per te kryer detyrat e kerkuara nga kjo Konvente, sipas kushteve qe mund te vendose Komiteti Administrativ.
4. Te dhenat personale mund te perdoren vetem kur perftohen nga sistemi qendror i automatizuar i informacionit ne perputhje me paragrafin 7 te nenit 38.

Neni 37
Mbajtja e te dhenave personale

1. Te dhenat personale te perfshira ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit do te mbahen vetem per kohen e nevojshme per te arritur qellimin per te cilin jane derguar. Palet Kontraktuese do te specifikojne periudhen e mbajtjes ne sistem te te dhenave personale qe ato dergojne.
2. Nje Pale Kontraktuese derguese mund te zgjase periudhen e mbajtjes referuar ne paragrafin 1 te ketij neni nese mbajtja e te dhenave personale eshte e nevojshme per qellimet per te cilat eshte derguar. Nese nuk ka zgjatje te kesaj periudhe, te dhenat do te fshihen nga sistemi qendror i automatizuar i informacionit me iniciative te Pales Kontraktuese qe ka derguar te dhenat personale.
3. Sekretari i Pergjithshem do te informoje Palen Kontraktuese derguese mbi fshirjen e menjehershme te te dhenave personale sipas paragrafit 2 te ketij neni, duke dhene njoftim njemujor.
4. Perfaqesuesi apo perfaqesuesit e pavarur te caktuar sipas paragrafit 1(f) te nenit 45 do te kryejne verifikime per te siguruar se periudha e mbajtjes se te dhenave personale ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit eshte respektuar. Nje regjistrim i te gjitha verifikimeve do te mirembahet ne sistem per t'u raportuar te Komiteti Administrativ dhe qe do te fshihet pas 12 muajsh.

Neni 38
Aksesi

1. Autoritetet kompetente dhe punonjesit e Keshillit te caktuar ne perputhje me paragrafet 3 dhe 4 te nenit 31, do te kene akses (hyrje) ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit.
2. Per qellimet e nenit 27 dhe pa paragjykuar paragrafin 7 te ketij neni, Palet Kontraktuese do te caktojne punonjes ne administratat e tyre doganore, dhe Sekretari i Pergjithshem do te caktojte punonjesit e Keshillit, te cilet do te kene akses ne informacionin e sistemit qendror te automatizuar te informacionit.
3. Aksesit ne sistem do te jete ne perputhje me procedurat e referuara ne paragrafin 2 te nenit 32. Per qellimet e zbatimit te nenit 32, ekipe manaxhuese do te kene akses ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit.
4. Komiteti Administrativ do te lejoje akses tek informacioni jopersonal ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit per organizmat nderkombetare rajonale dhe qeveritare mbi bazen e reciprocitetit dhe te kushteve qe mund te specifikoje Komiteti Administrativ.
5. Perfaqesuesi apo perfaqesuesit e caktuar nga Komiteti Administrativ sipas paragrafit 1 (f) te nenit 45 do te kene akses te sistemi qendror i automatizuar i informacionit.
6. Çdo Pale Kontraktuese do te njoftoje Sekretarin e Pergjithshem mbi punonjesit qe ka caktuar sipas paragrafit 2 te ketij neni. Sekretari i Pergjithshem do t'ua mundesoje kete informacion Paleve Kontraktuese, se bashku me informacionet lidhur me punonjesit e Keshillit te caktuar sipas te njejtij paragraf. Informacioni i permendur ne kete paragraf do te perfshihet ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit, por nuk do te kushtezohet nga dispozitat e kapitullit VII.
7. Palet Kontraktuese mund te percaktojne se kush do te kete apo nuk do te kete akses te te dhenat personale qe ato dergojne.
8. Te drejtat e personave fizike lidhur me te dhenat personale ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit, ne veçanti ato lidhur me aksesin, do te kene efekt ne perputhje me dispozitat ligjore dhe administrative te Pales Kontraktuese ne territorin e se ciles keto te drejta lindin.

Neni 39

Ndryshimi i informacionit jopersonal ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit

1. Te dhenat jopersonale ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit do te ndryshojne, shtohen, korrektohen apo fshihen vetem me inisiative te Pales Kontraktuese derguese.
2. Te dhenat jopersonale do te amendohen, shtohen, korrektohen apo fshihen ne perputhje me procedurat e percaktuara dhe zbatuara nga ekipe manaxhuese sipas paragrafeve 2 dhe 3 te nenit 32.

Neni 40

Ndryshimi i te dhenave personale ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit

1. Te dhenat personale ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit do te amendohen, shtohen, korrektohen apo fshihen vetem me inisiative te Pales Kontraktuese derguese.
2. Nese nje Pale Kontraktuese shikon se te dhenat personale qe ka derguar jane te pasakta ose jane perfshire apo magazinuar ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit ne kundershtrim me kete Konvente, ajo do te rregulloje mbi amendimin, shtimin, korrigjimin ose fshirjen e te dhenave pa vonese. Palet Kontraktuese te interesuara do te bien dakord me Sekretarin e Pergjithshem per te njoftuar ata te cilet kane akses ne te dhenat personale, siç referohet ne paragrafin 7 te nenit 38, mbi keto amendime, shtesa, korrigjime apo fshirje.
3. Nese nje Pale Kontraktuese ka informacion per te sugjeruar se ndonje e dhene personale eshte e pasakte ose ishte perfshire, ose ruajtur ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit ne kundershtrim me kete Konvente, ajo do te njoftoje Palen Kontraktuese derguese sa me shpejt te jete e mundur. Kjo e fundit do te kontrolloje te dhenat ne fjale dhe

nese eshte e nevojshme do te rakordoje mbi ndryshimet, shtimet, korrigjimet apo fshirjet pa vonese. Pala Kontraktuese derguese do te rakordoje me Sekretarin e Pergjithshem per te njoftuar ata qe kane akses ne te dhenat personale, siç referohet ne paragrafin 7 te nenit 38, mbi keto amendime, shtime, korrektive apo fshirje.

4. Nese, ne momentin e perfshirjes se te dhenave personale ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit, nje Pale Kontraktuese kupton se te dhenat e veta personale bien ne konflikt me te dhenat personale te derguara nga nje Pale tjeter Kontraktuese, kjo do te keshilloje menjehere Palen Kontraktuese qe ka derguar keto te dhena. Palet Kontraktuese te interesuara do te perpiqen te zgjidhin çeshtjen. Nese zgjidhja e çeshtjes rezulton ne nje ndryshim, shtim, korrigjim apo fshirje te te dhenave personale, Pala Kontraktuese qe ka derguar te dhenat do te rakordoje me Sekretarin e Pergjithshem per te njoftuar ata qe kane akses ne te dhenat personale, siç referohet ne paragrafin 7 te nenit 38, mbi keto ndryshime, shtime, korrigjime apo fshirje.

5. Kur nje gjykate apo autoritet tjeter kompetent brenda territorit te nje Pale Kontraktuese merr nje vendim final lidhur me ndryshimin, shtimin, korrigjimin apo fshirjen e te dhenave personale ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit, Pala Kontraktuese ne territorin e se ciles u mor vendimi, do te rakordoje, nese eshte ajo qe ka derguar te dhenat mbi ndryshimet, shtesat, korrigjimet apo fshirjen e ketyre te dhenave pa vonese ose nese te dhenat jane derguar nga nje Pale tjeter Kontraktuese, ajo do te keshilloje Palen Kontraktuese derguese mbi kete vendim. Pala Kontraktuese derguese do te rakordoje atehere per ndryshimin, shtesat, korrektimin apo fshirjen e te dhenave pa vonese.

Neni 41

Pergjegjesite dhe detyrimet

1. Nje Pale Kontraktuese do te jete pergjegjese, per aq sa eshte e mundur, per saktesine dhe ligjshmerine e informacionit qe ka perfshire ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit.

2. Nje Pale Kontraktuese do te mbaje pergjegjesi, ne perputhje me dispozitat e veta ligjore dhe administrative, per demtimet shkaktuar nje personi nga perdorimi i informacionit te perftuar nga sistemi qendror i automatizuar i informacionit nga kjo Pale Kontraktuese. I njejte do te jete rasti kur demtimi eshte shkaktuar nga Pala Kontraktuese derguese, e cila ka futur te dhena te pasakta ose ka futur te dhena ne kundersizim me kete Konvente.

3. Nese Pala Kontraktuese e gjetur pergjegjese per demtime, sipas paragrafit 2 te ketij neni, nuk eshte Pala Kontraktuese e cila ka derguar kete informacion, Palet Kontraktuese te interesuara do te rakordojne mbi termat dhe kushtet e rimbursimit te Pales Kontraktuese pergjegjese mbi shumat qe ka paguar si kompensim.

4. Nje Pale Kontraktuese do te jete pergjegjese, ne perputhje me dispozitat e veta ligjore dhe administrative, per demtimet e shkaktuara ndaj nje personi nepermjet perdorimit te informacionit nga punonjesit e Keshillit te perftuar nga sistemi qendror i automatizuar i informacionit, ne kundersizim me kete Konvente, per faktin se ky informacion eshte perfshire ne sistem nga kjo Pale Kontraktuese.

5. Nese demi eshte percaktuar nga nje autoritet kompetent ligjor ne respekt te paragrafit 4 te ketij neni, Pala Kontraktuese e referuar mund t'ia transmetoje vendimin Komitetit Administrativ i cili do t'i beje nje rekomandim Keshillit lidhur me ndonje rimbursim.

KAPITULLI XI

PERJASHTIME DHE REZERVA

Neni 42

Perjashtime

1. Kur nje ndihme e kerkuar sipas kesaj Konvente mund te shkele sovranitetin, ligjet dhe detyrimet sipas traktateve, sigurine, politikat publike ose çdo interes tjeter thelbesor kombetar

te nje Pale Kontraktuese te kerkuar ose mund te paragjykoj e interesa te ligjshme komerciale apo profesionale, nje ndihme e tille mund te refuzohet nga kjo Pale Kontraktuese ose mund te jepet ne baze te termave dhe kushteve qe ajo mund te vendose.

2. Kur nje administrate kerkuese e ka te pamundur t'i pergjigjet nje kerkese te ngjashme qe mund te behet nga administrata e kerkuar, ajo do ta theksoje kete fakt ne kerkese. Pergjigja ndaj nje kerkese te tille do te varet nga administrata e kerkuar.

3. Ndihma mund te shtyhet nese ka baza per te besuar se ajo mund te nderhyje ne nje hetim ne vazhdim apo procedim. Ne nje rast te tille, administrata e kerkuar do te konsultohet me administraten kerkuese per te percaktuar nese ndihma mund te jepet bazuar ne termat dhe kushtet qe mund te specifikoje administrata e kerkuar.

4. Nese administrata e kerkuar konsideron se perpjekja e kerkuar per te permbushur nje kerkese eshte qartesisht ne disproporcion me perfitimin e parashikuar te administrates kerkuese, ajo mund te kundershtojte dhenien e ndihmes.

5. Kur ndihma mohohet apo shtyhet, duhet te paraqiten shkaqet per mohimin apo shtyrjen.

Neni 43 Rezerva

1. Nenet 9, 10, 12, 14, 15, 16 17, 19, 20, 21, 22, 23, 29 dhe 30 mundet, pjeserisht apo teresisht, te kushtezohen nga rezerva.

2. Nje Pale Kontraktuese do te konsiderohet se i ka pranuar te gjitha dispozitat e neneve 9, 10, 12, 14, 15, 16, 17, 19,20,21,22,23,29 dhe 30 nese ne momentin e firmosjes, ratifikimit apo hyrjes ne Konvente nuk e ka njoftuar Sekretarin e Pergjithshem mbi ndonje rezervim lidhur me keto dispozita.

3. Nje Pale Kontraktuese qe ka pasur rezerva mund t'i terheqe ato, pjeserisht apo teresisht, ne çdo moment nepermjet njoftimit te depozituesi ku specifikon daten ne te cilat marrin efekt keto anulime.

KAPITULLI XII KOSTOT

Neni 44

1. Kushtezuar nga paragrafet 2 dhe 3 te ketij neni, kostot e dala nga zbatimi i kesaj Konvente do te mbulohen nga Pala Kontraktuese e kerkuar.

2. Shpenzimet dhe dietat paguar eksperteve dhe deshmitareve, si dhe kostot e perkthyesve dhe interpretuesve qe nuk jane punonjes qeveritare, do te mbulohen nga Pala Kontraktuese kerkuese.

3. Nese ekzekutimi i nje kerkese kerkon shpenzime te nje natyre thelbesore apo te jashtezakonshme, Palet Kontraktuese do te konsultohen per te percaktuar termat dhe kushtet sipas te cilave do te ekzekutohet kerkesa, si dhe menyren me te cilen do te perballohen kostot.

KAPITULLI XIII DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Neni 45 Menaxhimi i Konventes

1. Nje Komitet Administrativ do te ngrihet:

a) per te marre ne konsiderate çeshtje lidhur me zbatimin dhe administrimin e kesaj Konvente, si dhe mbi ndryshimet e propozuara;

b) per t'u rekomanduar Paleve Kontraktuese ndryshimin e kesaj Konvente;

- c) per t'u rekomanduar Paleve Kontraktuese masat per te siguruar interpretimin uniform dhe zbatimin e kesaj Konvente;
 - d) per te vendosur mbi perberjen e skuadres manaxhuese referuar ne paragrafin 1 te nenit 32;
 - e) per te ekzaminuar dhe aprovuar procedurat teknike dhe operationale referuar ne paragrafin 2 te nenit 32 lidhur me sistemin qendror te automatizuar te informacionit;
 - f) per te caktuar nje ose me teper perfaqesues te pavarur per te kryer verifikimet e referuara ne paragrafin 2 te nenit 33 dhe paragrafin 4 te nenit 37 dhe per te percaktuar fushembulimin, frekuencen dhe termat e kushtet e tjera per te tilla verifikime;
 - g) per te determinuar kushtet e referuara ne paragrafin 3 te nenit 36 lidhur me perdorimin nga punonjesit e keshillit te informacionit te perftuar nepermjet sistemit qendror te automatizuar te informacionit;
 - h) per te percaktuar kushtet e referuara ne paragrafin 4 te nenit 38 lidhur me lejimin e aksesit per informacionin jopersonal ne sistemin qendror te automatizuar te informacionit per organizatat nderkombetare dhe qeveritare rajonale;
 - i) per te bere rekomandime te Keshilli lidhur me rimbursimet sipas paragrafit 5 te nenit 41;
 - j) per te mirembajtur lidhjet me organizata te tjera nderkombetare te interesuara;
 - k) per te konsideruar ceshtje te tjera lidhur me kete Konvente qe mund t' i referohen kesaj;
 - l) per te informuar Komitetin e Antikontrabandes dhe Keshillin mbi vendimet e mara.
2. Komiteti Administrativ do te marre vendime lidhur me ndryshimin e listes ne nenet 10, 28 dhe 29, sipas kerkeses, pa kundershuar nenin 49 dhe lidhur me zbatimin e ketyre vendimeve.
 3. Te gjitha Palet Kontraktuese ne kete Konvente do te jene anetare te Komitetit Administrativ;
 4. Çdo entitet i kualifikuar per te qene nje Pale Kontraktuese ne kete Konvente sipas dispozitave te nenit 46 mund te ftohet te ndjeke sesionet e Komitetit Administrativ si vezhgues. Statusi dhe te drejtat e ketyre vezhguesve do te percaktohen nga Komiteti Administrativ. Komiteti Administrativ mund te ftoje perfaqesues te organizatave nderkombetare per te ndjekur sesionet e veta si vezhgues.
 5. Komiteti Administrativ do te percaktoje rregullat e procedurave te veta nga shumica e jo me pak se dy te tretave te Paleve Kontraktuese ne kete Konvente. Ne mungese te rregullave te procedurave te Komitetit Administrativ ne kohen e hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente, rregullat e procedures se Keshillit do te zbatohen derisa Komiteti Administrativ te adoptoj e rregullat e veta.
 6. Pa paragjykuar paragrafin 5 te ketij neni, ceshtje et e lidhura me kete Konvente perpara Komitetit Administrativ do te te vendosen me konsensusin e atyre prezente. Kur nuk mund te arrihet nje vendim me konsensus, ceshtja do te vendoset nga shumica e thjeshte e votave e atyre prezente. Ne çdo rast, per qellimet e ndryshimit te listes ne paragrafin 2 te nenit 10, paragrafit 1 te nenit 28, paragrafit 1 te nenit 29, si dhe per qellimet e caktimit te nje ose me shume perfaqesuesve nen paragrafin 1(f) te ketij neni, vendimet do te merren nga maxhoranca e jo me pak se dy te tretave te Paleve Kontraktuese prezente dhe me te drejte vote. Ne rastin e lejimit te aksesit per informacionin jopersonal referuar ne paragrafin 4 te nenit 38, vendimi do te merret nga vota unanime e atyre prezente.
 7. Secila Pale Kontraktuese do te kete te drejten e nje vote. Kur zbatohen paragrafet 3 dhe 4 te nenit 46, unionet doganore apo ekonomike te cilat jane Pale Kontraktuese do te kene, ne rast votimi, vetem nje numer votash te barabarte me totalin e votave te alokuara per anetaret e tyre qe jane Pale Kontraktuese.
 8. Komiteti Administrativ do te mblidhet te pakten nje here ne çdo vit. Do te zgjedhe per çdo vit nje kryetar dhe nje nenkryetar. Administratat Doganore te Paleve Kontraktuese do t'i komunikojne Sekretarit te Pergjithshem çdo kerkese per perfshirjen ne axhenten e sesioneve te Komitetit Administrativ. Sekretari i Pergjithshem do te shperndaje ftesen dhe draftaxhenten tek administratat doganore te Paleve Kontraktuese dhe te vezhguesit e referuar ne paragrafin 4 te ketij neni te pakten gjashte jave perpara mbledhjes se Komitetit Administrativ.
 9. Keshilli do t'i mundesoje Komitetit Administrativ sherbime sekretarie.

Neni 46
Firmosja, ratifikimi dhe pranimi

1. Çdo anetar i Keshillit dhe çdo anetar i Kombeve të Bashkuara ose agjencite e veta të specializuara mund të behen anetare kontraktuese në këto Konvente:
 - duke e firmosur atë pa rezervë ratifikimi;
 - duke depozituar një instrument ratifikimi pas firmosjes kushtëzuar ratifikimit ose
 - duke hyrë në të.
2. Kjo Konventë do të jetë e hapur deri më 28 qershor 2004 për firmosje në zyrat e Keshillit në Bruksel nga anetaret e referuar në paragrafin 1 të këtij neni. Pas kësaj do të jetë e hapur për pranim për këta anetare.
3. Çdo union ekonomik apo doganor mund të behet Pale Kontraktuese në këto Konvente në përputhje me paragrafet 1 dhe 2 të këtij neni. Këto unione ekonomike apo doganore do të informojnë Sekretarin e Përgjithshëm mbi anetaret që përbejnë Unionin, si dhe mbi kompetencat e veta në respekt të çështjeve të trajtuara nga kjo Konventë. Këto unione ekonomike apo doganore do të njoftojnë gjithashtu Sekretarin e Përgjithshëm mbi çdo modifikim thelbësor në përshirje të këtyre kompetencave.
4. Një union ekonomik apo doganor që është Pale Kontraktuese në këto Konvente, për çështjet brenda kompetencave të veta, do të ushtroje nën emrin e vet të drejtat, dhe përmbushë përgjegjësitë të cilat Konventa ofron për anetaret e një unioni të tillë të cilët janë Pale Kontraktuese në këto Konvente. Në rast të tillë, anetaret e një unioni të tillë nuk do të kenë të drejtë të ushtrojnë individualisht këto të drejta, duke përfshirë të drejtën për të votuar.
5. Secila Pale Kontraktuese që ratifikon këto Konvente ose e pranon atë do të kushtëzohet nga çdo amendim i kësaj Konvente që ka hyrë në fuqi në datën e depozitimit të instrumenteve të veta të ratifikimit apo hyrjes.

Neni 47
Zbatimi territorial i Konventes

1. Secila Pale Kontraktuese mund të deklarojë në çdo kohë nepermjet një njoftimi të dhënë të depozitari se kjo Konventë do të zbatohet në të gjithë apo në secilin nga territoret për të cilat është përgjegjës për marrëdhëniet ndërkombëtare. Këto njoftime do të kenë efekt tre muaj pas datës së marrjes së njoftimit në fjalë nga depozitari. Gjithsesi, kjo Konventë nuk do të zbatohet në ndonjë nga territoret e emëruara në njoftim përpara se kjo Konventë të ketë hyrë në fuqi për Palen Kontraktuese në fjalë.
2. Secila Pale Kontraktuese që ka bërë njoftimin sipas paragrafit 1 të këtij neni, për ta zbatuar këto Konvente në çdo territor për të cilin është marrë marrëdhëniet ndërkombëtare të se cilit është përgjegjës mund të njoftojë të depozitari, sipas procedurave të nenit 52 të kësaj Konvente, se territori në fjalë nuk do të zbatohet me këto Konvente.

Neni 48
Implementimi dhe aplikimi i Konventes

1. Në zbatim të kësaj Konvente, Palet Kontraktuese do të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar, aq sa është e mundur, se punonjësit e vet që janë përgjegjës për hetimin apo luftën ndaj shkeljeve doganore do të mbajnë lidhje personale dhe direkte me njëri-tjetrin.
2. Dy ose më tepër Pale Kontraktuese mund të vendosin mbi rregullimet e ndërsjella për të lehtësuar implementimin dhe aplikimin e kësaj Konvente ndërmjet tyre.

Neni 49
Ndryshimi në Konventë

1. Teksti i çdo amendimi rekomanduar te Palet Kontraktuese nga Komiteti Administrativ ne perputhje me paragrafin l(b) te nenit 45, do t'i komunikohet nga Sekretari i Pergjithshem te gjitha Paleve Kontraktuese dhe atyre anetareve te Keshillit te cilet nuk jane Pale Kontraktuese.
2. Çdo amendim i propozuar per kete Konvente do te hyje ne fuqi tre muaj pas skadimit te periudhes se 24 muajve nga data e komunikimit te amendimeve te propozuara ne perputhje me paragrafin 1 te ketij neni, kushtezuar se asnje kundershtrim per amendimin e propozuar nuk eshte komunikuar nga nje Pale Kontraktuese te Sekretari i Pergjithshem gjate kesaj periudhe.
3. Nese nje kundershtrim mbi ndryshimet e propozuara eshte depozituar nga nje Pale Kontraktuese perpara skadimit te periudhes prej 24 muajsh te specifikuar ne paragrafin 2 te ketij neni, amendimi konsiderohet se nuk eshte pranuar

Neni 50 Zgjidhja e mosmarreshjeve

1. Pa paragjykuar paragrafin l(c) te nenit 45, çdo mosmarreshje ndermjet dy apo me teper administratash doganore lidhur me interpretimin apo zbatimin e kesaj Konvente do te zgjidhet per aq sa eshte e mundur, me negociata ndermjet tyre.
2. Çdo mosmarreshje qe nuk zgjidhet me negociata do t'i referohet nga Palet Kontraktuese Komitetit Administrativ, i cili do te marre ne konsiderate mosmarreshjen dhe do beje rekomandime per zgjidhjen e saj.
3. Palet Kontraktuese ne mosmarreshje mund te bien dakord per te pranuar rekomandimet e Komitetit Administrativ si detyruese.
4. Mosmarreshjet per te cilat nuk eshte gjetur zgjidhje do te zgjidhen me rruge diplomatike.

Neni 51 Hyrja ne fuqi

1. Kjo Konvente do te hyje ne fuqi tre muaj pasi pese nga entitetet e referuara ne paragrafin 1 dhe 3 te nenit 46 kane firmosur Konventen pa rezerva ratifikimi ose kane depozituar instrumentet e tyre te ratifikimit apo pranimit.
2. Pas hyrjes ne fuqi ne perputhje me paragrafin 1 te ketij neni, kjo Konvente do te hyje ne fuqi, per çdo Pale tjetere Kontraktuese, tre muaj pasi kjo te jete bere Pale Kontraktuese ne perputhje me dispozitat e nenit 46.

Neni 52 Denoncimi

1. Kjo Konvente eshte e nje kohezgjatjeje te pakufizuar, por çdo Pale Kontraktuese mund ta denoncoje ate ne çdo kohe pas hyrjes se saj ne fuqi sipas nenit 51.
2. Denoncimi do te njoftohet me shkrim dhe depozitohet te depozitari.
3. Denoncimi do te kete efekt gjashte muaj pas marrjes se instrumentit te denoncimit te depozitari.

Neni 53 Depozitari i Konventes

1. Kjo Konvente, te gjitha firmosjet me ose pa rezerva ratifikimi dhe te gjitha instrumentet e ratifikimit apo pranimit do te depozitohen te Sekretari i Pergjithshem.
2. Depozitari:
 - a) do te marre dhe kete nen pergjegjesi tekstet origjinale te kesaj Konvente;

- b) do të përgatisë kopje të certifikuara të teksteve origjinale të kësaj Konvente dhe do t'ua transmetojë ato Paleve Kontraktuese dhe atyre anëtarëve të Keshillit të cilët nuk janë Pale Kontraktuese dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara;
- c) do të marrë çdo firmosje me ose pa rezervë të ratifikimit, ratifikimit ose hyrjes në këtë Konventë dhe do të marrë dhe mbajë nën përgjegjësi instrumentet, njoftimet dhe komunikimet e lidhura me të;
- d) do të marrë dhe mbajë nën përgjegjësi dispozitat ligjore dhe administrative dhe deklaratat e shkruara në respekt të paragrafit 4 të nenit 25;
- e) do të marrë dhe mbajë nën përgjegjësi njoftimet dhe rezervat e Paleve Kontraktuese në përputhje me nenin 43;
- f) do të ekzaminojë nëse firmat ose çdo instrument, njoftim apo komunikim i lidhur me këtë Konventë është i përshtatshëm, në formën e duhur dhe, nëse është e nevojshme, të sjellë çështjen në vëmendje të Paleve Kontraktuese të interesuar;
- g) do të njoftojë Palet Kontraktuese, ata anëtarë të Keshillit që nuk janë Pale Kontraktuese dhe Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara mbi:
- datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenin 51 të kësaj Konvente;
 - njoftimet e marra në përputhje me nenet 43, 46, 47 dhe 51 të kësaj Konvente;
 - denoncimet sipas nenit 52 të kësaj Konvente;
 - çdo amendim të pranuar apo kundërshtuar në përputhje me nenin 49 të kësaj Konvente dhe datën e hyrjes në fuqi dhe
 - çdo vendim të marrë nga Komiteti Administrativ referuar sipas paragrafit 2 të nenit 45;
- h) njoftojë Palet Kontraktuese mbi autoritetet e referuara në paragrafin 3 të nenit 2;
- i) njoftojë administratat doganore mbi pikat e kontaktit zyrtar referuar në paragrafin 1 të nenit

3. Në rast të ndonjë mosmarreveshjeje të paraqitur ndërmjet një Pale Kontraktuese dhe depozitarit lidhur me performancën e funksionit të kësaj të fundit, depozitari ose ajo Pale Kontraktuese do të sjellë këtë çështje në vëmendje të Paleve të tjera Kontraktuese dhe të firmosësve ose, sipas rastit, të Komitetit Administrativ.

Neni 54

Regjistrimi dhe tekstet autentike

Në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara, kjo Konventë do të regjistrohet të Sekretariati i Kombeve të Bashkuara sipas kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm.

Dëshmitare për sa më sipër, të poshteshënuarit, të autorizuar perkatesisht, kanë firmosur këtë Konventë.

Berë në Bruksel, më 27 qershor 2003 në anglisht dhe frëngjisht, të dyja tekstet njëlloj autentike, në një kopje të vetme që depozitohet të Sekretarit të Përgjithshëm, i cili do t'i transmetojë kopje të vertetuara të gjitha entiteve të përmendura në paragrafet 1 dhe 3 të nenit 46 të kësaj Konvente.



LIGJ

Nr. 9404, date 19.5.2005

PER RATIFIKIMIN E "MARREVESHJES KUADER NDERMJET REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE KOMUNITETIT EUROPIAN, PER PARIMET E PERGJITHSHME PER PJESEMARRJEN E SHQIPERISE NE PROGRAMET KOMUNITARE"

Ne mbeshtetje te neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marreveshja kuader ndermjet Republikes se Shqiperise dhe Komunitetit Evropian, per parimet e pergjithshme per pjesemarrjen e Shqiperise ne programet komunitare", nenshkruar ne Bruksel me 22 nentor 2004.

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4611, date 6.6.2005 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Alfred Moisiu.

MARREVESHJE KUADER NDERMJET KOMUNITETIT EUROPIAN DHE SHQIPERISE MBI PARIMET E PERGJITHSHME PER PJESEMARRJEN E SHQIPERISE NE PROGRAMET KOMUNITARE

Komuniteti Evropian, ketu e tutje referuar si "Komuniteti", nga njera ane, dhe Republika e Shqiperise, ketu e tutje referuar si "Shqiperia", nga ana tjeter, te dyja palet ketu e tutje referuar si "Palet Kontraktuese", duke marre parasysh se:

- 1) Keshilli Evropiane ne Kopenhage ne dhjetor 2002 konfirmoi perspektiven evropiane te vendeve te Ballkanit Perendimor, si kandidatate te mundshem, dhe theksoi vendosmerine e tij, per te mbeshtetur perpjekjet e tyre per t'iu afruar me shume Bashkimit Evropiane;
- 2) Keshilli Evropian ne Selanik ne qershor 2003 pranoi qe procesi i Stabilizim-Asocimit do te mbetet kuadri per te gjithe rrugen evropiane te vendeve te Ballkanit Perendimor drejt hyrjes se ardhshme dhe miratoi "Axhenden e Selanikut per Ballkanin Perendimor: rruga drejt integritimit evropian", e cila synon te perforcoje me tej marredheniet e privilegjuara midis BE-se dhe Ballkanit Perendimor, duke u mbeshtetur ne pervojen e zgjerimit te BE-se;
- 3) Axhenda e Selanikut ftoi vendet e Ballkanit Perendimor te merrnin pjese ne programet dhe agjencite e komunitetit ne perputhje me parimet e vendosura per pjesemarrjen e vendeve

kandidate, duke synuar t'i njohe vendet ne fjale dhe popujt e tyre me politikat dhe metodat e punes se BE-se, duke i afruar keshtu edhe me fort me BE-ne dhe duke i nxitur ne rrugen drejt integritimit evropian;

- 4) Shqiperia ka shprehur deshiren e saj te marre pjese ne disa programe komunitare;
- 5) Rregullat dhe kushtet specifike, duke perfshire edhe kontributin perfundimtar, lidhur me pjesemarrjen e Shqiperise ne çdo program te posaçem, duhet te percaktohen me marreveshje midis Komisionit te Komuniteteve Evropiane, ne emer te komunitetit dhe Qeverise se Shqiperise,

kane rene dakord si vijon:

Neni 1

Shqiperia do te lejohet te marre pjese ne keto programe komunitare:

- a) Programet komunitare aktive, te cilat jepen ne shtojcen I, te cilat jane te hapura ndaj pjesemarrjes se Shqiperise sapo te hyje ne fuqi kjo Marreveshje (ketu e tutje referuar si "Marreveshja").
- b) Programet komunitare, te cilat krijohen ose riperterihen pas hyrjes ne fuqi te Marreveshjes, dhe te cilat permbajne nje dispozite hyrese qe parashikon pjesemarrjen e Shqiperise.

Neni 2

Shqiperia do te kontribuojë nga ana financiare ne buxhetin e pergjithshem te Bashkimit Evropian sipas programeve te veçanta ne te cilat merr pjese.

Neni 3

Perfaqesuesit e Shqiperise do te lejohen te marrin pjese, si vezhgues dhe per ato çeshtje te cilat kane te bejne me Shqiperine, ne komitetet e menaxhimit te cilat jane pergjegjese per monitorimin e programeve per te cilat Shqiperia kontribuon financiarisht.

Neni 4

Projektet dhe nismat qe paraqiten nga pjesemarrësit nga Shqiperia do t'u nenshtrohen, per aq sa eshte e mundur, te njejtave kushte, rregullave dhe procedurave lidhur me programet ne fjale, qe vlejne edhe per shtetet anetare.

Neni 5

Rregullat dhe kushtet specifike, lidhur me pjesemarrjen e Shqiperise ne secilin program te veçante, e veçanerisht kontributi financiar qe duhet paguar, do te percaktohen me marreveshje, ne formen e nje memorandumimi mirekuptimi, midis Komisionit, i cili vepron ne emer te komunitetit, dhe Qeverise se Shqiperise.

Ne rast se Shqiperia aplikon per ndihme te jashtme komunitare ne baze te Rregullores se Keshillit (CE) nr.2666/2000, te dates 5 dhjetor 2000, ndryshuar nga Rregullorja e Keshillit (CE) nr.2415, date 10 dhjetor 2001 per ndihmen per Shqiperine, Bosnje-Hercegovinen, Kroacine, Republiken Federale te Jugosllavise dhe ish- Republiken Jugosllave te Maqedonise, ose ne perputhje me çdo rregullore te ngjashme qe parashikon ndihme te jashtme komunitare per Shqiperine, e cila mund te miratohet ne te ardhmen, kushtet qe rregullojne perdorimin nga Shqiperia te ndihmes komunitare do te percaktohen ne nje marreveshje financiare.

Neni 6

Memorandumi i mirekuptimit do te percaktoje, ne perputhje me rregullat financiare te komunitetit, qe kontrolli ose revizionimet financiare do te behen prej, ose nen autoritetin e Komisionit Evropian, ZLKK-se dhe Gjykates se Llogarive e Komuniteteve Evropiane.

Dispozita te hollesishme do te perfshihen per kontrollin dhe revizionimin financiar, masat administrative, ndeshkimet dhe rikuperimin, duke aftesuar Komisionin Evropian, ZLKK-ne dhe Gjykatën e Llogarive te kene fuqi te barasvlershme me fuqite e tyre, lidhur me fituesit ose kontraktuesit e vendosur ne komunitet.

Neni 7

Marreveshja do te zbatohet per nje periudhe te papercaktuar kohe.

Secila Pale Kontraktuese mund ta denoncoje kete Marreveshje duke njoftuar me shkrim Palen tjetër Kontraktuese. Kjo Marreveshje do te bjere nga fuqia gjashte muaj pas dates se nje njoftimi te tille.

Neni 8

Jo me vone se tre vjet pas dates se hyrjes ne fuqi te kesaj Marreveshjeje, dhe çdo tre vjet me pas, te dyja Palet Kontraktuese mund te rishikojne zbatimin e kesaj Marreveshjeje ne baze te pjesemarrjes konkrete te Shqiperise ne nje ose me shume programe komunitare.

Neni 9

Kjo Marreveshje do te vlejë, nga njera ane, per ato terriore ne te cilat zbatohet Traktati Themelues i Komunitetit Evropian dhe nen ato kushte qe parashikon ky Traktat, dhe nga ana tjetër, per terriorin e Shqiperise.

Neni 10

Kjo Marreveshje do te hyje ne fuqi ne datën e marrjes se njoftimit te fundit me shkrim nepermjet kanaleve diplomatike me ane te te cilit secila Pale Kontraktuese informon tjetren qe procedurat e saj per hyrjen ne fuqi te kesaj Marreveshjeje jane perfunduar.

Neni 11

1) Marreveshja hartohet ne dy kopje ne gjuhet çeke, daneze, holandeze, angleze, estoneze, finlandeze, frenge, gjermane, greke, hungareze, italiane, letoneze, lituaneze, polake, portugeze, sllovakë, sllovene, spanjolle, suedeze si dhe shqip.

2) Kur institucionet e Bashkimit Evropian do te detyrohen te botojne te gjitha aktet zyrtare ne gjuhen malteze ne Gazeten Zyrtare te Bashkimit Evropian, Marreveshja do te hartohet ne dy kopje edhe ne gjuhen malteze.

3) Secili nga tekstet ne secilen gjuhe eshte njesoj autentik.

Per Qeverine e Republikës se Shqiperise

Per Komunitetin Evropian

Por La Comunidad Europea

Za Evropské společenství

For Det Europæiske Fællesskab

Für die Europäische Gemeinschaft

Euroopa Ühenduse nimel

Για την Ευρωπαϊκή Κοινότητα

For the European Community

Pour la Communauté européenne
Per la Comunità europea
Eiropas Kopienas vārdā
Europos bendrijos vardu
az Európai Közösség reszéről
Ghall-Komunitá Ewropea
Voor de Europese Gemeenschap
W imieniu Wspólnoty Europejskiej
Pela Comunidade Europeia
Za Európske spoločenstvo
za Evropsko skupnost
Euroopan yhteisön puolesta
På Europeiska gemenskapens vägnar

SHTOJCA I

LISTA E PROGRAMEVE KOMUNITARE AKTIVE, REFERUAR NE NENIN 1

- Lufta kunder diskriminimit (2001-2006)¹
- Lufta kunder perjashtimit shoqeror (2001-2006)²
- Masat komunitare ne mbeshtetje te politikës se konsumatorit (2004-2007)³
- Programi komunitar i veprimit per te ndihmuar organizatat qe veprojnë ne planin evropian dhe per te mbeshtetur veprimtari specifike ne fushen e arsimit dhe trajnimit (2004-2006)⁴
- Programi komunitar i veprimit per nxitjen e qytetarise aktive evropiane (2004- 2006)⁵
- Veprimi komunitar ne fushen e shendetit publik (2003-2008)⁶
- Kultura 2000 (2000-2006)⁷

¹ Krah. Vendimi i Keshillit nr. 2000/750/EC i dates 27 nentor 2000 qe krijoi nje program veprimi komunitar per te luftuar kunder diskriminimit (2001 deri 2006) - OJL 303/2000

² Krah. Vendimi nr. 50/2002/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit te dates 7 dhjetor 2001 qe krijoi nje program veprimi komunitar per rritjen e bashkepunimit midis shteteve anetare per te luftuar kunder perjashtimit shoqeror - OJL 10/2002

³ Krah. Vendimi nr. 20/2004/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit i dates 8 dhjetor 2003 qe krijoi nje kuader per financimin e veprimeve komunitare ne mbeshtetje te politikës se konsumatoreve per vitet 2004 deri 2007 (Teksti me interes per AEM-ne) -OJL 05/2004

⁴ Krah. Vendimi nr. 791/2004/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit i dates 21 prill 2004 qe krijoi nje program veprimi komunitar per te ndihmuar organizatat qe veprojnë ne planin evropian dhe per te mbeshtetur veprimtari specifike ne fushen e arsimit dhe trajnimit - OJL 138/2004

⁵ Krah. Vendimi i Keshillit nr. 2004/100/EC i dates 26 janar 2004 qe krijoi nje program veprimi komunitar per te nxitur qytetarine aktive evropiane (pjesemarrjen civile - OJL 030/2004

⁶ Krah. Vendimi nr. 1786/2002/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit i dates 23 shtator 2002 qe miratoi nje program veprimesh komunitare ne fushen e shendetit publik (2003-2008) -OJL 271/2002

⁷ Krah. Vendimi nr. 508/2000/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit i dates 14 shkurt 2000 qe krijoi programin Kultura 2000 - OJL 63/2000 dhe vendimi nr. 626/2004/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit i dates 31 mars 2004 qe ndryshoi vendimin nr.508/2000/EC qe krijoi programin Kultura 2000 (Tekst me interes per AEM-ne)-OJL 99/2004

- Doganat (2003-2007)⁸
- Programi Daphne II (2004-2008)⁹
- eContent Plus (2004-2008)¹⁰

- eLearning (2004-2006) ¹¹
- Erasmus Mundus (2004-2008) ¹²
- Programi Fiscalis (2003-2007) ¹³
- Barazia gjinore (2001-2006)] ¹⁴
- Programi Hercule (2004-2006) ¹⁵
- Energji Inteligjente per Evropen (2003-2006) ¹⁶
- Life (2000-2006) ¹⁷
- Leonardo da Vinçi II (2000-2006) ¹⁸
- Programi Marko Polo (2003-2010) ¹⁹
- Media Plus ²⁰ / Trajnimi i medies (2001-2006) ²¹
- Internet me i sigurt plus (2005-2008) ²²
- Programi i gjashte per zhvillimin dhe kerkimin teknologjik (2002-2006) ²³

⁸Krah. Vendimi nr. 253/2003/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit i dates 11 shkurt 2003 qe miratoi nje program veprimesh per doganat ne komunitet (Dogana 2007) - OJL 36/2003

⁹Krah. Vendimi nr. 803/2004/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit i dates 21 prill 2004 qe miratoi nje program veprimesh komunitare (nga 2004 deri 2008) per te parandaluar dhe luftuar kunder dhunes kunder femijeve, te rinjve dhe grave dhe per t'i mbrojtur viktimat dhe grupet e rrezikuara (programi Daphne II) OJL 143/2004

¹⁰pret miratimin - Krah. COM [2004] 96 - 2004/0025/COD

¹¹Krah. Vendimi nr.2318/2003/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit i dates 5 dhjetor 2003 qe miratoi nje program shumevjeçar (nga 2004 deri 2006) per integrimin e efektshem te teknologjive informatike dhe komunikimit (ICT) ne sistemet arsimore dhe trajnuese ne Evrope (Programi e Learning) - OJL 345/2003

¹²Krah. Vendimi nr. 2317/2003/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit i dates 5 dhjetor 2003 qe krijoi nje program per rritjen e cilesise se arsimit te larte, si dhe per rritjen e mirekuptimit nderkulturor nepermjet bashkepunimit me vendet e treta (Erasmus Mundus) (nga 2004 deri 2008) - OJL 345/2003

¹³Krah. Vendimi nr. 2235/2002/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit i dates 3 dhjetor 2002 qe miratoi nje program komunitar per permiresimin e funksionimit te sistemeve tatimore ne tregun e brendshem (Programi Fiscalis 2003-2007) - OJL 341/2002

¹⁴Krah. Vendimi i Keshillit nr. 2001/51/EC i dates 20 dhjetor 2000 qe krijoi nje program lidhur me kuadrin strategjik komunitar per barazine gjinore (2001-2005) - OJL 017/2001 me ndryshimet nga vendimi i Keshillit [...] OJL [...] [po pergatitet zgjatja deri ne fund te vitit 2006-krah.COM(2004)551-2004/0194 COD]

¹⁵Krah. Vendimi nr.804/2004/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit te dates 21 prill 2004 qe krijoi nje program masash komunitare per te ndihmuar veprimtarite ne fushen e mbrojtjes se interesave financiare te komunitetit (Hercule-programe) - OJL 143/2004

¹⁶Krah. Vendimi nr.1230/2003/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit i dates 26 qershor 2003 qe miratoi nje program shumevjeçar per veprim ne fushen e energjetikes: "Energji Inteligjente per Evropen" (2003 - 2006) (Tekst me interes per AEM-ne) - OJL 176/2003

¹⁷Krah. Rregullorja (EC) nr.1655/2000 e Parlamentit Evropian dhe e Keshillit i dates 17 korrik 2000 lidhur me Instrumentin Financiar per Mjedisin (UFE) - OJL 192/2000 me ndryshuar Rregullores (EC) nr.1682/2004 e dates 15 shtator 2004 - OJL 308/2004

¹⁸Krah. Vendimi i Keshillit nr. 1999/382/EC i dates 26 prill 1999 qe krijoi fazen e dyte te programit te veprimit komunitar per formimin profesional "Leonardo da Vinci" - OJL 146/1999

¹⁹Krah. Rregullorja (EC) nr. 1382/2003 e Parlamentit Evropian dhe e Keshillit e dates 22 korrik 2003 per dhenien e ndihmave financiare komunitare per permiresimin e funksionimit mjedisor te sistemit te transportit te mallrave (Programi Marko Polo) - OJL 196/2003

²⁰Krah. Korrigjimi i vendimit te Keshillit 2000/821/EC i dates 20 dhjetor 2000 per zbatimin e nje programi per nxitjen e zhvillimit, shperndarjes dhe promovimit te veprave audiovizive evropiane (MEDIA Plus Zhvillimi, Shperndarja dhe Promovimi) (2001-2005) (OJL 336 i

dates 30.12.2000) - OJL 013/2001 ndryshuar nga vendimi nr.846/2004/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit i dates 29 prill 2004 - OJL 157/2004

²¹Krah. Vendimi nr.163/2001/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit i dates 19 janar 2001 per zbatimin e nje programi trajnimi per profesionistet ne sektorin e programeve audiovizive europiane (MEDIA-Training) (20012005) - OJL 026/2001 ndryshuar nga vendimi nr.845/2004 i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit i 29 prill 2004-OJL 157/2004

²²pritet miratimi - Cf. COM [2004]91 - 2004/0023/COD

- Socrates II (2000-2006) ²⁴

- Rinia (2000-2006) ²⁵

²³Krah. Vendimi nr.1513/20021/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit i dates 27 qershor 2002 lidhur me programin e gjashte kuader te Komunitetit Evropian per kerkimin, zhvillimin teknologjik dhe aktivitetet demonstruese, duke kontribuar ne krijimin e nje hapësire kerkimore evropiane dhe te risive(2002 to 2006) - OJL 23212002

²⁴Krah. Vendimi nr. 253/2000/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit i dates 24 janar 2000 qe krijoi fazen e dyte te programit te veprimit komunitar ne fushen e arsimit" Socrates" - OJL28/2000

²⁵Krah. Vendimi nr.1031 /2000/EC i Parlamentit Evropian dhe i Keshillit i dates 13 prill 2000 qe krijoi programin e veprimit komunitar "Rinia" - OJL 117/2000



LIGJ

Nr. 9503, date 3.4.2006

PER ADERIMIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE KONVENTEN PER KONTRATEN E TRANSPORTIT RRUGOR NDERKOMBETAR TE MALLRAVE (CMR) DHE PROTOKOLLIN E NENSHKRIMIT

Ne mbeshtetje te neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqiperise aderon ne Konventen per Kontraten e Transportit Rrugor Nderkombetar te Mallrave (CMR) dhe Protokollin e nenshkrimit.

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare
Shpallur me dekretin nr.4837, date 25.4.2006 te Presidentit te Republikes se Shqiperise,
Alfred Moisiu

KONVENTA MBI KONTRATEN PER TRANSPORTIN RRUGOR NDERKOMBETAR TE MALLRAVE (CMR)

Bere ne Gjeneve, me 19 Maj 1956 Kombet e Bashkuara

PREAMBULE

Palet kontraktuese,

duke njohur dobine e standardizimit te kushteve qe rregullojne kontraten per transportin rrugor nderkombetare te mallrave, sidomos ne lidhje me dokumentet per kete transport dhe pergjegjesine e transportuesit,

rane dakord si me poshte:

KAPITULLI I

FUSHA E ZBATIMIT

Neni 1

1. Kjo Konvente zbatohet per çdo kontrate te transportit rrugor te mallrave ne automjete me shperblim, ku vendi i marrjes ne dorezim te mallrave dhe vendi i caktuar per dorezim, sipas parashikimit ne kontrate, ndodhen ne dy vende te ndryshme, nga te cilet njeri eshte vend kontraktues, pavaresisht nga vendbanimi ose shtetesia e paleve.

2. Per qellimet e kesaj Konvente, "automjete" jane mjetet motorike, maunat dhe automjetet me rimorkio dhe gjysmerimorkio, siç parashikohet ne nenin 4 te Konventes mbi Trafikun Rrugor, te dates 19 Shtator 1949.

3. Kjo Konvente zbatohet edhe nese transporti qe perfshihet ne fushen e saj te zbatimit kryhet nga shtete ose institucione apo organizata qeveritare.

4. Kjo Konvente nuk zbatohet:

- a) per transportin e kryer ne baze te kushteve te Konventes Portare Nderkombetare;
- b) per transportet funerale;
- c) per transportin e mobilieve.

5. Palet kontraktuese bien dakord per te mos ndryshuar asnje nga dispozitat e kesaj Konvente me ane te marreveshjeve te veçanta ndermjet dy ose me shume prej tyre, perveçse per ta bere ate te pazbatueshme ne trafikun e brendshem ose per te autorizuar ne operacionet e transportit te kufizuara teresisht ne territorin e tyre perdorimin e faturave te shoqerimit te mallit qe perfaqesojne pronesine mbi mallin.

Neni 2

1. Nese automjeti qe mbart mallin transportohet ne nje pjese te udhetimit me rruge detare, hekurudhore, ujera te brendshme ose rruge ajrore dhe, perveç kur zbatohen dispozitat e nenit 14, malli nuk shkarkohet nga automjeti, kjo Konvente zbatohet per te gjithë transportin. Nese dhe ne masen e provuar se çdo humbje, dem ose vonese ne dorezimin e mallit qe shkaktohet gjate transportit me mjete te tjera te transportit nuk eshte shkaktuar nga transportuesi rrugor, por nga ndonje rrethane qe mund te ndodhte gjate dhe per shkak te transportit me mjetin tjetër te transportit, pergjegjesia e transportuesit rrugor nuk percaktohet nga kjo Konvente por ne menyren ne te cilen do te percaktohej pergjegjesia e transportuesit me mjetin tjetër te transportit, nese do te ishte bere nje kontrate per transportimin e mallit vetem nga derguesi dhe transportuesi me mjetin tjetër te transportit ne pajtim me kushtet e parashikuara nga ligji per transportin e mallit me mjetin tjetër te transportit. Megjithate, nese nuk ka kushte te tilla te parashikuara, pergjegjesia e transportuesit rrugor percaktohet nga kjo Konvente.

2. Nese transportuesi rrugor eshte po i njejti transportues me mjetin tjetër te transportit, pergjegjesia e tij percaktohet gjithashtu ne pajtim me dispozitat e paragrafit te pare te ketij neni, por sikur ai te ishte dy persona te ndryshem ne cilesine e transportuesit rrugor dhe me mjetin tjetër te transportit.

KAPITULLI II

PERSONAT PER TE CILET TRANSPORTUESI ESHTË I PERGJEGJSHËM

Neni 3

Per qellimet e kesaj Konvente, transportuesi eshte i pergjegjshem per veprimet ose mosveprimet e agjenteve dhe sherbyesve te tij, dhe te personave te tjere, sherbimet e te cileve ai i perdor per te kryer transportin, nese keta agjente, sherbyes ose persona te tjere veprojne ne kuadrin e punesimit te tyre, sikur keto veprime ose mosveprime te ishin te tijat.

KAPITULLI III

LIDHJA DHE ZBATIMI I KONTRATES SE TRANSPORTIT

Neni 4

Kontrata e transportit konfirmohet duke perpiluar nje fature per shoqerimin e mallit. Mungesa, parregullsia ose humbja e fatures shoqeruese te mallit nuk ka efekt mbi ekzistencen ose vlefshmerine e kontrates se transportit qe mbetet e rregulluar nga dispozitat e kesaj Konvente.

Neni 5

1. Fatura shoqeruese e mallit perpilohet ne tri kopje origjinale te nenshkruara nga derguesi dhe nga transportuesi. Keto nenshkrime mund te shtypen ose te zevendesohen nga vula e derguesit dhe transportuesit nese kete e lejon ligji i vendit ku eshte perpiluar fatura shoqeruese e m allit. Kopja e pare i jepet derguesit, e dyta shoqeron mallin dhe e treta mbahet nga transportuesi.

2. Nese malli qe do te transportohet duhet te ngarkohet ne automjete te ndryshme apo eshte i llojeve te ndryshme ose do te ndahet te pjese te ndryshme, derguesi ose transportuesi do te kete te drejten te kerkoje nje fature te veçante shoqeruese per mallin qe duhet te pergatitet per çdo automjet te perdorur, per çdo lloj ose per çdo pjese te mallit.

Neni 6

1. Fatura shoqeruese e mallit permban hollesite e meposhtme:

- a) Daten e fatures shoqeruese te mallit dhe vendin ne te cilin ajo eshte perpiluar;
- b) Emrin dhe adresen e derguesit;
- c) Emrin dhe adresen e transportuesit;
- d) Vendin dhe daten e marrjes ne dorezim te mallit dhe vendin e caktuar per t'u dorezuar;
- e) Emrin dhe adresen e marresit;
- f) Pershkrimin ne pergjithesi te natyres se mallit dhe metoden e paketimit, dhe, ne rastin e mallrave te rrezikshem, pershkrimin e tyre pergjithesisht te njohur;
- g) Numrin e paketave dhe shenjat, si dhe numrat e tyre te veçante,
- h) Peshen bruto te mallit ose sasine e tyre te shprehur ndryshe;
- i) Tarifat qe lidhen me transportin (tarifat e transportit, tarifate shtese, tarifate doganore dhe tarifa te tjera qe shkarkohen nga perpilimi i kontrates deri ne momentin e dorezimit);
- j) Udhezimet e nevojshme per doganen dhe formalitetet e tjera;
- k) Nje deklarate qe transporti, pavaresisht nga ndonje dispozite me efekt te kundert, i nenshtrohet dispozitave te kesaj Konvente.

2. Sipas rastit, fatura shoqeruese e mallit permban edhe hollesite e meposhtme:

- a) Nje deklarate qe ringarkimi nuk lejohet;
- b) Tarifate qe merr persiper te paguaje derguesi;
- c) Shumen e tarifave te "pagesave ne momentin e dorezimit";

- d) Nje deklarate per vleren e mallit dhe shumen qe perfaqeson interes te veçante per dorezimin;
 - e) Udhezimet e derguesit per transportuesin ne lidhje me sigurimin e mallit;
 - f) Afati kohor qe eshte rene dakord per kryerjen e transportit;
 - g) Nje liste te dokumenteve qe i dorezohet transportuesit.
3. Palet mund te perfshijne ne faturen shoqeruese te mallit çdo hollesi tjetër qe atyre mund t'u duket e dobishme.

Neni 7

1. Derguesi eshte i pergjegjshem per te gjitha shpenzimet, humbjen ose demin e pesuar nga transportuesi per shkak te pasaktësisë ose papershtatshmerise se:
- a) hollesive te percaktuara ne nenin 6 paragrafi 1, (b), (d), (e), (f), (g), (h) dhe (j);
 - b) hollesive te percaktuara ne nenin 6 paragrafi 2;
 - c) çdo hollesie ose udhezimi tjetër te dhene prej tij per te mundësuar perpilimin e fatures shoqeruese te mallit ose per t'u perfshire ne te.
2. Nese, me kerkesen e derguesit, transportuesi perfshin ne faturen shoqeruese te mallit hollesite e permendura ne paragrafin 1 te ketij neni, ai mendohet ta kete bere kete, nese nuk vertetohet e kunderta, ne emer te derguesit.
3. Nese fatura shoqeruese e mallit nuk e permban deklaraten e percaktuar ne nenin 6 paragrafi 1 (k), transportuesi eshte i pergjegjshem per te gjitha shpenzimet, humbjen dhe demin e pesuar nepermjet ketyre mosveprimeve nga personi qe ka te drejten te disponoje mbi mallin.

Neni 8

1. Gjate marrjes ne dorezim te mallit, transportuesi kontrollon:
- a) saktësinë e deklarimeve ne faturen shoqeruese te mallit ne lidhje me numrin e paketave dhe shenjat, dhe numrat e tyre, dhe
 - b) gjendjen e jashtme te mallrave dhe paketimin e tyre.
2. Nese transportuesi nuk ka mjete te arsyeshme per te kontrolluar saktësinë e deklarimeve te permendura ne paragrafin 1 (a) te ketij neni, ai perfshin rezervat e tij ne faturen shoqeruese te mallit se bashku me arsyet ku ai i mbështet ato. Ai gjithashtu percakton arsyet per çdo rezerve qe ai ben ne lidhje me gjendjen e jashtme te mallit dhe paketimin e tij. Keto rezerva nuk e detyrojne derguesin, perveç kur ai ka rene shprehimisht dakord per te qene i detyruar prej tyre ne faturen shoqeruese te mallit.
3. Derguesi ka te drejte t'i kerkoje transportuesit te kontrolloje peshen bruto te mallit ose sasine e tij te shprehur ndryshe. Ai mund te kerkoje gjithashtu qe te kontrollohet permbajtja e pakove. Transportuesi ka te drejte te pretendojë koston per nje kontroll te tille. Rezultati i kontrollit shenohet ne faturen shoqeruese te mallit.

Neni 9

1. Fatura shoqeruese e mallit eshte prove prima facie e lidhjes se kontrates se transportit, kushteve te kontrates dhe marrjes ne dorezim te mallit nga transportuesi.
2. Nese fatura shoqeruese e mallit nuk permban ndonje rezerve te veçante nga transportuesi, prezumohet, nese nuk provohet e kunderta, se malli dhe paketimi i tij dukej se ishte ne

gjendje të mire kur u mor në dorezim nga transportuesi dhe numri i pakove, shenjat dhe numrat e tyre korrespondojnë me fakturën shoqeruese të mallit.

Neni 10

Derguesi është i përgjegjshëm kundrejt transportuesit për demin e shkaktuar personave, pajisjeve ose mallrave të tjera; dhe për të gjitha shpenzimet për shkak të paketimit të parregullt të mallit, përveç kur parregullsia është e dukshme ose transportuesi kishte dijeni në momentin e marrjes në dorezim të mallit dhe ai nuk ka bërë rezervë për këto.

Neni 11

1. Për qellimet e doganës ose formaliteteve të tjera që duhet të perfundohen për dorezimin të mallit, derguesi i bashkëngjit fakturën shoqeruese të mallit të gjitha dokumentet e nevojshme ose i ve në dispozicion të transportuesit dhe i jep atij të gjithë informacionin që ai i kërkon.

2. Transportuesi nuk është i detyruar të hetojë për saktësinë ose pershtatshmerinë e ketyre dokumenteve ose informacioni. Derguesi është i përgjegjshëm për transportuesit për çdo dem që shkaktohet nga mungesa, papershtatshmeria ose parregullsia e ketyre dokumenteve ose këtij informacioni, përveç në rastin e veprimtimit të gabuar ose neglizhimit nga ana e transportuesit.

3. Përgjegjësia e transportuesit për pasojat që rrjedhin nga humbja ose përdorimi i pasakte të dokumenteve të percaktuara në fakturën shoqeruese të mallit dhe që e shoqerojnë ato, ose të depozituara tek transportuesi është ajo e agjentit, me kusht që kompensimi që paguhet nga transportuesi nuk e kalon atë që paguhet në rastin e humbjes së mallit.

Neni 12

1. Derguesi ka të drejtë të shesë mallin, veçanërisht duke i kërkuar transportuesit të ndalojë mallin në transit, të ndryshojë vendin në të cilin duhet të bëhet dorezimi ose t'ia dorëzojë mallin një marresi tjetër të ndryshëm nga marresi që është në fakturën shoqeruese të mallit.

2. Kjo e drejtë pushon në ekzistencë pasi t'i jete dorëzuar marresit kopja e dytë e fakturës shoqeruese të mallit, ose kur marresi ushtron të drejtën në bazë të nenit 13 paragrafi 1; që nga ai moment transportuesi plotëson porositë e marresit.

3. Megjithatë, marresi ka të drejtën e shitjes që nga momenti i përpilimit të fakturës shoqeruese të mallit, nëse derguesi ben një shënim për këto qellime në fakturën shoqeruese të mallit.

4. Nëse në ushtrim të së drejtës së shitjes marresi ka porositur dorezimin e mallit të një personi tjetër, ky i fundit nuk ka të drejtë të caktojë marres tjetër.

5. Ushtrimi i së drejtës së shitjes u nënshtrohet kushteve të mëposhtme:

a) Që derguesi ose, në rastin e parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, marresi që dëshiron të ushtrojë këto të drejta jep kopjen e parë të fakturës shoqeruese të mallit në të cilën janë shënuar udhëzimet e reja për transportuesin dhe zhdedton transportuesin në lidhje me të gjitha shpenzimet, humbjen dhe demtimin që lidhet me zbatimin e ketyre udhëzimeve të reja.

b) Që zbatimi i ketyre udhëzimeve është i mundshëm në momentin kur udhëzimet mberrijnë të personi që duhet t'i zbatojë ato dhe nuk ndërhyjnë në aktivitetin normal të sipërmarrjes së transportuesit dhe nuk cenojnë porositë e tjera të derguesit ose marresit.

c) Që udhëzimet nuk shkaktojnë ndarje të porositë.

6. Nese per shkak te dispozitave te paragrafit 5(b) te ketij neni transportuesi nuk mund te zbatoje udhezimet qe ai ka marre, ai njofton menjehere personin qe i ka dhene atij udhezimet.

7. Nje transportues qe nuk ka zbatuar udhezimet e dhena sipas kushteve te parashikuara ne kete nen ose qe i ka zbatuar ato pa kerkuar t'i jepet kopja e pare e fatues shoqeruese te mallit, ai pergjigjet para personit qe ka te drejte te ngreje pretendim ne lidhje me çdo humbje ose demtim te shkaktuar nga kjo.

Neni 13

1. Pas mberritjes se mallit ne vendin e caktuar per t'u dorezuar, marresi ka te drejte t'i kerkoje transportuesit t'i jape atij, kundrejt nje fature, kopjen e dyte te fatures shoqeruese te mallit dhe mallin. Nese provohet humbja e mallit, ose nese malli nuk ka mberritur edhe pas kalimit te afatit te parashikuar ne nenin 19, marresi ka te drejte te ushtroje ne emer te tij kunder transportuesit te gjitha te drejtat qe rrjedhin nga kontrata e transportit.

2. Marresi qe ushtron te drejtat e parashikuara per te ne paragrafin 1 te ketij neni paguan te gjitha tarifat qe kerkohen ne faturen shoqeruese te mallit, por ne rast mosmarreveshjeje per kete çeshtje transportuesit nuk i kerkohet te dorezoje mallin, perveç kur nga marresi jepet garanci.

Neni 14

1. Nese per nje arsye te caktuar behet i pamundur zbatimi i kontrates ne pajtim me kushtet e parashikuara ne faturen shoqeruese te mallit para se malli te arrije vendin e caktuar per dorezim, transportuesi kerkon udhezime nga personi qe ka te drejten te beje shitjen e mallit ne pajtim me dispozitat e nenit 12.

2. Megjithate, nese rrethanat jane te tilla qe lejojne transportin te kryhet ne kushte te ndryshme nga ato te parashikuara ne faturen shoqeruese te mallit dhe nese transportuesi nuk ka qene ne gjendje te marre udhezime ne nje afat te arsyeshem nga personi qe ka te drejten e shitjes se mallit ne pajtim me dispozitat e nenit 12, ai ndermerr ato hapa qe duken se per te jane ne favor te interesave te larta te personit qe ka te drejten te shese mallin.

Neni 15

1. Nese rrethanat nuk lejojne qe te behet dorezimi i mallit pas mberritjes se tij ne vendin e caktuar per dorezim, transportuesi i kerkon udhezi me derguesit. Nese marresi e refuzon mallin, derguesi ka te drejten t'a shese ate pa qene i detyruar te jape kopjen e pare te fatures shoqeruese te mallit.

2. Edhe nese marresi e refuzon mallin, ai megjithate mund te kerkoje dorezimin e mallit nese transportuesi nuk ka marre udhezime te tjera nga derguesi.

3. Nese rrethanat qe pengojne dorezimin e mallit dalin pasi marresi, ne ushtrim te te drejtave te tij sipas nenit 12 paragrafi 3, ka dhene nje porosi per t'iu dorezuar malli nje personi tjetër, paragrafi 1 dhe 2 i ketij neni zbatohen sikur marresi te ishte dergues dhe personi tjetër te ishte marresi.

Neni 16

1. Transportuesi ka te drejten e kompensimit te shpenzimeve te nga kerkesa e tij per udhezime dhe te te gjitha shpenzimeve qe shkaktohen nga zbatimi i ketyre, pervec kur keto shpenzime u shkaktuan nga veprimi i gabuar ose neglizhenca e transportuesit.

2. Ne rastet e permendura ne nenin 14 paragrafi 1 dhe ne nenin 15, transportuesi mund ta shkarkoje mallin per llogari te personit qe ka te drejten ta shese ate dhe me kete transporti konsiderohet i perfunduar. Transportuesi e mban mallin ne emer te personit qe e ka kete te drejte. Megjithate, ai mund t'ia besoje ate nje pale te trete dhe ne kete rast ai nuk ka asnje pergjegjesi pervecse per te treguar kujdesin e arsyeshem ne zgjedhjen e kesaj pale te trete. Tarifat qe paguhen ne baze te fatures shoqeruese te mallit dhe te gjitha shpenzimet e tjera paguhen kundrejt marrjes se mallit.

3. Transportuesi mund ta shese mallin pa pritur udhezime nga personi qe ka te drejten e shitjes se tij, nese malli mund te priset ose gjendja e tij e kerkon kete veprim, ose kur shpenzimet e magazinimit nuk do te ishin ne raport me vleren e mallit. Ai mund ta beje shitjen e mallit edhe ne raste te tjera, nese pas kalimit te nje afati te arsyeshem ai nuk ka marre nga personi qe ka te drejten e shitjes se mallit udhezime per te kunderten e asaj qe atij do t'i kerkohej normalisht per ta zbatuar.

4. Nese malli shitet ne baze te ketij neni, te ardhurat nga shitja, pasi te jene zbritur shpenzimet qe paguhen me marrjen e mallit, vihen ne dispozicion te personit qe ka te drejten e shitjes e mallit. Nese keto tarifa jane me te larta se te ardhurat nga shitja, transportuesi ka te drejten e diferences.

5. Procedura ne rastin e shitjes vendoset ne baze te ligjit ose zakonit te vendit ku ndodhet malli.

KAPITULLI IV

PERGJEGJESIA E TRANSPORTUESIT

Neni 17

1. Transportuesi pergjigjet per humbjen teresore ose pjesore te mallit dhe per demtimin e tij, qe ndodh nga momenti kur ai merr ne dorezim mallin deri ne momentin e dorezimit, si dhe per çdo vonese ne dorezim.

2. Megjithate, transportuesi lirohet nga pergjegjesia nese humbja, demtimi dhe vonesa jane shkaktuar nga veprimi i gabuar ose neglizhenca e pretenduesit, nga udhezimet e pretenduesit te dhena jo per shkak te veprimit te gabuar ose neglizhences nga ana e transportuesit, nga vesi i brendshem i mallit ose nga rrethanat qe transportuesi nuk mund t'i menjanonte dhe pasojat e te cilave ai nuk ishte ne gjendje t'i parandalonte.

3. Transportuesi nuk lirohet nga pergjegjesia per shkak te gjendjes me defekt te automjetit qe perdoret prej tij per te kryer transportin ose per shkak te veprimit te gabuar, ose neglizhences se personit nga i cili ai mund te kete marre me qira automjetin ose te agjenteve ose sherbyesve te ketij te fundit.

4. Ne baze te nenit 18, paragrafet 2 deri 5, transportuesi lirohet nga pergjegjesia nese humbja ose demtimet qe rrjedhin nga rreziqet e veçanta qe jane ne nje ose me shume prej rrethanave te mepostme:

a) perdorimi i automjeteve te hapura te pambuluara, nese per perdorimin e tyre eshte rene shprehimisht dakord dhe parashikuar ne faturen shoqeruese te mallit;

b) mungesa ose gjendja me defekt e paketimit ne rastin e mallit qe, nga natyra e tij, mund te firoje ose demtohet nese nuk eshte i paketuar ose nuk eshte paketuar si duhet;

- c) trajtimi, ngarkimi, ruajtja gjate transportit ose shkarkimi i mallit nga derguesi, marresi ose personi qe vepron ne emer te derguesit ose marresit;
 - d) natyra e disa llojeve te mallrave qe i ekspozon ata kundrejt humbjes se plote ose pjesore ose demtimit; sidomos nepermjet thyerjes, ndryshkjes, kalbezimit, tharjes, rrjedhjes, firos se zakonshme ose veprimit te moles, ose insekteve;
 - e) pamjaftueshmeria ose papershtatshmeria e shenjave, ose, numrave neper pako;
 - f) transportimi i kafsheve.
5. Nese ne baze te ketij neni transportuesi nuk ka pergjegjesi ne lidhje me ndonje faktor qe ka shkaktuar humbjen, demtimin ose vonesen, ai pergjigjet deri ne ate mase qe ata faktore, per te cilet ai mban pergjegjesi ne baze te ketij neni, kane kontribuar ne humbjen, demtimin ose vonesen.

Neni 18

1. Barra e proves per te provuar se humbja, demtimi ose vonesa ishte per shkak te nje prej shkaqeve te parashikuara ne nenin 17 paragrafi 2 i bie transportuesit.
2. Nese transportuesi verteton se ne rrethanat e çeshtjes humbja ose demtimi mund te ishte p er shkak te nje ose disa prej rreziqeve te veçanta te parashikuara ne nenin 17 paragrafi 4, prezumohet se ai u shkaktua ne kete menyre. Megjithate, pretenduesi ka te drejten te provoje se humbja ose demtimi faktikisht nuk ishte plotesisht ose pjeserisht si rezultat i ketyre rreziqeve.
3. Ky prezumim nuk zbatohet ne rrethanat e parashikuara ne nenin 17 paragrafi 4(a), nese ka pasur nje pakesim jo te zakonshem ose humbje te ndonje pakoje.
4. Nese transporti kryhet ne automjete te pajisura ne menyre te veçante per te mbrojtur mallin nga efektet e te nxehtit, te ftohtit dhe ndryshimet ne temperature ose te lageshtires se ajrit, transportuesi nuk ka te drejte te pretendoje privilegjin e nenit 17 paragrafi 4(d), nese nuk provon se jane marre te gjitha hapat qe kerkohen prej tij ne rrethanat qe kane te bejne me zgjedhjen, mirembajtjen dhe perdorimin e kesaj pajisjeje dhe se ai ka permbushur te gjitha udhezimet e veçanta qe i jane dhene atij.
5. Transportuesi nuk ka te drejte te pretendoje privilegjin e nenit 17 paragrafi 4(f), nese ai nuk provon se jane ndermarre te gjitha hapat qe kerkohen prej tij dhe se ai ka permbushur çdo udhezim te veçante qe i eshte dhene.

Neni 19

Vonesa ne dorezim konsiderohet te kete ndodhur nese malli nuk eshte dorezuar brenda afatit kohor qe eshte rene dakord ose, nese nuk ka afat kohor te tille, kohezgjatja faktike e transportit, duke pasur parasysh rrethanat e çeshtjes dhe sidomos ne rastin e ngarkesave te pjesshme, koha qe nevojitet per realizimin e nje ngarkese te plote normalisht e tejkalon kohen qe do te ishte e arsyeshme per nje transportues te kujdesshem.

Neni 20

1. Fakti qe malli nuk eshte dorezuar brenda tridhjete diteve pas kalimit te afatit kohor te rene dakord ose, nese nuk ka afat kohor te tille, brenda gjashtedhjete diteve nga momenti kur transportuesi ka marre ne dorezim mallin, eshte prove perfundimtare per humbjen e mallit dhe personi qe ka te drejte te ngreje nje pretendim ne lidhje me kete mund ta konsideroje ate te humbur.

2. Personi qe ka kete te drejte, me marrjen e kompensimit per mallin e humbur, mund te kerkoje me shkrim qe ai te njoftohet menjehere nese malli gjendet brenda vitit pas pageses se kompensimit. Atij i jepet njohja me shkrim ne lidhje me kete kerkese.

3. Brenda tridhjetete diteve nga marrja e nje njoftimi te tille, personi qe ka te drejten e siperpermendur mund te kerkoje qe malli t'i dorezohet atij kundrejt pageses se tarifave qe duhet te paguhen ne baze te fatures shoqeruese te mallit dhe kundrejt kthimit te kompensimit qe ka marre duke zbritur te gjitha tarifat qe perfshihet ne te pa cenuar ndonje pretendim per kompensim ne lidhje me ndonje vonese ne dorezim ne baze te nenit 23 dhe, sipas rastit, nenit 26.

4. Ne mungese te kerkeses se parashikuar ne paragrafin 2 ose te ndonje udhezimi te dhene brenda afatit prej tridhjetete ditesh te parashikuar ne paragrafin 3, apo nese malli nuk eshte gjetur brenda nje viti nga pagesa e kompensimit, transportuesi ka te drejte ta trajtojte ate ne pajtim me ligjin e vendit ku ndodhet malli.

Neni 21

Nese malli i eshte dorezuar marresit pa marre tarifen e "parase ne dore ne momentin e dorezimit" e cila duhej te merrej nga transportuesi ne baze te kushteve te kontrates se transportit, transportuesi pergjigjet kundrejt derguesit per nje kompensim qe nuk e kalon shumen e nje tarife te tille, duke mos cenuar te drejten e tij per te ngritur padi kundrejt marresit.

Neni 22

1. Nese derguesi i jep transportuesit mall me nje natyre te rrezikshme, ai e informon transportuesin ne lidhje me natyren e sakte te rrezikut dhe nese eshte e nevojshme tregon masat qe duhet te merren. Nese nje informacion i tille nuk eshte shenuar ne faturen shoqeruese te mallit, barra per te provuar me mjete te tjera se transportuesi e dinte natyren e sakte te rrezikut qe rrjedh nga ky mall i bie derguesit ose marresit.

2. Malli me natyre te rrezikshme qe ne rrethanat e parashikuara ne paragrafin 1 te ketij neni nuk dihej nga transportuesi se ishte i rrezikshem, mund te shkarkohen, shkaterrohen ose te neutralizohen nga transportuesi ne çdo vend dhe kohe pa kompensim; per me teper, derguesi pergjigjet per shpenzimet, humbjen ose demin qe shkaktohet nga dhenia e tyre per transport ose nga transporti i tyre.

Neni 23

1. Nese ne baze te dispozitave te kesaj Konvente, nje transportues pergjigjet per kompensimin ne lidhje me humbjen teresore ose pjesore te mallit, ky kompensim llogaritet duke iu referuar vleres se mallit ne vendin dhe kohen ne te cilen ai u pranua per transport.

2. Vlera e mallit caktohet ne baze te çmimit te burses se mallrave ose, nese nuk ka çmim te tille, ne baze te çmimit aktual te tregut, ose, nese nuk ka çmim ne bursen e mallrave ose çmim aktual ne treg, ne baze te vleres normale te mallit te te njejtit lloj dhe cilesi.

3. Megjithate kompensimi nuk i kalon 25 franga per kilogram te peshes bruto. "Frange" eshte frange ari qe peshon 10/31 e gramit dhe me pasterti 900.

4. Pervec kesaj, tarife e transportit, tarifat doganore dhe tarifat e tjera te paguara per transportin e mallit kthehen teresisht ne rastin e humbjes se plote dhe proporcionalisht me humbjen e pesuar ne rastin e humbjes se pjesshme, por nuk paguhet per asnje dem tjeter.

5. Ne rastin e voneses, nese pretenduesi provon qe demi eshte shkaktuar nga kjo, transportuesi paguan kompensim per kete dem qe nuk kalon tarifat e transportit.

6. Kompensim me i larte mund te paguhet vetem kur vlera e mallit ose nje interes i veçante ne dorezim eshte deklaruar ne pajtim me nenet 24 dhe 26.

Neni 24

Derguesi, nepermjet pageses se nje tarife shtese per te cilen bie dakord, mund te deklaroje ne faturen shoqeruese te mallit nje vlere per mallin e cila e kalon kufirin e caktuar ne nenin 23 paragrafi 3 dhe ne kete rast, shuma e vleres se deklaruar zevendeson kete kufi.

Neni 25

1. Ne rastin e demit, transportuesi pergjigjet per ate shume qe malli ka pesuar renie ne vlere, te llogaritur duke iu referuar vleres se mallit te caktuar ne pajtim me nenin 23, paragrafet 1, 2 dhe 4.

2. Kompensimi megjithate nuk mund te kaloje:

a) nese eshte demtuar i gjithe malli i derguar, shumen e pagueshme ne rastin e humbjes se plote;

b) nese eshte demtuar vetem nje pjese e mallit te derguar, shumen e pagueshme ne rastin e humbjes se pjeses perkatese.

Neni 26

1. Derguesi, me ane te pageses se nje tarife shtese per te cilen bie dakord, mund te caktoj shumen e nje interesi te veçante ne dorezim ne rastin e humbjes ose demtimit, ose te kalimit te afatit kohor qe eshte rene dakord, duke shenuar kete shume ne faturen shoqeruese te mallit. Nese eshte bere deklarimi i nje interesi te veçante ne dorezim, kompensimi per humbjen ose demin shtese te provuar mund te pretendohet deri ne shumen e plote te interesit te deklaruar, pavaresisht nga kompensimi i parashikuar ne nenet 23, 24 dhe 25.

Neni 27

1. Pretenduesi ka te drejte te pretendoje interesin per kompensimin e pagueshem. Ky interes, i llogaritur me pese per qind ne vit, fillon nga data ne te cilen pretendimi i eshte derguar me shkrim transportuesit ose, nese nuk eshte ngritur nje pretendim i tille, nga data ne te cilen ka filluar procesi gjyqesor.

2. Nese shumat ne te cilat bazohet llogaritja e kompensimit nuk jane shprehur ne valuten e vendit ne te cilen pretendohet pagesa, konvertimi behet me kursin e kembimit te dites dhe vendit te pageses se kompensimit.

Neni 28

1. Ne rastet kur ne baze te ligjit te zbatuar humbja, demtimi ose vonesa qe shkaktohet nga transporti ne baze te kesaj Konvente behet shkak per pretendime jashtekontraktuale, transportuesi mund t'u referohet dispozitave te kesaj Konvente qe perjashtojne pergjegjesine e tij ose qe caktojne ose kufizojne kompensimin qe duhet paguar.

2. Ne rastet e pergjegjesise jashtekontraktuale te nje prej personave per te cilin transportuesi eshte i pergjegjshem ne baze te kushteve te nenit 3 per humbjen, demtimin ose vonesen, ky person mund t'u referohet gjithashtu dispozitave te kesaj Konvente qe perjashtojne pergjegjesine e transportuesit apo caktojne ose kufizojne kompensimin qe duhet paguar.

Neni 29

1. Transportuesi nuk ka te drejte t'u referohet dispozitave te ketij kapitulli qe perjashtojne ose kufizojne pergjegjesine e tij ose qe e kalojne barren e proves nese demi eshte shkaktuar nga veprimi i qellimshem ose nga nje mosveprim i tille qe, ne pajtim me ligjin e gjykates ose autoritetit qe shqyrton ceshtjen, konsiderohet si i barasvlershem me veprimin e qellimshem.
2. E njejta dispozite zbatohet nese veprimi i qellimshem ose mosveprimi kryhet nga agjentet ose sherbyesit e transportuesit ose nga persona te tjere sherbimet e te cileve ai i perdor per te kryer transportin, nese keta agjente, sherbyes ose persona te tjere veprojne ne kuadrin e punesimit te tyre.

KAPITULLI V

PRETENDIMET DHE PADITE

Neni 30

1. Nese marresi pranon dorezimin e mallit pa kontrolluar si duhet gjendjen e tij me transportuesin ose pa i derguar ketij rezervat e tij duke i dhene nje pershkrim te pergjithshem per humbjen ose demtimin, jo me vone se momenti i dorezimit ne rastin e humbjes ose demtimit te dukshem dhe brenda shtate diteve nga dorezimi, ku ditet e diela dhe festat publike perjashtohen, ne rastin kur humbja ose demtimi nuk eshte i dukshem, fakti i pranimit te dorezimit eshte prove prima facie qe ai ka pranuar mallin ne gjendjen e pershkruar ne faturen shoqeruese te mallit. Ne rastin kur humbja ose demtimi nuk eshte i dukshem, rezervat perkatese behen me shkrim.
2. Nese gjendja e mallit eshte kontrolluar rregullisht nga marresi dhe transportuesi, pranohen prova qe kundershtojne rezultatin e ketij kontrolli vetem ne rastin kur humbja ose demtimi nuk eshte i dukshem dhe me kusht qe marresi t'i kete derguar rregullisht rezervat me shkrim transportuesit brenda shtate diteve, ku ditet e diela dhe festat publike perjashtohen, nga data e kontrollit.
3. Nuk paguhet kompensim per vonese ne dorezim, pervec kur i eshte derg uar transportuesit nje rezerve me shkrim brenda njezet e nje diteve nga momenti qe malli eshte vene ne dispozicion te marresit.
4. Ne llogaritjen e afateve kohore te parashikuara ne kete nen, perkatesisht data e dorezimit, data e kontrollit ose data kur malli u vu ne dispozicion te marresit nuk llogaritet.
5. Transportuesi dhe marresi i japin njeri-tjetrit ndihme te arsyeshme per te bere hetime dhe kontrole te pershtatshme.

Neni 31

1. Ne proceset gjyqesore qe lindin nga transporti ne baze te kesaj Konvente, paditesi mund te ngreje padi ne çdo gjykate ose autoritet te nje vendi kontraktues qe eshte caktuar me marreveshje ndermjet paleve dhe, pervec kesaj, ne gjykatat ose autoritetet e nje vendi ne territorin e te cilit:
 - a) i padituri ka vendbanimin e zakonshem ose ka vendin kryesor te biznesit, ose degen apo agjencine nepermjet se ciles u perpilua kontrata e transportit; ose
 - b) ndodhet vendi ku u mor ne dorezim malli nga transportuesi ose vend i caktuar per t'u dorezuar.
2. Nese ne lidhje me nje pretendim te parashikuar ne paragrafin 1 te ketij neni eshte ngritur padi para nje gjykate ose autoriteti kompetent ne baze te ketij paragrafi, ose nese ne lidhje me nje pretendim te tille eshte dhene nje vendim nga nje gjykate ose autoritet, nuk ngrihet padi tjeter ndermjet te njejtave pale dhe per te njejtat shkaqe nese vendimi i gjykates ose i autoritetit para se ciles u ngrit padia e pare nuk eshte i paekzekutueshem ne vendin ne te cilin fillon gjykimi i ri.

3. Nese nje vendim i dhene nga nje gjykate ose autoritet i nje vendi kontraktues per nje padi sipas parashikimit te paragrafit 1 te ketij neni eshte bere i ekzekutueshem ne ate vend, ai behet i ekzekutueshem ne secilin nga shtetet e tjera kontraktues menjehere sapo te jene permbushur formalitetet e duhura ne vendin perkates. Keto formalitete nuk lejojne qe te rishqyrtohet themeli i çeshtjes.
4. Dispozitat e paragrafit 3 te ketij neni zbatohen per vendimet e dhena ne fund te gjykimit, vendimet ne mungese dhe pajtimet e konfirmuara me vendim gjykate, por nuk zbatohen per vendimet paraprake ose per vendimet per njohjen e demeve, qe u shtohen shpenzimeve te nje paditesi qe ka deshtuar plotesisht ose pjeserisht me padine e tij.
5. Nuk kerkohet garanci per shpenzimet ne gjykimet qe lindin per shkak te transportit ne baze te kesaj Konvente nga shtetas te vendeve kontraktuese qe kane vendbanimin ose vendin e biznesit ne nje prej ketyre vendeve.

Neni 32

1. Afati i parashkrimit per padite qe ngrihen per shkak te transportit ne baze te kesaj Konvente eshte nje vit. Megjithate, ne rastin e veprimit te qellimshem ose te mosveprimit qe ne baze te ligjit te gjykates ose autoritetit qe shqyrton çeshtjen konsiderohet si veprim i qellimshem, afati i parashkrimit eshte tre vjet. Afati i parashkrimit fillon:
 - a) ne rastin e humbjes se pjesshme, demtimit ose voneses ne dorezim, nga data e dorezimit;
 - b) ne rastin e humbjes se plote, nga dita e tridhjetete pas kalimit te afatit kohor te rene dakord ose, nese nuk ka afat kohor te rene dakord, nga dita e gjashtedhjetete duke filluar nga data ne te cilen malli eshte marre ne dorezim nga transportuesi;
 - c) ne te gjitha rastet e tjera, me kalimin e nje afati prej tre muajsh pas perpilimit te kontrates se transportit.

Dita ne te cilen fillon afati i parashkrimit nuk llogaritet brenda ne afat.

2. Nje pretendim me shkrim e pezullon afatin e parashkrimit deri ne ate date qe transportuesi e hedh poshte pretendimin me ane te nje njoftimi me shkrim dhe kthen dokumentet qe i bashkengjiten asaj. Nese pranohet nje pjese e pretendimit, afati i parashkrimit fillon perseri vetem ne lidhje me ate pjese te pretendimit qe eshte i debatueshem. Barra e proves ne lidhje me marrjen e pretendimit ose te pergjigjes dhe te kthimit te dokumenteve i bien asaj pale qe mbeshtetet mbi keto fakte. Afati i parashkrimit nuk pezullohet nga pretendime te tjera me te njejtin objekt.
3. Ne pajtim me dispozitat e paragrafit 2 te mesiperem, zgjatja e afatit te parashkrimit rregullohet nga ligji i gjykates ose autoritetit qe shqyrton çeshtjen. Ky ligj rregullon edhe lindjen e se drejtes per padi ne te ardhmen.
4. E drejta e padise qe eshte parashkruar nuk mund te ushtrohet me ane te kunderpadise ose kompensimit ne proces.

Neni 33

Kontrata e transportit mund te permbaje nje dispozite qe t'i delegoje kompetence nje gjykate arbitrazhi nese kjo dispozite qe i delegon kete kompetence gjykates se arbitrazhit parashikon qe kjo gjykate do te zbatoje kete Konvente.

KAPITULLI VI

DISPOZITA NE LIDHJE ME TRANSPORTIN E KRYER NGA DISA TRANSPORTUES

Neni 34

Nese transporti i rregulluar nga nje kontrate kryhet nga disa transportues rrugore, secili prej

tyre ka pergjegjesi per kryerjen e te gjithë operacionit, transportuesi i dyte dhe çdo transportues pasues behen pale te kontraten e transportit, ne kushtet e fatures shoqeruese te mallit dhe bazuar ne pranimin e mallit dhe te fatures shoqeruese te mallit.

Neni 35

1. Nje transportues qe pranon mallin nga nje transportues tjetër i jep ketij te fundit nje fature me date dhe firme. Ai shenon emrin dhe adresen e tij ne kopjen e dyte te fatures shoqeruese te mallit. Sipas rastit, ai shenon ne kopjen e dyte te fatures shoqeruese te mallit dhe ne faturen e tij rezervat e llojit te parashikuar ne nenin 8 paragrafi 2.

Dispozitat e nenit 9 zbatohen per marredheniet ndermjet disa transportuesve.

Neni 36

Perveç rastit te kunderpadise ose kompensimit ne nje proces per nje padi ne lidhje me nje pretendim bazuar ne te njejten kontrate transporti, proceset gjyqesore ne lidhje me humbjen, demtimin ose vonesen mund te fillohen vetem kunder transportuesit te pare, transportuesit te fundit ose transportuesit qe ka kryer ate pjese te transportit gjate te cilit ka ndodhur ngjarja qe ka shkaktuar humbjen, demtimin ose vonesen; padia mund te ngrihet njekohesisht kunder disa prej transportuesve.

Neni 37

Nje transportues qe ka paguar kompensim ne pajtim me kete Konvente ka te drejten e rimbursimit te ketij kompensimi se bashku me interesat e tij dhe te gjitha shpenzimet qe ka bere ne lidhje me pretendimin, nga transportuesit e tjere qe kane marre pjese ne transport, ne pajtim me dispozitat e meposhtme:

- a) Transportuesi i pergjegjshem per humbjen ose demtimin ka i vetem detyrimin e kompensimit pavaresisht nese paguan vete apo nje transportues tjetër;
- b) Nese humbja ose demtimi eshte shkaktuar nga veprimi i dy ose me shume transportuesve, secili prej tyre paguan nje shume ne raport me pjesen e tij te detyrimit; nese eshte e pamundur te ndahet detyrimi, secili transportues ka detyrimin ne raport me ate pjese te pageses per transportin qe ai duhet te marre;
- c) Nese nuk mund te gjendet se cilit prej transportuesve u takon detyrimi per humbjen ose demtimin, shuma e kompensimit ndahet ndermjet te gjithë transportuesve sipas parashikimit ne (b) me siper.

Neni 38

Nese njeri nga transportuesit falimenton, pjesa e kompensimit qe kerkohet prej tij dhe eshte e papaguar prej tij ndahet ndermjet transportuesve te tjere ne raport me pjesen e pageses per transportin qe ata duhet te marrin.

Neni 39

1. Asnjeri nga transportuesit kunder te cileve eshte ngritur nje pretendim ne baze te neneve 37 dhe 38 nuk ka te drejte te kundershroje vlefshmerine e pageses se bere nga transportuesi qe ka ngritur pretendimin nese shuma e kompensimit eshte caktuar nga nje organ gjyqesor pasi transportuesit te pare t'i jete bere njoftim i rregullt ne lidhje me gjykimin dhe mundesine e tij per t'u paraqitur.

2. Nje transportues qe deshiron te ndjeke rrugen gjyqesore per te ekzekutuar te drejten e tij te kompensimit mund te ngreje nje pretendim para nje gjykate ose organi kompetent ne vendin ku njeri nga transportuesit perkates ka vendbanimin e zakonshem ose ka vendin kryesor te

biznesit ose degen apo agjencine nepermjet te ciles eshte perpiluar kontrata e transportit. Te gjithë transportuesit perkates mund te behen te paditur ne te njejten padi.

3. Dispozitat e nenit 31, paragrafet 3 dhe 4, zbatohen per vendimet e dhena ne gjykimet e permendura ne nenet 37 dhe 38.

4. Dispozitat e nenit 32 zbatohen per pretendimet ndermjet transportuesve. Megjithate, afati i parashkrimit fillon ose ne daten e vendimit perfundimtar gjyqesor qe cakton shumen e kompensimit qe paguhet ne baze te dispozitave te kesaj Konvente, ose, nese nuk ka vendim te tille gjyqesor, nga data faktike e pageses.

Neni 40

Transportuesit jane te lire te bien dakord ndermjet tyre per dispozita te ndryshme nga ato te neneve 37 dhe 38.

KAPITULLI VII PAVLEFSHMERIA E DISPOZITAVE NE KUNDERSHTIM ME KONVENTEN

Neni 41

1. Ne pajtim me dispozitat e nenit 40, çdo dispozite qe do te devijonte drejtperdrejt ose jo drejtperdrejt nga dispozitat e kesaj Konvente eshte e pavlefshme. Pavlefshmeria e nje dispozite te tille nuk ben qe edhe dispozitat e tjera ne kontrate te jene te pavlefshme.

2. Veçanerisht, nje privilegj nga siguracioni ne favor te transportuesit ose çdo dispozite e ngjashme apo ndonje dispozite qe zhvendos barren e proves eshte e pavlefshme.

KAPITULLI VIII

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 42

1. Kjo Konvente eshte e hapur per nenshkrim ose aderim nga vendet anetare te Komisionit Ekonomik te Europes dhe vendet e pranuar ne Komision ne cilesine konsultative ne baze te paragrafit 8 te termave te references se Komisionit.

2. Keto vende qe mund te marrin pjese ne aktivite te caktuara ne Komisionin Ekonomik te Europes, ne pajtim me paragrafin 11 te termave te references se Komisionit, mund te behen pale kontraktuese ne kete Konvente duke aderuar ne te pas hyrjes se saj ne fuqi.

3. Konventa eshte e hapur per nenshkrim deri me duke perfshire dhe 31 gushtin 1956. Pas kesaj, ajo eshte e hapur per aderim.

4. Kjo Konvente ratifikohet.

5. Ratifikimi ose aderimi realizohet nepermjet depozitimit te nje instrumenti te Sekretari i Pergjithshem i Kombeve te Bashkuara.

Neni 43

1. Kjo Konvente hyn ne fuqi ne ditën e nentëdhjetë e pasë pesë nga vendet e permendura ne nenin 42 paragrafi 1, te kene depozituar instrumentet e ratifikimit ose aderimit.

2. Per çdo vend qe ratifikon ose aderon ne te pasi pesë vende te kene depozituar instrumentet e tyre te ratifikimit ose aderimit, kjo Konvente hyn ne fuqi ne ditën e nentëdhjetë e pasë vëndi perkates te kete depozituar instrumentin e tij te ratifikimit ose aderimit.

Neni 44

1. Çdo pale kontraktuese mund ta denoncoje kete Konvente duke njoftuar Sekretarin e Pergjithshem te Kombeve te Bashkuara.

Denoncimi hyn ne fuqi dymbedhjete muaj pas dates se marrjes nga Sekretari i Pergjithshem i njoftimit te denoncimit.

Neni 45

Nese pas hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente numri i paleve kontraktuese pakesohet, si rezultat i denoncimeve, ne me pak se pese, Konventa pushon se qeni ne fuqi nga data ne te cilen ka hyre ne fuqi denoncimi i fundit i ketyre denoncimeve.

Neni 46

1. Çdo vend, ne momentin e depozitimit te instrumentit te ratifikimit ose aderimit ose ne çdo moment pas kesaj, mund te deklaroje me ane te njoftimit drejtuar Sekretarit te Pergjithshem te Kombeve te Bashkuara qe kjo Konvente shtrihet ne te gjithë ose ne ndonje pjese territori per marredheniet nderkombetare te te cilit ai eshte i pergjegjshem. Konventa shtrihet ne territorin ose pjeset e territorit te caktuara ne njoftim nga data e nentdhjete pas marrjes nga Sekretari i Pergjithshem ose, nese ne ate dite Konventa nuk ka hyre ne fuqi, ne momentin e hyrjes se saj ne fuqi.

2. Çdo vend qe ka bere nje deklarate, ne baze te paragrafit te mesiperm, qe e shtrin kete Konvente ne nje pjese territori te caktuar per marredheniet nderkombetare te te cilit eshte i pergjegjshem, mund ta denoncoje kete Konvente, ne menyre te veçante, ne lidhje me kete pjese territori ne pajtim me dispozitat e nenit 44.

Neni 47

Çdo mosmarreveshje ndermjet dy ose me shume paleve kontraktuese ne lidhje me interpretimin ose zbatimin e kesaj Konvente, te cilen palet nuk jane ne gjendje ta zgjidhin me bisedime ose mjete te tjera, me kerkese te njerës prej paleve kontraktuese perkatese mund t'i referohet per zgjidhje Gjykates Nderkombetare te Drejtesise.

Neni 48

1. Secila pale kontraktuese, ne momentin e nenshkrimit, ratifikimit ose aderimit ne kete Konvente, mund te deklaroje se ajo nuk e konsideron veten te detyruar nga neni 47 i Konventes. Palet e tjera kontraktuese nuk jane te detyruara nga neni 47 ne lidhje me çdo pale kontraktuese qe ka bere nje rezerve te tille.

2. Çdo pale kontraktuese, qe ka bere nje rezerve sipas parashikimit te parashikuar ne paragrafin 1 mund, ta terheqe ne çdo kohe nje rezervim te tille duke njoftuar Sekretarin e Pergjithshem te Kombeve te Bashkuara.

3. Nuk lejohet asnje rezerve tjeter per kete Konvente.

Neni 49

1. Pasi kjo Konvente te kete qene ne fuqi per tre vjet, çdo pale kontraktuese, nepermjet nje njoftimi drejtuar Sekretarit te Pergjithshem te Kombeve te Bashkuara, mund te kerkoje te

thirret nje konference per qellimin e rishikimit te Konventes. Sekretari i Pergjithshem njofton te gjitha palet kontraktuese ne lidhje me kerkesen dhe nje konference rishikuese thirret nga Sekretari i Pergjithshem nese, brenda nje afati prej kater muajsh pas dates se njoftimit nga Sekretari i Pergjithshem, jo me pak se nje e katerta e paleve kontraktuese e njoftojne ate per aprovimin e tyre per kerkesen.

2. Nese thirret nje konference ne pajtim me paragrafet e mesiperm, Sekretari i Pergjithshem njofton te gjitha palet kontraktuese dhe i fton ato te paraqesin brenda nje afati prej tre muajsh ato propozime qe ato duan te shqyrtohen nga Konferenca. Sekretari i Pergjithshem e qarkullon agjenden provizore te konferences se bashku me tekstet me keto propozime te te gjitha shtetet kontraktuese te pakten tre muaj para dates ne te cilen eshte caktuar te mbahet Konferenca.

3. Sekretari i Pergjithshem fton ne çdo konference qe thirret ne pajtim me kete nen te gjitha vendet e permendura ne nenin 42 paragrafi 1 dhe vendet qe jane bere pale kontraktuese ne baze te nenit 42 paragrafi 2.

Neni 50

Perveç njoftimeve te parashikuara ne nenin 49, Sekretari i Pergjithshem i Kombeve te Bashkuara njofton vendet e permendura ne nenin 42 paragrafi 1 dhe vendet qe jane bere pale kontraktuese ne baze te nenit 42 paragrafi 2 ne lidhje me:

- a) Ratifikimet dhe aderimet ne baze te nenit 42;
- b) Datat e hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente ne pajtim me nenin 43;
- c) Denoncimet ne baze te nenit 44;
- d) Pushimin e efektit te kesaj Konvente ne baze te nenit 45;
- e) Njoftimet e marra ne pajtim me nenin 46;
- f) Deklarimet dhe njoftimet e marra ne pajtim me nenin 48, paragrafet 1 dhe 2.

Neni 51

Pas 31 gushtit 1956, origjinali i kesaj Konvente depozitohet te Sekretari i Pergjithshem i Kombeve te Bashkuara, i cili u transmeton kopje te vertetuara autentike secilit prej vendeve qe permenden ne nenin 42, paragrafet 1 dhe 2.

Si deshmi e kesaj, te poshteshenuarit, duke qene per kete rregullisht te autorizuar, kane nenshkruar kete Konvente.

Bere ne Gjeneve, me nentembedhjete maj, nje mije e nenteqind e pesedhete e gjashte, ne nje kopje te vetme ne gjuhet angleze dhe franceze, secili nga tekstet eshte njolloj autentik.

PROTOKOLLI I NENSHKRIMIT

Duke kaluar ne nenshkrimin e Konventes mbi Kontraten per Transportin Nderkombetar Rrugor te Mallrave, te nenshkruarit, duke qene rregullisht te autorizuar, kane rene dakord per deklarimin dhe shpjegimin e meposhtem:

1. Kjo Konvente nuk zbatohet ne trafikun ndermjet Mbreterise se Bashkuar te Britanise se Madhe dhe Irlandes se Veriut dhe Republikes se Irlandes.

2. Ad Nen 1, paragrafi 4.

Te poshteshenuarit marrin persiper te bisedojne ne lidhje me konventat qe te rregullojne kontratat per transportin e mobilieve dhe transportin e perzier.

Si deshmi e kesaj, te poshteshenuarit, duke qene per kete rregullisht te autorizuar, kane nenshkruar kete protokoll.

Bere ne Gjeneve, me nentembedhete maj, nje mije e nenteqind e pesedhete e gjashte, ne nje kopje te vetme ne gjuhet angleze dhe franceze, secili nga tekstet eshte njelloj autentik.



LIGJ

Nr. 9926, date 09.06.2008

**PER ADERIMIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE KONVENTEN "PER
TAKSIMIN E AUTOMJETEVE RRUGORE PER PERDORIM PRIVAT NE
TRAFIKUN NDERKOMBETAR" DHE NE PROTOKOLLIN E NENSHKRIMIT**

Ne mbeshtetje te neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqiperise aderon ne konventen "Per taksimin e automjeteve rrugore per perdorim privat ne trafikun nderkombetar" dhe ne protokollin e nenshkrimit, nenshkruar ne Gjeneve me 18 maj 1956.

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5782, date 30.6.2008 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Bamir Topi

E/ECE/262

E/ECE/TRANS/488

KONVENTA

**MBI TAKSIMIN E AUTOMJETEVE RRUGORE PER PERDORIM PRIVAT NE
TRAFIKUN NDERKOMBETAR DHE PROTOKOLLI I NENSHKRIMIT**

Bere ne Gjeneve me 18 maj 1956

Palet Kontraktuese,

duke marre ne konsiderate se disa Shtete Evropiane kane arritur marreveshje dypaleshe, ose kane ndermarre hapa te tjere per caktimin e nje procedure me liberale sesa ajo e Konventes se 30 marsit 1931 mbi taksimin e mjeteve motorike te huaja;

me deshiren per te lehtesuar zhvillimin e turizmit nderkombetar,

kane rene dakord per sa me poshte:

Neni 1

Per qellime te kesaj Konvente:

- a) Termi "automjete" nenkupton te gjithë biçikletat, automjetet vetelevizese dhe te gjithë rimorkiot te lidhur me keto automjete, qofte te importuar se bashku me automjetin, qofte veçmas, me perjashtim, gjithsesi, te automjeteve ose kombinimeve te lidhura me to per transportin e udhetareve, te cilet kane me shume se tete vende, perveç vendit te shoferit.
- b) Termi "perdorim privat" do te perjashtoje transportin e udhetareve kundrejt pageses, shperblimit ose formave te tjera dhe transportin per nevoja industriale ose tregtare te mallrave me ose pa pagese.

Neni 2

Automjetet e regjistruara ne territorin e njerit prej Shteteve Kontraktues, automjetet e lejuara per te qarkulluar ne kete vend, si edhe ato te perjashtuara nga detyrimi per tu regjistruar ne kete territor, kur qendrojne perkohesisht per perdorim privat ne territorin e nje Shteti tjetër Kontraktues, do te perjashtohen nga taksat dhe pagesat tarifore te vena per qarkullimin ose mbajtjen e automjeteve ne territorin e atij Shteti Kontraktues, sipas kushteve te percaktuara me poshte. Ky perjashtim nuk duhet te zbatohet per pagesat, taksat dhe detyrimet per perdorim.

Neni 3

1. Per automjetet e permendura ne nenin 2, ky perjashtim do te behet ne territorin e nje Shteti Kontraktues, persa kohe te permbushen kushtet e percaktuara ne Rregulloren Doganore ne fuqi te atij territori per pranim te perkohshem pa pagese, pa detyrime te importit dhe taksa te importit.
2. Megjithate, nje Shtet Kontraktues mund te kufizojë kohezgjatjen e ketij perjashtimi ne treqind e gjashtedhete e pese dite, edhe ne qofte se automjeti pranohet perkohesisht pa pagesen e detyrimeve te importit dhe taksave te importit per nje periudhe me te gjate.

Neni 4

Kur nje Shtet Kontraktues i Konventes se 30 marsit 1931 "Mbi taksimimin e automjeteve te huaja", behet Pale Kontraktuese e kesaj Konvente, ai duhet te marre menjehere masat e percaktuara ne nenin 17 te Konventes se vitit 1931, per ta denoncuar kete Konvente.

Dispozita perfundimtare

Neni 5

1. Vendet qe jane anetare te Komisionit Ekonomik per Evropën dhe vendet e pranuar ne Komision si pale konsultative, sipas paragrafit 8 te termave te references te Komisionit, mund te behen Pale Kontraktuese te kesaj Konvente:
 - a) duke e nenshkuar ate;
 - b) duke e ratifikuar pas nenshkrimit me qellim ratifikimi;
 - c) duke e pranuar.

2. Vendet qe marrin pjese ne veprimtari te caktuara te Komisionit Ekonomik per Evropën, sipas paragrafit 11 te termave te references se Komisionit, mund te behen Pale Kontraktuese e kesaj Konvente, duke e pranuar ate pas hyrjes se saj ne fuqi.

3. Konventa do te jete e hapur per nenshkrim deri me 31 gusht 1956. Ne periudhen ne vazhdim, ajo do te jete e hapur per pranim.

4. Ratifikimi ose pranimi, do te behet efektiv pas depozitimit te nje instrumenti prane Sekretarit te Pergjithshem te Kombeve te Bashkuara.

Neni 6

1. Kjo Konvente do te hyje ne fuqi nentehjete dite nga data kur te pese shtetet e percaktuara ne nenin 5, paragrafi 1, e kane nenshkruar ratifikimin pa rezerva ose kane depozituar instrumentet e tyre te ratifikimit ose aderimit.

2. Per çdo shtet tjeter qe e ratifikon apo e pranon, pasi pese shtetet e kane nenshkruar ate pa rezerva, ose kane depozituar instrumentet e tyre te ratifikimit ose aderimit, kjo Konvente do te hyje ne fuqi nentehjete dite nga data kur vendi i permendur depoziton instrumentin e tij te ratifikimit ose aderimit.

Neni 7

1. Çdo Pale Kontraktuese mund ta denoncoje kete Konvente duke njoftuar Sekretarin e Pergjithshem te Kombeve te Bashkuara.

2. Denoncimi do te hyje ne fuqi pesembedhjete muaj nga data kur Sekretari i Pergjithshem merr njoftimin per denoncimin.

Neni 8

Kjo Konvente nuk do te jete me ne fuqi ne rast se per nje periudhe 12 mujore pasi ka hyre ne fuqi, numri i Paleve Kontraktuese eshte me pak se pese.

Neni 9

1. Ne kohen e nenshkrimit te kesaj Konvente pa rezerva per ratifikimin ose depozitim e nje instrumenti ratifikimi ose aderimi, apo ne çdo kohe pas kesaj, çdo shtet mund te deklaroje me ane te nje njoftimi drejtuar Sekretarit te Pergjithshem te Kombeve te Bashkuara, nese kjo Konvente do te mbuloje te gjitha, ose ndonje nga fushat e marredhenieve nderkombetare, per te cilat eshte pergjegjese. Konventa do te mbuloje hapesiren ose hapesirat e permendura ne njoftim, qe nga dita e nentehjete pasi Sekretari i Pergjithshem ka marre dijene, ose, ne rast se ate dite Konventa nuk ka hyre ende ne fuqi, ne kohen kur ajo hyn ne fuqi.

2. Çdo shtet, qe ka bere deklaratën sipas paragrafit te mesiper, per ta shtrire kete Konvente ne ate hapesire te marredhenieve nderkombetare per cilen ajo eshte pergjegjese, mund ta denoncoje Konventen per sa i perket kesaj hapesire, ne perputhje me dispozitat e nenit 7.

Neni 10

1. Çdo mosmarreveshje midis dy ose me shume Paleve Kontraktuese ne lidhje me interpretimin ose zbatimin e kesaj Konvente duhet te zgjidhet brenda mundesive me negociata ndermjet tyre.

2. Çdo mosmarreveshje, e cila nuk zgjidhet me ane te negociatave, duhet te dorezohet per arbitrazh, ne rast se nje nga Palet Kontraktuese ne konflikt e kerkon kete, dhe do t'i referohet me radhe nje ose me shume gjyqtareve te arbitrazhit te zgjedhur ne marreveshje nga Palet ne konflikt. Ne rast se brenda tre muajve nga data e kerkeses per arbitrazh, Palet ne konflikt nuk bien dakord mbi zgjedhjen e nje gjyqtari arbitrazhi ose gjyqtareve te arbitrazhit, nje nga Palet mund t'i kerkoje Sekretarit te Pergjithshem te Kombeve te Bashkuara te emeruje nje gjyqtar te vetem arbitrazhi, te cilit duhet t'i jepet çeshtja per vendim.

3. Vendimi i gjyqtarit ose gjyqtareve te arbitrazhit, te emeruar sipas paragrafit te mesiperm, do te jete detyrues per palet ne konflikt.

Neni 11

1. Çdo Pale Kontraktuese, ne kohen e nenshkrimtit, ratifikimit, ose pranimit ne kete Konvente, ose ne çdo kohe te mevonshme, mund te deklaroje qe nuk do ta zbatoje Konventen per automjetet pa motore.

2. Çdo Pale Kontraktuese, ne kohen e nenshkrimtit, ratifikimit, apo pranimit ne kete Konvente, mund te deklaroje qe nuk e konsideron veten te detyruar nga neni 10 i Konventes. Palet e tjera Kontraktuese nuk do te jene te detyruara nga neni 10, ne lidhje me Palen Kontraktuese qe ka regjistruar nje rezerve ndaj ratifikimit.

3. Çdo Pale Kontraktuese qe ka regjistruar nje rezerve, si ajo e permendur ne paragrafin 1 ose paragrafin 2, mund ta terheqe rezerven duke lajmeruar Sekretarin e Pergjithshem te Kombeve te Bashkuara.

4. Nuk lejohet asnje rezerve tjeter per kete Konvente.

Neni 12

1. Tre vjet nga hyrja ne fuqi e kesaj Konvente, çdo Pale Kontraktuese mund te kerkoje mbledhjen e nje Konference me qellim rishikimin e Konventes, duke lajmeruar Sekretarin e Pergjithshem te Kombeve te Bashkuara. Sekretari i Pergjithshem do te njoftoje te gjitha Palet Kontraktuese per kerkesen dhe nje Konference rishikimi do te mblidhet nga Sekretari i Pergjithshem ne rast se, brenda nje periudhe kater mujore nga data e njoftimit nga Sekretari i Pergjithshem, jo me pak se nje e treta e Paleve Kontraktuese e njoftojne ate per pajtimin e tyre me kerkesen.

2. Ne rast se konferenca mblidhet ne perputhje me paragrafin e mesiperm, Sekretari i Pergjithshem duhet te njoftoje te gjitha Palet Kontraktuese dhe t'i ftoje ato te paraqesin brenda nje periudhe tre mujore, propozimet qe ato deshirojne qe Konferenca t'i marre ne konsiderate. Sekretari i Pergjithshem duhet te qarkulloje te gjitha Palet Kontraktuese rendin provizor te dites per Konferencen, se bashku me tekstet e propozimeve, te pakten tre muaj para dates ne te cilen do te zhvillohet Konferenca.

3. Ne çdo Konference te mbledhur ne perputhje me kete nen, Sekretari i Pergjithshem duhet te ftoje te gjitha shtetet e percaktuara ne nenin 5, paragrafi 1, dhe vendet qe jane bere Pale Kontraktuese sipas nenit 5, paragrafi 2.

Neni 13

1. Çdo Pale Kontraktuese mund te propozoje nje ose me shume amendamente per kete Konvente. Teksti i çdo amendamenti te propozuar duhet te transmetohet te Sekretari i Pergjithshem i Kombeve te Bashkuara, i cili e transmeton kete te gjitha Palet Kontraktuese dhe informon te gjitha shtetet e tjera te percaktuara ne nenin 5, paragrafi 1.

2. Çdo amendament i propozuar, i qarkulluar sipas paragrafit të mesiperm do të vlerësohet i pranuar, në rast se asnjë nga Palet Kontraktuese nuk shpreh ndonjë kundërshtim brenda një periudhe gjashtë mujore që nga data e qarkullimit të amendamentit të propozuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Sekretari i Përgjithshëm duhet të njoftojë të gjitha Palet Kontraktuese sa më parë që të jetë e mundur, në rast se është shprehur ndonjë kundërshtim për amendamentin e propozuar. Në rastin kur është shprehur një kundërshtim për amendamentin e propozuar, amendamenti do të vlerësohet i papranuar dhe nuk do të ketë asnjë efekt. Në rast se nuk është shprehur asnjë kundërshtim i tillë, amendamenti do të hyjë në fuqi për të gjitha Palet Kontraktuese tre muaj pas përfundimit të periudhës gjashtë mujore të përcaktuar në paragrafin e mesiperm.

Neni 14

Perveç njoftimeve të parashikuara nga nenet 12 dhe 13, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet të njoftojë shtetet e përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1 dhe shtetet që janë bërë Palet Kontraktuese sipas nenit 5, paragrafi 2, për:

- a) nënshkrimet, ratifikimet, ose aderimet sipas nenit 5;
- b) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 6;
- c) denoncimet sipas nenit 7;
- d) renien nga fuqia të kësaj Konvente, në përputhje me nenin 8;
- e) njoftimet e marra, në përputhje me nenin 9;
- f) deklaratat dhe njoftimet e marra, në përputhje me nenin 11, paragrafi 1 dhe 2;
- g) hyrjen në fuqi të çdo amendamenti, në përputhje me nenin 13.

Neni 15

Protokolli i nënshkrimit të kësaj Konvente do të ketë të njëjtin fuqi, efekt dhe kohezgjatje, si vetë Konventa, të e cila është pjesë përbërëse.

Neni 16

Pas datës 31 gusht 1956, origjinali i kësaj Konvente do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do të transmetojë kopje origjinale të certifikuara të çdo vendi të përmendur në nenin 5, paragrafi 1 dhe 2.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit, duke qenë plotësisht të autorizuar, kam nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Gjenevë, më tetëmbëdhjetë maj, njëmijë e nëntë qind e pesëdhjetë e gjashtë, në një kopje të vetme në anglisht dhe frëngjisht, secili tekst njëlloj autentik.

PROTOKOLLI I NËNSHKRIMIT

Gjate procedurave të sotme të nënshkrimit të Konventës mbi Taksimin e Automjeteve Rrugore për Përdorim Privat në Trafikun Nderkombëtar, të nënshkruarit, duke qenë plotësisht të autorizuar, kanë rënë dakord për kushtet dhe kanë mbajtur shenimet përkatëse për rezervat e mëposhtme:

1. Për qëllime të kësaj Konvente, përdorimi i një automjeti të marre me qira do të konsiderohet si përdorim privat i automjetit, në qoftë se automjeti merret me qira pa shofer, si dhe në rast se personi që e merr automjetin me qira merr shofer.

Transporti i bagazheve personale qe i perkasin udhetareve, ose ne rastin e perfaqesuesve tregtare, transporti i mostrave, nuk duhet te ndaloje perdorimin e automjetit nga qellimi per perdorim privat.

Ne deshmi sa me siper, te nenshkruarit, duke qene plotesisht te autorizuar, kane nenshkruar kete protokoll.

Bere ne Gjeneve, me tetembedhjete maj njemije e nente qind e pesedhjete e gjashte, ne nje kopje te vetme ne anglisht dhe frengjisht; secili tekst njelloj autentik.



LIGJ

Nr. 10 077, date 16.02.2009

**PER ADERIMIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE KONVENTEN PER
LEJIMIN E PERKOHSEM, BERE NE STAMBOLL ME 26 QERSHOR 1990**

Ne mbeshtetje te neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqiperise aderon ne konventen per lejimin e perkohshem, bere ne Stamboll me 26 qershor 1990.

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6079, date 4.3.2009 te Presidentit te Republikes se Shqiperise,
Bamir Topi

KONVENTA MBI LEJIMIN E PERKOHSEM

(Stamboll, 26 qershor 1990)
PARATHENIE

Palet kontraktuese te kesaj Konvente, te krijuara nen kujdesin e Keshillit per Bashkepunimin Doganor,

duke verejtur se situata aktuale ne lidhje me perhapjen dhe natyren e shperndare te konventave nderkombetare doganore mbi lejimin e perkohshem eshte e pakenaqshme;

duke marre ne konsiderate se situata mund te perkeqesohet ne te ardhmen kur kategori te reja te lejimit te perkohshem duhet te rregullohen nderkombetarisht;

duke marre parasysh kerkesat e perfaqesuesve te tregut dhe paleve te tjera te interesuara, me qellim lehtesimin e kryerjes se formaliteteve te lejimit te perkohshem;

duke konsideruar se thjeshtezimi dhe harmonizimi i procedurave doganore dhe, ne veçanti, miratimi i nje instrumenti te vetem nderkombetar qe te nderthure te gjitha konventat ekzistuese mbi lejimin e perkohshem mund te lehtesoje aksesin per dispozitat nderkombetare qe rregullojne lejimin e perkohshem dhe kontribuojne me efektshmeri per zhvillimin e tregut nderkombetar dhe shkembimeve te tjera nderkombetare;

te bindur se nje instrument nderkombetar, i cili propozon dispozita uniforme ne lidhje me lejimin e perkohshem, mund te sjelle perfitime thelbesore per shkembimet nderkombetare

dhe mund të sigurojë një nivel të lartë të thjeshtëzimit dhe harmonizimit të procedurave doganore, i cili është një ndër qëllimet kryesore të Keshillit për Bashkëpunimin Doganor; *te vendosura* për të lehtësuar lejimin e perkohshëm me anë të thjeshtëzimit dhe harmonizimit të procedurave, lidhur me objektivat ekonomike, humanitare, kulturore, sociale ose turistike; *duke marrë parasysh* se miratimi i dokumenteve të pranimit të perkohshëm me një model të standardizuar si dokumente nderkombetare doganore me siguri nderkombetare kontribuon për lehtësimin e procedurës së lejimit të perkohshëm kur kërkohet një dokument dhe garanci doganore, kanë rënë dakord si më poshtë:

KREU I

DISPOZITA TË PERGJITHSHME

Perkufizimet

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente, termi:

a) "lejimi i perkohshëm" do të thotë:

- procedura doganore, sipas së cilës mallra të caktuara (duke përfshirë mjetet e transportit) mund të hyjnë në një territor doganor, duke u përjashtuar me kusht nga tatimet dhe taksat e importit, dhe pa zbatuar ndalimet ose kufizimet e importit të natyrës ekonomike; keto mallra (duke përfshirë mjetet e transportit) mund të importohen për një qëllim specifik dhe duhet të jenë për qëllim rieksporimit brenda një periudhe të specifikuar dhe pa pësuar ndonjë ndryshim, përveç amortizimit normal për shkak të përdorimit të tyre;

b) "detyrimet dhe taksat e importit" nënkuptojnë:

- detyrimet doganore dhe të gjitha detyrimet, taksat, pagesat dhe detyrime të tjera që mbliidhen që vilen për importimin e mallrave ose në lidhje me to (duke përfshirë mjetet e transportit), por ku nuk përfshihen pagesa dhe detyrimet që kufizohen me shumën e kostos së përafërt të shërbimeve të kryera;

c) "garancia" do të thotë:

- sigurimi i plotësimit të një detyrimi doganor që kënaq kërkesat e doganës. Garancia përshkruhet si "e përgjithshme" kur siguron përmbushjen e detyrimeve që lindin nga disa operacione;

d) "dokumentet e lejimit të perkohshëm" do të thotë:

- dokumentin nderkombëtar doganor të pranuar si deklaratë doganore, e cila bën të mundur identifikimin e mallrave (duke përfshirë edhe mjetet e transportit) dhe që përfshin një garanci të vlefshme nderkombëtarisht për të mbuluar detyrimet dhe taksat e importit;

e) "bashkimi doganor ose ekonomik" do të thotë:

- një bashkim i themeluar dhe i përbërë nga anëtarët, siç përmenden në nenin 24, paragrafi 1 i kësaj Konvente, i cili ka kompetencën për të miratuar legjislacionin e tij që është i detyrueshëm për anëtarët e tij, në lidhje me çështjet e trajtuara nga kjo Konvente, dhe ka kompetencën të vendosë, në përputhje me procedurat e saj të brendshme, të nënshkruajë, të ratifikojë ose të pranojë anëtarë në këto Konvente;

f) "person" do të thotë: person fizik dhe juridik, përjashtuar rasti kur konteksti e kërkon ndryshe;

g) "Keshill" do të thotë:

- organizata e themeluar nga Konventa duke krijuar një Keshill për Bashkëpunimin Doganor, në Bruksel, më 15 dhjetor 1950;

h) "ratifikim" do të thotë: ratifikimi, pranimi ose miratimi.

KREU II

Neni 2

Qellimi i Konventes

1. Secila prej paleve kontraktuese merr persiper te jape lejim te perkohshem, ne perputhje me dispozitat e kesaj Konvente, per mallrat (duke perfshire mjetet e transportit) e specifikuar ne shtojcat e kesaj Konvente.
2. Pa paragjykuar dispozitat e shtojces E, lejimi i perkohshem duhet te jepet me perjashtimin total te kushtezuar nga detyrimet dhe taksat doganore dhe pa zbatuar kufizimet ose ndalimet e nje natyre ekonomike.

Neni 3

Struktura e shtojcave

Secila prej shtojcave te kesaj Konvente, ne parim, konsiston ne:

- a) perkufizimin e termave kryesore doganore te perdorur ne shtojce;
- b) dispozita te veçanta te zbatueshme per mallrat (duke perfshire mjetet e transportit), te cilat perbejne objektin e shtojcave.

KREU III

DISPOZITA TE VEÇANTA

Neni 4

Dokumenti dhe garancia

1. Pervec rastit kur parashikohet ndryshe ne njeren nga shtojcat, secila pale kontraktuese ka te drejte te kryeje lejimin e perkohshem te mallrave (duke perfshire mjetet e transportit) duke paraqitur nje dokument doganor dhe duke mundesuar garancine.
2. Kur kerkohet garancia (sipas paragrafit 1 me siper), personat te cilet perdorin rregullisht proceduren e lejimit te perkohshem, mund te autorizohen qe te mundesojne nje garanci te pergjithshme.
3. Pervec rastit kur parashikohet ndryshe ne njeren nga shtojcat, shuma e garancise nuk duhet te tejkaloje shumen e detyrimeve dhe taksave te importit prej te cilave mallrat (duke perfshire mjetet e transportit) perjashtohen me kusht.
4. Per mallrat (duke perfshire mjetet e transportit) te cilat jane objekt i ndalimeve ose kufizimeve te importit sipas legjislacionit kombetar, mund te kerkohet nje garanci shtese sipas dispozitave te percaktuara ne legjislacionin kombetar.

Neni 5

Dokumentet e lejimit te perkohshem

Pa paragjykuar veprimet e lejimit te perkohshem sipas dispozitave te shtojces E, secila pale kontraktuese duhet te pranoje, ne vend te dokumenteve te saj kombetare doganore dhe si te nevojshme per sigurimin e shumave te referuara ne nenin 8 te shtojces A, dokumentet e lejimit te perkohshem, te vlefshme per territorin e saj dhe te leshuara dhe te perdorura ne perputhje me kushtet e percaktuara ne ate shtojce per mallrat (duke perfshire mjetet e

transportit) te importuara perkohesisht sipas shtojcave te tjera te kesaj Konvente, qe ajo i ka pranuar.

Neni 6

Identifikimi

Secila pale kontraktuese mund te kryeje lejimin e perkohshem te mallrave (duke perfshire mjetet e transportit) me kusht qe te jene te identifikueshme kur perfundon lejimi i perkohshem.

Neni 7

Periudha e rieksporimit

1. Mallrat (duke perfshire mjetet e transportit) te cilave u jepet lejimi i perkohshem, do te rieksporohen brenda nje periudhe te dhene, e konsideruar te mjaftueshme per te arritur qellimin e lejimit te perkohshem. Kjo periudhe eshte e percaktuar vecmas ne secilen shtojce.
2. Organet doganore mund t'i japin nje periudhe me te gjate se ajo e parashikuar ne secilen shtojce, ose mund te zgjatin periudhen fillestare.
3. Kur mallrat qe iu eshte dhene lejimi i perkohshem (duke perfshire mjetet e transportit), nuk mund te kryejne rieksporimin e tyre si rezultat i konfiskimit qe nuk eshte konfiskimi i kryer me padine e personave privat, kerkesa per rieksporim duhet te pezullohet per sa kohe zgjat konfiskimi.

Neni 8

Transferimi i regjimit te lejimit te perkohshem

Kur kerkohet, secila pale kontraktuese mund t'ia autorizojte transferimin e perfitimit te procedures se lejimit te perkohshem cdo personi tjetër, duke mundesuar qe ky personi tjetër:

- a) te permbushet kushtet e shprehura ne kete Konvente; dhe
- b) te pranoje detyrimet e perfituesit te pare te procedures se lejimit te perkohshem.

Neni 9

Perfundimi i lejimit te perkohshem

Lejimi i perkohshem normalisht mbyllet nga rieksporimi i mallrave (duke perfshire mjetet e transportit) qe u eshte dhene lejimi perkohshem.

Neni 10

Mallrat perkohesisht te lejuara (duke perfshire mjetet e transportit) mund te rieksporohen ne nje ose me shume dergesa.

Neni 11

Mallrat perkohesisht te lejuara (duke perfshire mjetet e transportit) mund te rieksporohen nepermjet nje zyre doganore tjetër veç asaj nepermjet se ciles u importuan.

Neni 12

Raste te tjera te mundshme perfundimi

Lejimi i perkohshem mund te perfundoje me marreveshje te organeve kompetente, duke i vendosur mallrat (perfshire mjetet e transportit) ne nje port te lire ose zone te lire, ne nje magazine doganore ose nen procedurat e tranzitit doganor, me synim eksportimin e tyre pasues ose disponime te tjera te autorizuar.

Neni 13

Lejimi i perkohshem mund te perfundoje me ane te zhdoganimit per perdorim vendas, kur e justifikojne rrethanat dhe e lejon legjislacioni kombetar, duke iu nenshtruar kushteve dhe formaliteteve te cilat zbatohen ne keto raste.

Neni 14

1. Lejimi i perkohshem mund te perfundoje kur mallrat (duke perfshire mjetet e transportit) jane demtuar seriozisht nga aksidenti ose nga nje force madhore, dhe, siç mund te vendosin autoritetet doganore, ato:

a) u nenshtrohen detyrimeve dhe taksave te importit, te cilat ishin te detyruar t'i paguanin ne kohen kur u paraqiten ne dogane ne gjendjen e tyre te demtuar, me qellim perfundimin e lejimit te perkohshem;

b) te braktisur, te perjashtuara nga te gjitha shpenzimet, per autoritetet kompetente te territorit te lejimit te perkohshem, ne rastin kur personi qe perfiton nga lejimi i perkohshem duhet te jete i perjashtuar nga te gjitha pagesat e detyrimeve dhe taksave te importit; ose

c) te shkaterruara, sipas mbikeqyrjes zyrtare, me shpenzimet e paleve te interesuara, çdo pjese apo material i shpetuar, nese zhdoganohen per perdorim vendas do t'u nenshtrohen detyrimeve dhe taksave te importit, te cilat jane te detyruara t'i paguajne ne kohen kur jane paraqitur dhe me kushtet qe jane paraqitur ne dogane pas aksidentit ose forces madhore;

2. Lejimi i perkohshem mund te perfundoje edhe kur, me kerkesen e personit te interesuar, mallrat (perfshire mjetet e transportit) disponohen ne njeren prej menyrave te parashikuara ne paragrafin 1 (b) ose (c) me siper, siç mund te vendosin organet doganore.

3. Lejimi i perkohshem, gjithashtu, mund te perfundoje me kerkesen e personit te interesuar kur ky person permbush kriteret e organeve doganore lidhur me asgjesimin ose humbjen totale te mallrave (duke perfshire mjetet e transportit) nga nje aksident ose force madhore. Ne kete rast, personi qe perfiton nga lejimi i perkohshem do te perjashtohet nga pagesa e detyrimeve dhe taksave te importit.

KREU IV DISPOZITA TE NDRYSHME

Neni 15

Reduktimi i formaliteteve

Secila pale kontraktuese duhet te reduktoje deri ne minimum formalitetet doganore te kerkuara ne lidhje me lehtesirat e parashikuara ne kete Konvente. Te gjitha rregulloret lidhur me keto formalitete duhet te botohen menjehere.

Neni 16

Autorizimet paraprake

1. Kur lejimi i perkohshem i nenshtrohet autorizimit paraprak, kjo duhet te jepet nga zyra kompetente doganore sa me shpejt qe te jete e mundur.
2. Ne raste te veçanta, kur kerkohet autorizimi jodoganor, kjo duhet te jepet sa me shpejt qe te jete e mundur.

Neni 17

Lehtesira minimale

Dispozitat e kesaj Konvente percaktojne lehtesirat minimale qe duhet te akordohen. Ato nuk e ndalojne aplikimin e lehtesirave me te medha qe palet kontraktuese japin ose mund te japin ne te ardhmen me ane te dispozitave te njeanshme ose me ane te marreveshjeve dypaleshe ose shumepaleshe.

Neni 18

Bashkimet doganore ose ekonomike

1. Per qellim te kesaj Konvente, territoret e paleve kontraktuese, te cilat perbejne nje bashkim doganor ose ekonomik mund te konsiderohen nje territor i vetem.
2. Asgje ne kete Konvente nuk ndalon palet kontraktuese, te cilat perbejne nje bashkim doganor ose ekonomik, te miratojne dispozita te veçanta te zbatueshme per veprimet e lejimit te perkohshem ne territorin e ketij bashkimi, me kushtin qe keto dispozita te mos i reduktojne lehtesirat e parashikuara nga kjo Konvente.

Neni 19

Ndalimet dhe kufizimet

Dispozitat e kesaj Konvente nuk perjashtojne zbatimin e ndalimeve ose kufizimeve te vena sipas ligjeve dhe rregulloreve kombetare mbi bazen e konsideratave joekonomike, te tilla si: konsiderata te moralitetit ose rendit publik, sigurise publike dhe higjienes ose shendetit publik, konsideratave veterinare ose fitosanitare, konsideratat qe lidhen me mbrojtjen e specieve te rrezikuara te faunes dhe flores se eger dhe te gjalle, ose konsideratave qe lidhen me mbrojtjen e se drejtes se autorit ose prones industriale.

Neni 20

Shkeljet

1. Çdo shkelje e dispozitave te kesaj Konvente e ben shkelesin pergjegjes ne territorin e pales kontraktuese ku u krye shkelja sipas sanksioneve te parashikuara nga legjislacioni i pales kontraktuese.
2. Kur nuk eshte e mundur te percaktohet territori ne te cilin ka ndodhur nje parregullsi, do te merret sikur ka ndodhur ne territorin e pales kontraktuese ku eshte zbuluar.

Shkembimi i informacionit
Neni 21

Palet kontraktuese duhet t'i komunikojne njera-tjetres, me kerkese dhe deri ne masen qe lejon legjislacioni kombetar, informacionin e nevojshem per implementimin e dispozitave te kesaj Konvente.

KREU V
DISPOZITAT PER FUNDIMTARE

Neni 22

Komiteti administrativ

1. Nje komitet administrativ duhet te krijohet me qellim implementimin e kesaj Konvente, çdo mase per te siguruar njetrajtshmerine lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kesaj Konvente dhe çdo ndryshim te propozuar per te. Komiteti administrativ duhet te vendose ne lidhje me perfshirjen e shtojcave te reja ne kete Konvente.
2. Palet kontraktuese duhet te jene pjesetare te komitetit administrativ. Komiteti mund te vendos qe administrata kompetente e çdo vendi anetar, shteti ose territori doganor te permendur ne nenin 24 te kesaj Konvente, te cilet nuk jane pale kontraktuese, ose perfaqesuesit e organizatave nderkombetare, per çeshtjet qe u interesojne, mund te marrin pjese ne sesionet e komitetit si vezhgues.
3. Keshilli i siguron komitetit sherbime sekretarie.
4. Me rastin e çdo mbledhjeje, komiteti, zgjedh nje kryetar dhe nje zevendes kryetar.
5. Administratat kompetente te paleve kontraktuese e njoftojne keshillin lidhur me propozimet per ndryshimet e kesaj Konvente per to, se bashku me çdo kerkese per perfshirjen e pikave ne rendin e dites e sesioneve te komitetit. Keshilli duhet t'ua beje te ditur administratave kompetente te paleve kontraktuese dhe te vendeve anetare, shteteve ose territoreve doganore te permendura ne nenin 24 te kesaj Konvente te cilat nuk jane pale kontraktuese.
6. Keshilli e mbledh komitetin ne nje kohe te percaktuar nga ai dhe gjithashtu, sipas kerkeses se administratave kompetente, te pakten te dy prej paleve kontraktuese. Projekti i rendit te dites do te qarkulloje ne administratat kompetente te paleve kontraktuese dhe te anetareve, shteteve ose territoreve doganore te permendura ne nenin 24 te kesaj Konvente te cilat nuk jane pale kontraktuese, te pakten gjashte jave perpara mbledhjes se komitetit.
7. Sipas vendimit te komitetit, duke u mbeshtetur ne dispozitat e paragrafit 2 te ketij neni, keshilli fton administratat kompetente te anetareve, shteteve ose territoreve doganore te permendura ne nenin 24 te kesaj Konvente, te cilat nuk jane pale kontraktuese, si dhe organizatat nderkombetare te interesuara per t'u perfaqesuar nga vezhgues ne sesionet e komitetit.
8. Propozimet duhet te hidhen ne votim. Secila prej paleve kontraktuese e perfaqesuar ne mbledhje ka te drejten e nje vote. Propozimet, perveç atyre per ndryshimet e kesaj Konvente, miratohen nga komiteti me shumicen e anetareve te pranishem dhe qe votojne. Propozimet per ndryshimet e kesaj Konvente miratohen me dy te tretat e shumices se anetareve te pranishem dhe qe votojne.
9. Kur zbatohet neni 24, paragrafi 7 i kesaj Konvente, bashkimet doganore ose ekonomike, pale ne kete Konvente, ne rast votimi, do te kene vetem nje numer votash te barabarte me totalin e votave te caktuara per anetaret e tyre, qe jane palet kontraktuese te kesaj Konvente.
10. Perpara mbylljes se sesionit, komiteti duhet te miratoje nje raport.
11. Ne mungese te dispozitave perkatese ne kete nen, rregullat e procedures se keshillit zbatohen perjashtuar rastin kur komiteti vendos ndryshe.

Neni 23
Zgjidhja e mosmarreveshjeve

1. Çdo mosmarreveshje midis dy ose me shume prej paleve kontraktuese, ne lidhje me interpretimin ose zbatimin e kesaj Konvente, per aq sa eshte e mundur, duhet te zgjidhen me negociata midis tyre.
2. Çdo mosmarreveshje qe nuk eshte zgjidhet me negociata, palet kontraktuese duhet t'ia referojne komitetit administrativ, i cili e merr ne konsiderate mosmarreveshjen dhe ben rekomandimet perkatese per zgjidhjen e saj.
3. Palet kontraktuese qe kane mosmarreveshje, mund te bien dakord paraprakisht qe te pranojne rekomandimet e komitetit administrativ si detyruese.

Neni 24
Nenshkrimi, ratifikimi dhe miratimi

1. Secili vend anetar i keshillit dhe secili vend anetar i Kombeve te Bashkuara, apo agjencite e tyre te specializuara, mund te behen pale kontraktuese ne kete Konvente :
 - a) duke e nenshkuar ate pa rezerva per ratifikimin;
 - b) duke depozituar nje instrument te ratifikimit pasi eshte nenshkuar si objekt ratifikimi; ose
 - c) duke u bere anetar i saj.
2. Konventa eshte e hapur per nenshkrim nga vendet anetare te permendura ne paragrafin 1 te ketij neni, ose gjate sesioneve te keshillit ku mund te miratohet, ose me pas ne zyrat qendrore te keshillit ne Bruksel deri ne 30 qershor 1991. Pas kesaj date, ajo do te jete e hapur per te pranuar keta anetare.
3. Secili shtet ose qeveri e secilit prej territorit te veçuar doganor qe propozohet nga nje pale kontraktuese si pergjegjes per kryerjen zyrtare te marredhenieve diplomatike, por qe eshte autonom ne kryerjen e marredhenieve tregtare, duke mos qene anetar i organizatave te permendura ne paragrafin 1 te ketij neni, te cilit i eshte derguar nje ftese per kete qellim nga depozituesi me kerkese te se komitetit administrativ, mund te behet pale kontraktuese ne kete Konvente duke u futur ne te pasi ajo te hyje ne fuqi.
4. Secili prej vendeve anetare, shteteve apo territorit doganor, te permendura ne paragrafin 1 ose 3 te ketij neni, kur nenshkruan pa rezerva per ratifikimin, kur e ratifikon ose behet pjese e kesaj Konvente, duhet te specifikoje shtojcat qe pranon, duke qene e domosdoshme qe te pranoje shtojcen A dhe te pakten nje prej shtojcave te tjera. Me pas duhet te njoftoje depozituesin qe pranon nje apo me shume shtojca.
5. Palet kontraktuese qe pranojne ndonje shtojce te re te cilen komiteti administrativ ka vendosur ta perfshije ne kete Konvente, duhet te njoftoje depozituesin, ne perputhje me paragrafin 4 te ketij neni.
6. Palet kontraktuese duhet te njoftojne depozituesin per kushtet e aplikimit ose informacionin e kerkuar sipas nenit 8 dhe nenit 24, paragrafi 7 i kesaj Konvente; shtojca A, neni 2, paragrafet 2 dhe 3, shtojca E, neni 4. Gjithashtu, duhet te njoftojne çdo ndryshim ne zbatimin e ketyre dispozitave.
7. Secili bashkim doganor ose ekonomik, ne perputhjeje me paragrafet 1, 2 dhe 4 te ketij neni, mund te behet pale kontraktuese e kesaj Konvente. Ky bashkim doganor ose ekonomik duhet te njoftoje depozituesin per kompetencat e tij lidhur me çeshtjet qe rregullon kjo Konvente. Bashkimi doganor ose ekonomik i cili eshte nje pale kontraktuese e kesaj Konvente, qe brenda çeshtjeve qe ka ne kompetencen e tij, duhet te ushtroje ne emer te tij te drejtat dhe te permbushe pergjegjesite, te cilat kjo Konvente u ka akorduar anetareve te saj qe jane palet kontraktuese te kesaj Konvente. Ne kete rast, anetareve nuk duhet t'u jepet e drejta qe t'i ushtrojne individualisht keto te drejta, duke perfshire te drejten e votes.

Neni 25

Depozituesi

1. Kjo Konvente, me te gjitha nenshkrimet, me ose pa rezerva per ratifikimin dhe te gjitha instrumentet e ratifikimit ose te pranimit, duhet te depozitohet ne Sekretarine e Pergjithshme te Keshillit.

2. Depozituesi:

a) duhet te marre dhe te ruaje tekstet origjinale te kesaj Konvente;

b) duhet te pergatite kopjet e njesuara me tekstin origjinal te kesaj Konvente dhe t'i shperndaje ato tek anetaret dhe bashkimet doganore ose ekonomike te permendura ne nenin 24, paragrafet 1 dhe 7, te kesaj Konvente;

c) duhet te pranoje çdo nenshkrim, me ose pa rezerva, per ratifikimin, ratifikimin ose hyrjen ne kete Konvente dhe te marre dhe te kujdeset per çdo instrument, njoftim dhe komunikim lidhur me te;

d) duhet te vezhgoje nese nenshkrimi ose çdo instrument, njoftim ose komunikim lidhur me kete Konvente eshte ne nje forme te pershtatshme dhe te duhur dhe, nese eshte e nevojshme, te sjelle çeshtjen ne vemendje te pales kontraktuese ne fjale;

e) duhet te njoftoje palet kontraktuese te kesaj Konvente, nenshkruetit e tjere, anetaret e keshillit te cilet nuk jane pale kontraktuese te kesaj Konvente dhe Sekretarin e Pergjithshem Qendror te Kombeve te Bashkuara lidhur me:

- nenshkrimet, ratifikimet, hyrjet dhe pranimet e shtojcave sipas nenit 24 te kesaj Konvente;

- shtojcat e reja te cilat komiteti administrativ vendos t'i perfshije ne kete Konvente;

- daten e hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente dhe te seciles shtojce ne perputhje me nenin 26 te kesaj Konvente;

- njoftimet e marra ne perputhje me nenin 24, 29, 30 dhe 32 te kesaj Konvente;

- denoncimet sipas nenit 31 te kesaj Konvente;

- çdo ndryshim qe konsiderohet se eshte pranuar ne perputhje me nenin 32 te kesaj Konvente, si dhe data e hyrjes se saj ne fuqi.

3. Kur shfaqen dallime midis nje pale kontraktuese dhe depozituesit lidhur me kryerjen e funksioneve te ketij te fundit, depozituesi ose pala kontraktuese duhet ta sjelle çeshtjen ne vemendje te paleve te tjera kontraktuese dhe te nenshkruesesve, ose te keshillit, kur duhet.

Neni 26

Hyrja ne fuqi

1. Kjo Konvente hyn ne fuqi tre muaj pasi pese vendet anetare ose bashkimet doganore dhe ekonomike, te permendura ne nenin 24, paragrafet 1 dhe 7 te kesaj Konvente, e kane nenshkruar kete Konvente per ratifikimin ose kane depozituar instrumentet e tyre te ratifikimit ose aderimit.

2. Per secilen prej paleve kontraktuese qe nenshkruan pa rezerva per ratifikimin, qe e ratifikon ose aderon ne kete Konvente, pasi pese vendet anetare ose bashkimet doganore ose ekonomike e kane nenshkruar ate pa rezerva per ratifikimin ose kane depozituar instrumentet e tyre lidhur me ratifikimin ose aderimin, kjo Konvente do te hyje ne fuqi tre muaj pasi pala kontraktuese ne fjale ta kete nenshkruar ate pa rezerva per ratifikimin ose te kete depozituar instrumentin e saj te ratifikimit ose aderimit.

3. Çdo shtojce e kesaj Konvente do te hyje ne fuqi tre muaj pasi pese vende anetare ose bashkimet doganore ose ekonomike ta kene pranuar kete shtojce.

4. Per çdo pale kontraktuese qe pranon nje shtojce pasi ta kene pranuar ate pese vendet anetare ose bashkimet doganore ose ekonomike, kjo shtojce do te hyje ne fuqi tre muaj pasi pala kontraktuese ne fjale te kete njoftuar pranimin e saj. Gjithsesi, asnje shtojce, nuk do te hyje ne fuqi per palen kontraktuese para se kjo Konvente te kete hyre ne fuqi per ate pale kontraktuese.

Neni 27

Dispozita shfuqizuese

Pas hyrjes ne fuqi te nje shtojce te kesaj Konvente qe permban nje dispozite shfuqizuese, kjo shtojce do te shfuqizohet dhe do te zevendesoje konventat ose dispozitat e konventave qe i nenshtrohen dispozites shfuqizuese, ne marredheniet mes paleve kontraktuese qe e kane pranuar ate shtojce dhe qe jane palet kontraktuese te ketyre konventave.

Neni 28

Konventa dhe shtojcat

1. Per qellimet e kesaj Konvente, çdo shtojce, qe detyron nje pale kontraktuese, do te konceptohet si pjese integrale e kesaj Konvente, dhe ne lidhje me ate pale kontraktuese, çdo referim ne kete Konvente do te gjykohet se perfshin referimin e ketyre shtojcave.
2. Per arsye votimi ne komitetin administrativ, çdo shtojce do te merret si nje konvente me vete.

Neni 29

Rezervat

1. Secila pale kontraktuese qe pranon nje shtojce, do te gjykohet se i pranon te gjitha dispozitat e saj, vetem nese ne kohen e miratimit te shtojces ose ne nje moment te mevonshem njofton depozituesin per dispozitat per te cilat shpreh rezervat, kur kjo mundesi parashikohet ne shtojcen ne fjale, duke deklaruar ndryshimet qe ekzistojne midis dispozitave te legjislacionit kombetar dhe dispozitave ne fjale.
2. Secila pale kontraktuese duhet qe te pakten nje here ne pese vjet te rishikojte dispozitat per te cilat ka shprehur rezerva, duke i krahasuar me dispozitat e legjislacionit kombetar dhe te njoftoje depozituesin per rezultatet e ketij rishikimi.
3. Secila prej paleve kontraktuese qe ka shprehur rezerva mund t'i terheqe ato, teresisht ose pjeserisht ne çdo kohe, duke njoftuar depozituesin dhe saktësuar daten kur kjo terheqje do te hyje ne fuqi.

Neni 30

Zgjerimi territorial

1. Secila pale kontraktuese, ne momentin e nenshkrimit te kesaj Konvente pa rezerva per ratifikimin ose depozitimimin e instrumenteve per ratifikimin ose aderimin, ose ne nje moment tjeter te mevonshem, mund te deklaroje duke njoftuar depozituesin se kjo Konvente do te shtrihet ne te gjitha ose ndonje prej territoreve per marredheniet nderkombetare te te cilave pergjigjet. Ky njoftim do te hyje ne fuqi tre muaj pas dates se marrjes nga depozituesi. Megjithate, kjo Konvente nuk zbatohet per territoret te emeruara ne njoftim perpara se kjo Konvente te hyje ne fuqi per palet kontraktuese ne fjale.
2. Çdo pale kontraktuese qe ka bere nje njoftim sipas paragrafit 1 te ketij neni duke zgjeruar kete Konvente me ndonje territor, per marredheniet nderkombetare te te cilit pergjigjet, mund ta njoftoje depozituesin, sipas procedures se nenit 31 te kesaj Konvente, se territori ne fjale nuk do ta zbatohet me kete Konvente.

Neni 31

Denoncimi

1. Kjo Konvente ka nje kohezgjatje te pakufizuar, por secila pale kontraktuese mund te beje denoncim per te ne çdo kohe pas dates se hyrjes ne fuqi sipas nenit 26 te kesaj Konvente.
2. Denoncimi duhet te njoftohet me ane te nje instrumenti me shkrim, e depozituar tek depozituesi.
3. Denoncimi hyn ne fuqi gjashte muaj pas marrjes se instrumentit te denoncimit nga depozituesi.
4. Dispozitat e paragrafeve 2 dhe 3 te ketij neni duhet te zbatohen gjithashtu lidhur me shtojcat e kesaj Konvente, duke pasur çdo pale kontraktuese te drejten qe ne çdo kohe pas dates se hyrjes se tyre ne fuqi, sipas nenit 26 te kesaj Konvente, te terheqe pranimin e saj per nje ose me shume shtojcave. Secila prej paleve kontraktuese qe te terheqe pranimin e saj e te gjitha shtojcave do te konsiderohet se e ka kallezuar Konventen. Gjithashtu, nje pale kontraktuese qe terheq pranimin e shtojces A, edhe pse vazhdon te pranoje shtojcat e tjera, do te konsiderohet se e ka kallezuar kete Konvente.

Neni 32

Procedura e amendimit

1. Komiteti administrativ, i mbledhur ne perputhje me nenin 22 te kesaj Konvente, mund te rekomandoje amendimet e kesaj Konvente dhe te shtojcave te saj.
2. Teksti i çdo amendimi te rekomanduar duhet t'i komunikohet nga depozituesi te gjitha paleve kontraktuese te kesaj Konvente, nenshkruesve te tjere dhe atyre vendeve anetare te keshillit, te cilat nuk jane pale kontraktuese te kesaj Konvente.
3. Çdo amendim i rekomanduar i komunikuar ne perputhje me paragrafin paraprires do te hyje ne fuqi per sa i perket te gjitha paleve kontraktuese, gjashte muaj pas mbarimit te afatit prej dymbedhjete muajsh pas dates se komunikimit te amendimit te rekomanduar, nese nuk jane njoftuar kundershite lidhur me amendimet e rekomanduara gjate kesaj periudhe per depozituesin nga pala kontraktuese.
4. Nese nje kundershite lidhur me amendimin e rekomanduar i eshte njoftuar depozituesit nga pala kontraktuese perpara skadimit te periudhes prej dymbedhjete muajsh, e specifikuar ne paragrafin 3 te ketij neni, amendimi do te konsiderohet i pamiruar dhe sidoqofte nuk do te kete fuqi.
5. Per qellimin e njoftimit te nje kundershite, çdo shtojce do te konsiderohet nje Konvente me vete.

Neni 33

Pranimi i amendimeve

1. Çdo pale kontraktuese qe e ratifikon kete Konvente, ose aderon ne te do te konsiderohet se e ka pranuar çdo amendament te saj qe ka hyre ne fuqi ne daten e depozitimit te instrumentit te saj te ratifikimit ose aderimit.
2. Çdo pale kontraktuese qe pranon nje shtojce, do te konsiderohet se ka pranuar çdo amendim te asaj shtojce qe ka hyre ne fuqi ne daten ne te cilen ajo i njofton depozituesit pranimin e saj, me perjashtim te rastit kur ajo paraqet rezerva, sipas nenit 29 te kesaj Konvente .

Neni 34

Regjistrimi dhe tekstet autentike

Ne perputhje me nenin 102 te Kartes te Kombeve te Bashkuara, kjo Konvente do te regjistrohet ne Sekretariatin e Kombeve te Bashkuara me kerkesen e depozituesit.

Kjo Konvente eshte nenshkruar duke deshmuar sa me siper, te nenshkruarit, te autorizuar rregullisht per kete, e kane nenshkruar kete Konvente.

E hartuar ne Stamboll, me njezet e gjashte qershor, nje mije e nenteqind e nentedhete, ne nje origjinal, ne gjuhen angleze dhe frenge, duke qene te dyja tekstet njesoj autentike. Depozituesit i kerkohet te pergatite dhe te qarkulloje perkthimet e autorizuar te kesaj Konvente ne gjuhet arabe, kineze, ruse dhe spanjolle.

SHTOJCA A

SHTOJCE PER DOKUMENTET E LEJIMIT TE PERKOHSEM (CARNET ATA DHE CARNET CPD)

KREU I

Perkufizime Neni 1

Per qellimet e kesaj shtojce, termi:

a) "dokumente te lejimit te perkohshem" do te thote:

- dokumenti nderkombetar doganor i pranuar si deklarate doganore qe ben te mundur identifikimin e mallrave (duke perfshire mjetet e transportit) dhe qe perfshin nje garanci te vlefshme nderkombetare per te mbuluar detyrimet dhe taksat e importit;

b) "Carnet ATA" do te thote:

- dokumentet e lejimit te perkohshem, qe perdoren per lejimin e perkohshem te mallrave, duke perjashtuar mjetet e transporti;

c) "Carnet CPD" do te thote:

- dokumentet e lejimit te perkohshem, qe perdoren per lejimin e perkohshem te mjeteve te transportit;

d) "zinxhiri garantues" do te thote:

- nje skeme garancie e administruar nga nje organizate nderkombetare, ku bejne pjese shoqatat e garancive;

e) "organizate nderkombetare" do te thote:

- nje organizate ku bejne pjese shoqata nderkombetare te autorizuar per garantimin dhe leshimin e dokumenteve te lejimit te perkohshem;

f) "shoqate garantuese" do te thote:

- nje shoqata e miratuar nga organet doganore te nje pale kontraktuese per te garantuar shumat e referuara ne nenin 8 te kesaj shtojce ne territorin e kesaj pale kontraktuese dhe qe ben pjese ne nje zinxhir garantues;

g) "shoqata leshuese" do te thote:

- shoqaten e miratuar nga organet doganore per te leshuar dokumentet e lejimit te perkohshem dhe qe ben pjese direkt dhe indirekt ne zinxhirin e garancise;

h) "shoqate homologe leshuese" do te thote:

- nje shoqate leshuese e themeluar ne nje pale tjeter kontraktuese dhe qe ben pjese ne te njejtin zinxhir garancie;

i) "transit doganor" do te thote:

- procedure doganore, sipas se ciles mallrat transportohen nen kontrollin doganor nga njera dege doganore ne tjetren.

KREU II

Qellimi Neni 2

1. Ne perputhje me nenin 5 te kesaj Konvente, secila pale kontraktuese duhet te pranoje ne vend te dokumenteve kombetare doganore, dhe si garanci e rregullt e shumave te referuara ne nenin 8 te kesaj shtojce, dokumentet e lejimit te perkohshem te vlefshme per territorin e kesaj pale kontraktuese, si dhe te leshuara dhe te perdorura ne perputhje me kushtet e percaktuara ne kete shtojce per mallrat (perjashtuar mjetet e transportit), te importuara perkohesisht sipas shtojcave te tjera te kesaj Konvente qe ajo i ka pranuar.
2. Çdo pale kontraktuese mundet gjithashtu te pranoje dokumentet e lejimit te perkohshem, te leshuara dhe te perdorura sipas te njejtave kushte, per operacionet e regjimit te lejimit te perkohshem sipas ligjeve dhe rregulloreve kombetare.
3. Çdo pale kontraktuese mund te pranoje dokumentet e lejimit te perkohshem per transitin doganor, te leshuara dhe te perdorura sipas te njejtave kushte.
4. Mallrat (perfshire mjetet e transportit), me qellim perpunimin dhe riparimin, nuk importohen te mbuluara nga dokumentet e lejimit te perkohshem.

Neni 3

1. Dokumentet e lejimit te perkohshem duhet t'u korrespondojne modeleve te percaktuara ne shtesat e kesaj shtojce: shtesa I per shtojcen ATA, shtesa II per *carnet* CPD.
2. Shtesat e kesaj shtojce do te interpretohen si pjese integrale e shtojces.

KREU III

Garancia dhe leshimi i dokumenteve te lejimit te perkohshem

Neni 4

1. Kundrejt kushteve dhe garancive te percaktuara nga çdo pale kontraktuese, ajo mund te autorizoj shoqatat garantuese te veprojne si garantues dhe te leshojne dokumentet e lejimit te perkohshem, ose direkt ose nepermjet shoqatave leshuese.
2. Nje shoqate garancie nuk duhet te miratohet nga asnje pale kontraktuese po qe se garancia nuk mbulon detyrimet e shkaktuara ne ate pale kontraktuese lidhur me operacionet qe mbulojne dokumentet e lejimit te perkohshem leshuar prej shoqatave homologe leshuese.

Neni 5

1. Shoqatat leshuese nuk mund te leshojne dokumentet e lejimit te perkohshem brenda nje periudhe vlefshmerie qe kalon nje vit nga data e leshimit.
2. Te dhenat e veçanta te shenuara ne dokumentet e lejimit te perkohshem nga shoqata leshuese mund te ndryshohen vetem me miratimin e shoqates leshuese ose garantuese. Asnje ndryshim nuk duhet t'u behet ketyre dokumenteve pasi ato te jene pranuar nga organet doganore te territorit te lejimit te perkohshem, perjashtuar kur keto organe japin pelqimin.
3. Pasi eshte leshuar *carnet* ATA, asnje njesi shtese nuk duhet t'i shtohet listes se mallrave te renditura ne anen e pasme te kapakut ballor te *carnet*-it, ose ne ndonje prej fleteve vijuese te bashkangjitura aty (lista e pergjithshme).

Neni 6

Te dhenat e veçanta me poshte duhet te shenohen ne dokumentet e lejimit te perkohshem:

- emrin e shoqates qe leshon *carnet*-in;
- emrin e zinxhirit garantues nderkombetar;
- vendet ose territoret doganore ku jane te vlefshme dokumentet e lejimit te perkohshem; dhe
- emrat e shoqatave te garancive te vendeve ose territoreve doganore ne fjale.

Neni 7

Periudha e fiksuar per rieksporimin e mallrave (perfshire mjetet e transportit) te importuara me mbulimin e dokumenteve te lejimit te perkohshem ne asnje rast nuk duhet ta kaloje periudhen e vlefshmerise se atyre dokumenteve.

KREU IV

Garancia

Neni 8

1. Secila shoqate e garancive duhet te ndermarre qe t'i paguaje organeve doganore te pales kontraktuese ne territorin ku eshte themeluar sasine e detyrimeve dhe taksave te importit dhe te çdo shume tjeter, duke perjashtuar ato qe permenden ne nenin 4, paragrafi 4 te kesaj Konvente, qe paguhen ne rast moszbatimi te kushteve te lejimit te perkohshem, ose te transitit doganor, per sa u perket mallrave (perfshire mjetet e transportit) qe jane futur ne ate territor te mbuluara nga dokumentet e lejimit te perkohshem te leshuar nga nje shoqate homologe leshuese. Shoqata do te pergjigjet bashkerisht ose veç e veç me peronat, prej te cileve duhen paguar shumat e mesiperme, per pagimin e ketyre shumave.

2. *Carnet*-i ATA:

Detyrimet e shoqates se garancise nuk duhet te kalojne shumen e detyrimeve dhe taksave te importit me shume se dhjete per qind.

Carnet CPD:

Shoqates se garancise nuk i kerkohet te paguaje nje shume me te madhe se totali i shumes se detyrimeve dhe taksave te importit, se bashku me interesat nese aplikohen.

3. Kur organet doganore ne territorin e lejimit te perkohshem kane mbyllur ne menyre te pakushtezuar dokumentet e lejimit te perkohshem per disa mallra (perfshire mjetet e transportit), ata nuk mund te kerkojne nga shoqata e garancise pagesen e shumave te referuara ne paragrafin 1 te ketij neni ne lidhje me keto mallra (perfshire mjetet e transportit). Sidoqofte, pretendimi mund te ngrihet kunder nje shoqate te garancise nese zbulohet me pas se mbyllja e dokumenteve ishte kryer ne menyre te pasakte ose te pandershme, ose kur ka pasur shkelje te kushteve te lejimit te perkohshem ose te transitit doganor.

4. *Carnet* ATA:

Organet doganore nuk duhet te kerkojne ne asnje rrethane nga shoqata e garancise pagesen e shumave te referuara ne paragrafin 1 te ketij neni nese nuk eshte ngritur pretendimi kunder shoqates se garancise brenda nje viti nga data e skadimit te vlefshmerise se *carnet*-it ATA.

2. *Carnet* CPD :

Organet Doganore nuk duhet te kerkojne ne asnje rrethane nga shoqata e garancise pagesen e shumave te referuara ne paragrafin 1 te ketij neni, nese njoftimi per mosmbylljen e *carnet* CPD-se nuk eshte bere per shoqaten e garancise brenda nje viti nga data e skadimit te vlefshmerise se *carnet*. Per me teper, organet doganore do t'i mundesojne shoqates se garancise detaje te llogaritjes se detyrimeve dhe tatimeve te importit per nje vit nga njoftimi i mosmbylljes se *carnet*-it CPD. Detyrimet e shoqates se garancise per keto shuma do te nderpriten nese ky informacion nuk jepet brenda periudhes se nje viti.

KREU V

Rregullimi i dokumenteve te lejimit te perkohshem Neni 9

1. *Carnet* ATA:

a) Shoqata e garancive do te kete nje periudhe kohe prej gjashte muajsh nga data e ngritjes se pretendimit te organeve doganore per shumet e permendura ne nenin 8, paragrafi 1 i kesaj shtojce, gjate se ciles do te paraqese prova te rieksporimit sipas kushteve te percaktuara ne kete shtojce ose ne ndonje anulim tjeter te rregullt te *carnet-it* ATA.

b) Nese keto prova nuk sigurohen brenda kohes se lejuar, shoqata e garancive si rrjedhoje duhet te menjehere te depozitoje ose t'i paguaje provizorisht keto shuma. Kjo depozite ose pagese do te finalizohet pas periudhes prej tre muajsh nga data e depozitimit ose pageses. Gjate periudhes se mevonshme, shoqata e garancise mund t'i paraqese akoma provat e permendura ne nenparagrafin (a) te ketij paragrafi me synimin per te kthyer shumet e depozituara ose te paguara.

c) Per palet kontraktuese, per te cilat ligjet dhe rregulloret nuk parashikojne depozita ose pagesa te perkohshme te detyrimeve dhe taksave te importit, pagesat e kryera ne perputhje me dispozitat e nenparagrafit (b) te ketij paragrafi do te konsiderohen si perfundimtare, ndersa shumet e paguara do te kthehen nese provat e permendura ne nenparagrafin (a) te ketij paragrafi paraqiten brenda tre muajve nga data e pageses.

2. *Carnet* CPD:

a) Shoqates se garancive i lejohet nje periudhe prej nje viti nga data e njoftimit per mosanulimin e *carne-it* CPD, ne te cilen te paraqese prova te rieksporimit sipas kushteve te percaktuara ne kete shtojce ose ne ndonje anulim tjeter te *carnet-it* CPD. Megjithate, kjo periudhe mund te hyje ne fuqi vetem ne daten e skadimit te *carnet-it* CPD. Nese organet doganore kundershtojne vlefshmerine e proves se paraqitur, ato duhet te njoftojne shoqaten e garancive brenda nje periudhe qe nuk i kalon 12 muaj.

b) Nese kjo prove nuk paraqitet brenda kohes se lejuar, shoqata e garancive do te depozitoje ose do te depozitoje menjehere, ose do te paguaje perkohesisht detyrimet dhe taksat pagueshme te importit brenda nje periudhe maksimale prej tre muajsh. Kjo depozite ose pagese do te finalizohet pas nje periudhe njevjeçare nga dita e depozitimit ose pageses. Me vone, shoqata e garancive mundet serish te siguroje proven e permendur ne nenparagrafin (a) te ketij paragrafi me synim kthimin e shumave te depozituara ose te paguara.

c) Per palet kontraktuese, per te cilat ligjet dhe rregulloret nuk parashikojne depozitat dhe pagesat e perkohshme te detyrimeve dhe taksave te importit, pagesat e kryera ne perputhje me dispozitat e nenparagrafit (b) te ketij paragrafi do te konsiderohen si perfundimtare, ndersa shumet e paguara do te kthehen nese provat e permendura ne nenparagrafin (a) te ketij paragrafi paraqiten brenda nje viti nga data e pageses.

Neni 10

1. Provat per rieksporimin e mallrave (perfshire edhe mjetet e transportit) te importuara sipas mbulimit nga dokumentet e lejimit te perkohshem, do te jepen me kuponin e kontrollit te rieksporimit, te plotesuar dhe vulosur nga organet doganore ne territorin e lejimit te perkohshem.

2. Nese rieksporimi nuk eshte certifikuar ne perputhje me paragrafin 1 te ketij neni, organet doganore te territorit te lejimit te perkohshem, edhe nese periudha e vlefshmerise se dokumenteve ka perfunduar, mund te pranojne si prove per rieksporimin:

a) te dhenat e veçanta te regjistruara ne organet doganore ose ne ndonje prej paleve te tjera kontraktuese ne dokumentet e lejimit te perkohshem mbi importimin ose rieksporimin, ose me ane te nje certifikate te leshuar nga keto organe te mbeshtetur ne te dhenat e veçanta te

paraqitura ne kuponin e shkeputur nga dokumentet e importimit dhe riimportimit e cila provohet te kete ndodhur pas rieksporimit te kryer, qe ajo synon te sqaroje;

b) çdo prove tjeter dokumentare, e cila verteton se mallrat (perfshire mjetet e transportit) jane jashte ketij territori.

2. Ne çdo rast kur organet doganore te Pales Kontraktuese heqin dore nga kerkesa per rieksporim te mallrave te caktuara (perfshire mjetet e transportit) te lejuara ne territorin e tyre sipas dokumenteve te lejimit te perkohshem, shoqata e garancive do te shkarkohet nga detyrimet vetem kur keto organe te kene te vertetuar me dokumente se eshte rregulluar pozicioni lidhur me keto mallra (perfshire mjetet e transportit).

Neni 11

Ne rastet e permendura ne nenin 10, paragrafi 2 i kesaj shtojce, organet doganore kane te drejten te kerkojne nje pagese rregulluese.

KREU VI

Dispozita te ndryshme

Neni 12

Vertetimi doganor lidhur me dokumentet e lejimit te perkohshem te perdorura sipas kushteve te percaktuara ne kete shtojce nuk do te kerkoje pagese per perkujdesjen doganore ne zyrat e doganes gjate oreve normale te punes.

Neni 13

Ne rastin e shkaterrimit, humbjes ose grabitjes se dokumenteve te lejimit te perkohshem, ndersa mallrat (perfshire mjetet e transportit) qe u referohen jane ne territorin e ndonjeres pale kontraktuese, organet doganore te kesaj pale kontraktuese, me kerkese te shoqates leshuese dhe sipas kushteve te parashkruara nga keto organe, duhet te pranojne dokumentet zevendesuese, vlefshmeria e te cilave perfundon ne te njejten date me afatin e dokumenteve qe ato zevendesojne.

Neni 14

1. Ne rastin kur pritet qe operacioni i lejimit te perkohshem do ta kaloje periudhen e vlefshmerise se dokumenteve te lejimit te perkohshem per shkak te pamundesise se mbajtesit per te rieksportuar mallrat (perfshire mjetet e transportit) brenda asaj periudhe, shoqata qe leshoi dokumentet mund te leshoje dokumente zevendesuese. Keto dokumente i paraqiten organeve doganore te pales kontraktuese te interesuar per kontrollin. Kur pranojne dokumentet zevendesuese, organet doganore ne fjale do te anulojne dokumentet e zevendesuara.

2. Vlefshmeria e *carnet*-eve CPD mundet te shtyhet vetem njehere per jo me shume se nje vit. Pas kesaj periudhe, nje *carnet* i ri duhet te leshohet per te zevendesuar *carnet*-in e meparshem, si dhe duhet te pranohet nga organet doganore.

Neni 15

Kur zbatohet neni 7, paragrafi 3, i kesaj Konvente, organet doganore, kur eshte e mundur, njoftojne shoqaten e garancive lidhur me konfiskimet e kryera nga ato, ose ne emer te tyre, per mallrat (perfshire mjetet e transportit) e pranuar sipas dokumenteve te lejimit te perkohshem te garantuara nga ajo shoqate, si dhe e njofton per masat qe synojne te ndermarrin.

Neni 16

Ne rastin e mashtrimit, kundervënies ose abuzimit, pala kontraktuese, pavaresisht dispozitave të kesaj shtojce, është e lire të marrë masa kundër personave të cilët përdorin dokumentet e lejimit të perkohshëm, për vjeljen e detyrimeve dhe taksave të importit dhe shumave të tjera të pagueshme, si dhe vendosjen e çdo penaliteti për të cilat këta persona i detyrohen. Në këto raste shoqatat duhet t'i japin ndihmesën e tyre organeve doganore.

Neni 17

Dokumentet e lejimit të perkohshëm ose pjesë të tyre, të cilat janë leshuar ose kanë për qëllim të leshohen në territorin në të cilin ato janë importuar dhe të cilat i janë dërguar një shoqate leshuese nga një shoqate e garancive, nga një organizatë nderkombetare ose nga organet doganore të palës kontraktuese, përjashtohen nga detyrimet dhe taksat e importit, si dhe përjashtohen nga çdo ndalim ose kufizim importi. Lehtësirat perkatese mundësohen gjatë eksportimit.

Neni 18

1. Secila palë kontraktuese ka të drejtën e regjistrimit të rezervave, në përputhje me nenin 29 të kesaj Konvente, lidhur me miratimin e *carnet-eve* ATA për trafikun postar.
2. Nuk lejohet asnjë rezervë tjetër për këto shtojce.

Neni 19

1. Pasi të hyjë në fuqi kjo shtojce, në përputhje me nenin 27 të kesaj Konvente, do të shfuqizojë dhe do të zëvendësojë Konventën doganore lidhur me *carnet* ATA për lejimin e perkohshëm të mallrave, Bruksel, 6 dhjetor 1961, (Konventa ATA), në marrëdhëniet mes paleve kontraktuese të cilat e kanë miratuar këto shtojce dhe të cilat janë palët kontraktuese të kesaj Konvente.
2. Pavaresisht dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, *carnet-et* ATA që janë leshuar në përputhje me termat e Konventës ATA përpara hyrjes në fuqi të kesaj shtojce, do të miratohen në momentin e permbushjes së operacioneve për të cilat janë leshuar.

Shtesa II për shtojcën A - Modeli *carnet* CPD

SHTOJCA B.1

SHTOJCE

LIDHUR ME MALLRAT PËR T'U SHFAQUR OSE PËRDORUR NEPER EKSPozITA,
PANAIRe, MBLEDHJE OSE NJGJARJE TE NGJASHME

KREU I

Perkufizimi Neni 1

Për arsye të kesaj shtojce, termi “ngjarje” do të thotë:

1. ekspozite, panair ose shfaqje të ngjashme me karakter tregtar, industrial, bujqësor ose artizanal;
2. ekspozite ose takim kryesisht i organizuar me qëllime bamiresie;

3. ekspozite ose takim kryesisht i organizuar per qellime shkencore, teknike, artizanale, artistike, edukative ose kulturore, sportive, fetare dhe kulti, sindikale, turistike ose, me qellim nxitjen e marredhenieve te miqesise mes vendeve te ndryshme;
4. takim i perfaqesuesve te organizatave ose shoqatave nderkombetare;
5. ceremoni dhe manifestime me karakter zyrtar ose perkujtimor, me perjashtim te ekspozitave te organizuara per qellime private ne dyqane ose ambiente te tjera tregtare me synim shitjen e mallrave te importit.

KREU II

Qellimi Neni 2

1. Lejimi i perkohshem u jepet mallrave si me poshte ne perputhje me nenin 2 te kesaj Konvente:

a) mallrat qe importohen me qellim per t'u ekspozuar ose shfaqur ne ndonje aktivitet te veçante, duke perfshire materialet e referuara ne shtojcat e Marreveshjes mbi importin e materialeve edukative, shkencore dhe kulturore, UNESCO, Nju-Jork, 22 nentor 1950 dhe protokollit te Nairobit, 26 nentor 1976;

b) mallrat qe synohet te perdoren per ekspozimin e mallrave te huaja ne nje eveniment, duke perfshire:

i) mallrat e nevojshme per te demonstruar makinerite e importuara ose aparaturat qe realizojne paraqitjen;

ii) materiale ndertimi dhe zburimi, perfshire pajisje elektrike per stendat e perkohshme per ekspozuesit e huaj;

iii) materiale reklame dhe demonstrimi, siç eshte materiali reklamues per mallrat e huaja te ekspozuara, per shembull regjistrime zanore ose pamore, filma dhe diapozitiva, se bashku me aparaturat e nevojshme per perdorimin e tyre;

c) pajisje, duke perfshire pajisje perkthimi, aparatura regjistrimi te zerit ose figures, si dhe filma me karakter edukativ, shkencor dhe kulturor, me qellim perdorimi ne takime nderkombetare, konferenca dhe kongrese.

2. Per lehtesirat e referuara ne kete shtojce, do te aplikohet:

a) numri ose sasia e secilit artikull te jete e arsyeshme duke marre parasysh qellimin e importit;

b) organet doganore te territorit te lejimit te perkohshem duhet te kenaqen me permbushjen e kushteve te kesaj Konvente.

KREU III

Dispozita te ndryshme Neni 3

Perjashtuar rasti kur legjislacioni vendas i territorit te lejimit te perkohshem e lejon, mallrat qe u jepet lejimi i perkohshem, nderkohe qe jane objekt i lehtesirave te pranuar sipas kesaj Konvente, nuk duhet:

a) te jepen hua ose te jepen me qira, ose te kompensohen; ose

b) te zhvendosen nga vendi i ngjarjes.

Neni 4

1. Periudha e rieksporimit te mallrave te importuara per t'u shfaqur ose per t'u perdorur ne ekspozita, panair, takime ose ngjarje te njejta duhet te jete te pakten gjashte muaj nga data e lejimit te perkohshem.

2. Pavaresisht nga dispozitat e paragrafit 1 te ketij neni, organet doganore do t'i lejojne keto mallra qe do te shfaqen ose perdoren ne nje ngjarje pasuese, madje dhe te qendrojne brenda territorit te lejimit te perkohshem, duke iu permbajtur kushteve te tilla qe mund te kerkojne ligjet dhe rregulloret e ketij territori dhe me kushtin qe mallrat te rieksporthen brenda nje viti nga data e lejimit te perkohshem.

Neni 5

1. Ne perputhje me termat e nenit 13 te kesaj Konvente, zhdoganimi i mallrave per perdorim vendas do te perjashtohet nga detyrimet dhe taksat e importit, si dhe do te perjashtohet nga ndalimet dhe kufizimet ne lidhje me mallrat e meposhtem:

a) Mostra te vogla qe perfaqesojne mallra te huaj te shfaqur ne nje ngjarje, duke perfshire mostra te tilla te ushqimeve dhe pijeve, ose te importuara ne formen e ketyre mostrave ose te prodhuara nga materiale te importuara ne ate ngjarje, me kushtin qe:

i) ato te jene furnizuar nga jashte vendit falas dhe te perdoren vetem per shperndarjen falas per publikun qe frekuenton ate ngjarje, per perdorim individual ose per konsum nga personat te cileve u jepen;

ii) te jene te identifikueshme si mostra me karakter reklame, me vlere te ulet per çdo njesi;

iii) te mos jene te pershtatshme per qellime tregtare, dhe kur mundet, te vendosen ne ambalazhe me te vogla mallrash sesa sasia me e vogel e te njejtimit mall, e shitur me pakice;

iv) mostra te produkteve ushqimore dhe te pijeve jo te paketuara siç parashikohet ne piken (iii) me siper, te konsumohen gjate ngjarjes; dhe per nga vlere dhe sasia e tyre ne teresi, sipas mendimit te organeve doganore te territorit te lejimit te perkohshem, te jene ne perputhje me natyren e ekspozites, numrin e vizitoreve dhe pjesemarrjesve ne ekspozite.

b) Mallrat e importuara vetem per demonstrim ose per demonstrimin e nje makine ose aparati te huaj te shfaqura ne nje ngjarje dhe qe konsumohen ose asgjesohen gjate demonstrimit, me kushtin qe vlere dhe sasia e tyre teresore, sipas mendimit te organeve doganore te territorit te lejimit te perkohshem, te jene ne perputhje me natyren e ekspozites, numrin e vizitoreve dhe gamen e pjesemarrjes se ekspozuesve ne te.

c) Produkte me vlere te vogel, qe perdoren per ndertimin, mobilimin dhe zburimin e stendave te perkohshme te pavijoneve te ekspozuesve te huaj gjate nje ngjarjeje si p.sh. bojera, vernik, leter muresh, etj.

d) Materiale te shtypura, kataloge, njoftime tregtare, lista çmimesh, postera reklame, kalendare te ilustruar ose jo, fotografi pa kornize te cilat tregojne se jane materiale reklamimi per mallrat e huaja te paraqitura ne nje ngjarje duke me kushtin qe:

i) te jene sjelle falas nga jashte vendit dhe te perdoren vetem per shperndarje falas per publikun qe viziton kete ngjarje, dhe

ii) vlere dhe sasia e tyre teresore, sipas mendimit te organeve doganore te territorit te lejimit te perkohshem, te jene ne perputhje me natyren e ekspozites, numrin e vizitoreve dhe gamen e pjesemarrjes se ekspozuesve ne te.

e) Raporte, regjistra, formulare dhe dokumente te tjera te cilat importohen per t'u perdorur si te tilla ne, ose ne lidhje me mbledhjet, konferencat ose kongreset nderkombetare.

2. Dispozitat e paragrafit 1 te ketij neni nuk aplikohen per pijet alkoolike, produktet e duhanit dhe karburantet.

Neni 6

1. Kontrolli dhe zhdoganimi doganor per importin dhe rieksportimin e mallrave, te cilat do te paraqiten ose jane paraqitur ose perdorur gjate nje ngjarjeje, kur eshte e mundur, te behet ne ate ngjarje.

2. Secila pale kontraktuese do te beje perpjekje, aty ku e konsideron te arsyeshme, duke pasur parasysh rendesine dhe permasat e ngjarjes, te krijojte nje zyre doganore per nje periudhe te arsyeshme ne mjediset ku zhvillohet ngjarja brenda territorit te tij.

Neni 7

Produktet e perfituara aksidentalisht gjate ngjarjes nga mallrat e lejimit te perkohshem, si rrjedhoje e demonstrimit per makinerite ose aparatet e paraqitura, u nenshtrohen dispozitave te kesaj Konvente.

Neni 8

Secila pale kontraktuese ka te drejten e rezervave, ne perputhje me nenin 20 te kesaj Konvente, ne perputhje me dispozitat e nenit 5, paragrafi 1 (a) i kesaj shtojce.

Neni 9

Pas hyrjes se saj ne fuqi, kjo shtojce, ne perputhje me nenin 27 te kesaj Konvente, i jep fund dhe zevendeson Konventen doganore lidhur me lehtesirat per importimin e mallrave gjate paraqitjes ose perdorimit ne ekspozita, panaire, mbledhje ose ngjarje te njejta, Bruksel, 8 qershor 1961, ne marredhenie midis paleve kontraktuese te cilet e kane pranuar kete shtojce dhe jane palet kontraktuese te kesaj Konvente.

SHTOJCA B. 2 SHTOJCA LIDHUR ME PAJISJET PROFESIONALE

KREU I

Perkufizime

Neni 1

Per qellimet e kesaj shtojce, termi "pajisje profesionale" do te thote:

1. pajisje per shtyp ose transmetim radiofonik apo televiziv, qe i nevojiten perfaqesuesve te shtypit ose te transmetimeve radiofonike apo televizive qe vizitojne territorin e nje vendi tjetër per qellime reportazhi ose per te transmetuar apo regjistruar materiale per programe te caktuara. Nje liste ilustruese e ketyre pajisjeve jepet ne shtesen 1 te kesaj shtojce;
2. pajisje kinematografike qe i nevojitet nje personi qe viziton nje vend tjetër per te xhiruar nje ose disa filma te caktuar. Nje liste ilustruese per keto pajisje jepet ne shtesen II te kesaj shtojce;
3. çdo pajisje tjetër e nevojshme per ushtrimin e vokacionit, tregtise ose profesionit nga nje person qe viziton territorin e nje vendi tjetër per te kryer nje detyre te caktuar. Nuk perfshin megjithate, kjo kategori, pajisjet te cilat do te perdoren per prodhimin industrial ose paketimin e mallrave ose (me perjashtim te veglave te dores) per shfrytezimin e rezervave natyrore, per ndertimin, riparimin ose mirembajtjen e ndertesave, per germimin dhe zhvendosjen e dherave si dhe pune te tjera te ngjashme. Nje liste ilustruese e ketyre pajisjeve jepet ne shtesen III te kesaj shtojce;
4. aparatura ndihmese per pajisjet e permendura ne piken 1, 2 dhe 3 te ketij neni dhe aksesoreve perkates.

KREU II

Qellimi

Neni 2

Lejimi i perkohshem jepet per mallrat si me poshte ne perputhje me nenin 2 te kesaj Konvente:

- a) pajisjet profesionale;

b) pjeset perberese te importuar per riparimin e pajisjeve profesionale te lejuara perkohesisht sipas paragrafit (a) me siper.

KREU III

Dispozita te ndryshme

Neni 3

1. Per lehtesirat e parashikuara nga kjo shtojce per t'u zbatuar, pajisjet profesionale:
 - a) duhet t'i perkasin nje personi te vendosur ose rezident jashte territorit te lejimit te perkohshem;
 - b) duhet te importohen nga nje person i vendosur ose rezident jashte territorit te lejimit te perkohshem;
 - c) duhet te perdoren vetem ose nen mbikeqyrjen personale te personit qe viziton kete territor te lejimit te perkohshem.
1. Paragrafi 1 nuk zbatohet per pajisjet kinematografike qe importohen per prodhim filmash, programesh televizive ose vepra audiovizive, sipas nje kontrate bashkeprodhimi te kryer me nje person te vendosur ne territorin e lejimit te perkohshem i cili eshte pale dhe qe eshte miratuar nga organet kompetente te atij territori sipas nje marreveshjeje nderqeveritare lidhur me bashkeprodhimin.
2. Pajisjet kinematografike dhe pajisjet per shtyp ose transmetim radiofonik apo televiziv, nuk jane objekt i kontratave te qiradhenieve ose marreveshje te njejta ne te cilat nje person i vendosur ne territorin e lejimit te perkohshem eshte pale, me kusht qe kjo te mos aplikohet ne rastin e programeve te perbashketa per transmetim radiofonik apo televiziv.

Neni 4

1. Lejimi i perkohshem i pajisjeve per prodhimin dhe transmetimin radiofonik dhe televiziv dhe veçanerisht pervesimi i furgonave radiofonike ose televizive dhe pajisjeve te tyre, te importuara nga organe publike ose private te miratuara per ate qellim nga organet doganore te territorit te lejimit te perkohshem, jepet pa kerkuar ndonje dokument ose garancie doganore.
2. Organet doganore mund te kerkojne paraqitjen e nje liste ose inventari te detajuar te pajisjeve te permendura ne paragrafin 1 te ketij nen, se bashku me angazhimin me shkrim per te rieksportuar.

Neni 5

Periudha per rieksportimin e pajisjeve profesionale duhet te jete te pakten dymbedhjete muaj nga data e lejimit te perkohshem. Periudha per rieksportimin e automjeteve, gjithsesi, mund te percaktohen ne lidhje me qellimin dhe kohezgjatjen e qellimshme te qendrimit ne territorin e lejimit te perkohshem.

Neni 6

Secila pale kontraktuese ka te drejten per te refuzuar ose anuluar lejimin e perkohshem ne lidhje me automjetet e permendura ne shtesat I dhe III te kesaj shtojce, qe dhe rastesisht, ngarkojne personat per pagesen ose ngarkimin e mallrave ne territorin e saj, per shkarkimin dhe zbarkimin ne nje vend brenda territorit te njejte.

Neni 7

Shtesat e kesaj shtojce do te konceptohen si pjese integrale saj.

Neni 8

Hyrja ne fuqi e kesaj shtojce, ne perputhje me nenin 27 te kesaj Konvente, sjell shfuqizimin dhe zevendesim e Konventes doganore mbi importimin e perkohshem te pajisjeve profesionale, Bruksel, 8 qershor 1961, ne marredhenie midis paleve kontraktuese te cilet kane miratuar kete shtojce dhe jane palet kontraktuese te kesaj Konvente.

Shtojca I

Liste ilustruese

Pajisje per shtypin ose per mjetet televizive ose degjuese

A) Pajisje per shtypin si:

- kompjutere;
- pajisje telefaksi;
- makina shkrimi;
- kamera te te gjitha llojeve (kamera filmi dhe elektronike);
- aparate per transmetimin, incizimin ose riprodhimin e zerit ose te imazhit (magnetofone dhe videoregjistrues, dhe videoriprodhues, mikrofone, konsolle per perzierje, bokse zeri);
- media per regjistrimin e imazhit ose te tingujve, te regjistruara ose te paregjistruara;
- instrumente per matje dhe testim dhe aparate (oshilografe, sisteme testimi per magnetofon dhe regjistrues video, multimeter, kuti mjetesh dhe çanta, vektoskope, riprodhues video etj.);
- pajisje ndriçuese (projektore, konvertues, mbajtese trikembeshe);
- aksesore operative (kaseta, ekspozimetra, lente, mbajtese trikembeshe, akumulatore, rripa baterie, karikues baterish, monitore).

b) Pajisje televizive per zerin, si:

- pajisje telekomunikacioni, si transmetues ose marres televizive; terminale qe mund te lidhen me rrjete ose satelitin; lidhje satelitore;
- pajisje per prodhimin me frekuence te tingullit (ngrites zeri, aparate per regjistrim ose riprodhim);
- instrumente per matje dhe testim dhe aparate (oscilografe, sisteme testimi per magnetofon dhe regjistrues video, multimeter, kuti mjetesh dhe çanta, vektoskope, riprodhues video, etj.);
- aksesore operacionale (ora, kronometra, kompase, mikrofone, konsolle per perzierje, kaseta, complete riprodhimi, transformatore, bateri dhe akumulatore, karikues baterish, ngrohesh, aparate per ajrin e kondicionuar dhe ventilimin, etj.);
- media per regjistrimin e zerit, te regjistruara ose te paregjistruara.

c) Pajisje televizive per televizionin, si:

- kamera televizive;
- telekinema;
- aparate dhe instrumente per testim dhe matje;
- aparate per transmetim dhe ritransmetim;
- aparate komunikimi;
- aparate per regjistrimin ose riprodhimin e imazhit dhe te tingullit (regjistrues kasetash magnetofoni dhe video dhe video riprodhues, mikrofona, konsolle per perzierje, bokse zeri);
- pajisje ndriçuese (prozhektore, konvertues, mbajtese trekembesh);
- pajisje per botim;
- aksesore operacionale (ora, kronometra, kompase, lente, ekspozimetra, mbajtete trekembesh, karikues baterish, kaseta magnetofoni, complete riprodhues, transformatore, bateri dhe akumulatore, ngrohesh, aparate per ajrin e kondicionuar dhe ventilimin, etj.);
- media per regjistrimin e imazhit ose te zerit, te regjistruara ose te paregjistruara (tituj krediti, stacione me shenje identifikuese, venes muzike, etj.);
- "plane te pamontuara filmash";

- instrumente muzikore, kostume, skenografi dhe materiale te tjera skenike, piedestale, materiale per makijazh, tharese flokesh.
- d) Mjete te dizenuara ose veçanerisht te adaptuara per qellimet specifike te mesiperme, si per shembull mjetet e transmetimit televiziv, mjetet per aksesoret televizive, mjetet per regjistrimin ose riprodhimin e imazhit ose te zerit, mjete me levizje te ngadalte, mjete ndriçuese.

Shtojca II

Materiale kinematografike

Liste ilustruese

a) Pajisje, si:

- kamera te te gjitha llojeve (kamera filmike dhe elektronike);
- instrumente dhe aparate per testim dhe matje (oshilografe, sisteme testimi per regjistrues kasetash magnetofoni dhe video, multimetra, kuti mjetesh dhe çanta, vektorskope, riprodhues video, etj.);
- karela kamerash dhe krahe mikrofoni;
- pajisje ndriçuese (projektore, konvertues, mbajtese trekembesh);
- pajisje botuese;
- aparate per regjistrimin e riprodhimin e imazhit dhe te tingullit (regjistrues magnetofoni dhe video dhe videoriprodhues, mikrofon, konsolle per perzierjen, bokse zeri);
- media per regjistrimin e imazhit dhe te zerit, te regjistruara ose te paregjistruara (tituj krediti, stacion me shenje identifikuese, venes muzike, etj.);
- "plane te pamontuara filmash";
- aksesore operacionale (ora, kronometra, kompase, mikrofon, konsolle per perzierje, kaseta magnetofoni, komplete riprodhues, transformator, bateri dhe akumulatore, karikues baterish, ngrohes, aparate per ajrin e kondicionuar dhe ventilimin, etj.);
- instrumente muzikore, kostume, skenografi dhe materiale te tjera skenike, piedestale, materiale per makijazh, tharese flokesh.

b) Automjete te percaktuara ose te pershtatura posaçerisht per qellimet e specifikuara me siper.

Shtojca III

C. Pajisje te tjera

A) Pajisje per ngritje, testim, venie ne pune, kontroll, mirembajtje ose riparim te makinerive, impiantit, mjeteve te transportit, etj., si:

- mjete;
- pajisje dhe instrumente per matje, kontroll ose testim (temperature, presioni, distance, peshe, sipërfaqe, shpejtesi, etj.), duke perfshire instrumente elektrike (voltmetra, ampermetra, kablllo matese, komparatore, transformatore, instrumente regjistrues, etj.), dhe mbajtese instrumentesh;
- aparate dhe instrumente per fotografimin e makinerive ose impianteve gjate dhe pas ngritjes,
- aparate per mbikeqyrjen e anijeve.

B) Pajisje te nevojshme per biznesmene, per efikasitetin e konsulentëve te biznesit, eksperte te produktivitetit, financiere dhe pjesetare te profesioneve te ngjashme, si:

- kompjutere;
- makina shkrimi;
- transmetues imazhi dhe zeri, aparate regjistrimi ose riprodhimi;

- aparate dhe instrumente llogarites.

C) Pajisje te nevojshme per eksperte qe ndermarrin sondazhe topografike ose pune kerkuese gjeofizike, si:

- aparate dhe instrumente mates;

- pajisje shpuese;

- pajisje transmetimi dhe komunikimi.

D) Pajisje te nevojshme per eksperte qe luftojne kunder ndotjes se mjedisit.

E) Instrumente dhe aparate te nevojshme per doktore, kirurge, kirurge veterinare, mami dhe pjesetare te profesioneve te ngjashme.

F) Pajisje te nevojshme per arkeologe, paleontologe, gjeografe, zoologe ose shkencetare te tjere.

G) Pajisje te nevojshme per argetues, per shoqeri teatrore dhe orkestra, duke perfshire te gjitha artikujt e perdorur per shfaqje publike ose private (instrumente muzikore, kostume, skenografi, etj.).

H) Pajisje te nevojshme per leksione ose per ilustrimin e ketyre leksioneve.

I) Pajisje te nevojshme per udhetime fotografike (kamera te te gjitha llojeve, kaseta, ekspozimetra, lente, mbajttese trekembesh, akumulatore, rripa baterie, karikues baterish, monitore, pajisje ndricuese, mallra mode dhe aksesore per foto modele, etj.).

J) Automjete te percaktuara ose te pershtatura posacerisht per qellimin e siperpermendur, si: njesi inspektimi te levizshme, punishte levizese dhe laboratore levizes.

SHTOJCA B.3

SHTOJCE PER KONTENIERE T PALETET, AMBALAZHET MOSTRAT DHE MALLRA TE TJERA TE IMPORTUARA NE LIDHJE ME NJE OPERACION TREGTAR

KREU I Perkufizime Neni 1

Per qellime te kesaj shtojce, me termin:

a) "mallra te importuara ne lidhje me nje operacion tregtar" kuptohen:

kontejneret, paletat, ambalazhet, mostrat, filmat publicitare dhe mallra te tjera te importuara ne lidhje me nje operacion tregtar, importimi i te cilave nuk perben ne vetvete nje operacion tregtar;

b) me "ambalazh" kuptohen:

te gjitha artikujt dhe materialet e perdoruar ose per t'u perdorur, ne gjendjen qe jane importuar, per te ambalazhuar, mbrojtur, vendosur ose ndare mallrat, duke perjashtuar materiale te tilla si: kashte, leter, lesh xhami, tallash, kur importohen ne ngarkesa te medha. Kontejneret dhe paletat, siç percaktohen ne pikat (c) dhe (d) te ketij neni jane gjithashtu perjashtohen perkatesisht;

C) me "kontejner" kuptohet:

nje pajisje transporti (kamion me ngritje, cisterne e levizshme ose struktura te tjera te ngjashme):

i) perben nje ndarje te mbyllur, plotesisht ose pjeserisht, per te mbajtur mallra;

ii) pajisje e pandryshueshme dhe e forte mjaftueshem per te pasur perdorim te perseritur;

iii) e ndertuar ne menyre te tille per te lehtesuar transportin e mallrave nepermjet nje ose disa menyrave te transportit, pa qene nevoja e ngarkimit dhe e shkarkimit te ndermjetem;

iv) ndertuar per manovrim te menjehershem, sidomos kur kalohet nga nje menyre transporti ne nje menyre tjeter transporti;

iv) ndertuar per t'u ngarkuar dhe shkarkuar lehtesisht; dhe

vi) kane nje volum te brendshem prej nje metri kub ose me shume.

Ne "kontejner (mbajtes)" perfshihen dhe aksesoret dhe pajisjet e kontejnerit, te pershtatshme per llojin ne fjale, me kusht qe aksesore dhe pajisje te tilla te transportohen se bashku me

kontejnerin. Termi "kontejner" nuk do të përfshijë automjetet, aksesoret, ose pjesët e kembimit të tyre, ose ambalazhet dhe paletat. "pjesë të çmontueshme" do të konsiderohen si kontejnere;

d) me "palet" kuptohet:

një pajisje në sipërfaqe të së cilës mund të vendosen së bashku një sasi mallrash duke formuar një njësi ngarkese për qëllime transporti, levizje ose ruajtje apo stivim të mallit nëpërmjet ndihmes së pajisjeve mekanike. Kjo pajisje përbehet prej dy kate të lidhura ndërmjet tyre prej traversash ose nga një kat i vetëm i mbështetur mbi kembe; lartësia e përgjithshme duhet të jetë aq sa të bëjë të mundur levizjen me vinça pirun ose karelat e paletave, dhe mund të kenë ose jo edhe superstruktura të ngritur mbi to;

e) me "mostra" kuptohet:

artikuj që përfaqësojnë një kategori të caktuar mallrash, të prodhuara ose që janë shembuj mallrash, të cilat duhet të prodhohen, përjashtuar artikuj identikë të sjellë nga i njëjti individ, ose derguar një marrësi të vetëm, në masën që e marrë në teresi, sipas përdorimit të zakonshëm tregtar nuk përbejnë me artikuj mostre;

f) me "filma publicitare" kuptohet:

pajisje të regjistrimit vizual, me ose pa efekte zanore, që konsistojnë kryesisht në imazhe që paraqesin karakterin ose mënyrën e përdorimit të produkteve ose pajisjeve të vendosura për shitje ose me qira nga një person me seli ose vendbanim jashtë territorit të përjashtimit të perkohshëm, me kusht që filmat janë të një lloji të përshtatshëm për demonstrim të klientit potencial, por jo për demonstrim të përgjithshëm për publikun, dhe të jenë importuar në një ambalazh që nuk ka me shumë se një kopje të secilit film dhe që nuk përben pjesë të një dergese me të madhe me filma;

g) me "trafik të brendshëm" do të kuptohet:

transporti i mallrave të ngarkuara në territorin doganor të një pale kontraktuese për t'u shkarkuar në një vend brenda territorit doganor të së njëjtes pale kontraktuese.

KREU II

Qellimi Neni 2

Mallrave të mëposhtme që kanë lidhje me një operacion tregtar do t'u jepet lejimi i perkohshëm në përputhje me nenin 2 të kësaj Konvente:

a) ambalazhe të importuara të mbushura për t'u rieksporuar të mbushura ose të zbrazura ose të importuara të zbrazura për t'u rieksporuar të mbushura;

b) kontejnere, nëse janë ose jo të mbushur me mallra, dhe aksesore dhe pajisje të mbajtesve të lejuar përkohësisht, të cilat janë importuar me një mbajtës për t'u rieksporuar veçmas ose me një mbajtës tjetër, ose janë importuar veçmas për t'u rieksporuar me një mbajtës;

c) pjesë përberëse të destinuara për riparimin e mbajtesve që i është dhënë lejimi i perkohshëm sipas pikës (b) të këtij neni;

d) paleta;

e) mostra;

f) filma publicitare;

g) çdo lloj tjetër malli importuar për kedo nga qellimet e renditura në shtojcën I të kësaj shtojce në lidhje me operacionet tregtare për importimi i të cilave nuk përben në vetvete një operacion tregtar.

KREU III

Dispozita të ndryshme Neni 3

Dispozitat e kesaj shtojce nuk ndikojne legjislacionin doganor te paleve kontraktuese ne lidhje me importimin e mallrave te transportuara ne mbajtes ose ambalazhe ose ne paleta.

Neni 4

1. Per qellimin e perfitimit te lehtesirave te dhena nga ky shtojce:

a) ambalazhet mund te rieksporthen vetem nga personi perfitues te lejimit te perkohshem. Ato nuk do te perdoren, qofte dhe rastesisht ne trafikun e brendshem;

b) mbajtesit (kontejneret) duhet te shenjzohen sipas menyres se pershkruar ne shtojcen II te kesaj shtojce. Ato mund te perdoren per trafikun e brendshem, por ne kete rast, çdo pale kontraktuese i nenshtrohet permbushjes se kushteve te meposhtme:

- udhetime duhet te sjelle kontejnerin pergjate nje itinerari te arsyeshem ose sa me afer me vendin ku ngarkesa e eksportit do te ngarkohet ose nga ku kontejneri do te eksportohet bosh;

- kontejneri do te perdoret vetem nje here ne trafikun e brendshem perpara se te rieksporthet;

c) paletat ose nje numer i barabarte paletash i te njejtut lloj dhe kryesisht me te njejtut vlere duhet te kene qene me pare te eksportuara ose qe do te eksportohen me pas ose rieksporthen;

d) mostrat dhe filmat publicitare duhet te jene ne pronesi te nje personi qe eshte rezident jashte territorit te lejimit te perkohshem dhe duhet te importohet vetem per qellime per t'u treguar ose demonstruar ne territorin e lejimit te perkohshem per te terhequr porosi per import te ketyre mallrave ne ate territor. Ato nuk mund te shiten ose te vendosen per perdorim normal perveç qellimit te demonstrimit, ose perdorur ne çfaredo menyre per dhenie me qira ose shperblim nderkohe qe eshte ne territorin e lejimit te perkohshem;

e) mallrat referuar ne pikat 1 dhe 2 te shtojces I te kesaj shtojce nuk do te perdoren per aktivitet fitimprures.

2. Çdo pale kontraktuese do te kene te drejten te refuzojne lejimin e perkohshem per kontejneret, paletat ose ambalazhet qe kane qene objekt i blerjes, qira-blerjes, dhenies me qira ose nje kontrate te nje natyre te tille, kryer nga nje person i vendosur ose rezident ne territorin e pales kontraktuese ne fjale.

Neni 5

1. Lejimi i perkohshem per kontejneret, paletat ose ambalazhet do te jepet pa dokument doganor ose pa kerkuar garanci.

2. Ne vend te nje dokumenti doganor dhe garancise per kontejneret, personit te cilit i eshte akorduar lejimi i perkohshem, mund t'i kerkohe me shkrim:

i) te vere ne dispozicion te autoriteteve doganore, ne baze te kerkeses se tyre, informacion te detajuar mbi levizjet e çdo kontejneri qe i eshte dhene lejimi i perkohshem, perfshire datat dhe vendet e hyrjes dhe daljes nga territori i lejimit te perkohshem, ose nje liste te kontejnereve bashke me zotimin per t'i rieksportuar,

ii) te paguaje detyrimet e importit dhe taksat sipas nevojës, ne rastet kur kushtet e lejimit te perkohshem nuk jane permbushur.

2. Ne vend te nje dokumenti doganor dhe garancise per paletat dhe ambalazhet, personit te cilit i eshte dhene autorizimi i lejimit te perkohshem, mund t'i kerkohe t'u paraqese autoriteteve doganore nje deklarate me shkrim ku zotohet per rieksportim.

3. Personat te cilet perdorin rregullisht proceduren e lejimit te perkohshem do te autorizohen qe te paraqesin nje deklarate te pergjithshme ku zotohen.

Neni 6

Periudha per rieksportimin e mallrave ne lidhje me nje operacion tregtar do te jete te pakten gjashte muaj nga data e lejimit te perkohshem.

Neni 7

Çdo pale kontraktuese ka te drejten te paraqese rezerva ne perputhje me nenin 29 te kesaj Konvente, ne lidhje me:

- a) jo me shume se tre grupe mallrash te renditura ne nenin 2;
- b) nenin 5, paragrafi 1 i kesaj shtojce.

Neni 8

Shtesat e kesaj shtojce jane pjese integrale e kesaj te fundit.

Neni 9

Me hyrjen ne fuqi, kjo shtojce, ne perputhje me nenin 27 te kesaj Konvente, do te shfuqizojë dhe zevendesojë dispozitat dhe konventat e meposhtme:

- Konventa evropiane mbi trajtimin doganor te paletave te perdorura per transport nderkombetar, Gjeneve, 9 dhjetor 1960;
- Konventa doganore mbi importimin e perkohshem te ambalazheve, Bruksel, 6 tetor 1960;
- nenet 2-11 dhe shtojcat 1 (paragraf 1 dhe 2) -3 te Konventes doganore per kontejneret, Gjeneva, 2 dhjetor 1972;
- nenet 3, 5 dhe 6 (1.b dhe 2) te Konventes nderkombetare per lehtesimin e importit te mostrave tregtare dhe materialeve publicitare, Gjeneve, 7 nentor 1952 ne marredheniet midis paleve kontraktuese te cilat kane pranuar kete shtojce dhe jane pale kontraktuese ne keto konventa.

SHTOJCA I

Lista e mallrave sipas Nenit 2 (g)

1. Mallra te importuara per testim, kontroll, eksperimentime ose demonstrime.
2. Mallra per perdorim ne testim, kontroll, eksperimentime ose demonstrime.
3. Filma kinematografike te zhvilluar ose printuar, pozitive dhe media te tjera qe kane te regjistruar imazhe me qellim per t'u pare para perdorimit te tyre tregtar.
4. Filma, kasete magnetike, filma te magnetizuar dhe media te tjera qe mbajne tingull ose imazh te destinuar per dublim, regjistrim ose riprodhim te tingullit.
5. Elemente te medies me te dhena, te derguara falas per perpunim automatik te dhenash.
6. Artikuj (perfshire automjetet) te cilat, ne baze te natyres se tyre, jane te papershtatshme per ndonje qellim tjetër, perveç se publicitetit te artikujve specifikë ose publicitet per nje qellim specifik.

SHTOJCA II

Dispozita rreth shenjzimit te kontejnereve (mbajtesve)

1. Informacioni i meposhtem do te shenjzohet ne menyre permanente dhe ne vend qartesisht te dukshem mbi kontejnere (mbajtes):
 - a) identifikimi i pronarit ose perdoruesit kryesor;
 - b) shenjat identifikuese dhe numrat e kontejnerit, te dhena nga pronari ose perdoruesi, dhe
 - c) pesha e mbajtesit, perfshire dhe pajisjet e tij te vendosura ne menyre permanente.
2. Shteti te cilit i perket kontejneri mund te tregohet ose i plote, ose nepermjet kodit te shtetit ISO Alpha-2 qe jepen sipas standardeve nderkombetare ISO 3166, ose nepermjet shenjave dalluese qe perdoren per te treguar shtetin e regjistrimit te automjeteve ne trafikun rrugor nderkombetar. Çdo shtet mund te percaktojë perdorimin e emrit ose te shenjës dalluese ne

kontejner sipas legjislacionit kombetar perkates. Identiteti i pronarit ose perdoruesit mund te tregohet ose nepermjet emertimit te plote, ose nepermjet nje identifikimi te percaktuar, ku simbolet si emblemat ose flamujt jane te perjashtuar.

3. Per shenjat dhe numrat identifikues qe vendosen mbi mbajtes qe konsiderohen te shenjeuar ne menyre permanente kur perdoret ambalazh prej flete plastike, nevojiten te permbushen specifikimet e meposhtme:

a) nje material adeziv i cilesise se larte duhet te perdoret. Shiriti plastik pasi te jete vendosur, duhet te kete nje force mbajtese me te ulet se ngjitja adezive perfundimtare ne menyre qe heqja e shiritit pa e shkaterruar ate te jete e pamundur. Shiriti i prodhuar me metode kast permbush keto kerkesa. Shiritat e prodhuar me kalandature nuk do te perdoren;

b) kur shenjat e identifikimit dhe numrat duhet te ndryshohet, shiriti qe duhet zevendesuar duhet te hiqet plotesisht para vendosjes se shiritit te ri, vendosja e nje shiriti te ri mbi shiritin ekzistues nuk do te lejohet.

1. Specifikimet per perdorimin e shiritit plastik per shenjezimin e mbajtesve percaktuar nga paragrafi 3 i kesaj shtojce nuk perjashton mundesine e perdorimit te metodave te tjera te shenjezimit ne menyre permanente.

SHTOJCA B.4

SHTOJCE PER MALLRAT E IMPORTUARA NE LIDHJE ME NJE OPERACION PERPUNIMI

KREU I

Perkufizime

Neni 1

Per qellime te kesaj shtojce me termin "mallra te importuara ne lidhje me nje operacion perpunimi" do te kuptohet:

1. a) matrica, blloqe, pllaka, stampa, dizenjo, plane, modele dhe artikuj te tjere te ngjashem;

b) instrumente matese, kontrolluese, verifikuese dhe artikuj te tjere te ngjashem;

c) instrumente dhe vegla te veçanta te importuara gjate nje procesi perpunimi; dhe

2. "pjese zevendesuese te mjeteve perpunuese ":

instrumente, aparate dhe makineri qe vihen ne dispozicion te klientit nga furnizuesi ose riparuesi, ne pritje te dergimit ose riparimit te produkteve te tilla.

KREU II

Qellimi

Neni 2

Mallrave te importuara ne lidhje me nje operacion perpunimi do t'u jepet lejimi i perkohshem ne perputhje me nenin 2 te kesaj Konvente.

KREU III

Dispozita te ndryshme

Neni 3

Per te perfituar lehtesite nga kjo shtojce, duhet qe:

a) mallrat e importuara ne kuadrin e nje operacioni perpunues duhet te jene ne pronesi te nje personi i vendosur jashte territorit te lejimit te perkohshem dhe te destinuar per nje person te vendosur ne nje territor te tille;

- b) gjithë prodhimi ose pjesë e tij, në bazë të legjislacionit kombëtar, që rezulton nga përdorimi i mallrave të importuara në kuadrin e një procesi përpunimi, sipas nenit 1, paragrafit 1, të kësaj shtojce, duhet të eksportohet nga territori i lejimit të perkohshëm;
- c) pjesë zëvendësuese të mjeteve përpunuese duhet të jenë të disponueshme, perkohësisht dhe pa pagesë, për personin e vendosur në territorin e lejimit të perkohshëm nga ose nëpërmjet furnizuesit të mjetit të përpunimit dërgesa e të cilit është shtyre ose që duhet të riparohet.

Neni 4

1. Periudha për rieksporimin e mallrave të përfshira në nenin 1, paragrafi 1 të kësaj shtojce duhet të jetë të pakten 12 muaj nga data e lejimit të perkohshëm.
2. Periudha e rieksporimit të pjesës zëvendësuese të mjetit të përpunimit duhet të jetë të pakten gjashtë muaj nga data e lejimit të perkohshëm.

SHTOJCA B. 5

SHTOJCA PËR MALLRAT E IMPORTUARA PËR QELIME EDUKATIVE, SHKENCORE OSE KULTURORE

KREU I

Percaktime

Neni 1

Per qellime të kësaj shtojce:

a) me termin "mallra të importuara për qellime edukative, shkencore ose kulturore " do të kuptohen:

pajisje shkencore, materiale pedagogjike, materiale ndihmese për lundertaret dhe çdo material tjetër i lidhur me aktivitetet edukative, shkencore dhe kulturore;

b) në paragrafin (a) sipër:

i) me termin "pajisje shkencore dhe materiale pedagogjike do të kuptohet:

çdo model, instrument, aparat, makineri ose pjesët e tyre të përdorura për qellime të kërkimeve shkencore ose trajnim edukativ ose profesional;

ii) me termin "material ndihmues për lundertaret " do të kuptohet:

material për ndjekjen e aktivitetëve kulturore, edukative, rikrijuese, fetare ose sportive nga persona të ngarkuar me detyra në lidhje me punën ose shërbimin në det në mjet lundrues të huaj të angazhuar në transportin detar ndërkombëtar.

Listat ilustruese për "materialet pedagogjike", "material ndihmues për lundertaret " dhe "çdo mall tjetër importuar në lidhje me aktivitetet edukative, shkencore ose kulturore " janë riprodhuar perkatesisht në shtojcat I, II dhe III, të kësaj shtojce.

KREU II

Qellimi

Neni 2

Mallrave të mëposhtme do t'u jepet lejimi i perkohshëm në përputhje me nenin 2 të kësaj Konvente:

a) mallrat e importuara ekskluzivisht për qellime edukative, shkencore ose kulturore;

b) pjesët e këmbimit, pajisje shkencore dhe materiale pedagogjike që i është dhënë lejimi i perkohshëm sipas paragrafit (a) më sipër, dhe veglat të dizenuara në mënyrë specifike për mirëmbajtjen, kontrollin, matje ose riparimin e pajisjeve të tilla.

KREU III

Dispozita te ndryshme Neni 3

Per te perfituar lehtesite qe jepen prej kesaj shtojce duhet qe:

- a) mallrat e importuara per qellime shkencore, edukative dhe kulturore te jene ne pronesi te nje personi te vendosur jashte territorit te lejimit te perkohshem dhe duhet te importohen nga institucionet per te cilat eshte dhene miratimi ne sasi te arsyeshem, duka mbajtur ne konsiderate qellimin e importimit;
- b) materiali ndihmues per lundertaret duhet te perdoret ne bordin e anijeve te huaja te angazhuara ne transportin detar nderkombetar ose duhet te shkarkohen nga anija per t'u perdorur perkohesisht ne toke nga ekuipazhi, ose duhet te importohet per perdorim ne fjetore, klube ose qendra argetimi per lundertaret, te menaxhuara ose nga organizata zyrtare ose fetare ose organizata jofitimpruese dhe vende adhurimi fetar ku mbahen sherbime te rregullta per lundertaret.

Neni 4

Lejimi i perkohshem per pajisje shkencore dhe materiale pedagogjike dhe materiale ndihmese per lundertaret te perdorura ne bordin e anijeve do te jepet pa qene nevoja e nje dokumenti doganor ose garancie. Kur eshte e nevojshme mund te kerkohet nje inventar se bashku me nje deklarate me shkrim per te bere rieksporitin per pajisjet shkencore dhe materialet pedagogjike.

Neni 5

Periudha e rieksporimit per mallrat e importuara per qellime edukative, shkencore ose kulturore do te jete te pakten 12 muaj nga data e lejimit te perkohshem.

Neni 6

Çdo pale kontraktuese ka te drejten te paraqese rezerva ne perputhje me nenin 29 te kesaj Konvente, per sa i perket dispozitave te nenit 4 te kesaj shtojce, ne lidhje me pajisjet shkencore dhe materiale pedagogjike.

Neni 7

Shtesat e kesaj shtojce do te konsiderohen si pjese integrale te tij.

Neni 8

Me hyrjen ne fuqi, kjo shtojce, ne perputhje me nenin 27 te kesaj Konvente, do te shfuqizojë dhe zevendesojë konventen doganore mbi materialin ndihmes per lundertaret, Bruksel, 1 dhjetor 1964, Konventen doganore per importimin e perkohshem te pajisjeve shkencore, Bruksel, 11 qershor 1968, dhe Konventen doganore mbi importimin e perkohshem te materialeve pedagogjike, Bruksel, 8 qershor 1970, per sa i perket paleve kontraktuese, te cilat kane pranuar kete shtojce dhe jane pale kontraktuese me kete Konvente.

SHTOJCA I

Material Pedagogjik
Liste ilustruese

a) Regjistruarit ose riprodhuarit e tingullit ose imazhit si:

- projektore me diapozitiv dhe shirit;
- projektore kinematografike;
- retroprojektore dhe episkope;
- magnetofon, magnetoskope dhe pajisje video;
- pajisje televizive me qark te mbyllur.

b) Media tingulli ose imazhi si:

- diapozitiv, shirit filmik dhe mikrofilma;
- filma kinematografike;
- incizime tingulli (kaseta magnetike, disqe);
- videokaseta.

c) Materiale te veçanta si:

- pajisje bibliografike dhe materiale audiovizive per librarite;
- librari te levizshme;
- laboratore gjuhësore;
- pajisje te perkthimit simultan;
- pajisje per mesime te programuara, mekanike ose elektronike;
- material i projektuar posaçerisht per trajnim arsimor ose profesional te personave me aftesi te kufizuara.

d) Materiale te tjera si:

- tabela mesimore, modele, grafike, harta, planimetri, foto dhe vizatime; instrumente, aparate dhe modele te projektuara per qellime demonstruese; mjete per studim me informacion pedagogjik vizual ose zanor pergatitur per mesimin e nje lende (mjete studimore); instrumente, aparate, vegla dhe vegla-makine per te mesuar nje sherbim ose zanat; pajisje, perfshire ato qe jane adoptuar posaçerisht per operacionet e shpetimit, qe importohen per trajnimin e personave te angazhuar ne operacionet e shpetimit.

SHTOJCA II

Material ndihmes per lundertaret

Lista ilustruese

A. Materiale leximi, te tilla si:

- libra te çdo lloji;
- kurse korrespondence;
- gazeta, revista dhe botime periodike;
- broshura ndihmese ne port.

B. Materiale audiovizive, te tilla si:

- instrument riprodhuar zanor dhe te imazheve;
- kaseta regjistruese;
- aparate radio dhe televizion;
- projektore kinematografike dhe te tjere;
- regjistrim ne kaseta ose disqe (kurse gjuhe, radio programe, pershendetje, muzike dhe argetim);
- film i ekspozuar dhe i zhvilluar;
- diapozitiv filmik;
- video kaseta.

C. Pajisje sportive, te tilla si:

- veshje sportive,
- topa,
- raketa dhe rrjeta,
- sporte lundrimi,
- pajisje atletike,
- pajisje gjimnastike.

D. Materiale per hobi, te tilla si:

- lojera ne salla te mbyllura;
 - instrumente muzikore;
 - materiale per teatrin amator;
 - materiale per pikurim, skulpture, punime druri dhe metalike, prodhim qilimi, etj.
- E. Pajisje per veprimtari fetare
- F. Pjese dhe aksesore per materialet ndihmese.

SHTOJCA III

MALLRA TE TJERA TE IMPORTUARA NE LIDHJE ME AKTIVITETET EDUKATIVE, SHKENCORE OSE KULTURORE

LISTA ILUSTRUESE

Mallra te tilla si:

1. kostume dhe mjete te skenes te dhena hua pa pagese per shoqeri teatrore ose teatro;
2. partitura muzikore te dhena hua pa pagese per teatro muzikore ose orkestra.

SHTOJCA B.6

SHTOJCE PER SENDET PERSONALE TE UDHETARIT DHE MALLRAT E IMPORTUARA PER QELLINE SPORTIVE

KREU I

Percaktime Neni 1

Per qellime te kesaj shtojce, me termin:

a) "udhetar" kuptohet:

çdo person qe hyn perkohesisht ne territorin e nje pale kontraktuese ne te cilin ai ose ajo nuk banon normalisht aty, per qellime turistike, sportive, biznesi, profesionale, takime, shendetesore, studimore, etj.;

b) me "sende personale" do te kuptohet :

te gjithë artikujt, te rinj ose perdorur te cilat nje udhetuesi i nevojiten ne menyre te arsyeshme per perdorimin e tij ose te saj personal gjate udhetimit, duke marre parasysh te gjithë rrethanat e udhetimit, por duke perjashtuar çdo mall te importuar per qellime tregtare. Nje liste ilustruese e sendeve personale jepet ne shtojen 1 te kesaj shtojce;

c) me "mallra te importuara per qellime sportive " do te kuptohet:

mallra te importuara per qellim sportive: artikuj sportive dhe materiale te tjera per t'u perdorur nga udhetari gjate konkurremeve ose shfaqjeve sportive ose me qellim stervitjeje qe do te kryhet ne territorin e vendit te lejimit te perkohshem. Nje liste ilustruese te mallrave te tille jepet ne shtojcen II te kesaj shtojce.

KREU II

Qellimi Neni 2

Sendet dhe mallrat personale te importuara per qellime sportive do te perfitojne lejimin e perkohshem ne perputhje me nenin 2 te kesaj Konvente.

KREU III

Dispozita te ndryshme

Neni 3

Per te perfituar nga lehtesirat e dhena nga kjo shtojce duhet qe:

- a) sendet personale duhet te importohen nga personi ose ne bagazhin (nese eshte ose jo i shoqeruar) e udhetarit;
- b) mallrat e importuara per qellime sportive duhet te jene ne pronesine e nje personi te vendosur ose banues jashte territorit te lejimit te perkohshem, dhe duhet te importohen ne sasi te arsyeshme ne kuader te qellimit te perdorimit te tyre.

Neni 4

1. Lejimi i perkohshem per sendet personale do te jepet pa pasur nevojte per dokument doganor ose garanci. Megjithate, ne rastin e artikujve qe kane nje nivel te larte te detyrimeve doganore dhe tatimeve, mund te kerkohet nje dokument doganor dhe garanci.
2. Kur eshte e mundur, ne vend te nje dokument doganor ose garancie mund te pranohet nje liste inventar i mallrave bashke me nje deklarate me shkrim ku zotohet per te kryer rieksporimin.

Neni 5

1. Sendet personale do te rieksportheshin jo me vone se kur personi qe i ka importuar ato largohet nga territori i lejimit te perkohshem.
2. Periudha e rieksporimit te mallrave te importuara per qellime sportive do te jete te pakten 12 muaj nga data e lejimit te perkohshem.

Neni 6

Shtesat e kesaj shtojce jane pjese integrale e kesaj te fundit.

Neni 7

Me hyrjen ne fuqi, kjo shtojce, ne perputhje me nenin 27 te kesaj Konvente, do te shfuqizojte dhe zevendesojte zbatimin e nenit 2 dhe 5 te Konventes doganore per udhetimin, Nju-Jork, 4 qershor 1954, ne marrredheniet midis paleve kontraktuese te cilat kane pranuar kete shtojce dhe qe jane pale kontraktuese te kesaj Konvente.

SHTOJCA I

Mjete personale

Lista ilustruese

A. Mjetet personale te udhetimit:

1. Veshja
2. Pajisje tualeti
3. Bizhuteri personale
4. Aparate fotografike te levizshme dhe statike se bashku me nje mase te arsyeshme filmash dhe pjeset e tyre
5. Projektore portative me diapozitiv ose film dhe pjeset e tyre, se bashku me nje mase te arsyeshme diapozitivash ose filmash
6. Video-kamera dhe video regjistruer portative, me nje mase te arsyeshme kasetash
7. Instrumente muzikore portative
8. Gramafon portative me disqe
9. Regjistruer dhe riprodhues zeri portative (perfshire diktofonin), me kaseta
10. Radiomarres portative
11. Aparate televizive portative

12. Makina shkrimi portative
13. Makina llogaritese portative
14. Kompjuter personal portative
15. Dylbi
16. Karroce femijesh
17. Karrige me rrota per invalide
18. Pajisje sportive te tilla si: tenda dhe pajime te tjera kampingu, pajime peshkimi, pajime alpinizmi, pajime zhytесе, arme zjarri sportive me municione, biçikleta te pamotorizuara, kanoe ose kajak jo me te gjate se 5,5 metra, ski, raketa tenisi, tavolina serfi, mjet fluturimi drejtuar me dore dhe te tipit me krahe delta dhe pajime golfi.
19. Aparate analizash dhe te tjera mjekesore te ngjashme, dhe pjeset e duhura per perdorimin e tyre
20. Artikuj te tjere te nje natyre plotesisht personale.

SHTOJCA II

Mallra te importuara per qellime sportive

Lista ilustruese

A. Pajisje per atletike, te tilla si:

- pengesa,
- Shkop per hedhje se larti, disk, gjyle, shtize dhe çekiç.

B. Pajisje per lojerat me top, te tilla si:

- topa te llojeve te ndryshme,
- raketa, shkopinj per kroket, shkopinj golfi, shkopinj bejsbolli dhe te ngjashme me to,
- rrjeta te te gjitha llojeve,
- shtylla porte.

C. Pajime te sporteve dimerore, te tilla si:

- ski dhe shkopinj dallimi,
- patina per akull,
- slita bob,
- pajime per slitat dredhese.

D. Veshje sportive, kepuce, dorashka, kaska, etj. te çdo lloji.

E. Pajime te sporteve ujore, te tilla si:

- kanoe dhe kajake,
- anije me vela dhe rrema, vela, rrema, rrema pa mbeshtetese.

F. Mjete te motorizuara, te tilla si:

- makina,
- motore,
- motobarka.

G. Pajime per veprimtari te ndryshme, te tilla si:

- arme sportive dhe municione,
- biçikleta te pamotorizuara,
- harqe shigjete dhe shigjeta,
- pajime gardhuese,
- pajime gjimnastikore,
- kompase,
- tapet mundjeje dhe tatamis (shtroje me kashte),
- pajime te peshengritjes,
- pajime kaloresie, kaloshina,
- pajime alpinizmi,
- kaseta muzikore qe shoqerojne ushtrimin.

H. Pajisje ndihmese, te tilla si:

- pajisje matjeje dhe tabela rezultatesh,
- aparate per testim gjaku dhe urine.

SHTOJCA B.7
SHTOJCE PER MATERIALET PUBLICITARE TURISTIKE

KREU I

Percaktim
Neni 1

Per qellime te kesaj shtojce, me “materiale publiciteti turistik” do te kuptohet: mallra qe importohen per qellim te nxitjes se publikut per te vizituar nje vend tjeter te huaj, ne veçanti per te ndjekur evenimente ose takime qe zhvillohen aty per qellime kulturore, fetare, turistike, sportive ose profesionale. Nje liste ilustruese e nje materiali te tille jepet ne shtesen e kesaj shtojce.

KREU II

Qellimi
Neni 2

Perveç materiale te referuara ne nenin 5 te kesaj shtojce, per te cilat jepet importim pa detyrime doganore te importit dhe taksa, materialeve publicitare turistike do te perfitojne lejimin e perkohshem ne perputhje me nenin 2 te kesaj Konvente.

KREU III

Dispozita te ndryshme
Neni 3

Per te perfituat lehtesite e dhena nga kjo shtojce duhet qe materiali turistik per publicitet te jete ne pronesi nga nje person banues jashte territorit te perjashtimit te perkohshem dhe duhet te importohet ne sasi te arsyeshme ne kuader te qellimit te perdorimit te tyre.

Neni 4

Periudha per rieksporim te materialit publicitar turistik do te jete te pakten 12 muaj nga data e lejimit te perkohshem.

Neni 5

Importim pa detyrime importi dhe taksa do te jepet per materialet publicitare te meposhtme:

- a) Dokumente (dosje, pamflete, libra, revista, udhezues, postera me kornize ose jo, fotografi dhe zmadhime fotografike, harta te ilustruara ose jo, flete transparente te printuara) per shperndarje falas, me kusht qe keto dokumente nuk permbajne me shume se 25% te publiciteti komercial privat dhe eshte e qarte qe jane per qellime publiciteti te pergjithshem;
- b) Lista dhe publikime vjetore te hoteleve te huaja te publikuara ose te sponsorizuara nga agjenci zyrtare turistike dhe fleteoraret e sherbimeve te transportit qe operojne jashte, nese keto dokumente shperndahen falas dhe nuk permbajne me shume se 25 % publicitet komercial privat;
- c) Materiale teknike, derguar per perfaqesuesit ose korrespondentet e akredituar nga agjenci zyrtare kombetare te turizmit, jo per t'u shperndare, si: publikime vjetore, numeratore telefonike, lista hotelesh, kataloge panairesh, mostra te punimeve artizanale jo me vlere te

larte, dokumente per muzeumet, universitetet, hotelet e banjave termale dhe institucione te ngjashme.

Neni 6

Shtojcat e kesaj shtojce jane pjese integrale te ketij te fundit.

Neni 7

Me hyrjen ne fuqi, kjo shtojce, ne perputhje me nenin 27 te kesaj Konvente, do te shfuqizoje dhe zevendesoje protokollin shtese te Konventes per turizmin, ne lidhje me dokumentet dhe materiale publicitare turistike, 4 qershor 1954, ne marredheniet midis paleve kontraktuese te cilat kane pranuar kete shtojce dhe qe jane pale kontraktuese te kesaj Konvente.

SHTOJCA

Material publicitar turistik

Lista ilustruese

1. Material me qellim per te ekspozuar ne zyrat e perfaqesuesve ose korrespondenteve te akredituar te caktuar nga agjencite kombetare turistike ose ne vende te aprovuara nga autoritetet doganore ne Republiken e Shqiperise: piktura dhe skica, fotografi ne kornize dhe zmadhime fotografike, libra arti, piktura, gravura ose litografi, skulptura dhe tapiceri dhe punime arti te tjera te ngjashme me to.
2. Materiale publikuese (tabela treguese, stenda dhe artikuj te ngjashem), perfshire pajisjet elektrike dhe mekanike te nevojshme per veprimet e ekspozimit.
3. Filma dokumentare, regjistruar, kaseta regjistruar dhe regjistrime te tjera zanore per perdorim te ekzekutimeve qe jane falas, perjashtuar ato objektet e te cilave jane per perdorim reklamues tregtar dhe ato te cilat jane per shitje te pergjithshme ne Republiken e Shqiperise.
4. Nje numer i arsyeshem flamujsh.
5. Diorama, modele te zvogeluara, diapozitiv, blloqe printuese, negative fotografish.
6. Mostra, ne nje numer te arsyeshem, te artikujve kombetare zejtare, kostume popullore dhe artikuj te ngjashem folklorike.

SHTOJCA B.8

SHTOJCE PER MALLRAT E IMPORTUARA SI TRANSPORT KUFITAR

KREU I

Percaktime

Neni 1

Per qellime te kesaj shtojce:

a) me termin "mallra te importuara si transport kufitar" do te kuptohen:

- ato mallra te marra nga banoret e zones kufitare per ushtrimin e profesionit te tyre ose tregtine (doktoze, artizane, etj.);
- mjete personale ose shtepiake te banoreve te zones kufitare te importuara prej tyre per riparim, prodhim ose perpunim;
- pajisje me destinacion per t'u perdorur ne punimin e tokes brenda zones kufitare te territorit te lejimit te perkohshem;
- pajisje ne pronesi te nje enti zyrtar, importuar ne lidhje me nje operacion ndihme (zjarr, permbytje, etj);

b) me termin "zone kufitare" do te kuptohet:

nje zone e territorit doganor prane kufirit tokesor, shtrirja e se ciles percaktohet nga legjislacioni kombetar, dhe kufizimet e se ciles sherbejne per dalluar transportin kufitar nga llojet e tjera te transportit;

c) me termin "banore te zones kufitare" do te kuptohet: persona te vendosur ose rezidente ne nje zone kufitare;

d) me termin "transport kufitar" do te kuptohen: importimet e kryera nga banoret e zones kufitare midis dy zonave kufitare perkatese.

KREU II

Qellimi

Neni 2

Mallrave te importuara nepermjet transportit kufitar do t'u jepet lejimi i perkohshem ne perputhje me nenin 2 te kesaj Konvente.

KREU III

Dispozita te ndryshme

Neni 3

Per te perfituar lehtesite nga kjo shtojce duhet qe:

a) mallrat e importuara si transport kombetar duhet te jene ne pronesi te nje banori te zones kufitare fqinje me ate te lejimit te perkohshem;

b) pajisje per punimin e tokes duhet te perdoret nga banoret e zones kufitare ne fqinjesi me zonen kufitare te lejimit te perkohshem te cilet punojne ne token e zones kufitare te dyte. keto pajisje duhet te perdoren per pune bujqesore ose per pylltari si shkarkim ose transport i drurit ose rritjen e peshkut;

c) transport kufitar per riparim, prodhim ose perpunim duhet te jete qartesisht i nje karakteri jo komercial.

Neni 4

1. Lejimi i perkohshem i mallrave te importuara me transport kufitar do te jepet pa qene nevoja e kerkeses per nje dokument doganor ose garanci.

2. Secila prej paleve kontraktuese mund te autorizojte lejimin e perkohshem te mallrave te importuara me transport kufitar me kusht qe te jepet nje inventar i mallrave bashke me nje dokument me shkrim ku behet zotimi per t'i riekportuar ato.

3. Lejimi i perkohshem mund te jepet gjithashtu ne baze te nje deklarimi te thjeshte ne nje regjister te mbajtur nga dogana.

Neni 5

1. Periudha e riekportimit te mallrave te importuara nepermjet transportit kufitar do te jete te pakten 12 muaj nga data e lejimit te perkohshem.

2. Pajisje te destinuar per punimin e tokes do te riekportohen ne momentin qe puna eshte kryer.

SHTOJCA B.9

SHTOJCE PER MALLRAT E IMPORTUARA PER QELIME HUMANITARE

KREU I

Perkufizime

Neni 1

Per qellime te kesaj shtojce:

- a) me termin "mallra te importuara per qellime humanitare" do te kuptohet: pajisje mjekesore, kirurgjike dhe laboratorike dhe dergesa per ndihme;
- b) me termin "dergesa per ndihme" do te kuptohet:
te gjitha mallrat si automjetet dhe mjete te tjera transporti, batanije, tenda, shtepi te parafabrikuara ose mallra te tjera te nevojës jetesore te derguara si ndihme per njerezit e prekur nga fatkeqesite natyrore dhe katastrofa te ngjashme.

KREU II

Qellimi Neni 2

Mallrave te importuara per qellime humanitare do tu jepet lejimi i perkohshem ne perputhje me nenin 2 te kesaj Konvente.

KREU III

Dispozita te ndryshme Neni 3

Per te perfituar lehtesite nga kjo shtojce duhet qe:

- a) mallrat e importuara per qellime humanitare te jene ne pronesi te nje personi te vendosur jashte territorit te lejimit te perkohshem dhe duhet te jepen falas;
- b) pajisje mjekesore, kirurgjike dhe laboratorike me destinacion per t'u perdorur ne spitale dhe institucione te tjera mjekesore, te cilat te ndodhura ne rrethana te pazakonta kane nevojë urgjente per to, me kusht qe keto pajisje te mos jene te disponueshme ne sasi te mjaftueshme ne territorin e lejimit te perkohshem;
- c) dergesa me ndihma duhet t'u dergohen personave te miratuar nga autoritetet kompetente ne territorin e lejimit te perkohshem.

Neni 4

1. Kur eshte e mundur, nje inventar me mallrat, se bashku me nje deklarate me shkrim ku behet zotimi per rieksporim mund te pranohet per pajisje mjekesore, kirurgjike dhe laboratorike, ne vend te nje dokumenti doganor dhe garancie.
2. Lejimi i perkohshem per dergesat e ndihmes do te autorizohet pa qene nevoja per nje dokument doganor ose garanci. Megjithate doganat mund te kerkojne nje inventar me mallrat se bashku me nje deklarate me shkrim ku behet zotimi per rieksporim.

Neni 5

1. Periudha e rieksporimit per pajisje mjekesore, kirurgjike dhe laboratorike do te percaktohet sipas nevojave.
2. Periudha e rieksporimit te dergesave me ndihma do te jete te pakten 12 muaj nga data e lejimit te perkohshem.

SHTOJCA C SHTOJCE PER MJETET E TRANSPORTIT

KREU I

Percaktime

Neni 1

Per qellime te ketij shtojce:

a) me termin "mjet transporti" do te kuptohet:

çdo mjet lundruar (perfshire barkat dhe trapet dhe ato te transportuara ne bordin e nje anije, dhe hidrorreshqiteset), aerorreshqitese, mjete ajrore, automjete (perfshite motoçikletat, trailerat, gjysmetrailerat dhe kombinacionet te automjeteve) dhe mjetet hekurudhore te levizshme; se bashku me pjeset normale te tyre te kembimit, aksesoret dhe pajisjet qe jane ne bordin e mjeteve te transportit (perfshire pajisje te veçanta per ngarkim-shkarkim, mbarevajtjen dhe ruajtjen e ngarkeses);

b) me termin "perdorim komercial" do te kuptohet:

transporti i personave me pagese ose transporti industrial dhe tregtar i mallrave nese eshte ose jo me pagese;

c) me termin "perdorim privat" do te kuptohet:

transporti qe eshte ekskluzivisht per perdorim personal nga personi ne fjale duke perjashtuar perdorimin tregtar;

d) me termin "transport i brendshem" kuptohet:

Transporti i personave ose mallrave te marre ose ngarkuar ne territorin e lejimit te perkohshem te cilet do te kthehen ose shkarkohen brenda te njejtut territor;

e) me termin "serbatore normale" do te kuptohet:

Serbatori i projektuar nga prodhuesi per te gjithë mjetet e transportit te te njejtut lloj me mjetin e transportit ne fjale dhe vendosja e perhershme e te cileve lejon perdorimin e drejtperdrejt te nje lloji te caktuar karburanti qofte per levizjen e mjetit te transportit dhe per funksionimin gjate transportit te sistemeve te ftohjes ose sistemeve te tjera. Serbatorët e instaluar ne mjetin e transportit qe lejojne per t'u perdorur drejtperdrejt me lloje te tjera karburanti dhe instaluar per sisteme te tjera do te konsiderohen si serbatore normale.

KREU II

Qellimi

Neni 2

Lejimi i perkohshem do te jepet per sa me poshte ne perputhje me nenin 2 te kesaj Konvente:

a) mjete transporti per perdorim tregtar dhe privat;

b) pjeset e kembimit dhe pajisjet e importuara per riparimin e mjeteve te transportit te cilat jane te lejuara perkohesisht. Pjese dhe pajisje te zevendesuara te cilat nuk jane rieksportuar do t'i nenshtrohen detyrimeve dhe taksave doganore perveç rasteve kur atyre i jepet nje destinacion sipas nenit 14 te kesaj Konvente.

Neni 3

Veprimet rutine te mirembajtjes dhe riparimet per mjetet e transportit te cilat nevojiten gjate udhetimit per ne territorin e lejimit te perkohshem ose brenda tij dhe te cilat kryen gjate periudhes se lejimit te perkohshem, nuk do te konsiderohen se perbejne nje modifikim ne kuptimin e nenit 1, paragrafi (a) i kesaj Konvente.

Neni 4

1. Karburanti i mbajtur ne serbatorët normale te mjeteve te transportit qe jane lejuar perkohesisht si dhe vajrat lubrifikante per perdorim normal te ketyre mjeteve te transportit do te pranohen pa detyrime dhe taksa doganore dhe pa zbatuar ndalimet ose kufizimet e eksportit.

2. Ne rastin e automjeteve rrugore per perdorim tregtar, çdo pale kontraktuese do te kete gjithsesi te drejten te percaktoje sasite maksimale te karburantit te cilat mund te lejohen ne territoret e tyre pa detyrime dhe taksa doganore dhe pa zbatuar ndalimet ose kufizimet ne serbatoret normale te automjete te tilla rrugore te lejuara perkohesisht.

KREU III

Dispozita te ndryshme

Neni 5

Per te perfituar lehtesite nga kjo shtojce duhet qe:

- a) mjetet e transportit per perdorim tregtar duhet te jene te regjistruara ne nje territor te ndryshem nga ai i lejimit te perkohshem ne emrin e nje personi te vendosur ose banues ne nje territor te ndryshem nga ai i lejimit te perkohshem dhe duhet te importohet dhe perdoret nga persona qe operojne ne nje territor te tille;
- b) mjete transporti per perdorim privat duhet te regjistrohet ne nje vend te ndryshem nga ai i lejimit te perkohshem, ne emer te nje personi te vendosur ose banues ne nje territor te ndryshem nga ai i lejimit te perkohshem dhe duhet te importohet dhe perdoret nga persona banues ne nje territor te tille.

Neni 6

Lejimi i perkohshem do te jepet pa qene nevoja per te kerkuar nje dokument doganor ose garanci.

Neni 7

Pavaresisht dispozitave te nenit 5 te kesaj shtojce:

- a) mjetet e transportit per perdorim tregtar mund te perdoren nga persona te trete, edhe nese jane te vendosur ose banues ne territorin e lejimit te perkohshem kur jane te autorizuar perkatesisht nga personat qe u eshte dhene lejimi i perkohshem dhe veprojne ne emer te tyre;
- b) mjetet e transportit per perdorim privat mund te perdoren nga personat e trete te cilet jane te autorizuar perkatesisht nga personat te cileve u eshte dhene lejimi i perkohshem. Çdo pale kontraktuese mund te lejoje perdorimin nga nje person banues ne territorin e saj, sidomos kur mjeti i transportit perdoren ne emer te dhe sipas udhezimeve te personit te cilit i eshte dhene lejimi i perkohshem.

Neni 8

Çdo pale kontraktuese ka te drejte te refuzoje ose revokojte perfitimet nga lejimi i perkohshem per:

- a) mjetet e transportit per perdorim tregtar te cilat perdoren ne transportin e brendshem;
- b) mjetet e transportit per perdorim privat te cilat perdoren per perdorim tregtar ne transportin e brendshem;
- c) mjetet e transportit te dhena me qira pas importimit ose nese jane importuar te marra me qira, rimerren me qira ose jepen perseri me qira per nje qellim te ndryshem nga ai i rieksportimit te menjehersh.

Neni 9

1. Mjetet e transportit per qellime tregtare do te rieksportohen ne momentin kur jane kryer veprimet e transportit per te cilat ato ishin importuar.

2. Mjetet e transportit per perdorim privat mund te qendrojne ne territorin e lejimit te perkohshem per nje periudhe, ne vazhdimesi ose jo, prej gjashte muajsh ne çdo periudhe prej 12 muajsh.

Neni 10

Çdo pale kontraktuese gezon te drejten qe te paraqese rezerva, ne perputhje me nenin 29 te kesaj Konvente ne lidhje me:

- a) nenin 2, nenparagrafi (a), per sa u perket automjeteve rrugore dhe mjeteve te levizshme hekurudhore;
- b) nenin 6, per sa u perket automjeteve rrugore per perdorim tregtar dhe mjeteve te transportit per perdorim privat;
- c) nenin 9, paragrafi 2 te kesaj shtojce.

Neni 11

Me hyrjen ne fuqi, kjo shtojce, ne perputhje me nenin 27 te kesaj Konvente, do te shfuqizoje dhe zevendesoj Konventen doganore per lejimin e perkohshem te automjeteve rrugore Nju-Jork 4 qershor 1954, Konventen doganore per lejimin e perkohshem, Gjeneve, 18 maj 1956, Konventen doganore per lejimin e perkohshem, Gjeneve, 18 maj 1956, per perdorim te mjeteve ajrore dhe lundruese per argetim ne marredheniet midis paleve kontraktuese te cilat kane pranuar kete shtojce dhe qe jane pale kontraktuese te kesaj Konvente.

SHTOJCA D SHTOJCE PER KAFSHET

KREU I

Perkufizime Neni 1

Per qellime te kesaj shtojce:

- a) me termin "kafshe" do te kuptohen: kafshe te gjalla te çdo specieje;
- b) me termin "zone kufitare" do te kuptohet: nje zone e territorit doganor prane kufirit tokesor, shtrirja e se ciles percaktohet ne legjislacionin kombetar dhe kufizimet e tyre sherbejne per te dalluar transportin kufitar nga transporte te llojeve te tjera;
- c) me termin "banor te zones kufitare" do te kuptohet: personi i vendosur ose banues midis dy zonave fqinje kufitare;
- d) me termin "transport kufitar" do te kuptohet: importimi i kryer nga banoret e zones kufitare midis dy zonave fqinje kufitare.

KREU II

Qellimi Neni 2

Kafshet e importuara per qellimet e specifikuara ne shtesen e kesaj shtojce do te perfitojne nga lejimi i perkohshem ne perputhje me nenin 2 te kesaj Konvente.

KREU III

Dispozita te ndryshme Neni 3

Per te perfituar lehtesite nga kjo shtojce duhet qe:

- a) kafshet te jene ne pronesi te nje personi te vendosur ose banues jashte territorit te lejimit te perkohshem;
- b) te jene kafshe pune qe perdoren per punimin e tokes qe eshte ne zonen kufitare te nje territori te lejimit te perkohshem duhet te importohen nga banoret e zones kufitare fqinje me ate te lejimit te perkohshem.

Neni 4

1. Lejimi i perkohshem per kafshet e punes referuar ne nenin 3 (b) te kesaj shtojce, dhe kafshet e importuara per nderrim kullote apo per kullotje ne token qe ndodhen ne zonen kufitare do te jepet pa qene nevoja e nje dokumenti doganor ose garancie.
2. Çdo pale kontraktuese mund te autorizojë lejimin e perkohshem te kafsheve referuar ne paragrafin 1 te ketij neni ne baze te venies ne dispozicion te nje inventari, se bashku me nje deklarate me shkrim ku behet zotimi per riekportim.

Neni 5

1. Çdo pale kontraktuese gezon te drejten te paraqese nje rezerve ne perputhje me nenin 29 te kesaj Konvente ne lidhje me nenin 4, paragrafi 1 te kesaj shtojce.
2. Çdo pale kontraktuese gezon edhe te drejten per te paraqitur nje rezerve ne perputhje me nenin 29 te kesaj Konvente, ne lidhje me pikat 12 dhe 13 te shteses se kesaj shtojce.

Neni 6

Periudha per riekportimin e kafsheve do te jete te pakten 12 muaj nga data e lejimit te perkohshem.

Neni 7

Shtesat e kesaj shtojce jane pjese integrale te ketij te fundit.

SHTOJCA

Lista sipas Nenit 2

1. Stervitje (e kuajve)
2. Trajnim
3. Mbareshtim
4. Mbathja ose peshimi i kofsheve
5. Trajtim veterinar
6. Testim (per shembull, per qellime shitjeje)
7. Pjesemarrje ne shfaqje, ekspozita, konkurse, ose demonstrime
8. Zbavitje (kafshet e cirkut, etj.)
9. Turizem (perfshire kafshet shtepiake per udhetaret)
10. Ushtrim funksioni (qente ose kuajt e policise; qen zbulimi, qen per te verbrit, etj.)
11. Operacione shpetimi
12. Nxjerrja ne kullote
13. Per qellime transporti ose pune
14. Per qellime mjekesore (shperndarje te helmit te gjarperinjve, etj.)

SHTOJCA E

SHTOJCE PER MALLRAT E IMPORTUARA ME PERJASHTIM TE PJESSHEM TE DETYRIMEVE TE IMPORTIT DHE TE TAKSAVE

KREU I

Percaktime

Neni 1

Per qellime te kesaj shtojce :

a) me termin "mallra te importuara me perjashtim te pjesshem" do te kuptohen: mallra te cilat importohen ne shtojcat e tjera te kesaj Konvente, por qe nuk permbushin te gjitha kushtet e parashtruara ketu per autorizimin e lejimit te perkohshem me perjashtim te plote nga detyrimet dhe taksat doganore dhe mallra qe nuk permenden ne te tjera shtojca te tilla dhe te cilat importohen per perdorim te perkohshem, per shembull ekzekutimin e projekteve te punes;

b) me termin "perjashtim i pjesshem" do te kuptohet: perjashtim nga pagesa e nje pjese ose totali i shumes se detyrimeve doganore dhe taksave te cilat do te paguheshin nese mallrat do te zhdoganoheshin per perdorim brenda vendit ne daten ne te cilen u vendosen nen regjimin e lejimit te perkohshem.

KREU II

Qellimi

Neni 2

Mallrave te referuar ne nenin 1, paragrafi "a" te kesaj shtojce do t'u jepet lejimi i perkohshem ne perputhje me nenin 2 te kesaj Konvente.

KREU III

Dispozita te ndryshme

Neni 3

Per te perfituar nga lehtesite qe jepen nga kjo shtojce, mallrat e importuara, me perjashtim te pjesshem, duhet te jene ne pronesi te nje personit te vendosur ose banues jashte territorit te lejimit te perkohshem.

Neni 4

Çdo pale kontraktuese mund te perpiloje nje liste mallrash te cilat mund te gezojne ose jo te drejten e perfitimit nga lejimi i perkohshem me perjashtim te pjesshem. Depozituesi do te njoftohet per permbajtjen e kesaj liste.

Neni 5

Shuma e detyrimeve dhe taksave te importit te vendosura sipas ketij regjimi nuk mund te kaloje 5 %, per çdo muaj ose fraksion muaji gjate se cilit mallrat vendosen nen regjimin e lejimit te perkohshem.

Neni 6

Shuma e detyrimeve te importit dhe taksave qe do te vihen ne asnje rast nuk do te kaloje ate shume qe do te kishin mallrat ne rast se ato do te zhdoganoheshin per t'u perdorur brenda vendit ne daten ne te cilen u vendosen nen regjimin e lejimit te perkohshem.

Neni 7

1. Shuma e detyrimeve te importit dhe taksave te pagueshme sipas kesaj shtojce do te mblidhen nga autoritetet kompetente kur te mbyllet procedura.
2. Kur, ne perputhje me nenin 13 te kesaj Konvente, procedura e lejimit te perkohshem perfundon duke bere zhdoganim per qarkullim brenda vendit, shumen e çdo detyrimi dhe takse doganore te ngarkuara gjate perjashtimit te pjesshem, do te zbriten nga shuma e detyrimeve te importit dhe taksave qe do te paguhen si rezultat i zhdoganimit per perdorim brenda vendit.

Neni 8

Periudha e rieksportimit te mallrave te importuara me perjashtim te pjesshem do te percaktohet duke marre parasysh dispozitat e neneve 5 dhe 6 te kesaj shtojce.

Neni 9

Çdo pale kontraktuese do te kete te drejten te paraqese rezerva ne perputhje me nenin 29 te kesaj Konvente, ne lidhje me nenin 2 te kesaj shtojce, per deri sa ka te beje me perjashtimin e pjesshem nga taksat e importit.



LIGJ
Nr. 37/2012

**PER ADERIMIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE KONVENTEN
NDERKOMBETARE “PER THJESHTIMIN DHE HARMONIZIMIN E
PROCEDURAVE DOGANORE”, BERE NE KYOTO ME 18 MAJ 1973 (E
NDRYSHUAR)**

Ne mbeshtetje te neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave,

**KUVENDI I
REPUBLIKES SE SHQIPERISE**

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqiperise aderon ne konventen nderkombetare “Per thjeshtimin dhe harmonizimin e procedurave doganore”, bere ne Kyoto me 18 maj 1973 (e ndryshuar).

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Miraturar ne daten 5.4.2012

Shpallur me dekretin nr. 7408, date 23.4.2012 te Presidentit te Republikes se Shqiperise,
Bamir Topi

**KONVENTA NDERKOMBETARE MBI THJESHTIMIN DHE HARMONIZIMIN E
PROCEDURAVE DOGANORE**

(e ndryshuar)

Keshilli i Bashkepunimit Doganor

(Organizata Boterore e Doganave)

Rue du Marche 30

B-1210 Bruxellés

**SHTOJCA I
HYRJE**

Palet kontraktuese te kesaj Konvente te mbledhura nen mbikeqyrjen e Keshillit te Bashkepunimit Doganor,

ne perpjekje per te eliminuar konfliktet midis procedurave dhe praktikave doganore te paleve kontraktuese qe mund te pengojne tregtine nderkombetare dhe shkembimet e tjera nderkombetare;

me deshiren per te kontribuar ne menyre efikase ne zhvillimin e tregtise dhe shkembimeve te tilla, duke thjeshtuar dhe harmonizuar procedurat e praktikave doganore dhe duke nxitur bashkepunimin nderkombetar;

duke verejtur se perfitimet kryesore te lehtesimit te tregtise nderkombetare mund te arrihen pa rrezikuar standardet e kontrollit doganor;

duke pranuar se ky thjeshtim dhe harmonizim mund te realizohet ne veçanti nga zbatimi i parimeve te meposhtme:

- zbatimi i programeve qe synojne modernizimin e vazhdueshem te procedurave dhe praktikave doganore dhe per rrjedhoje, rrisin eficencen dhe efikasitetin;

zbatimi i procedurave dhe praktikave doganore ne nje menyre te parashikueshme, te vazhdueshme dhe transparente;

dispozita per palet e interesuara per te gjithë informacionin e nevojshem ne lidhje me ligjet, rregullat, udhezimet administrative, procedurat dhe praktikat doganore;

miratimi i teknikave moderne si menaxhimi i riskut dhe kontrollet me baze auditi, dhe perdorimi maksimal i zbatimit te teknologjise se informacionit;

bashkepunim me autoritet e tjera kombetare, administratat e tjera doganore dhe komunitetet tregtare, nese eshte e pershtatshme;

zbatimi i standardeve perkatese nderkombetare;

dispozite per palet e prekura per procese lehtesisht te aksesueshme per rishikimin administrativ dhe juridik;

te bindura se nje instrument nderkombetar qe perfshin objektivat e mesiperm dhe parimet qe palet kontraktuese marrin persiper te zbatojne, do te çonte ne nivel te larte thjeshtimin dhe harmonizimin e procedurave dhe praktikave doganore, i cili eshte nje qellim thellesor i keshillit te bashkepunimit doganor, dhe ne kete menyre ofron nje kontribut te madh per lehtesimin e tregtise nderkombetare,

kane rene dakord si me poshte.

KAPITULLI I

Perkufizimet

Neni 1

Per qellimet e kesaj Konvente:

“Standard” do te thote nje dispozite, zbatimi i se ciles pranohet si i nevojshem per arritjen e harmonizimit dhe thjeshtimit te procedurave dhe praktikave doganore.

“Standard i perkohshem” do te thote nje standard ne aneksin e pergjithshem, per te cilin lejohet nje periudhe me e gjate zbatimi.

“Praktike e rekomanduara” do te thote nje dispozite ne nje aneks te veçante, i cili eshte njohur si progres i arritur drejt harmonizimit dhe thjeshtimit te procedurave dhe praktikave doganore, zbatimi sa me i gjere i te cilit konsiderohet i pershtatshem.

“Legjislacion kombetar” do te thote ligjet, rregulloret dhe masa te tjera te vendosura nga autoriteti kompetent i nje pale kontraktuese dhe qe aplikohet nepermjet territorit te pales kontraktuese perkatese apo traktatet ne fuqi, pjese e te cilave ajo pale eshte.

“Aneks i pergjithshem” do te thote teresia e dispozitave te zbatueshme per te gjitha procedurat dhe praktikat doganore te permendura ne kete Konvente.

“Aneks i veçante” do te thote teresia e dispozitave te zbatueshme per nje ose me shume procedura dhe praktika doganore te permendura ne kete Konvente.

“Udhezimet” do te thote teresia e shpjegimeve te dispozitave te aneksit te pergjithshem, aneksit te veçante dhe kapitujve te perfshire ketu, te cilet tregojne disa nga rruget e mundshme te veprimit, per t’u ndjekur ne zbatim te standardeve, standardeve te perkohshme dhe praktikave te rekomanduara, dhe ne veçanti qe pershkruajne praktikat me te mira dhe rekomandojne shembuj per lehtesira sa me te medha.

“Komitet i perhershëm teknik” do te thote komiteti i perhershëm teknik i keshillit.

“Keshill” do te thote organizata e ngritur nga Konventa qe krijon nje keshill te bashkepunimit doganor, bere ne Bruksel, me 15 dhjetor 1950.

“Bashkim doganor ose ekonomik” do te thote nje bashkim i formuar nga, dhe i perbere prej shteteve, i cili ka autoritetin te miratoje rregulloret e tij, qe jane te detyrueshme per keto shtete, ne lidhje me çeshtjet e trajtuara nga kjo Konvente, dhe ka autoritetin te vendose, te

nenshkruaje, te ratifikoje ose te miratoje kete Konvente, ne perputhje me procedurat e brendshme.

KAPITULLI II OBJEKTI DHE STRUKTURA

Objekti i Konventes Neni 2

Secila pale kontraktuese merr persiper te nxise thjeshtimin dhe harmonizimin e procedurave doganore dhe per kete qellim, te respektojte standardet ne perputhje me dispozitat e kesaj Konvente, standardet e perkohshme dhe praktikat e rekomanduara ne anekset e kesaj Konvente. Megjithate, asgje nuk e pengon nje pale kontraktuese nga ofrimi i lehtesirave me te medha se ato te parashikuara ketu, dhe secila pale kontraktuese rekomandohet te jape sa me shume lehtesira te tilla qe te jete e mundur.

Neni 3

Dispozitat e kesaj Konvente nuk perjashtojne zbatimin e legjislacionit kombetar ne lidhje me ndalimet ose kufizimet mbi mallrat qe u nenshtrohen kontrollit doganor.

Struktura e Konventes Neni 4

Konventa perfshin nje pjese kryesore, nje aneks te pergjithshem dhe anekset e veçanta. Aneksi i pergjithshem dhe secili aneks i veçante i kesaj Konvente perbehet, ne parim, prej kapitujve, te cilet nendajne nje aneks dhe perfshijne: perkufizimet; dhe standardet, disa prej te cilave ne aneksin e pergjithshem jane standarde te perkohshme.

Secili aneks i veçante, gjithashtu perbehet nga praktikat rekomanduese. Çdo aneks eshte i shoqeruar nga udhezime, tekstet e te cilave nuk jane te detyrueshme per palet kontraktuese.

Neni 5

Per qellimet e kesaj Konvente, çdo aneks(e) i veçante ose kapitull(j) qe eshte i detyrueshem per nje pale kontraktuese konsiderohet pjese perberese e Konventes, dhe per ate pale kontraktuese, çdo reference ne Konvente do te konsideroje te perfshire dhe referencen per kete aneks(et) ose kapitullin(jt).

KAPITULLI III MENAXHIMI I KONVENTES

Komiteti drejtues Neni 6

Nje komitet drejtues duhet te ngrihet per te marre ne konsiderate zbatimin e kesaj Konvente, çdo mase per te siguruar njetrajtshmeri ne interpretimin dhe zbatimin e saj, dhe çdo amendament te propozuar per te.

Palet kontraktuese duhet te jene anetare te komitetit drejtues.

Administrata kompetente e çdo organi te kualifikuar per t'u bere pale kontraktuese ne kete Konvente sipas dispozitave te nenit 8 ose te çdo anetari te organizates boterore te tregtise ka te drejte te marre pjese si vezhgues ne seancat e komitetit drejtues. Statusi dhe te drejtat e

ketyre vezhguesve do te percaktohen me vendim te keshillit. Te drejtat e mesiperme nuk mund te ushtrohen para hyrjes ne fuqi te vendimit.

Komiteti drejtues mund te ftoje perfaqesues te organizatave nderkombetare qeveritare dhe joqeveritare per te marre pjese ne seancat e komitetit drejtues si vezhgues.

Komiteti drejtues:

a) do t'i rekomandoje paleve kontraktuese:

i) amendime per pjesen kryesore te kesaj Konvente; ii) amendime per aneksin e pergjithshem, anekset e veçanta dhe kapitujt e meposhtem dhe perfshirjen e kapitujve te rinj per aneksin e pergjithshem; dhe

iii) perfshirjen e anekseve te reja te veçanta dhe kapitujve te rinj ne anekset e veçanta; mund te vendose te amendoje praktikat e rekomanduara ose te perfshije praktika te reja rekomanduese ne anekset e veçanta ose ne kapitujt e meposhtem ne perputhje me nenin 16; do te shqyrtoje zbatimin e dispozitave te kesaj Konvente ne perputhje me nenin 13, paragrafi 4;

do te rishikojte dhe perditesojte udhezimet;

do te shqyrtoje çdo çeshtje te lidhur me kete Konvente qe mund t'i jete referuar;

do te informojte komitetin e perhershem teknik dhe keshillin per vendimet e tij.

Administrata kompetente e paleve kontraktuese do t'i komunikojte propozimet sekretarit te pergjithshem te keshillit, sipas paragrafeve 5 (a), (b), (c) ose (d) te ketij neni, si dhe arsyet se bashku me çdo kerkese per perfshirjen e çeshtjeve ne agjenden e seancave te komitetit drejtues. Sekretari i pergjithshem i keshillit do te sjelle propozimet ne vemendje te administratave kompetente te paleve kontraktuese dhe te vezhguesve te permendur ne paragrafet 2, 3 dhe 4 te ketij neni.

Komiteti drejtues do te mblidhet te pakten nje here ne vit. Do te zgjedhe çdo vit nje kryetar dhe nenkryetar. Sekretari i pergjithshem i keshillit do te shperndaje ftesen dhe projektajندن per administratat kompetente te paleve kontraktuese dhe per vezhguesit e permendur ne paragrafet 2, 3 dhe 4 te ketij neni te pakten gjashte jave perpara se te mblidhet komiteti drejtues.

Kur nje vendim nuk arrihet me marreveshje, çeshtjet duhet te vendosen nga votimi i paleve kontraktuese te pranishme, perpara komitetit drejtues. Propozimet sipas paragrafeve 5(a), (b) ose (c) te ketij neni duhet te miratohen me shumicen e dy te tretave te votave. Te gjitha çeshtjet e tjera duhet te vendosen nga komiteti drejtues me shumice votash.

Kur zbatohet neni 8, paragrafi 5 i kesaj konvente, bashkimet doganore ose ekonomike te cilat jane palet kontraktuese, ne rast votimi, duhet te kene vetem nje numer votash te barabarte me totalin e votave te caktuara per anetaret e tyre, qe jane pale kontraktuese.

Para mbylljes se sesionit te tij, Komiteti Drejtues do te miratoje nje raport. Ky raport duhet t'i percillet keshillit dhe paleve kontraktuese dhe vezhguesve te permendur ne paragrafet 2, 3 dhe 4.

Rregullat e procedurave te keshillit do te zbatohen, ne mungese te dispozitave perkatese ne kete nen, nese komiteti drejtues nuk vendos ndryshe.

Neni 7

Per qellim te votimit ne komitetin drejtues, duhet te kete nje votim te veçante per secilin aneks te veçante dhe per secilin kapitull te nje aneksi te veçante.

Çdo pale kontraktuese ka te drejte te votoje mbi çeshtje qe lidhen me interpretimin, zbatimin ose amendimin e pjeses kryesore dhe aneksit te pergjithshem te konventes.

Per sa u perket çeshtjeve ne lidhje me nje aneks te veçante apo me nje kapitull te nje aneksi te veçante qe tashme eshte ne fuqi, vetem ato pale kontraktuese qe kane pranuar ate aneks te veçante ose kapitullin brenda tij, kane te drejte te votojne.

Çdo pale kontraktuese gezon te drejten te votoje per draftet e anekseve te veçanta ose per kapitujt e rinj te nje aneksi te veçante.

KAPITULLI IV PALA KONTRAKTUESE

Ratifikimi i Konventes Neni 8

1. Çdo anetar i keshillit dhe çdo anetar i Kombeve të Bashkuara ose agjencive të veçanta të saj mund të bëhet pale kontraktuese e kësaj Konvente: duke nënshkruar atë pa rezerve ratifikimi; nga depozitimi i një instrumenti për ratifikim, i cili pas nënshkrimit i nënshtrohet ratifikimit; ose duke aderuar në të.

Kjo Konvente do të jetë e hapur për nënshkrim deri më 30 qershor 1974, në zyrtarë qëndrore të keshillit në Bruksel nga anëtarët e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni. Me pas do të jetë e hapur për aderim nga këta anëtarë.

Çdo pale kontraktuese, në kohën e nënshkrimit, ratifikimit ose aderimit të kësaj Konvente, duhet të specifikojë se cilat prej anekseve të veçanta ose kapitujve në të ka pranuar, nëse ka pranuar ndonjë prej tyre. Me pas mund të njoftojë depozitarin, që pranon një ose më shumë anekse të veçanta ose kapitujve në të.

Palet kontraktuese që pranojnë ndonjë aneks të ri të veçantë ose kapitull të ri të një aneksi të veçantë duhet të njoftojë depozituesin në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni.

a) Çdo bashkim doganor ose ekonomik, në përputhje me paragrafet 1, 2 dhe 3 të këtij neni, mund të bëhet një pale kontraktuese e kësaj Konvente. Një bashkim i tillë doganor ose ekonomik duhet të informojë depozitarin për kompetencat e tij në lidhje me çështjet e trajtuara nga kjo Konvente. Ky bashkim doganor ose ekonomik duhet të njoftojë gjithashtu depozitarin për çdo modifikim kryesor për atë që i përket autoritetit të tij.

b) Një bashkim doganor apo ekonomik që është pale kontraktuese e kësaj Konvente, për çështje brenda kompetencave të tij, duhet të ushtrojë në emër të tij të drejtat dhe të përmbushë përgjegjësitë, të cilat Konventa u jep anëtarëve të bashkimit, që janë pale kontraktuese të kësaj Konvente. Në këto raste, anëtarët e një bashkimi të tillë nuk kanë të drejtë të ushtrojnë individualisht këto të drejta, përfitime të drejtën për të votuar.

Neni 9

Çdo pale kontraktuese e cila ratifikon këto Konvente ose aderon në të, duhet të përmbushë detyrimet që i jep çdo amendim i kësaj Konvente, përfitime aneksin e përgjithshëm, i cili ka hyrë në fuqi në datën e depozitimit të instrumentit të ratifikimit ose aderimit.

Çdo pale kontraktuese e cila pranon një aneks të veçantë ose ndonjë kapitull brenda tij duhet të përmbushë detyrimet që i jep çdo ndryshim i standardeve të përfshira në atë aneks të veçantë ose kapitull, që kanë hyrë në fuqi në datën kur depozitari njoftohet për pranimin e saj. Çdo pale kontraktuese e cila pranon një aneks të veçantë ose kapitull të tij, duhet të përmbushë detyrimet që i jep çdo ndryshim në praktikën e rekomanduarë të përfshira aty, të cilat kanë hyrë në fuqi në datën kur depozitari njoftohet për pranimin e saj, përveç kur ka vërejtje ndaj një ose më shumë praktikave të rekomanduarë në përputhje me nenin 12 të kësaj Konvente.

Zbatimi i Konventes Neni 10

1. Çdo pale kontraktuese, në kohën e nënshkrimit të kësaj Konvente pa vërejtje ndaj ratifikimit ose depozitimit të instrumentit të ratifikimit të saj apo aderimit ose në çdo rast tjetër të mëvonshëm, mund të deklarojë nëpërmjet njoftimit që i është dhënë depozitarit, se kjo Konvente do të shtrihet në të gjithë ose në ndonjë nga territoret për të cilat ai është

pergjegjes per marredheniet nderkombetare. Ky njoftim do te hyje ne fuqi tre muaj pas marrjes se tij nga depozitari. Megjithate, kjo Konvente nuk do te zbatohet ne territoret e permendura ne njoftim para se kjo Konvente te hyje ne fuqi per palen kontraktuese ne fjale.

2. Çdo pale kontraktuese qe ka bere nje njoftim sipas paragrafit 1 te ketij neni duke e shtrire kete Konvente ne çdo territor per marredheniet nderkombetare te te cilit eshte pergjegjes, mund te njoftoje depozitarin sipas procedurave te nenit 19 te kesaj Konvente, se territori ne fjale nuk do te zbatohet me kete Konvente.

Neni 11

Per zbatimin e kesaj Konvente, nje bashkim doganor ose ekonomik qe eshte nje pale kontraktuese do te njoftoje sekretarin e pergjithshem te keshillit te territoreve qe formojne bashkimin doganor ose ekonomik, dhe keto territore do te merren si nje territor i vetem.

Pranimi i dispozitave dhe rezervave

Neni 12

Me ane te kesaj Konvente, te gjitha palet kontraktuese jane te lidhura nga aneksi i pergjithshem.

Nje pale kontraktuese mund te pranoje nje ose me shume anekse te veçanta apo nje ose me shume kapituj aty. Nje pale kontraktuese e cila pranon nje aneks te veçante apo nje kapitull(j) aty, do te jete e detyruar nga te gjitha standardet ne te. Nje pale kontraktuese e cila pranon nje aneks te veçante apo ndonje kapitull(j) aty do te jete e detyruar nga te gjitha praktiket e rekomanduara ne te, vetem nese ne kohen e pranimi ose ne çdo kohe te mevonshme, njofton depozitarin per praktiken(at) e rekomanduar(a) per te cilen ka verejtje, duke shprehur ndryshimet qe ekzistojne midis dispozitave te legjislacionit te tij kombetar dhe atyre te praktikave(ave) perkatese te rekomanduar(a). Çdo pale kontraktuese e cila ka shprehur verejtje mund t'i terheqe ato, te gjitha ose pjeserisht ne çdo kohe duke e njoftuar depozitarin dhe duke specifikuar daten ne te cilen kjo terheqje hyn ne fuqi.

Secila pale kontraktuese, e detyruar nga nje aneks i veçante ose kapitull(j) aty, do te shqyrtoje mundesine e terheqjes se ndonje rezerve per praktiket e rekomanduara te shprehura sipas kushteve te paragrafit 2 dhe do te njoftoje sekretarin e pergjithshem te keshillit per rezultatet e ketij shqyrtimi ne fund te çdo periudhe trevjeçare, duke filluar nga data e hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente per ate pale kontraktuese, duke specifikuar dispozitat e legjislacionit te saj kombetar qe sipas mendimit te saj, jane ne kundërshtim me terheqjen e rezervave.

Zbatimi i dispozitave

Neni 13

Çdo pale kontraktuese duhet te zbatohet standardet e aneksit te pergjithshem dhe te aneksit(ve) te veçante(a) ose kapitullit(ve) aty, qe ka pranuar brenda 36 muajve pasi ky aneks(e) ose kapitull(j) te kene hyre ne fuqi per ate pale kontraktuese.

Çdo pale kontraktuese duhet te zbatohet standardet e perkohshme ne aneksin e pergjithshem brenda 60 muajve nga data kur aneksi i pergjithshem ka hyre ne fuqi per ate pale kontraktuese.

Çdo pale kontraktuese duhet te zbatohet praktiket e rekomanduara ne aneksin(et) e veçanta ose kapitullin(j) aty, qe ajo ka pranuar brenda 36 muajve pasi ky aneks(e) ose kapitull(j) ka hyre ne fuqi per ate pale kontraktuese, perveçse kur jane bere verejtje per nje ose me shume praktika rekomanduese.

a) Kur periudhat e parashikuara ne paragrafin 1 ose 2 te ketij neni, ne praktike, mund te jene te pamjaftueshme, per ndonje pale kontraktuese per te zbatuar dispozitat e aneksit te pergjithshem, kjo pale kontraktuese mund t'i kerkoje komitetit drejtues, t'i jape nje zgjatje te kesaj periudhe, perpara perfundimit te periudhes se permendur ne paragrafin 1 ose 2 te ketij neni. Gjate berjes se kerkeses, pala kontraktuese duhet te shprehe dispoziten(at) e aneksit te

pergjithshem ne lidhje me te cilen nje zgjatje e kesaj periudhe eshte kerkuar dhe arsyet e nje kerkese te tille.

b) Ne kushte te jashtezakonshme, komiteti drejtues mund te vendose te miratoje nje shtyrje te tille. Çdo vendim nga komiteti drejtues qe miraton nje shtyrje te tille duhet te shprehe kushtet e jashtezakonshme duke justifikuar vendimin dhe shtyrja ne asnje rast nuk duhet te jete me shume se 1 vit. Me mbarimin e periudhes se shtyre, pala kontraktuese duhet te njoftoje depozituesin per zbatimin e dispozitave per te cilat eshte dhene shtyrja.

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Neni 14

Çdo mosmarreveshje ndermjet dy ose me shume paleve kontraktuese ne lidhje me interpretimin ose zbatimin e kesaj Konvente, per sa eshte e mundur duhet te zgjidhet me bisedime midis tyre.

Çdo mosmarreveshje qe nuk zgjidhet me negociata do t'i referohet, nga palet kontraktuese ne mosmarreveshje, komitetit drejtues, i cili duhet te marre parasysh mosmarreveshjen dhe te beje rekomandime per zgjidhjen e saj.

Palet kontraktuese ne konflikt mund te bien dakord paraprakisht per te pranuar rekomandimet e komitetit drejtues si te detyrueshme.

Amendamentet e Konventes

Neni 15

Teksti i çdo amendimi rekomanduar paleve kontraktuese nga komiteti drejtues ne perputhje me nenin 6, paragrafi 5 (a) (i) dhe (ii) do t'u komunikohet te gjitha paleve kontraktuese dhe atyre anetareve te keshillit qe nuk jane pale kontraktuese, nga sekretari i pergjithshem i keshillit.

Amendimet ne pjesen kryesore (ne tekstin) e Konventes do te hyjne ne fuqi per te gjitha palet kontraktuese dymbedhete muaj pas depozitimit te instrumenteve te pranimit nga keto pale kontraktuese te pranishme ne seancen e komitetit drejtues, gjate se ciles u rekomanduan amendimet, me kusht qe asnje kundershtim te mos jete depozituar nga ndonje pale kontraktuese brenda nje periudhe prej dymbedhete muajsh nga data e komunikimit te ketyre amendamenteve.

Çdo amendim i rekomanduar per aneksin e pergjithshem ose per anekset e veçanta ose per kapitujt ne te, do te konsiderohen si te pranuar gjashte muaj pas dates kur amendimet e rekomanduara u jane komunikuar paleve kontraktuese, perveç kur:

ka pasur nje kundershtim nga nje pale kontraktuese ose, ne rastin e nje aneksi te veçante apo kapitulli, nga nje pale kontraktuese me detyrime ndaj ketij aneksi te veçante apo kapitulli; ose nje pale kontraktuese njofton sekretarin e pergjithshem te keshillit se, megjithese do te pranoje ndryshimin e rekomanduar, kushtet e nevojshme per kete pranim nuk jane permbushur ende.

Nese nje pale kontraktuese i dergon sekretarit te pergjithshem te keshillit nje komunikim, siç parashikohet ne paragrafin 3 (b) te ketij neni, nese nuk ka njoftuar sekretarin e pergjithshem te keshillit per pranimin e amendamentit te rekomanduar, mund te paraqese nje kundershtim per kete amendament brenda nje periudhe prej tetembedhete muajsh pas perfundimit te periudhes gjashtemujore te permendur ne paragrafin 3 te ketij neni.

Nese nje kundershtim per amendamentin e rekomanduar njoftohet ne perputhje me kushtet e paragrafit 3 (a) ose 4 te ketij neni, amendamenti do te konsiderohet i papranuar dhe nuk ka asnje fuqi.

Nese ndonje pale kontraktuese ka derguar nje komunikim ne perputhje me paragrafin 3 (b) te ketij neni, amendamenti do te konsiderohet te jete pranuar me pare se dy datat e meposhtme: dates prej se ciles te gjitha palet kontraktuese, qe kane derguar keto njoftime, kane njoftuar sekretarin e pergjithshem te keshillit se kane pranuar ndryshimin e rekomanduar, me kusht qe nese te gjitha pranimet jane njoftuar perpara perfundimit te periudhes gjashtemujore te

permendur ne paragrafin 3 te ketij neni, kjo date do te merret si data e perfundimit te periudhes gjashtemujore ne fjale;

data e mbarimit te periudhes tetembedhjetemujore te permendur ne paragrafin 4 te ketij neni.

7. Çdo amendament i aneksit te pergjithshem ose anekseve te veçanta ose kapitujve aty, I konsideruar per t'u pranuar, do te hyje ne fuqi ose gjashte muaj pas dates ne te cilen ishte vendosur per t'u pranuar ose nese nje periudhe tjeter eshte specifikuar ne amendamentin e rekomanduar, ne perfundim te asaj periudhe pas dates ne te cilen amendamenti ishte vendosur per t'u pranuar.

8. Sekretari i pergjithshem i keshillit duhet, sa me shpejt qe te jete e mundur, te njoftoje palet kontraktuese te kesaj Konvente per çdo kundersiztim ndaj amendamentit te rekomanduar, te bere ne perputhje me paragrafin 3 (a) dhe çdo komunikimi te marre ne perputhje me paragrafin 3 (b) te ketij neni. Me pas, sekretari i pergjithshem i keshillit duhet te informoje palet kontraktuese nese pala ose palet kontraktuese qe kane derguar kete komunikim kane kundersiztim ndaj amendamentit te rekomanduar ose nese e pranojne ate.

Neni 16

Pavaresisht procedures se amendimit te percaktuar ne nenin 15 te kesaj Konvente, komiteti drejtues, ne perputhje me nenin 6, mund te vendose te ndryshoje çdo praktike te rekomanduar ose te perfshije praktika te reja te rekomanduara ne ndonje aneks te veçante ose ne kapitullin aty. Sekretari i pergjithshem i keshillit duhet te ftojë secilen pale kontraktuese per te marre pjese ne diskutimet e komitetit drejtues. Teksti i ndonje amendamenti te tille ose praktikave te reja te rekomanduara te rena dakord duhet t'u komunikohet paleve kontraktuese dhe atyre anetareve te keshillit qe nuk jane pale kontraktuese te kesaj Konvente, nga sekretari i pergjithshem i keshillit.

Çdo amendament apo perfshirje e praktikave te reja te rekomanduara te rena dakord sipas paragrafit 1 te ketij neni, duhet te hyjne ne fuqi gjashte muaj pas komunikimit te tyre nga sekretari i pergjithshem i keshillit. Secila pale kontraktuese e detyruar nga nje aneks i veçante ose kapitull aty, qe perben lenden e ketyre amendamenteve apo perfshirjes te praktikave te reja te rekomanduara do te konsiderohen sikur te kene pranuar keto amendamente apo praktika te reja te rekomanduara, perveçse kur shpreh verejtje sipas procedures te nenit 12 te kesaj Konvente.

Kohezgjatja e aderimit

Neni 17

Kjo Konvente ka nje kohezgjatje te pakufizuar por çdo pale kontraktuese mund ta shpalle te pavlefshem ate ne çdo kohe pas dates se hyrjes ne fuqi, sipas nenit 18.

Shpallja e pavlefshme do te njoftohet me shkrim me nje instrument te depozituar te depozitari.

Shpallja e pavlefshme do te hyje ne fuqi gjashte muaj pas marrjes se instrumentit te shpalljes se pavlefshme nga depozitari.

Dispozitat e paragrafeve 2 dhe 3 te ketij neni do te zbatohen gjithashtu per sa u perket anekseve te veçanta dhe kapitujve aty, per te cilat çdo pale kontraktuese mund te terheq pranimin e saj ne çdo kohe nga data kur ka hyre ne fuqi.

Çdo pale kontraktuese qe terheq pranimin qe ajo i ka bere aneksit te pergjithshem do te konsiderohet sikur ka shpallur te pavlefshem Konventen. Ne kete rast do te zbatohen gjithashtu dispozitat e paragrafeve 2 dhe 3.

KAPITULLI V DISPOZITAT PERFUNDIMTARE

Hyrja ne fuqi e Konventes

Neni 18

Kjo Konvente do te hyje ne fuqi tre muaj pasi pese nga subjektet e permendura ne paragrafet 1 dhe 5 te nenit 8 kane nenshkruar Konventen pa ndonje rezerve ratifikimi ose kane depozituar instrumentet e tyre te ratifikimit ose aderimit.

Kjo Konvente do te hyje ne fuqi per çdo pale kontraktuese tre muaj pasi eshte bere pale kontraktuese ne perputhje me dispozitat e nenit 8.

Çdo aneks i veçante ose kapitull i kesaj konvente do te hyje ne fuqi tre muaj pasi pese pale kontraktuese te kene pranuar ate aneks te veçante apo ate kapitull.

Pas hyrjes ne fuqi te ndonje aneksi te veçante apo kapitulli aty ne perputhje me paragrafin 3 te ketij neni, ai aneks i veçante apo kapitull aty do te hyje ne fuqi per çdo pale kontraktuese tre muaj pasi kjo e fundit te kete njoftuar pranimin e tyre. Megjithate, asnje aneks i veçante apo kapitull aty nuk do te hyje ne fuqi per nje pale kontraktuese para se kjo Konvente te kete hyre ne fuqi per ate pale kontraktuese.

Depozitari i Konventes Neni 19

Kjo Konvente, te gjitha firmat me ose pa rezervat e ratifikimit dhe te gjitha instrumentet e ratifikimit apo aderimit do te depozitohen te sekretari i pergjithshem i keshillit.

Depozitari:

do te marre dhe ruaje tekstet origjinale te kesaj Konvente;

do te pergatise kopje te vertetuara te teksteve origjinale te kesaj Konvente dhe do t'ua transmetoje ato paleve kontraktuese dhe atyre anetareve te keshillit qe nuk jane pale kontraktuese dhe sekretarit te pergjithshem te kombeve te bashkuara;

do te marre çdo firme me ose pa rezervat e ratifikimit, ratifikimin apo aderimin ne kete Konvente dhe do te marre e ruaje çdo instrument, njoftime dhe komunikime ne lidhje me to;

do te shqyrtoje nese nenshkrimi i ndonje instrumenti, njoftimi apo komunikimi ne lidhje me kete Konvente eshte ne kohen dhe formen e duhur dhe nese eshte e nevojshme, ta sjelle kete çeshtje ne vemendje te pales kontraktuese ne fjale;

do te njoftoje palet kontraktuese, ata anetare te keshillit qe nuk jane pale kontraktuese, dhe sekretarin e pergjithshem te kombeve te bashkuara per:

nenshkrimet, ratifikimet, aderimet dhe pranimet e anekseve dhe kapitujve sipas nenit 8 te kesaj Konvente;

kapitujt e rinj te aneksit te pergjithshem dhe per anekset e veçanta ose kapitujt aty, te cilat komiteti drejtues vendos t'i rekomandoje qe te perfshihen ne kete Konvente;

daten e hyrjes ne fuqi te kesaj Konvente, te aneksit te pergjithshem dhe te secilit aneks te veçante apo kapitulli aty, ne perputhje me nenin 18 te kesaj Konvente;

njoftimet e marra ne perputhje me nenet 8, 10, 11, 12 dhe 13 te kesaj Konvente;

terheqjet e pranimeve te anekseve/kapitujve nga palet kontraktuese;

shpalljet e pavlefshme sipas nenit 17 te kesaj Konvente; dhe

çdo amendamenti te pranuar ne perputhje me nenin 15 te kesaj Konvente dhe per daten e hyrjes ne fuqi.

Ne rast te ndonje konflikti qe lind midis nje pale kontraktuese dhe depozitarit ne lidhje me kryerjen e funksioneve te ketij te fundit, depozitari ose ajo pale kontraktuese do ta sjelle çeshtjen ne vemendje te paleve te tjera kontraktuese dhe atyre qe e kane nenshkruar ose sipas rastit, ne vemendje te komitetit drejtues ose keshillit.

Regjistrimi dhe tekstet origjinale
Neni 20

Ne perputhje me nenin 102 te Kartes se Kombeve te Bashkuara, kjo Konvente do te regjistrohet te sekretariati i Kombeve te Bashkuara, me kerkese te sekretarit te pergjithshem te keshillit.

Ne deshmi te kesaj nenshkruessit, te autorizuar siç duhet, kane nenshkruar kete Konvente. Bere ne Kyoto, me 18 maj 1973 ne gjuhet angleze dhe franceze, ku te dyja tekstet jane njelloj autentike, ne nje origjinal te vetem qe do te depozitohet te sekretari i pergjithshem i keshillit, i cili do t'u shperndaje kopje te vertetuara te gjitha subjekteve te permendura ne paragrafin 1 te nenit 8 te kesaj Konvente.

ANEKS I PERGJITHSHEM

KAPITULLI 1

PARIME TE PERGJITHSHEME

1.1. Standard

Perkufizimet, standardet dhe standardet e perkohshme ne kete aneks do te zbatohen per procedurat dhe praktikat doganore te specifikuara ne kete aneks dhe ne masen qe jane te zbatueshme, per procedura dhe praktika ne anekse specifike.

1.2. Standard

Kushtet per t'u permbushur dhe formalitetet doganore per t'u permbushur per procedurat dhe praktikat ne kete aneks dhe ne anekset specifike duhet te specifikohen ne legjislacionin kombetar dhe te jene sa me te thjeshta te jete e mundur.

1.3. Standard

Doganat duhet te ndertojne dhe te ruajne marredhenie formale konsultative me tregtine per te rritur bashkepunimin dhe per te lehtesuar pjesemarrjen ne percaktimin e metodave me efektive te punes ne perputhje me dispozitat kombetare dhe marreveshjet nderkombetare.

KAPITULLI 2

PERKUFIZIMET

Per qellime te anekseve te kesaj Konvente:

E1./ "Apelim" nenkuptohet akti me ane te te cilit nje person, qe eshte ndikuar drejtperdrejt nga nje F23. vendim ose mosveprim i doganave dhe e konsideron veten te demtuar nga kjo, kerkon korrigjim perpara nje autoriteti kompetent.

E2./ "Vleresim i detyrimeve dhe taksave" nenkupton percaktimin e shumes se detyrimeve dhe F19. taksave te pagueshme.

E3./ "Kontroll me baze auditi" nenkupton masat me ane te te cilave doganat binden per saktesine

F4. dhe vertetesine e deklarimeve nepermjet shqyrtimit te librave perkates, regjistrimeve, sistemeve te biznesit dhe te dhenat tregtare te mbajtura nga personat e interesuar.

E4./ "Verifikim i deklarimit te mallrave" nenkupton veprimin e marre nga doganat per t'u bindur se F15. deklarimi i mallrave eshte bere ne menyre te sakte dhe qe dokumentet mbeshtetese te kerkuara plotesojne kushtet e paracaktuara.

E5./ "Zhdoganim" nenkupton plotesimin e formaliteteve doganore te nevojshme per te lejuar mallrat F9. per te hyre ne perdorim ne vend, per t'u eksportuar ose per t'u vendosur nen nje procedure tjeter doganore.

E6./ “Dogana” nenkupton sherbimin shteteror i cili eshte pergjegjes per administrimin e ligjit F10. doganor dhe mbledhjen e detyrimeve dhe taksave dhe e cila eshte gjithashtu pergjegjese per zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve te tjera mbi importimin, eksportimin, levizjen apo magazinimin e mallrave.

E7./ “Kontroll doganor” nenkupton masat e zbatuara nga doganat per te garantuar perputhjen me F3. ligjin doganor.

E8./ “Detyrime doganore” nenkupton detyrimet e percaktuara nga tarifa doganore per te cilat mallrat F11. jane pergjegjese per te hyre apo per te lene territorin doganor.

E9./ “Formalite te doganore” nenkupton te gjitha operacionet te cilat duhet te kryhen nga personat e F16. interesuar dhe nga doganat per t’u perputhur me ligjin doganor.

E10./ “Ligj doganor” nenkupton dispozitat e parashikuara me ligj dhe rregulloret ne lidhje me F18. importimin, eksportimin, levizjen apo magazinimin e mallrave, administrimi dhe ligjzbatimin i te cilave u ngarkohen veçanerisht doganave, si edhe çdo rregullore te bere nga doganat nen kompetencat e tyre me ligj.

E11./ “Zyre doganore” nenkupton njesine administrative doganore kompetente per permbushjen e F2. formaliteve doganore, si dhe ambientet apo zonat e tjera te miratuara per kete qellim nga autoritetet kompetente.

E12./ “Territor doganor” nenkupton territorin ne te cilin zbatohet ligji doganor i nje pale F25. kontraktuese.

E13./ “Vendim” nenkupton aktin individual me ane te te cilit dogana vendos per nje çeshtje ne lidhje F6. me ligjin doganor.

E14./ “Deklarues” nenkupton çdo person qe ben nje deklarim mallrash ose ne emer te te cilit behet F7. nje deklarim i tille.

E15./ “Date e caktuar” nenkupton daten e caktuar per pagimin e detyrimeve dhe taksave te F5. kerkueshme.

E16./ “Detyrime dhe taksa” nenkupton detyrimet dhe taksat e importit dhe/ose detyrimet dhe taksat e F12. eksportit.

E17./ “Shqyrtimi i mallrave” nenkupton inspektimin fizik te mallrave nga doganat per t’u bindur se F27. natyra, origjina, kushtet, sasia dhe vlera e mallrave jane ne perputhje me hollesirat e dhena ne deklarimin e mallrave.

E18./ “Detyrime dhe taksa eksporti” nenkupton detyrimet doganore dhe te gjitha detyrimet e tjera, F13. taksat apo pagesat, te cilat mblidhen gjate ose ne lidhje me eksportimin e mallrave, por duke mos perfshire detyrime te tjera te cilat kufizohen ne shume me shpenzimet e peraferta te sherbimeve te dhena ose te mbledhura nga doganat ne interes te nje autoriteti tjeter kombetar.

E19./ “Deklarim i mallrave” nenkupton nje deklarate te bere ne menyren e paracaktuar nga Doganat, F8. me ane te se ciles personat e interesuar i tregojne doganave proceduren qe zbatohet per mallrat dhe jep hollesirat qe kerkohen nga doganat per zbatimin e saj.

E20./ “Detyrime dhe taksa importi” nenkupton detyrimet doganore dhe te gjitha detyrimet e tjera, F14. taksat apo pagesat, te cilat mblidhen gjate ose ne lidhje me importimin e mallrave, por duke mos perfshire detyrime te tjera te cilat kufizohen ne shume me shpenzimet e peraferta te sherbimeve te dhena ose te mbledhura nga doganat ne interes te nje autoriteti tjeter kombetar.

E21./ “Ndhime e ndersjelle administrative” nenkupton veprimet ne interes te nje administrate F1. doganore ose veprimet ne bashkepunim me nje administrate tjeter per zbatimin e duhur te ligjit doganor dhe per parandalimin, hetimin dhe shtypjen e krimeve doganore.

E22./ “Mosveprim” nenkupton deshtimin per te vepruar ose per te dhene nje vendim te kerkuar nga F21. doganat sipas ligjit doganor brenda nje afati kohor te arsyeshem per nje çeshtje te paraqitur siç duhet tek ato.

E23./ “Person” nenkupton si personat fizike edhe juridike, pervec kur kerkohet ndryshe nga F22. konteksti.

E24./ “Çlirim i mallrave” nenkupton veprimin nga doganat per te lejuar mallrat qe kalojne F20. zhdoganimin qe te vendosen ne dispozicion te personave te interesuar.

E25./ “Shlyerje” nenkupton rimbursimin, te plote ose pjeserisht te detyrimeve dhe taksave te paguara F24. per mallrat dhe faljen, te plote ose te pjesshme, te detyrimeve dhe taksave kur nuk eshte bere pagesa.

E26./ “Garanci” nenkupton ate e cila garanton doganat se detyrimi ndaj tyre eshte permbushur. F17. Garancia pershkruhet si “e pergjithshme” kur ajo garanton qe do te permbushen te gjitha detyrimet qe lindin nga disa operacione.

E27./ “Pale e trete” nenkupton çdo person qe merret drejtperdrejt me doganat, per dhe ne interes te F26. nje personi tjetër, ne lidhje me importimin, eksportimin, levizjen dhe magazinimin e mallrave.

KAPITULLI 3 ZHDOGANIMI DHE FORMALITETET E TJERA DOGANORE

Zyrat doganore kompetente

Standard

Doganat caktojne zyrat doganore tek te cilat mallrat mund te prodhohen ose zhdoganohen. Ne percaktimin e kompetencave dhe vendndodhjen e ketyre zyrave dhe oret e tyre te punes, faktoret qe do te merren ne konsiderate duhet te perfshijne ne veçanti kerkesat e tregtise.

Standard

Me kerkese te personit te interesuar dhe per arsye te konsideruara te vlefshme nga doganat, kjo e fundit, ne varesi te burimeve ne dispozicion, kryen funksionet e percaktuara per qellime te nje procedure dhe praktike doganore jashte oreve te punes ose larg zyrave doganore. Çdo shpenzim i ngarkuar nga doganat duhet te kufizohet me koston e perafert te sherbimeve te dhena.

Standard

Kur zyrat doganore jane ne nje pike kalimi te perbashket kufitar, administratat doganore ne fjale duhet te bashkerendojne oret e punes dhe kompetencat e ketyre zyrave.

Standard i perkohshem

Ne pika kalimi te perbashketa kufitare, administratat doganore ne fjale, kurdohere qe eshte e mundur, kryejne kontrolle te perbashketa.

Standard i perkohshem

Kur doganat kane si qellim te caktojne nje zyre te re doganore ose te kthejne nje zyre ekzistuese ne nje pike kalimi te perbashket kufitar, ato, kurdohere qe eshte e mundur, duhet te bashkepunojne me doganat fqinje per te caktuar nje zyre doganore te perbashket per te lehtesuar kontrollet e perbashketa.

Deklaruesi

a) Personat qe kane te drejte te veprojne si deklarues

3.6. Standard

Legjislacioni kombetar specifikon kushtet nen te cilat nje person ka te drejte te veproje si deklarues.

3.7. Standard

Çdo person qe ka te drejten e disponimit te mallrave ka te drejte te veproje si nje deklarues.

b) Pergjegjesite e deklaruesit

3.8. Standard

Deklaruesi eshte pergjegjes para doganave per saktesine e hollesirave te dhena ne deklarimin e mallrave dhe per pagimin e detyrimeve dhe taksave.

c) Te drejtat e deklaruesit

3.9. Standard

Perpara depozitimit te deklarimit te mallrave, deklaruesi lejohet, sipas kushteve te percaktuara nga doganat: te inspektoje mallrat; dhe

te marre mostra.

3.10. Standard

Doganat nuk duhet te kerkojne nje deklarim mallrash te veçante per sa u perket mostrave te marra nen mbikeqyrje doganore, me kusht qe mostra te tilla te perfshihen ne deklarimin e mallrave ne lidhje me ngarkesen perkatese.

Deklarimi i mallrave

a) Formati dhe permbajtja e deklarimit te mallrave

3.11. Standard

Permbajtja e deklarimit te mallrave duhet te paracaktohet nga doganat. Formati ne leter i deklarimit te mallrave duhet te jete ne perputhje me modelin e OKB-se.

Per procese te automatizuara te zhdoganimeve doganore, formati elektronik i depozituar i deklarimit te mallrave duhet te mbeshtetet ne standardet nderkombetare per shkembimin elektronik te informacionit, siç paracaktohet ne rekomandimet e keshillit te bashkepunimit doganor per teknologjine e informacionit.

3.12. Standard

Doganat duhet te kufizojne te dhenat e kerkuara ne deklarimin e mallrave vetem per ato hollesira qe gjykohen te nevojshme per vleresimin dhe mbledhjen e detyrimeve dhe taksave, pergatitjen e statistikave dhe zbatimin e ligjit doganor.

3.13. Standard

Kur, per arsye te gjykuara te vlefshme nga doganat, deklaruesi nuk ka te gjithë informacionin e kerkuar per te bere deklarimin e mallrave, nje deklarim mallrash i perkohshem apo i paplote lejohet te depozitohet, me kusht qe te permbaje detajet e nevojshme per doganat dhe qe deklaruesi merr persiper ta plotesoje brenda nje periudhe kohore te specifikuar.

3.14. Standard

Nese doganat regjistrojne nje deklarim mallrash te perkohshem apo te paplote, trajtimi tarifar qe i akordohet mallrave nuk duhet te jete ndryshe nga ai i cili do te akordohej sikur deklarimi i mallrave te depozitohet i plote dhe i sakte qe ne momentin e pare.

Çlirimi i mallrave nuk duhet te vonohet kur eshte dhene garancia e kerkuar per mbledhjen e detyrimeve dhe taksave te zbatueshme.

3.15. Standard

Doganat duhet te kerkojne depozitim e deklarimit fillestar te mallrave dhe vetem numrin minimal te kopjeve te nevojshme.

b) Dokumentet qe mbeshtetin deklarimin e mallrave

3.16. Standard

Ne mbeshtetje te deklarimit te mallrave, doganat kerkojne vetem ato dokumente qe jane te nevojshme per te lejuar kontrollin e operacionit dhe qe garantojne se te gjitha kerkesat ne lidhje me zbatimin e ligjit doganor jane ne perputhje me ate.

3.17. Standard

Kur dokumente te caktuara mbeshtetese nuk mund te depozitohen me deklarimin e mallrave per arsye te gjykuara te vlefshme nga doganat, ato duhet te lejojne pergatitjen e ketyre dokumenteve brenda nje periudhe kohore te specifikuar.

3.18. Standard i perkohshem

Doganat duhet te lejojne depozitim e dokumenteve mbeshtetese me ane te mjeteve elektronike.

3.19. Standard

Doganat nuk duhet te kerkojne perkthimin e hollesirave te dokumenteve mbeshtetese, perveç kur eshte e nevojshme per te lejuar perpunimin e deklarimit te mallrave. Depozitimi, regjistrimi dhe verifikimi i deklarimit te mallrave

3.20. Standard

Doganat duhet te lejojne depozitim e deklarimit te mallrave ne çdo zyre doganore te caktuar.

3.21. Standard i perkohshem

Doganat duhet te lejojne depozitimin e deklarimit te mallrave me ane te mjeteve elektronike.

3.22. Standard

Deklarimi i mallrave duhet te depozitohet gjate oreve te caktuara nga doganat.

3.23. Standard

Kur legjislacioni kombetar percakton nje afat kohor per depozitimin e deklarimit te mallrave, koha e lejuar duhet te jete e mjaftueshme per t'i dhene mundesine deklaruesit te plotesoje deklarimin e mallrave dhe te siguroje dokumentet mbeshtetese te kerkuara.

3.24. Standard

Me kerkese te deklaruesit dhe per arsye te gjykuara te vlefshme nga doganat, kjo e fundit shtyn afatin kohor te paracaktuar per depozitimin e deklarimit te mallrave.

3.25. Standard

Legjislacioni kombetar duhet te marre masat per depozitimin dhe regjistrimin apo verifikimin e deklarimit te mallrave dhe dokumenteve mbeshtetese perpara mberritjes se mallrave.

3.26. Standard

Kur doganat nuk mund te regjistrojne deklarimin e mallrave, ato duhet t'i japin arsyet deklaruesit.

3.27. Standard

Doganat duhet te lejojne deklaruesin te ndryshoje deklarimin e mallrave qe eshte depozituar, me kusht qe ne momentin e marrjes se kerkeses, doganat te mos kene filluar te verifikojne deklarimin e mallrave ose te kene shqyrtuar mallrat.

3.28. Standard i perkohshem

Doganat duhet te lejojne deklaruesin te ndryshoje deklarimin e mallrave, kur merret kerkesa pas fillimit te verifikimit te deklarimit te mallrave, ne qofte se arsyet e dhena nga deklaruesi gjykohen te vlefshme nga doganat.

3.29. Standard i perkohshem

Deklaruesi lejohet te terheqe deklarimin e mallrave dhe te aplikojte per nje procedure tjeter doganore, me kusht qe kerkesa te jete bere perpara çlirimit te mallrave dhe kur arsyet e dhena gjykohen te vlefshme nga doganat.

3.30. Standard

Verifikimi i deklarimit te mallrave behet ne te njejtin moment ose sa me shpejt qe te jete e mundur pas regjistrimit te deklarimit te mallrave.

3.31. Standard

Per qellim te verifikimit te deklarimit te mallrave, doganat duhet te marrin vetem veprime te tilla qe i gjykojne thelbesore per te garantuar pajtueshmerine me ligjin doganor. Procedura te veçanta per persona te autorizuar

3.32. Standard i perkohshem

Per persona te autorizuar qe plotesojne kriteret e specifikuara nga doganat, duke perfshire dhe nje regjistrim te duhur te perputhshmerise me kerkesat doganore dhe nje sistem te kenaqshem per menaxhimin e regjistrimeve te tyre tregtare, doganat duhet te parashikojne:

Çlirimin e mallrave me informacionin minimal te nevojshem per te identifikuar mallrat dhe per te lejuar plotesimin e mevonshem te deklarimit perfundimtar te mallrave;

Zhdoganimin e mallrave ne ambientet e deklaruesit ose ne nje vend tjeter te autorizuar nga Doganat;

dhe, perveç kesaj, ne masen e mundshme, procedura te tjera te veçanta te tilla si:

Lejimin e nje deklarimi te vetem mallrash per te gjitha importet ose eksportet ne nje periudhe kohore te caktuar, kur mallrat jane importuar ose eksportuar shpesh nga i njejti person;

Perdorimin e regjistrimeve tregtare te personit te autorizuar per te vetevleresuar detyrimet dhe taksat qe jane pergjegjes dhe sipas rastit, per te garantuar pajtueshmerine me kerkesat e tjera doganore;

Lejimin e depozitimit te deklarimit te mallrave me ane te nje hedhje ne regjistrin e personit te autorizuar dhe duke e mbeshtetur me pas me nje deklarim plotesues mallrash.

Shqyrtimi i mallrave

a) Koha e kerkuar per shqyrtimin e mallrave

3.33. Standard

Kur doganat vendosin qe te shqyrtohen mallrat e deklaruar, ky shqyrtim duhet te kryhet sa me shpejt qe eshte e mundur pas regjistrimit te deklarimit te mallrave.

3.34. Standard

Kur behen shqyrtime te planifikuara, prioritet duhet t'u jepet kafsheve te gjalla dhe mallrave qe prishen dhe per mallra te tjera qe doganat e pranojne se kerkohen me urgjence.

3.35. Standard i perkohshem

Kur mallrat duhet te inspektohen nga autoritete te tjera kompetente dhe doganat gjithashtu kane planifikuar shqyrtim, doganat duhet te sigurojne qe inspektimet te bashkerendohen dhe, ne qofte se eshte e mundur, te kryhen ne te njejten kohe.

b) Prania e deklaruesit gjate shqyrtimit te mallrave

3.36. Standard

Doganat duhet te shqyrtojne kerkesat nga deklaruesi per te qene te pranishem gjate shqyrtimit te mallrave. Kerkesa te tilla duhet te pranohen, pervecse kur ekzistojne rrethana perjashtuese.

3.37. Standard

Ne qofte se doganat e gjykojne te dobishme, ato i kerkojne deklaruesit te jete i pranishem ose te perfaqesohet gjate shqyrtimit te mallrave dhe t'u jape doganave çdo ndihme te nevojshme per lehtesimin e shqyrtimit.

c) Marrja e mostrave nga doganat

3.38. Standard

Mostrat duhet te merren vetem kur gjykohet e nevojshme nga doganat per te percaktuar pershkrimin tarifor dhe/ose vleren e mallrave te deklaruar apo per te garantuar zbatimin e dispozitave te tjera te legjislacionit kombetar. Mostrat e marra duhet te jene sa me te vogla te jete e mundur.

Gabimet

3.39. Standard

Doganat nuk duhet te vendosin penalitete thelbesore per gabime kur ato jane te bindura qe gabime te tilla jane te paqellimshme dhe nuk kane si synim mashtrim apo neglizhence flagrante. Kur ato e konsiderojne te nevojshme per te ndeshkuar perseritjen e gabimeve te tilla, mund te vendoset nje penaltet, por te mos jete me i madh se i nevojshem per kete qellim.

Çlirimi i mallrave

3.40. Standard

Mallrat e deklaruar duhet te çlirohen sapo doganat t'i kene shqyrtuar ato ose kane vendosur per te mos i shqyrtuar, me kusht qe:

te mos jete konstatuar asnje shkelje;

te jete marre licenca e importit ose e eksportit apo dokumentet e tjera te kerkuara;

te jene marre te gjitha lejet ne lidhje me proceduren ne fjale; dhe

çdo detyrim apo taksa te jene paguar ose te jene marre masat e duhura per te garantuar mbledhjen e tyre.

3.41. Standard

Ne qofte se doganat jane te bindura qe deklaruesi do te plotesoje me pas te gjitha formalitetet per sa i perket zhdoganimit, ato duhet te çlirojne mallrat, me kusht qe deklaruesi te jape nje dokument zyrtar apo tregtar me hollesirat kryesore te ngarkeses ne fjale dhe te jene te pranueshme per doganat, dhe garanci, nese kerkohet, qe ai garanton pagesen e detyrimeve dhe te taksave te aplikueshme.

3.42. Standard

Kur doganat vendosin qe kerkohet analize laboratorike e mostrave, dokumente te detajuara teknike ose mendim ekspertesh, ato i çlirojne mallrat perpara njohjes se rezultateve te shqyrtimeve te tilla, me kusht qe te jepet nje garanci e kerkuar dhe kur doganat jane te bindura qe mallrat nuk jane objekt kufizimesh apo ndalimesh.

3.43. Standard

Kur zbulohet nje shkelje, doganat nuk duhet te presin per plotesimin e mases administrative apo ligjore perpara çlirimit te mallrave, me kusht qe mallrat te mos i nenshtrohen konfiskimit apo te nevojiten si prove ne nje faze te mevonshme dhe kur deklaruesi paguan detyrimet dhe taksat dhe jep garanci per mbledhjen e detyrimeve dhe taksave shtese, si edhe te çdo penaliteti qe mund te vendoset.

Braktisja ose asgjesimi i mallrave

3.44. Standard

Kur mallrat nuk jane çliruar ende per perdorim ose kur nuk jane vendosur nen nje procedure tjeter doganore, si edhe kur nuk eshte zbuluar ndonje shkelje, personit ne fjale nuk i kerkohet te paguaje detyrime dhe taksa apo t'i jepet e drejta e rimbursimit:

kur, me kerkese te tij, mallra te tilla braktisen nen kontrollin doganor te rezervat e shtetit ose asgjesohen apo behen te pavlefshme per tregti, siç mund te vendose dogana. Çdo shpenzim qe lind i ngarkohet personit ne fjale;

kur keto mallra asgjesohen apo humbin ne menyre te pakthyeshme nga ndonje aksident apo force madhore, me kusht qe ky asgjesim apo humbje te percaktohet siç duhet per te bindur doganat;

ne rast mungesash per shkak te natyres se mallrave, kur mungesa te tilla percaktohen siç duhet per te bindur doganat.

Çdo mbetje apo skrap qe mbetet pas asgjesimit te mallrave do t'i nenshtrohet, ne qofte se do vendosen ne perdorim apo eksportohen, detyrimeve dhe taksave qe do te ishin te aplikueshme nese ky skrap apo kjo mbetje do te importohet apo eksportohet ne ate vend.

3.45. Standard i perkohshem

Kur doganat shesin mallra te cilat nuk jane deklaruar brenda afatit kohor te lejuar apo nuk mund te çliroheshin megjithese nuk ishte konstatuar ndonje shkelje, te ardhurat nga shitja, pas zbritjes se detyrimeve dhe taksave dhe te te gjithe pagesave te tjera dhe shpenzimeve te shkaktuara, do t'u ngarkohen atyre personave qe kane te drejten mbi ato mallra ose, kur kjo nuk eshte e mundur, te lihen ne dispozicion te tyre per nje periudhe kohore te specifikuar.

KAPITULLI 4 DETYRIMET DHE TAKSAT

A. VLERESIMI, MBLEDHJA DHE PAGESA E DETYRIMEVE DHE TAKSAVE

4.1. Standard

Legjislacioni kombetar percakton rrethanat kur shkaktohet detyrimi per detyrimet dhe taksat.

4.2. Standard

Periudha kohore brenda te ciles vleresohen detyrimet dhe taksat duhet te percaktohet ne legjislacionin kombetar. Vleresimi duhet te behet sa me shpejt qe eshte e mundur pas depozitimit te deklarimit te mallrave ose kur detyrimi shkaktohet ndryshe.

4.3. Standard

Faktoret ne te cilet mbeshtetet vleresimi i detyrimeve dhe taksave dhe kushtet nen te cilat ato percaktohen, specifikohen ne legjislacionin kombetar.

4.4. Standard

Normat e detyrimeve dhe taksave percaktohen ne botimet zyrtare.

4.5. Standard

Legjislacioni kombetar duhet ta percaktojë momentin kohor per t'u marre ne konsiderate per qellim te percaktimit te normave te detyrimeve dhe taksave.

4.6. Standard

Legjislacioni kombetar specifikon metodat qe mund te perdoren per te paguar detyrimet dhe taksat.

4.7. Standard

Legjislacioni kombetar specifikon personin(at) pergjegjes per pagesen e detyrimeve dhe taksave.

4.8. Standard

Legjislacioni kombetar percakton daten dhe vendin e duhur ku duhet te behet pagesa.

4.9.Standard

Kur specifikohet ne legjislacionin kombetar qe data e caktuar mund te jete pas çlirimit te mallrave, kjo date duhet te jete te pakten dhjete dite pas çlirimit. Asnje interes nuk duhet te vendoset per periudhen kohore midis dates se çlirimit dhe dates se caktuar.

4.10.Standard

Legjislacioni kombetar specifikon periudhen kohore brenda se ciles doganat mund te marrin hapa ligjore per te mbledhur detyrimet dhe taksat e papaguara ne daten e caktuar.

4.11.Standard

Legjislacioni kombetar percakton normen e interesit mbi shumat e detyrimeve dhe taksave qe nuk jane paguar ne daten e caktuar dhe kushtet e zbatimit te ketyre interesave.

4.12.Standard

Kur detyrimet dhe taksat jane paguar, nje fature qe sherben si prove e pageses duhet t'i leshohet paguesit, pervec kur ka prova te tjera qe deshmojne pagesen.

4.13.Standard i perkohshem

Legjislacioni kombetar duhet te specifikojte nje vlere minimale dhe/ose nje shume minimale te detyrimeve dhe taksave nen te cilen ato nuk do te mblidhen.

4.14.Standard

Ne qofte se doganat konstatojne qe gabimet ne deklarimin e mallrave ose ne vleresimin e detyrimeve dhe taksave do te shkaktojne ose kane shkaktuar mbledhje ose marrje me te vogel te detyrimeve dhe taksave sesa ato ligjerisht te ngarkueshme, doganat duhet te korrigojne gabimet dhe te mbledhin shumen e papaguar, megjithate, nese shuma e perfshire eshte me pak se shuma minimale e specifikuar ne legjislacionin kombetar, doganat nuk duhet ta mbledhin ose ta marrin ate shume.

B. SHTYRJA E PAGESAVE TE DETYRIMEVE DHE TAKSAVE

4.15.Standard

Kur legjislacioni kombetar parashikon shtyrjen e pagesave te detyrimeve dhe taksave, ai duhet te specifikojte kushtet nen te cilat lejohet kjo lehtesi.

4.16.Standard

Shtyrja e pageses duhet te lejohet pa interesa ne masen e mundshme.

4.17.Standard

Periudha kohore per shtyrjen e pageses se detyrimeve dhe taksave duhet te jete te pakten 14 dite.

C. SHLYERJA E DETYRIMEVE DHE TAKSAVE

4.18.Standard

Shlyerja e detyrimeve dhe taksave duhet te miratohet kur percaktohet qe detyrimet dhe taksat jane mbingarkuar si rezultat i ndonje gabimi ne vleresimin e tyre.

4.19.Standard

Shlyerja e detyrimeve dhe taksave duhet te miratohet per sa u perket mallrave te importuara ose te eksportuara te cilat jane konstatuar te demtuara ose ndryshe ne mosperputhje me specifikimet e rena dakord ne momentin e importimit ose eksportimit dhe jane rikthyer ose te furnizuesi ose te nje person tjetër i caktuar nga ai, te cilat u nenshtrohen kushteve te meposhtme:

Mallrat nuk jane punuar, riparuar ose perdorur ne vendin e importimit, dhe jane rieksportuar brenda nje afati kohor te arsyeshem;

Mallrat nuk jane punuar, riparuar ose perdorur ne vendin ne te cilin ato ishin eksportuar, dhe jane riimportuar brenda nje afati kohor te arsyeshem.

Megjithate, perdorimi i mallrave nuk duhet te pengojte shlyerjen e detyrimeve dhe taksave ne qofte se nje perdorim i tille ishte i domosdoshem per te zbuluar defektet ose rrethana te tjera qe shkaktojnë rieksportimin ose riimportimin e mallrave.

Si alternative ndaj rieksportimit ose riimportimit, mallrat mund te braktisen te rezervat e shtetit ose te asgjeshohen apo te behen te pavlefshme nga pikepamja tregtare nen kontrollin doganor, siç mund te vendosin doganat. Kjo braktisje ose ky asgjesim nuk duhet t'i shkaktojte shtepzime rezervave te shtetit.

4.20. Standard i perkohshem

Kur jepet leja nga doganat per mallra fillimisht te deklaruar per nje procedure doganore me pagese detyrimesh dhe taksash qe te vendosen nen nje procedure tjeter doganore, duhet te shlyhet çdo detyrim dhe takse qe ishte ngarkuar me shume sesa shuma e duhur nen proceduren e re.

4.21. Standard

Vendimet per pretendimet per shlyerje detyrimesh dhe taksash duhet te arrihen dhe t'i njoftohen me shkrim personit te interesuar pa vonese te paarsyeshme, dhe shlyerja e detyrimeve dhe taksave duhet te behet sa me shpejt qe te jete e mundur pas verifikimit te pretendimeve.

4.22. Standard

Kur percaktohet nga doganat qe mbingarkimi eshte si rezultat i gabimit nga ana e doganave ne vleresimin e detyrimeve dhe taksave, shlyerja e tyre duhet te behet si nje çeshtje me prioritet.

4.23. Standard

Kur vendosen afate kohore nen te cilat nuk pranohen pretendime per shlyerje detyrimesh dhe taksash, keto kufizime duhet te kene nje kohezgjatje te mjaftueshme per te marre ne konsiderate çdo rrethane te ndryshme qe lidhet me çdo lloj rasti, ne te cilin mund te miratohet shlyerje detyrimesh dhe taksash.

4.24. Standard

Shlyerja e detyrimeve dhe taksave nuk miratohet nese shuma e perfshire eshte me e vogel se shuma minimale e specifikuar ne legjislacionin kombetar.

KAPITULLI 5

GARANCIA

5.1. Standard

Legjislacioni kombetar duhet te rendise rastet ne te cilat kerkohet garanci dhe te specifikojë format si te jepet garancia.

5.2. Standard

Doganat percaktojne shumen e garancise.

5.3. Standard

Çdo personi qe i kerkohet te jape garanci duhet t'i lejohet te zgjedhe nje nga format e garancise, me kusht qe kjo te jete e pranueshme per doganat.

5.4. Standard

Kur parashikohet ne legjislacion, doganat nuk kerkojne garanci kur ato jane te bindura qe do te permbushet detyrimi ndaj tyre.

5.5. Standard

Kur kerkohet garanci per te garantuar qe te permbushen detyrimet qe rrjedhin nga procedura doganore, doganat duhet te pranojne nje garanci te pergjithshme, ne veçanti nga deklaruesi i cili deklaroi rregullisht mallra ne zyra te ndryshme ne territorin doganor.

5.6. Standard

Kur kerkohet garanci, shuma e garancise qe do jepet duhet te jete sa me e ulet te jete e mundur dhe, per sa i perket pageses se detyrimeve dhe taksave, nuk duhet te kaloje shumen e mundshme qe do i ngarkohet.

5.7. Standard

Kur jepet garanci, ajo duhet te shkarkohet sa me shpejt qe te jete e mundur pas bindjes se doganave qe detyrimet nen te cilat eshte kerkuar garancia jane plotesuar siç duhet.

KAPITULLI 6 KONTROLI DOGANOR

6.1.Standard

Te gjitha mallrat, perfshire mjetet e transportit, te cilat hyjne apo dalin nga territori doganor, pavaresisht se u nenshtrohen apo jo detyrimeve dhe taksave, jane objekt i kontrolleve doganore.

6.2.Standard

Kontrolli doganor duhet te kryhet ne perputhje me ligjin doganor.

6.3.Standard

Per kryerjen e kontrollit doganor, doganat duhet te perdorin menaxhimin e riskut.

6.4.Standard

Doganat duhet te perdorin analizen e riskut per te percaktuar personat, mallrat dhe mjetet e transportit qe duhet te kontrollohen dhe shkallen e kontrollit te tyre.

6.5.Standard

Doganat duhet te miratojne nje strategji masash perputhshmerie ne mbeshtetje te menaxhimit te riskut.

6.6.Standard

Sistemet e kontrolleve doganore duhet te perfshijne kontrollet e bazuara te auditi.

6.7.Standard

Doganat do te kerkojne bashkepunim me administratat e tjera doganore dhe do te kerkojne te lidhin marreveshjet e ndihmes administrative per te rritur kontrollin doganor.

6.8.Standard

Doganat do te kerkojne te bashkepunojne me tregtaret dhe te firmosin memorandume mirekuptimi me ta, me qellim rritjen e kontrollit doganor.

6.9.Standard i perkohshem

Doganat do te perdorin teknologjine e informacionit dhe mjetet elektronike ne masen me te madhe te mundshme, me qellim rritjen e kontrollit doganor.

6.10.Standard

Doganat duhet te vleresojne sistemet tregtare te subjekteve qe kane ndikim ne operacionet doganore per t'u siguruar qe keto sisteme plotesojne kerkesat e doganave.

KAPITULLI 7 PERDORIMI I TEKNOLOGJISE SE INFORMACIONIT

7.1.Standard

Doganat duhet te perdorin teknologjine e informacionit ne mbeshtetje te operacioneve doganore kur kjo eshte me kosto efektive dhe efikase per doganat dhe per tregtaret. Doganat do te percaktojne kushtet per perdorimin e saj.

7.2.Standard

Per futjen e sistemeve kompjuterike, doganat do te perdorin standardet perkatese te pranuar nderkombetarisht.

7.3.Standard

Futja e teknologjise se informacionit do te behet duke u konsultuar sa me gjeresisht qe te jete e mundur me palet perkatese qe ndikohen drejtpersedrejti.

7.4.Standard

Legjislacioni kombetar i ri ose i rishikuar do te percaktoje:

Kerkesat per perdorimin e metodave elektronike te punes si alternative ndaj dokumenteve ne leter;

Metodat elektronike si edhe ato te dokumenteve ne leter per autenticitetin;

Te drejten e doganes per te mbajtur informacion per nevojat e saj dhe, kur eshte e duhur, kete informacion ta shkembejne elektronikisht me administrata te tjera doganore dhe çdo pale tjetere te miratuar me ligj.

KAPITULLI 8

MARREDHENIA MIDIS DOGANAVE DHE PALEVE TE TRETE

8.1.Standard

Personat e interesuar do te kene mundesi te zgjedhin nese do t'i kryejne vete veprimet ne lidhje me doganat apo do te caktojne nje pale te trete qe te veproje ne emer te ketyre personave.

8.2.Standard

Legjislacioni kombetar do te percaktoje kushtet nen te cilat nje person mund te veproje ne interes ose ne emer te nje personi tjetere ne lidhje me doganat dhe do te percaktoje gjithashtu pergjegjesite e paleve te trete ndaj doganave per detyrimet dhe taksat, si edhe per çdo parregullsi.

8.3.Standard

Personat qe zgjedhin te kryejne vete veprimet doganore nuk do te trajtohen ne menyre me pak te favorshme apo t'u nenshtrohen kerkesave me te rrepta krahasuar me ata qe zgjedhin t'i kryejne veprimet doganore nepermjet nje pale te trete.

8.4.Standard

Nje person i caktuar si pale e trete do te kete te njejta te drejta me personin qe e ka caktuar ate per çeshtjet ne lidhje me veprimet doganore.

8.5.Standard

Doganat do t'u mundesojne paleve te trete pjesemarrjen ne konsultimet formale qe doganat bejne me tregtaret.

8.6.Standard

Doganat do te percaktojne rrethanat nen te cilat ato nuk mund te kryejne veprime me nje pale te trete.

8.7.Standard

Doganat duhet te njoftojne me shkrim palen e trete ne lidhje me vendimin e tyre per moskryerjen e veprimeve.

KAPITULLI 9

INFORMACIONI, VENDIMET DHE AKTVENDIMET E DHENA NGA DOGANAT

A. INFORMACION I ZBATIMIT TE PERGJITHSHEM

9.1.Standard

Doganat sigurojne qe i gjithe informacioni perkates per zbatim te pergjithshem ne lidhje me ligjin doganor eshte ne dispozicion te çdo pale te interesuar.

9.2.Standard

Kur informacioni i vene ne dispozicion duhet te ndryshohet per shkak te ndryshimeve te ligjit doganor, rregullimeve ose kerkesave administrative, doganat duhet te vene ne dispozicion informacionin e ndryshuar per nje kohe te mjaftueshme perpara se keto ndryshime te hyjne ne fuqi, me qellim qe t'u mundesojne personave te interesuar t'i marrin parasysh ato, pervec kur njoftimi paraprak perjashtohet.

9.3.Standard i perkohshem

Doganat do te perdorin teknologjine e informacionit per te rritur dhenien e informacionit.

B. INFORMACION I NJE NATYRE SPECIFIKE

9.4.Standard

Me kerkese te personit te interesuar, doganat do te sigurojne, sa me shpejt dhe sa me sakte qe te jete e mundur, informacionin e kerkuar nga personi i interesuar per çeshtje specifike ne lidhje me ligjin e doganave.

9.5.Standard

Doganat do te japin jo vetem informacionin e kerkuar specifikisht por edhe çdo informacion tjetër qe ka lidhje dhe per te cilin ata mendojne se personi i interesuar duhet te vihet ne dijeni.

9.6.Standard

Kur doganat japin informacion, ato duhet te sigurohen se nuk po zbulojne te dhena te nje natyre private apo konfidenciale qe ka ndikim te doganat ose palet e treta, perveç rasteve kur kjo kerkohet ose autorizohet nga legjislacioni kombetar.

9.7.Standard

Kur doganat nuk mund te japin informacionin falas, çdo pagese do te kufizohet me koston e perafert te sherbimit te ofruar.

C. VENDIMET DHE AKTVENDIMET

9.8.Standard

Pas kerkeses me shkrim nga personi i interesuar, doganat duhet te njoftojne vendimin e tyre me shkrim brenda nje periudhe kohore te percaktuar nga legjislacioni kombetar. Kur vendimi eshte kunder personit ne fjale, duhet te jepen arsyet e vendimit dhe te keshillohet e drejta e depozitimit te ankimimit.

9.9. Standard

Doganat nxjerrin vendime detyruese me kerkese te personit te interesuar, me kusht qe ato te kene ne dispozicion te gjithe informacionin qe e gjykojne te nevojshem.

KAPITULLI 10

APELIMET PER ÇESHTJE DOGANORE

A. E DREJTA E APELIMIT

10.1.Standard

Legjislacioni kombetar parashikon te drejten e apelimit per çeshtjet doganore.

10.2.Standard

Çdo person qe preket drejtperdrejt nga nje vendim ose gabim i doganave ka te drejten e apelimit.

10.3.Standard

Personit te prekur drejtperdrejt nga nje vendim ose gabim i doganave i jepet, pas kerkeses se tij me shkrim, arsyeja per nje vendim ose gabim te tille brenda nje periudhe kohore te percaktuar nga legjislacioni kombetar. Kjo mund te çoje ose jo ne apelim.

10.4.Standard

Legjislacioni kombetar duhet te parashikojte te drejten e nje apelimi fillestar ndaj doganave.

10.5.Standard

Kur nje apelim ndaj doganave hidhet poshte, apeluesi duhet te kete te drejten e nje apelimi tjetër prane nje autoriteti qe nuk eshte ne varesi te administrates doganore.

10.6.Standard

Ne instancen e fundit, apeluesi do te kete te drejten e apelimit ne gjykate.

B. FORMA DHE ARSYET E APELIMIT

10.7.Standard

Apelimi depozitohet me shkrim dhe duhet te percaktoje arsyet mbi te cilat po behet.

10.8.Standard

Duhet te caktohet nje afat kohor per depozitim e nje apelimi kundrejt nje vendimi te doganave dhe ai duhet te jete i tille qe t'i jape apeluesit kohe te mjaftueshme te studioje vendimin e kundershuar dhe te pergatise nje apel.

10.9.Standard

Kur apelimi eshte ndaj doganave, ato nuk duhet te kerkojne qe prova mbeshtetese te depozitohen bashke me apelimin por ne rrethanat e duhura, do te lejojne nje afat kohor te arsyeshem per depozitim e ketyre provave.

C. SHQYRTIMI I NJE APELI

10.10.Standard

Doganat do te japin vendimin mbi apelimin dhe do te njoftojne me shkrim apeluesin sa me shpejt te jete e mundur.

10.11. Standard

Kur nje apelim ndaj doganave rrezohet, doganat duhet te japin per kete arsyet me shkrim dhe do te keshillojne apeluesin mbi te drejten e tij per apelimim te metejshe me nje autoritet administrativ ose te pavarur dhe per afatet kohore te depozimitit te apelimit.

10.12.Standard

Kur apeli pranohet, doganat do te zbatojne vendimin e tyre ose te nje autoriteti gjyqesor ose te pavarur sa me shpejt te jete e mundur, perveç kur doganat apelojne ndaj vendimit.



LIGJ
Nr. 35/2012

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN
NDËRKOMBËTARE PËR SISTEMIN E HARMONIZUAR TË KODIFIKIMIT DHE
PËRSHKRIMIT TË MALLRAVE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën Ndërkombëtare për Sistemin e Harmonizuar të Kodifikimit dhe Përshkrimit të Mallrave.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 29.3.2012

**Shpallur me dekretin nr. 7388, datë 10.4.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

KONVENTA NDËRKOMBËTARE

MBI SISTEMIN E HARMONIZUAR (Bërë në Bruksel, më 14 qershor 1983) (Amenduar sipas protokollit të amendimit të Konventës Ndërkombëtare të Sistemit të Harmonizuar të Përshkrimit të Mallrave dhe Sistemit të Kodifikimit, më 24 qershor 1986)

HYRJE

Palët kontraktuese në këtë Konventë, themeluar nën kujdesin e Këshillit të Bashkëpunimit Doganor,

me dëshirën për të lehtësuar tregtinë ndërkombëtare;

me dëshirën për të lehtësuar mbledhjen, krahasimin dhe analizën e statistikave, në veçanti ato mbi tregtinë ndërkombëtare;

me dëshirën për të zvogëluar shpenzimet që rrjedhin nga ripërshkrimi, riklasifikimi dhe rikodimi i mallrave kur ato lëvizin nga një sistem klasifikimi në një tjetër në rrjedhën e tregtisë ndërkombëtare dhe për të lehtësuar standardizimin e dokumentacionit tregtar dhe transmetimin e të dhënave;

duke pasur parasysh se ndryshimet në teknologji dhe modelet e tregtisë ndërkombëtare kërkojnë modifikime të shumta në Konventën mbi Nomenklaturën për Klasifikimin e Mallrave në Tarifat Doganore, bërë në Bruksel, më 15 dhjetor 1950;

duke pasur parasysh, gjithashtu, se niveli i të dhënave që kërkohen për qëllime doganore dhe qëllime statistikore nga qeveritë dhe interesat e tregtisë është rritur më shumë nga ajo që ofron nomenklatura e aneksuar në Konventën e lartpërmendur;

duke pasur parasysh rëndësinë e të dhënave të sakta dhe të krahasueshme për qëllimet e negociatave të tregtisë ndërkombëtare;

duke pasur parasysh se sistemi i harmonizuar ka për qëllim të përdoret për qëllime të tarifave të transportit të mallrave dhe statistikave të llojeve të ndryshme të transportit;

duke pasur parasysh se sistemi i harmonizuar synon të përfshihet në përshkrimin e mallrave tregtare dhe sistemin e kodimit sa më shumë që të jetë e mundur;

duke pasur parasysh se sistemi i harmonizuar synon të nxisë një lidhje më të afërt të mundshme midis statistikave të tregtisë në import dhe eksport dhe statistikave prodhuese;

duke pasur parasysh se një lidhje e afërt duhet të mbahet midis sistemit të harmonizuar dhe klasifikimit standard ndërkombëtar të tregtisë (SITC) të Shteteve të Bashkuara;

duke pasur parasysh dëshirën e plotësimit të nevojave të lartpërmendura nëpërmjet nomenklaturës tarifore/statistikore, të përshtatshme për t'u përdorur nga interesat e ndryshme lidhur me tregtinë ndërkombëtare;

duke pasur parasysh rëndësinë e mbajtjes së sistemit të harmonizuar të përditësuar me ndryshimet e teknologjisë apo modelet e tregtisë ndërkombëtare;

duke pasur parasysh punën e bërë në këtë fushë nga Komiteti i sistemit të harmonizuar të ngritur nga Këshilli i bashkëpunimit doganor;

duke pasur parasysh se ndërsa Konventa e sipërpërmendur e nomenklaturës është provuar si një instrument në arritjen e disa prej këtyre objektivave, mënyra më e mirë për të arritur rezultatet e dëshiruara në këtë drejtim është të nxirret një konventë ndërkombëtare e re;

kanë rënë dakord si më poshtë vijon,

Neni 1 Përkufizimet

Për qëllim të kësaj Konvente:

a) "Përshkrimi i mallrave të harmonizuara dhe sistemi i kodimit", më poshtë referuar si "sistemi i harmonizuar", do të thotë nomenklatura në të cilën përfshihen kapitujt, nënkaptujt dhe kodet numerike përkatëse të tyre, seksioni, kapitulli, shënimet e nënkaptujve dhe rregullat e përgjithshme për interpretimin e sistemit të harmonizuar, të përcaktuara në aneksin e kësaj Konvente.

b) "Nomenklatura e tarifës doganore" do të thotë nomenklatura e themeluar sipas legjislacionit të një pale kontraktuese për qëllimet e mbledhjes së detyrimeve doganore mbi mallrat e importuara.

c) "Nomenklaturë statistikore" do të thotë mallrat e nomenklaturës themeluar nga një palë kontraktuese për mbledhjen e të dhënave për statistikave të tregtisë së importit dhe eksportit.

d) "Nomenklaturë e kombinuar tarifore/statistikore" do të thotë një nomenklaturë, në të cilën janë integruar tarifat doganore dhe nomenklatura statistikore, të kërkuara sipas ligjit nga një palë kontraktuese për deklarimin e mallrave të importit.

e) "Konventa për themelimin e Këshillit" do të thotë Konventa e krijimit të Këshillit të bashkëpunimit doganor, bërë në Bruksel më 15 dhjetor 1950.

f) "Këshilli" do të thotë Këshilli i bashkëpunimit doganor të referuar në paragrafin "d" më lartë.

g) "Sekretari i përgjithshëm" nënkupton sekretarin e përgjithshëm të Këshillit.

h) Termi "ratifikimin" do të thotë ratifikim, pranim ose miratim.

Neni 2 Aneksi

Aneksi i kësaj Konvente formon një pjesë integrale të saj, dhe çdo referencë ndaj Konventës përfshin një referencë në aneks.

Neni 3 Detyrimet e palëve kontraktuese

1. Lidhur me përjashtimet e renditura në nenin 4:

a) Çdo palë kontraktuese merr përsipër, përveçse siç parashikohet në nënparagrafin “c” të këtij paragrafi që nga data në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në lidhje me të, tarifa doganore e saj dhe nomenklatura statistikore duhet të jenë në përputhje me sistemin e harmonizuar. Pra, ajo merr përsipër se, në lidhje me tarifatat doganore dhe nomenklaturën statistikore:

i) do të përdorë të gjithë titujt dhe nëntitujt e sistemit të harmonizuar, pa shtesë ose modifikim, së bashku me kodet numerike përkatëse;

ii) se do të zbatojë rregullat e përgjithshme për interpretimin e sistemit të harmonizuar dhe të gjitha shënimet e seksionit, kapitullit dhe nënkaptullit dhe nuk do të modifikojnë qëllimin e seksionit, kapitullit, titullit apo nënkaptullit të sistemit të harmonizuar; dhe

iii) se do të ndjekë renditjen numerike të sistemit të harmonizuar;

b) Çdo palë kontraktuese i bën, gjithashtu, të ditura publikisht statistikat tregtare të importit dhe eksportit në pajtim me kodet gjashtëshifrore të sistemit të harmonizuar ose me nismën e palës kontraktuese, përtej atij niveli, në atë masë që publikimi të mos pengohet për arsye të jashtëzakonshme, të tilla si fshehtësia komerciale apo siguria kombëtare;

c) Asgjë në këtë nen nuk i kërkon një palë kontraktuese të përdorë nënkaptujt e sistemit të harmonizuar në nomenklaturën e tarifës doganore me kusht që të përmbushë detyrimet e mësipërme në “a” “i”, “a” “ii” dhe “a” “iii” në një nomenklaturë të kombinuar tarifore/statistikore.

2. Në përputhje me ndërmarrjet në paragrafin 1 (a) të këtij neni, çdo palë kontraktuese mund të bëjë ndryshime të tilla në tekst që mund të jenë të nevojshme për të bërë efikas sistemin e harmonizuar në ligjin e brendshëm.

3. Asgjë në këtë nen nuk ndalon një palë kontraktuese të krijojë, në tarifën doganore ose nomenklaturën statistikore, nënndarje të klasifikimit të mallrave përtej nivelit të sistemit të harmonizuar, me kusht që çdo nënndarje e tillë të shtohet dhe kodohet në një nivel përtej atij të kodit numerik gjashtëshifror të përcaktuar në aneksin e kësaj Konvente.

Neni 4 Aplikimi i pjesshëm nga vendet në zhvillim

1. Çdo vend në zhvillim, palë kontraktuese, mund të vonojë aplikimin e saj për disa ose të gjithë nënkaptujt e sistemit të harmonizuar për një periudhë të tillë sa mund të jetë e nevojshme, duke pasur parasysh modelin e saj të tregtisë ndërkombëtare ose burimeve të saj administrative.

2. Një vend në zhvillim, palë kontraktuese, që zgjedh të aplikojë sistemin e harmonizuar pjesërisht, sipas dispozitave të këtij neni pranon të bëjë përpjekjet e saj më të mira drejt zbatimit të sistemit të harmonizuar të plotë gjashtëshifror, brenda pesë vjetëve nga data në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në lidhje me atë apo brenda një periudhe të tillë më tej siç mund ta konsiderojë të nevojshme, duke marrë parasysh dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni.

3. Një vend në zhvillim, palë kontraktuese, që zgjedh të aplikojë sistemin e harmonizuar pjesërisht sipas dispozitave të këtij neni zbaton të gjitha ose asnjë nga nënkaptujt me dy viza

të çdo njërit nënkapitull me një vizë ose të gjithë ose asnjë nënkapitull me një vizë të ndonjë kapitulli. Në raste të tilla të aplikimit të pjesshëm, shifra e gjashtë apo e pestë dhe e gjashtë e asaj pjese të kodit të sistemit të harmonizuar që nuk zbatohet duhet të zëvendësohet përkatësisht me “0” ose “00”.

4. Një vend në zhvillim që zgjedh të zbatojë sistemin e harmonizuar pjesërisht në bazë të dispozitave të këtij neni në momentin e bërjes palë kontraktuese, njofton sekretarin e përgjithshëm për ato nënkapituj që ajo nuk do të zbatojë në datën kur kjo Konventë hyn në fuqi në lidhje me të dhe do të njoftojë, gjithashtu, sekretarin e përgjithshëm për ato nënkapituj të cilët zbatohen pas kësaj.

5. Çdo vend në zhvillim që zgjedh të zbatojë sistemin e harmonizuar pjesërisht sipas dispozitave të këtij neni, në momentin e bërjes palë kontraktuese mund të njoftojë sekretarin e përgjithshëm se ai formalisht angazhohet për zbatimin e sistemit të harmonizuar të plotë gjashtëshifrorit brenda tre vjetëve nga data kur kjo Konventë hyn në fuqi në lidhje me të.

6. Çdo vend në zhvillim palë kontraktuese, e cila pjesërisht zbaton sistemin e harmonizuar sipas dispozitave të këtij neni lirohet nga detyrimet e saj sipas nenit 3 në lidhje me nënkapitujt që nuk zbatohen.

Neni 5

Ndihmë teknike për vendet në zhvillim

Vendet e zhvilluara palë kontraktuese do të japin për vendet në zhvillim që kërkojnë ndihmë teknike mbi kushtet e rëna dakord bashkërisht në lidhje me, ndër të tjera, trajnimin e personelit, zhvendosjen e nomenklaturës së tyre ekzistuese në sistemin e harmonizuar dhe këshilla për mbajtjen e sistemeve të tyre të zhvendosura në mënyrë të përditësuar me ndryshimet e sistemit të harmonizuar, ose zbatimin e dispozitave të kësaj Konvente.

Neni 6

Komiteti i Sistemit të Harmonizuar

1. Sipas kësaj Konvente do të themelohet një komitet që do të njihet si Komiteti i sistemit të harmonizuar, i përbërë nga përfaqësues prej secilës palë kontraktuese.

2. Ai do të mbledhet normalisht të paktën dy herë në vit.

3. Mbledhjet e tij do të thirren nga sekretari i përgjithshëm dhe, përveç kur palët kontraktuese vendosin ndryshe, do të mbahen në selinë e Këshillit.

4. Në Komitetin e sistemit të harmonizuar secila palë kontraktuese ka të drejtën e një vote, megjithatë, për qëllimet e kësaj Konvente dhe pa paragjykuar ndonjë konventë në të ardhmen, në të cilën një bashkim doganor ose ekonomik sikurse dhe kur një ose më shumë nga shtetet e tij anëtare janë palë kontraktuese, të tilla palë kontraktuese do të ushtrojnë së bashku vetëm një votë. Në mënyrë të ngjashme, në rastin kur të gjitha shtetet anëtare të bashkimit doganor ose ekonomik, të cilat kanë të drejtë të bëhen një palë kontraktuese sipas dispozitave të nenit 11 (b) bëhen palë kontraktuese, ato së bashku do të ushtrojnë vetëm një votë.

5. Komiteti i sistemit të harmonizuar zgjedh kryetarin e tij dhe një ose më shumë zëvendëskryetarë.

6. Ai harton rregulloren e vet të procedurës me vendim që merret nga jo më pak se dy të tretat e votave që u atribuohen anëtarëve të tij. Rregullat e procedurës të hartuara në këtë mënyrë do të miratohen nga Këshilli.

7. Ai fton organizata ndërqeveritare apo të tjera ndërkombëtare siç mund t'i konsiderojë të përshtatshme për të marrë pjesë si vëzhgues në punën e tij.

8. Ai ngre nënkomitete ose palët e punës sipas nevojës, duke pasur parasysh veçanërisht dispozitat e paragrafit 1 (a) të nenit 7, dhe përcakton anëtarësimin, të drejtat e votimit dhe rregullat e procedurës për nënkomitete të tilla ose palët e punës.

Neni 7 Funksionet e Komitetit

1. Komiteti i sistemit të harmonizuar, në përputhje me dispozitat e nenit 8, ka funksionet e mëposhtme:

- a) të propozojë amendamente të tilla në këtë Konventë që mund të konsiderohen si të dëshirueshme, duke pasur parasysh, në veçanti, nevojat e përdoruesve dhe ndryshimet në teknologji ose në modelet e tregtisë ndërkombëtare;
 - b) të përgatisë shënime sqaruese, opinione klasifikuese apo këshilla të tjera si udhërrëfyes për interpretimin e sistemit të harmonizuar;
 - c) të përgatisë rekomandime për të siguruar njëtrajtshmëri në interpretimin dhe zbatimin e sistemit të harmonizuar;
 - d) të sistemojë dhe qarkullojë informacionin që lidhet me zbatimin e sistemit të harmonizuar;
 - e) me iniciativën e vet ose me kërkesë që të sigurojë informata ose udhëzime mbi çdo çështje në lidhje me klasifikimin e mallrave në sistemin e harmonizuar për palët kontraktuese, për anëtarët e Këshillit dhe organizata të tilla ndërqeveritare apo të tjera ndërkombëtare që komisioni mund t'i konsiderojë të përshtatshme;
 - f) të paraqesë raporte për çdo seancë të Këshillit në lidhje me aktivitetet e tij, duke përfshirë amendamentet e propozuara, shënimet shpjeguese, opinionet klasifikuese dhe këshilla të tjera;
 - g) të ushtrojë kompetenca dhe funksione të tjera në lidhje me sistemin e harmonizuar sipas nevojave të Këshillit ose palëve kontraktuese.
2. Vendimet administrative të Komitetit të sistemit të harmonizuar që kanë të bëjnë me buxhetin do të jenë subjekt i miratimit nga Këshilli.

Neni 8 Roli i Këshillit

1. Këshilli shqyrton propozimet për ndryshimin e kësaj Konvente, të përgatitur nga Komiteti i sistemit të harmonizuar, dhe ua rekomandon palëve kontraktuese sipas procedurës së nenit 16, përveç rastit kur një anëtar i Këshillit, i cili është një palë kontraktuese në këtë Konventë kërkon që propozimet ose ndonjë pjesë e saj t'i referohen Komitetit për rishqyrtim.
2. Shënimet sqaruese, opinionet e klasifikimit, këshilla të tjera për interpretimin e sistemit të harmonizuar dhe rekomandime për të siguruar njëtrajtshmëri në interpretimin dhe zbatimin e sistemit të harmonizuar, të përgatitur gjatë një sesiioni të Komitetit të sistemit të harmonizuar në bazë të dispozitave të paragrafit 1 të nenit 7, konsiderohen si të miratuara nga Këshilli, në qoftë se, jo më vonë se në fund të muajit të dytë që pason muajin gjatë të cilit është mbyllur sesiioni, asnjë palë kontraktuese në këtë Konventë nuk ka njoftuar sekretarin e përgjithshëm se ajo kërkon që çështje të tilla t'i referohen Këshillit.
3. Kur një çështje i është referuar Këshillit në bazë të dispozitave të paragrafit 2 të këtij neni, Këshilli miraton shënime të tilla sqaruese, opinione klasifikimi, këshilla apo rekomandime të tjera, përveç rastit kur ndonjë anëtar i Këshillit, i cili është palë kontraktuese në këtë Konventë kërkon që ato t'i referohen plotësisht ose pjesërisht Komitetit për rishqyrtim.

Neni 9

Normat e taksës doganore

Palët kontraktuese nuk marrin përsipër nga kjo Konventë ndonjë detyrim në lidhje me normat e taksës doganore.

Neni 10

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje midis palëve kontraktuese, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, për aq sa është e mundur, do të zgjidhet me negociata midis tyre.
2. Çdo mosmarrëveshje që nuk është zgjidhur do t'i dërgohet nga palët në mosmarrëveshje Komitetit të sistemit të harmonizuar, i cili pas kësaj do të shqyrtojë mosmarrëveshjen dhe do të bëjë rekomandime për zgjidhjen e saj.
3. Nëse Komiteti i sistemit të harmonizuar nuk mund të zgjidhë mosmarrëveshjen, ai do t'ia referojë çështjen Këshillit, i cili do të bëjë rekomandime në përputhje me nenin 3 (e) të Konventës për themelimin e Këshillit.
4. Palët në mosmarrëveshje mund të bien dakord paraprakisht për të pranuar rekomandimet e Komitetit ose Këshillit si të detyrueshme.

Neni 11

E drejta për t'u bërë palë kontraktuese

Sa më poshtë kanë të drejtë të bëhen palë kontraktuese në këtë Konventë:

- a) Vendet anëtare të Këshillit;
- b) Bashkimet doganore ose ekonomike tek të cilat është transferuar kompetenca për të hyrë në traktate në lidhje me disa ose të gjitha çështjet që rregullohen nga kjo Konventë, dhe çdo shtet tjetër të cilit i është drejtuar një ftesë për këtë qëllim nga sekretari i përgjithshëm në drejtimin e Këshillit.

Neni 12

Procedura për t'u bërë palë kontraktuese

1. Çdo shtet ose bashkim doganor ose ekonomik i pranueshëm mund të bëhet palë kontraktuese në këtë Konventë:
 - a) duke e nënshkruar atë pa rezerva për ratifikim;
 - b) duke depozituar një instrument ratifikimi, pasi ka nënshkruar Konventën subjekt për ratifikim; ose
 - c) duke aderuar në të pasi Konventa ka pushuar së qeni e hapur për nënshkrim.
2. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim deri më 31 dhjetor 1986, në selinë e Këshillit në Bruksel nga shtetet dhe bashkimet doganore ose ekonomike të përmendura në nenin 11. Pas kësaj, ajo do të jetë e hapur për pranimin e tyre.
3. Instrumentet e ratifikimit ose të pranimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 13

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi ditën më të parë të 1 janarit që bie të paktën tre muaj pasi minimumi shtatëmbëdhjetë shtete ose bashkime doganore apo ekonomike të referuara në nenin 11 më lart e kanë nënshkruar atë për ratifikim pa rezervë ose kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit ose pranimit, por jo para 1 janarit 1988.
2. Për çdo shtet ose bashkim doganor ose ekonomik që e ka nënshkruar për ratifikim pa rezervë ose që aderon në këtë Konventë pas përmbushjes së numrit minimal të specifikuar në

paragrafin 1 të këtij neni, kjo Konventë hyn në fuqi në 1 janar që bie të paktën dymbëdhjetë muaj, por jo më shumë se njëzet e katër muaj pasi ajo ka nënshkruar Konventën për ratifikim pa rezervë ose ka depozituar instrumentin e tij të ratifikimit ose aderimit, përveçse nëse ai përcakton një datë më të hershme. Megjithatë, data e hyrjes në fuqi sipas dispozitave të këtij paragrafi nuk do të jetë më herët se data e hyrjes në fuqi të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 14

Aplikimi nga territoret e varësisë

1. Çdo shtet, në kohën e bërjes palë kontraktuese në këtë Konventë, ose në çdo kohë pas kësaj, mund të deklarojë me anë të njoftimit të dhënë sekretarit të përgjithshëm që Konventa do të shtrihet në të gjitha ose ndonjë nga territoret për marrëdhëniet ndërkombëtare të cilave ai është përgjegjës, të përmendur në njoftimin e tij. Ky njoftim hyn në fuqi në 1 janar që bie të paktën dymbëdhjetë muaj, por jo më shumë se njëzet e katër muaj pas datës së marrjes së tij nga sekretari i përgjithshëm, përveç rasteve kur një datë më e hershme është specifikuar në njoftim. Megjithatë, kjo Konventë nuk zbatohet për territore të tilla para se të ketë hyrë në fuqi në shtetin në fjalë.

2. Kjo Konventë pushon së pasuri fuqi për një territor të caktuar në datën kur pala kontraktuese, pushon së qeni përgjegjëse për marrëdhëniet ndërkombëtare të atij territori ose më parë se një datë e tillë siç mund t'i jetë njoftuar sekretarit të përgjithshëm sipas procedurës së nenit 15.

Neni 15

Denoncimi

Kjo Konventë ka një kohëzgjatje të pakufizuar. Megjithatë, çdo palë kontraktuese mund ta denoncojë atë dhe një denoncim i tillë hyn në fuqi një vit pas marrjes së instrumentit të denoncimit nga ana e sekretarit të përgjithshëm, përveç kur një datë e mëvonshme është specifikuar atje.

Neni 16

Procedura e amendimit

1. Këshilli mund të rekomandojë ndryshime të kësaj Konvente për palët kontraktuese.

2. Çdo palë kontraktuese mund të njoftojë sekretarin e përgjithshëm për një kundërshtim mbi një ndryshim të rekomanduar dhe më pas mund ta tërheqë këtë kundërshtim brenda periudhës së specifikuar në paragrafin 3 të këtij neni.

3. Çdo ndryshim i rekomanduar konsiderohet të jetë pranuar gjashtë muaj pas datës së njoftimit të tij nga sekretari i përgjithshëm me kusht që të mos ketë asnjë kundërshtim të pazgjidhur në fund të kësaj periudhe.

4. Ndryshimet e pranuar hyjnë në fuqi për të gjitha palët kontraktuese në një nga datat e mëposhtme:

a) kur ndryshimi i rekomanduar është njoftuar para datës 1 prill, do të jetë data e 1 janarit të vitit të dytë pas datës së një njoftimi të tillë; ose

b) kur ndryshimi i rekomanduar është njoftuar në ose pas 1 prillit, do të jetë data e 1 janarit të vitit të tretë pas datës së një njoftimi të tillë.

5. Nomenklatura statistikore e çdo palë kontraktuese dhe nomenklatura e tarifës doganore, ose, në rastin e parashikuar në paragrafin 1 (c) të nenit 3, nomenklatura e kombinuar tarifore/statistikore, do të paraqiten në pajtim me sistemin e harmonizuar të ndryshuar në datën e specifikuar në paragrafin 4 të këtij neni.

6. Çdo shtet ose bashkim doganor ose ekonomik që ka nënshkruar pa rezerva, ratifikimin ose aderimin në këtë Konventë konsiderohen se kanë pranuar çdo ndryshim, të

cilat, në datën kur janë bërë një palë kontraktuese, kanë hyrë në fuqi ose janë pranuar në bazë të dispozitave të paragrafit 3 të këtij neni.

Neni 17

Të drejtat e palëve kontraktuese në lidhje me sistemin e harmonizuar

Në çdo çështje që ndikon në sistemin e harmonizuar, paragrafi 4 i nenit 6, nenit 8 dhe paragrafi 2 i nenit 16 do t'i japë të drejta një palë kontraktuese:

- a) në lidhje me të gjitha pjesët e sistemit të harmonizuar të cilat zbatohen sipas dispozitave të kësaj Konvente, ose
- b) deri në datën kur kjo Konventë hyn në fuqi në lidhje me të në përputhje me dispozitat e nenit 13, në lidhje me të gjitha pjesët e sistemit të harmonizuar për të cilat është e detyruar t'i zbatojë në atë datë sipas dispozitave të kësaj Konvente; ose
- c) në lidhje me të gjitha pjesët e sistemit të harmonizuar, me kusht që të ketë marrë përsipër zyrtarisht zbatimin e sistemit të harmonizuar të plotë gjashtëshifror brenda periudhës së tri viteve të referuara në paragrafin 5 të nenit 4 dhe deri në mbarimin e kësaj periudhe.

Neni 18

Rezerva

Asnjë rezervë nuk do të lejohet për këtë Konventë.

Neni 19

Njoftimet nga sekretari i përgjithshëm

Sekretari i përgjithshëm njofton palët kontraktuese, shtetet e tjera nënshkruese, shtetet anëtare të Këshillit që nuk janë palë kontraktuese në këtë Konventë, dhe sekretarin e përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, për sa vijon:

- a) Njoftimet sipas nenit 4;
- b) Nënshkrimet, ratifikimet dhe pranimet siç referohen në nenin 12;
- c) Datën në të cilën Konventa hyn në fuqi në përputhje me nenin 13;
- d) Njoftimet sipas nenit 14;
- e) Denoncimet sipas nenit 15;
- f) Ndryshimet e Konventës të rekomanduara sipas nenit 16;
- g) Kundërshtimet në lidhje me ndryshimet e rekomanduara në bazë të nenit 16 dhe, kur është e përshtatshme, tërheqjen e tyre; dhe
